

# MËSIMI NË DISTANCË

E-MËSIMI NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË,  
NË RRETHANAT E KRIJUARA NGA PANDEMIA COVID – 19







**MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NË ARSIMIN  
PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË, NË RRETHANAT E KRIJUARA  
NGA PANDEMIA COVID – 19**

Maj, 2020

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Për botuesin:**

Nezir Çoçaj, drejtor

**Ekipi hulumtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës**

**Udhëheqës i projektit hulumtues:**

Selim Mehmeti

**Korrektues gjuhësor:**

Bekim Morina

**Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

**Shtypi:**

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

## Falënderim

Ky studim u realizua nga Instituti Pedagogjik i Kosovës. Studimi nuk do të mund të realizohej pa bashkëpunimin, angazhimin dhe përkrahjen e të gjithë hulumtuesve që morën pjesë, si dhe pa mirëkuptimin dhe përkrahjen e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave, zyrtarëve arsimorë në DKA, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të dy zëvendësministrave të MASHTI-t.

Më këtë rast, falënderojmë të gjithë ata që përkrahën dhe mbështetën realizimin dhe përfundimin me sukses të këtij studimi. Në veçanti nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, të cilët iu përgjigjen pa asnjë hezitim këtij kërkesës për të qenë mostër e këtij studimi, si dhe ata që ndihmuan në informimin e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve.

Po ashtu, shprehim falënderim të veçantë për z. Arber Zylfiu, i cili, në mënyrë vullnetare dhe me përkushtim, dizajnoi dhe lansoi versionin elektronik të të tri instrumenteve të hulumtimit për plotësim nga mostra e studimit, përmes aplikacionit Google Forms.

Ky studim është produkt dhe kontribut i veçantë i IPK-së dhe stafit të tij, për mësimin në distancë/e-mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia Covid – 19.

## SHKURTESAT

<b>AP</b>	Aktivitet/Departamentet Profesionale
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>IA</b>	Inspektorati i Arsimit
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>KC</b>	Koordinatori i Cilësisë
<b>KDSH</b>	Këshilli Drejtues i Shkollës
<b>KEC</b>	Qendra për Arsim e Kosovës
<b>KKAP</b>	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
<b>KSNA</b>	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO)
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit.
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PISA</b>	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
<b>PSAK</b>	Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>PVV</b>	Plani Vjetor i Veprimit
<b>PZHSH</b>	Plani Zhvillimor i Shkollës
<b>SC</b>	Sigurimi i Cilësisë
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>UNICEF</b>	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

## **PËRMBAJTJA**

<b>Parathënie</b> .....	7
<b>Introduction</b> .....	10
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	13
Lista e tabelave.....	31
Lista e grafikëve.....	32
<b>HYRJE</b> .....	34
<b>I. PJESA E PARË</b> .....	37
<b>1.1. Arsimi në distancë</b>	
Bashkim Ali Azemi .....	37
<b>1.2. Përmbajtja mësimore e platformave ekzistuese online në Kosovë</b>	
Arbnesha Mexhuani .....	49
<b>1.3. Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë</b>	
Selim Mehmeti .....	57
<b>1.4. Ecuria e zhvillimi të mësimi në distancë në disa vende të BE-së dhe në vendet e Ballkanit</b>	
Murteza Osdautaj .....	75
<b>II. PJESA E DYTË</b> .....	103
<b>2.1. Metodologjia e studimit</b>	
Selim Mehmeti, Haxhere Zylfiu & Ismet Potera .....	103
<b>III. PJESA E TRETË - REZULTATET E STUDIMIT</b> .....	113
<b>3.1. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e drejtorëve të Institucioneve Arsimore</b>	
Agim Bujari & Bekim Morina .....	113

<b>3.2. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e mësimdhënësve</b>	
Haxhere Zylfiu, Amantina Pervizaj & Selim Mehmeti .....	129
<b>3.3. Mësimdhënia elektronike në distancë e-mësimi</b>	
Ismet Potera, Luljeta Shala & Selim Mehmeti.....	151
<b>3.4. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e nxënësve</b>	
Skender Mekolli & Zehrije Plakolli .....	173
<b>3.5. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e prindërve</b>	
Lirije Bytyqi, Mevlude Aliu & Safete Shala.....	193
<b>3.6. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e qendrave burimore</b>	
Sahare Reçica - Havolli.....	215
<b>3.7. Mësimi në distancë/e-mësimi nga perspektiva e grupeve të marginalizuara</b>	
Laura Lutfiu Hoxha.....	231
<b>3.8. Krahasimi i rezultateve dhe diskutimi i tyre</b>	
Selim Mehmeti, Amantina Pervizaj, Haxhere Zylfiu & Ismet Potera.....	249
<b>Referencat .....</b>	<b>271</b>



## Parathënie

Trajtimi dhe hulumtimi i tematikave të veçanta, me interes për nxënësit dhe sistemin arsimor, është një përpjekje e vazhdueshme e hulumtuesve të Institutit Pedagogjik të Kosovës. Edhe ky studim për mësimin në distancë, tani botim, trajton një tematikë të veçantë, si për nga rrethanat e organizimit të mësimin në distancë, ashtu edhe për nga koha e realizimit të hulumtimit, ndaj së cilës u reflektua edhe në punën hulumtuese në IPK.

Kur vendosëm të hulumtojmë dhe të trajtojmë këtë temë, ishin të shumta dyshimet dhe diskutimet se cilat do të jenë aspektet më të rëndësishme që do t'i trajtojmë, qasjet hulumtuese, organizimin e hulumtimit për të pasqyruar gjendjen reale të mësimin në distancë, dhe si mund t'u ndihmojnë institucioneve arsimore në këtë proces, sa kompleks aq edhe të ndjeshëm, për shkak të rrethanave të organizimit të mësimin në distancë.

Përvoja në hulumtime ndihmoi që hulumtimi të marrë drejtim, të shtrihet në një projekt të shpejtë të hulumtimit, të ndahen detyrat dhe përgjegjësitë e hulumtuesve dhe stafit të IPK-së dhe të operacionalizohen hapat që mund t'i bënim në këto rrethana, të cilët na mundësuan që brenda një afati të shpejtë të marrë drejtim trajtimi i objektit të hulumtimit, të hulumtohen aspektet e përcaktuara me prioritet në këtë fazë të mësimin në distancë dhe të dalim me këtë publikim të veçantë, me emërtim: *Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19.*

Nisma për realizimin e këtij studimi ishte arritja e qëllimit të përcaktuar nga IPK-ja, që të përshkruajë dhe të analizojë organizimin e mësimin në distancë/e-mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19. Po ashtu, të prezantojë përvojat aktuale të disa sistemeve arsimore të rajonit dhe më gjerë, të pasqyrojë efektivitetin e mësimin në kushtet e shtëpisë, format e mësimin në këto kushte, sfidat, mundësitë dhe nevojat për mbështetje, nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave. Pjesë e qëllimit të këtij studimi ishte edhe nxitja e dialogut në mes të komunitetit të shkollës, me qëllim përmirësimin e mësimin në distancë.

Në ndërlidhje me qëllimin, janë trajtuar dhe hulumtuar aspektet e përcaktuara për këtë studim, të cilat janë organizuar në tri pjesë, në kuadër të këtij botimi të veçantë, të cilit i paraprin një përmbledhje ekzekutive e zgjeruar, e cila përshkruan qasjen hulumtuese dhe sjell përfundimet kryesore të organizuara në katër tema kryesore, të bazuara në gjetjet e këtij studimi, dhe rekomandimet kryesore, të cilat do t'u shërbejnë MASHTI-it dhe institucioneve të tjera arsimore, si referencë për hapat e mëtejme në organizimin e mësimit në distancë në këto rrethana dhe për të ardhmen e kësaj qasjeje në mësimdhënie.

Pas hyrjes, e cila përshkruan kontekstin e mësimit në distancë në Kosovë, në pjesën e parë të botimit është trajtuar arsimi në distancë dhe teoritë e tij, si dhe karakteristikat e mësimdhënies dhe mësimit në distancë. Pastaj, është vazhduar me platformat online, me përmbajtje mësimore të bazuara në kurrikulën e Kosovës, si një komponentë e veçantë e mësimit në distancë, për të sjellë për lexuesin situatën që ka qenë para organizimit të mësimit në distancë, në rrethanat e pandemisë. Dy çështje tjera të trajtuara në pjesën e parë janë ecuria e zhvillimit të mësimit në distancë në disa vende të BE-së dhe në vendet e Ballkanit dhe mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë. Të dyja këto pjesë trajtojnë rrethanat në të cilat sistemet arsimore e kanë ndërprerë mësimin në shkolla, për shkak të rrethanave nga pandemia COVID-19 dhe kanë filluar organizimin e mësimit në distancë, masat kryesore që i kanë ndërmarrë sistemet arsimore, dokumentet dhe platformat mësimore të zhvilluara apo të riaktualizuara për rrethanat e mësimit në distancë në kushtet e shtëpisë, por edhe sfidat dhe problemet, me të cilat ballafaqohen sistemet arsimore.

Pjesa e dytë përshkruan metodologjinë e studimit, popullatën dhe mostrën sipas shtresave, metodat dhe instrumentet e hulumtimit, procedurën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, aspektin etik dhe kufizimet e studimit. Përgjigjja e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve në këtë studim ishte befasuese, përtej pritjeve në diskutimet fillestare për realizimin e këtij studimi, gjithsej 6051 respondentë nga komuniteti i shkollës ishin pjesë e këtij studimi. Për mbledhjen e të dhënave studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të përzier, sasiore dhe cilësore.

Pjesa e tretë është pjesa më e veçantë e këtij studimi. Kjo pjesë sjell argumente për përvojën e mësimit në distancë dhe drejtorëve të shkollave në mësimin online para situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, pastaj argumente, perceptime, ide dhe propozime për nivelin e informimit lidhur me organizimin e mësimit në distancë, pjesëmarrjen e nxënësve mësimit në distancë, prindërve, format dhe qasjet e mësimit në distancë, format e komunikimit dhe aplikacionet që përdoren gjatë mësimit në distancë. Gjithashtu, mbështetjen e të nxënësve nga mësimi elektronik që transmetohet përmes RTK dhe në kanalin e MASHTI-t në 'YouTube' dhe nga qasjet që i aplikojë mësimit në distancë, përparësitë, sfidat, problemet dhe mundësitë e organizimit të mësimit në distancë, gjithnjë nga perspektiva e nxënësve, mësimit në distancë, drejtorëve të shkollave, prindërve, por edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Perspektivat e përfaqësuesve të komunitetit shkollor janë pasqyruar të ndara në nënkapituj të pjesës së tretë dhe në një nënkapitull të veçantë janë bërë edhe krahasime. Në fund të secilit nënkapitull të pjesës së tretë të këtij botimi janë nxjerrë përfundime dhe rekomandime të bazuara në gjetje, me qëllim që lexuesit, studiuesit dhe referuesit e tyre, të jenë më të informuar për situatën e përshkruar, nevojat dhe mundësitë për mbështetje dhe studime më të thelluara.

Realizimi i qëllimit të këtij studimi del përtej përshkrimit të gjendjes së mësimit në kohë pandemie, duke sugjeruar kahe zhvillimore në koherencë me kohën.

I falënderojmë për zemërsisht nxënësit, prindërit, mësimit në distancë, drejtorët e shkollave, të cilët iu përgjigjën pa asnjë hezitim këtij studimi, si dhe të gjithë ata që ndihmuan në informimin dhe në mbledhjen e të dhënave për realizimin e këtij hulumtimi. Pa ndihmën e tyre nuk do të mund të bëhej hulumtimi dhe të dilte ky botim që po ua ofrojmë lexuesve.

Çdo sugjerim, kritikë dhe ndihmë tjetër në këtë fushë të studimit, IPK-ja e pret me kënaqësi, si formë të bashkëpunimit për përmirësimin dhe avancimin e arsimit kosovar.

Nezir Çoçaj, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës

## Introduction

The ongoing effort of researchers at the Kosovo Pedagogical Institute is treating and researching specific topics of interest for students and the education system. Also, this study on distance learning, now publication, treats a specific topic, both in terms of the organization of distance learning, and the timing of the research, which was reflected in the research work of KPI.

When we decided to research and treat this topic, there were many doubts and discussions about what would be the most important aspects we would address, research approaches, research organization to reflect the real situation of distance learning, and how they could help educational institutions in this process, as complex as it is sensitive, due to the circumstances of organizing distance learning.

The experience in research has helped the research take direction, expand into a fast-paced research project, share the tasks and responsibilities of researchers and KPI staff, and operationalize the steps we could take in these circumstances, which enabled us to direct the treatment of the research object within a short period of time, to examine the aspects defined with priority at this stage of distance learning and to come up with this special publication, entitled: *Distance learning / e-learning in pre-university education in Kosovo, in the circumstances created by the COVID- 19 pandemic.*

The initiative for conducting this study was to achieve the goal set by the KPI, to describe and analyze the organization of distance / e-learning in pre-university education in Kosovo in the circumstances created by COVID - 19 pandemic. Also, to present the current experiences of some educational systems in the region and beyond, to reflect the effectiveness of learning in home conditions, forms of learning in these conditions, challenges, opportunities and needs for support, from the perspective of students, parents, teachers and school leaders. Part of the purpose of this study was to promote dialogue among the school community, in order to improve distance learning.

In relation to the purpose, the defined aspects for this study have been treated and researched, and organized in three parts, within this special publication, which is preceded by an extended executive summary, which describes the research approach and draws conclusions organized in four main topics, based on the findings of this study, and the main recommendations, which will serve MEST and other educational institutions, as a reference for further steps in organizing distance learning in these circumstances and for the future of this teaching approach.

After the introduction, which describes the context of distance learning in Kosovo, in the first part of the publication is treated distance education and its theories, as well as the characteristics of distance learning and teaching. Then, it continued with online platforms, with teaching content based on the Kosovo`s curriculum, as a special component of distance learning, bringing to the reader the situation that was before the organization of distance learning, in the circumstances of pandemics. Two other issues treated in the first part are the progress of distance learning development in some EU countries and in the Balkan countries as well as distance / e-learning in pre-university education in Kosovo. Both of these sections treat the circumstances in which educational systems have discontinued teaching in schools, due to the circumstances of the *COVID-19 pandemic* and have begun organizing distance learning, the main measures taken by educational systems, developed or reactivated documents and teaching platforms for distance learning circumstances in home conditions, but also the challenges and problems faced by educational systems.

The second part describes the study methodology, population and sample by layers, research methods and instruments, data collection and analysis procedure, ethical aspect and study constraints. The response of teachers, students and parents in this study was surprising, beyond the expectations in the initial discussions for the realization of this study, a total of 6051 respondents from the school community were part of this study. For data collection, the study was conducted through a mixed, quantitative and qualitative research approach.

The third part is the most special part of this study. This section provides arguments for the experience of teachers and school principals in online learning before the situation created by COVID-19 pandemic, then arguments, perceptions, ideas and proposals for the level of information regarding the organization of distance learning, participation of students, teachers and parents, forms and approaches of distance learning, and forms of communication and applications used during distance learning. Also, supporting student learning from e-learning that is broadcast via RTK and on the MEST channel on YouTube and from the approaches applied from teachers, the advantages, challenges, problems and opportunities of organizing distance learning, always by the perspective of students, teachers, school principals, parents, and civil society representatives. The perspectives of the school community representatives are reflected separately in the subchapters of the third part and comparisons are made in a separate subchapter. At the end of each sub-chapter of the third part of this publication, based on findings are drawn conclusions and recommendations, in order the readers, researchers and their referrals to be more informed about the described situation, the needs and opportunities for support and more in-depth studies.

The realization of the purpose of this study goes beyond the description of teaching conditions in pandemic time, suggesting developmental directions in coherence with time.

We cordially thank the students, parents, teachers, school principals, who responded with no hesitation to this study, as well as all those who helped in informing and collecting data for the realization of this research. Without their help, research could not be done and this publication that we are offering to readers could not be published.

Every suggestion, criticism and other assistance in this field of study, KPI welcomes with pleasure, as a form of cooperation for the improvement and advancement of Kosovar education.

Nezir Çoçaj, director of the Kosovo Pedagogical Institute

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rrethanat e krijuara me pandeminë ndryshuan rrjedhën e proceseve normale në të gjitha poret e shoqërisë, pjesë e së cilave është edhe sistemi arsimor, prandaj edhe në IPK u reflektua një gjendje e tillë. Krahas proceseve dhe vendimeve që ndërmori MASHTI, një nismë në kuadër të këtij procesi e ndërmorën hulumtuesit e IPK-së: organizimin e hulumtimit, me qëllim të pasqyrimin të gjendjes, sfidave, por edhe nxjerrjen e mësimëve për të ardhmen e nxënësve, mësimdhënësve dhe të vetë sistemit arsimor. Mobilizimi ishte i menjëhershëm, në të cilin u përfshi, me angazhime të veçanta, stafi hulumtues.

Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të përzier, sasiore dhe cilësore. Mbledhja e të dhënave sasiore është realizuar përmes pyetësorëve online, me nxënës, mësimdhënës dhe prindër, të cilat u përdorën më pas si bazë për të analizuar situatën aktuale dhe për të zhvilluar analiza krahasuese. Ndërsa, në kuadër të metodave cilësore, hulumtimi është realizuar përmes intervistave dhe pyetësorëve me drejtorë të shkollave, mësimdhënës, prindër, nxënës, me një mostër prej 6051 respondentëve, si dhe përmes protokollit për vëzhgimin e orëve të e-mësimit në RTK dhe analizës së tyre.

**Qëllimi i studimit** - Për këtë studim u vendosën disa qëllime: (i) të përshkruajë dhe të analizojë organizimin e mësimit në distancë dhe *e-mësimit* në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19, përfshirë edhe përvojat aktuale të disa sistemeve arsimore të rajonit dhe më gjerë; (ii) të pasqyrojë efektivitetin e mësimit në kushtet e shtëpisë, format e mësimit në këto kushte, sfidat, mundësitë dhe nevojat për mbështetje, nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave; dhe (iii) të nxitet dialogu në mes të komunitetit të shkollës dhe më gjerë, me qëllim përmirësimin e mësimit në distancë.

Rekomandimet do t'u shërbejnë MASHTI-t dhe institucioneve të tjera arsimore, si referencë për orientimin dhe për përshtatjen e politikave në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive për realizimin e mësimit në distancë, për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe organizimit cilësor në

të gjitha hallkat e sistemit arsimor, në funksion të mësimdhënies dhe nxënies cilësore për të gjithë nxënësit.

Realizimi i qëllimit të këtij studimi del përtej përshkrimit të gjendjes së mësimdhënies në kohë pandemie, duke sugjeruar kahe zhvillimore në koherencë me kohën.

### **Disa nga rezultatet kryesore të hulumtimit**

Në fokus të hulumtimit ishin analiza e politikave dhe vendimeve aktuale, të cilat kishin të bënin me situatën dhe ndërmarrjen e hapave në kohën e pandemisë; realizimi i e-mësimit nëpërmjet TV-së dhe këndvështrimi i komunitetit të shkollës për efektivitetin e mësimin në kushtet e shtëpisë; format e mësimin në këto kushte, sfidat, mundësitë dhe nevojat për mbështetje; si dhe mësimet nga organizimi i mësimin në distancë dhe e-mësimin.

Referuar këtyre aspekteve, që ishin në fokus të studimit, të gjeturat janë përmbledhur në katër tema kryesore.

#### **1. Masat e ndërmarra për organizimin e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë**

Mbi bazën e gjetjeve të studimit për masat e ndërmarra për organizimin e mësimin në distancë, në arsimin parauniversitar në Kosovë, përfundimet kryesore janë si në vijim:

- Përgatitjet për vazhdimin e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar nuk kanë qenë të lehta, për shkak të rrethanave nga pandemia COVID-19 dhe për shkak se sistemi nuk ishte i përgatitur për një modalitet të tillë të mësimin dhe të mësimdhënies;
- Masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse kanë qenë tejet të shpejta, të centralizuara, por shumica janë në përputhje me rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19 dhe nevojat për të siguruar qasje në mësim për të gjithë fëmijët e Kosovës;



- Masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse janë të përafërta me ato të rajonit, të cilat lidhen me nxjerrjen e vendimeve për ngritjen e mekanizmave për menaxhimin e mësimin në distancë, nxjerrjen e udhëzimeve dhe udhëzuesve për ndarjen e detyrave, përgjegjësisë dhe modalitetet e organizimit të mësimin, zhvillimin e platformave online, si dhe me angazhimin e televizioneve publike si transmetues zyrtarë të mësimin në distancë për arsimin bazë;
- Mësimi në distancë në Kosovë në kushtet e pandemisë, si edhe në shumicën e vendeve të rajonit, ka filluar me sfida të shumta, për shkak të rrethanave, kontekstit dhe përgatitjes paraprake të sistemit. Fillimi i transmetimit të orëve mësimore përmes transmetuesit publik RTK, më 23 mars, është vlerësuar i shpejtuar, por që ka mobilizuar gjithë komunitetin e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe shoqërisë dhe ka mundësuar vazhdimin e vitit mësimor/shkollor;
- MASHTI, me përkrahjen e DKA-ve, të Prishtinës dhe të Prizrenit, në mënyrë të veçantë me përkrahjen e mësimdhënësve të këtyre komunave dhe shkollave (SHFMU “Qamil Batalli” në Prishtinë dhe SHFMU “Emin Duraku” në Prizren), ka arritur të përgatisë dhe të transmetojë materiale mësimore/ video-ligjëratat, në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake;
- Edhe pse MASHTI ka lejuar që çdo person fizik ose juridik, që u përmbahet kushteve të përcaktuara, t’i përdorë, t’i publikojë ose t’i transmetojë video-ligjëratat e shfaqura në RTK dhe kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’ te publiku, përmes çfarëdo lloj mënyre, forme apo formati që ka në dispozicion, një gjë e tillë nuk është shënuar të këtë ndodhur në televizione tjera private dhe lokale, ashtu siç është duke ndodhur në vende të ndryshme, për të siguruar qasje sa më të gjerë në mësimin në distancë, përfshirë edhe grupet e marginalizuara;
- MASHTI ka zhvilluar dhe publikuar shtatë dokumente (udhëzues dhe vendime) për realizimin e mësimin në distancë, në arsimin parauniversitar në Kosovë, dhe ka lansuar dy platforma mësimore online, platformën e parë online në Kosovë “Edukimi në distancë -

Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç” dhe platformën e dytë “Arsimi gjithëpërfshirës”;

- Në përgjithësi, dokumentet e hartuara për mësimin në distancë, në rrethanat e pandemisë, e kanë fokusin në detyrat dhe përgjegjësitë institucionale dhe të komunitetit arsimor përkatës, në realizimin e mësimin në distancë, dhe një pjesë e tyre janë të përshkruara me udhëzime për mësimdhënës;
- MASHTI, në dokumentet e zhvilluara, nuk detajon udhëzime për zbatimin e kurrikulës, përcaktimin e përmbajtjeve mësimore/temave kryesore që duhet të realizohen gjatë mësimin në distancë, ose për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Kjo ka bërë që mësimi në distancë të vazhdojë nga aty ku është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë, për shkak të pandemisë COVID-19, dhe mësimdhënësit shpesh t’i ngarkojnë nxënësit me detyra e angazhime, në përpjekje për të realizuar planin dhe programin mësimor;
- Referuar realitetit, pasi mësimi në distancë është sfidë edhe për prindërit, dokumentet e para kanë farë pak orientime, këshilla dhe udhëzime për punën e prindërve dhe përmbushjen e rolit të tyre gjatë mësimin në distancë. Ato janë plotësuar në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë, të publikuar një muaj pasi që ka filluar mësimi në distancë. UNESCO ka prodhuar materiale të shkurtra vizuale dhe lehtë të kuptueshme për elemente të ndryshme të mësimin në distancë në periudhën e pandemisë, përfshirë edhe për këshillim të prindërve, se si t’i motivojnë fëmijët e tyre gjatë mësimin në distancë;
- Në udhëzuesit e MASHTI-it ka mungesë të informatave për nxënës, me sugjerime dhe udhëzime se si duhet t’u qasen mësimëve dhe detyrave gjatë kohës së mësimin në distancë, si të bashkëpunojnë me prindërit e tyre, mësimdhënësit dhe bashkëmoshatarët, për zhvillimin e mësimëve dhe projekteve që ndihmojnë zhvillimin e kompetencave kryesore, si të menaxhojnë orarin e mësimin dhe angazhimin të tyre në mësim. Kjo më shumë ka mbetur përgjegjësi e

shkollave, mirëpo as shkollat nuk janë sugjeruar të bëjnë një gjë të tillë dhe nuk janë udhëzuar si ta bëjnë;

- Sfida kryesore mbeten cilësia e mësimit në distancë, përfshirë cilësinë e video-materialeve dhe cilësinë e qasjeve të mësimdhënies që i praktikojnë mësimdhënësit gjatë mësimit në distancë, pastaj vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimdhënësit dhe të nxënësit (familjet), mungesa e kushteve shkollore në shtëpi, mospjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara dhe familjet me kushte të rënduara;
- Shumica e organizatave të shoqërisë civile, që punojnë me fëmijë të grupeve të marginalizuara, me gjithë vështirësitë, kanë arritur të përshtaten dhe të ofrojnë shërbime edhe në situatën e shpërthimit të COVID-19. Qendrat rezidenciale, që përkujdesen për fëmijët e braktisur dhe ata në strehimore të viktimave të dhunës në familje, me angazhim maksimal të stafit dhe të mësimdhënësve, arrijnë ta mbajnë me sukses mësimin në distancë.

Si përfundim, mësimi në distancë, në këto rrethana, është një mundësi e mirë për të mbajtur të mobilizuar fëmijët, për të shpërqendruar vëmendjen e tyre nga aktualiteti i epidemisë etj. Po ashtu, është një mundësi e mirë për të mësuar për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, për modalitetin e mësimit në distancë, dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimit online në sistemin arsimor të Kosovës, i cili duhet të jetë në shërbim të të gjithë fëmijëve në Kosovë dhe në diasporë.

## **2. Mësimdhënia elektronike në distancë**

Sipas Carroll, A., Forlin, C. dhe Jobling, A. (2003), mësimdhënësit kanë nevojë të kenë besim në aftësinë e tyre dhe të kenë njohuri dhe aftësi në arsimin gjithëpërfshirës, për të përmbushur sfidat, me të cilat ata përballen në klimën aktuale në shkollë. Këto nevoja u reflektuan edhe gjatë mësimdhënies elektronike në distancë. Mësimdhënësit që punojnë në klasa dhe nivele të ndryshme të arsimit parauniversitar, të cilët u angazhuan në

mësimdhënien elektronike, në distancë, treguan besim, u mobilizuan dhe dhanë maksimumin që të mbahet gjallë procesi mësimor në arsimin bazë.

Procedura e përcjelljes dhe vëzhgimit të e-mësimit ndodhi çdo ditë kur transmetimi bëhej në RTK (nga datat 01-20 prill). Objekt i vëzhgimit ishin: metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies si dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës.

Përveç vëzhgimit të e-mësimit, gjithsej 100 orë mësimore dhe 50 mësimdhënës, të klasave 1-5 dhe 6-9, edhe 20 mësimdhënësve ua dërguam një pyetësor me 5 pyetje të hapura për të marrë mendimin e tyre lidhur me sfidat dhe çështjet tjera rreth organizimit të kësaj forme të mësimdhënies, për herë të parë nga ana e tyre dhe në vend. Kërkuam mendimin edhe nga tre zyrtarë të kurrikulës në MASHTI, por nuk morëm përgjigje në pyetjet e dërguara.

Për nxjerrjen e përfundimeve për mësimdhënien elektronike, iu referuam aspekteve që ishin objekt i vëzhgimit të orëve mësimore, video-ligjëratave të shfaqura në: *metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies, si dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës.*

- E-mësimi, me gjithë vështirësitë, ka krijuar mundësinë që mësimdhënësit e angazhuar të tregojnë dhe të dëshmojnë se mësimdhënia përmes e-mësimit është një mundësi që duhet shfrytëzuar. Qasja e mësimdhënësve të angazhuar në e-mësimin është përmirësuar dhe po i përshtatet ngadalë realitetit të e-mësimit;
- Promovimi i qasjes së të nxëniet nëpërmjet teknologjisë është në koherencë me kohën, por edhe me parimet bazë të kurrikulës. Të gjendesh në situata të këtilla, të papritura, siç ishte pandemia, flet për një qasje mundësuese për të gjithë nxënësit, pa dallim, për vitalitetin dhe entuziazmin shoqëror dhe për besim e aftësi të mësimdhënësve për t'i kontribuar sistemit;
- Shumica e mësimdhënësve që punojnë në shkollimin fillor (1-5) janë të sistemit të njëjtë të përgatitjes së tyre, këtë më së miri e tregon

ngjashmëria në mësimdhënie dhe përafërsia e shkathtësive metodike të tyre;

- Dallimi ndërmjet mësimdhënësve lëndorë dhe mësuesve qëndron në dy rrafshë: të parët - lëndorët shfaqin njohje më të thelluar të lëndës, tregojnë siguri dhe qartësi në sqarimin e përmbajtjeve, ndërsa të dytët - mësuesit (1-5) veçohen për qasje metodike, përdorim të teknikave dhe shembujve më të përshtatshëm për të kuptuarit e përmbajtjes të njësisë mësimore që shtjellonin;
- Dy grupe kryesore të mësimdhënësve u identifikuan: me përgatitje profesionale-pedagogjike të mira dhe me përgatitje profesionale-pedagogjike të dëshirueshme;
- Qasja e mësimdhënies elektronike në distancë është e lidhur më shumë me përmbajtjen e teksteve shkollore. Kjo tregohet me shembujt, pyetjet, detyrat dhe me qasjen e mbarështrimit të orëve mësimore;
- Harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës reflektohet të jetë një nga sfidat kryesore të mësimin në distancë;
- Pjesa më e madhe e lëshimeve dhe mangësive, të evidentuara në orët mësimore nga e-mësimi, ndërlidhen me nivelin e ngarkesës, presionin kohor dhe kushtet teknike, me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit gjatë xhirimit të video-materialeve, por edhe me sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve, si dhe me shkathtësitë metodike, profesionale e pedagogjike, të një numri mësimdhënësish.

### **3. Mësimi në distancë nga perspektiva e komunitetit të shkollës (nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave)**

Mësimi në distancë ishte një sfidë e re për gjithë komunitetin shkollor, në mënyrë të veçantë për nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave. Për këtë, në studim kemi përfshirë një mostër të nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave, duke siguruar të dhëna të rëndësishme qysh në fazën e tanishme të zbatimit të mësimin në distancë/e-mësimin.

Përfundimet kryesore, mbi bazën e gjetjeve të studimit, janë si në vijim:

- Mësimi online dhe e-mësimi para pandemisë kishin qasje të kufizuar nga mësimdhënësit, përjashtim bëjnë mësimdhënësit e disa shkollave që kanë qenë pjesë e ndonjë projekti ose programi për mësim online dhe mësimdhënësit që kanë praktikuar mësimin online me vetiniciativë;
- Kompetenca digjitale raportohet të jetë e kufizuar. Rreth 42% mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave nuk kanë ndjekur asnjë program aftësimi për përdorimin e TIK-ut dhe të materialeve mësimore online në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies. Kjo ishte sfida kryesore në realizimin e mësimin në distancë, sepse, me mungesë të kompetencës digjitale, në mësimin në distancë nuk mund të krijohet ndërveprimi social, i cili, sipas studiuesve, është çelësi për pedagogji efektive në internet;
- Udhëzimet e publikuara nga MASHTI-i (e-mësimi), për organizimin e mësimin në distancë dhe informacionet për orarin javor të transmetimeve të orëve mësimore në RTK, kishin efekt pozitiv në informimin e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave. Megjithatë, procesi i informimit është përshkruar me dallime. Nxënësit dhe prindërit, përfshirë edhe ata të grupeve të marginalizuara, deklaruan se nuk ishin mirë të informuar. Edhe informacionet për një pjesë të mësimdhënësve (rreth 30%) ishin tejte të shpërndara dhe të paqarta, apo të pamjaftueshme për realizimin e mësimin në distancë;
- Për nxënësit nga grupet e marginalizuara, RTK-ja është burimi kryesor dhe shpesh i vetmi i të mësuarit në distancë. Si i tillë, është i dobishëm, sidomos për familjet me gjendje të rënduar ekonomike, por kanalet e RTK-së jo gjithmonë janë të qasshme, qoftë për shkak të mungesës së televizorëve apo sinjalit të transmetimit;
- Sipas përfaqësuesve të komunitetit shkollor, mobilizimi i aktorëve kryesorë: nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve, ishte i lartë. Në një kohë të shkurtër u bë mobilizimi i këtyre aktorëve, gjë që tregon dëshirën e tyre për të ruajtur vazhdimësinë e vitit mësimor. Nga 80% e gjithë komunitetit të shkollës, të përfshirë në studim, fillimi i mësimin

në distancë është pritur me qetësi, interesim, gatishmëri, por edhe me mobilizim për angazhim;

- Nxënësit nga grupet e marginalizuara janë ballafaquar me shqetësim dhe stres, kryesisht për shkak të pamundësisë teknike për ndjekjen e mësimin në distancë, si pasojë e mungesës së pajisjeve të nevojshme;
- Pajisjet kryesore të komunikimit, që janë duke i përdorur mësimdhënësit dhe nxënësit për mësim në distancë/e-mësim, kryesisht janë telefoni i mençur (rreth 90%) dhe laptopi (rreth 70%). Probleme të theksuara janë evidentuar në familjet e nxënësve që kanë disa fëmijë në shkollë dhe nuk është arritur të harmonizohen oraret e mësimin, si dhe në familjet e grupeve të marginalizuara;
- Pavarësisht që ka kaluar mbi një muaj nga fillimi i mësimin në distancë, rreth 8% e nxënësve janë shprehur se akoma nuk kanë filluar të mbajnë mësim në distancë me mësimdhënësit e tyre, apo janë në përgatitje për të filluar. Ndërsa, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave konfirmojnë se rreth 10% e nxënësve nuk marrin pjesë në mësimin në distancë. Kjo konfirmohet edhe në raportet javore të disa DKA-ve, që i dërgojnë në fund të javës në MASHTI. Te disa mësimdhënë, në disa lëndë, mospjesëmarrja e nxënësve në mësim është e lartë dhe kjo krijon pabarazi, që pritet të reflektohet në suksesin e nxënësve dhe të ardhmen e tyre. (Sipas intervistave me mësimdhënë, disa nxënës po e shohin si obligative pjesëmarrjen në mësimin online vetëm në lëndët që po emetohen në TV). Nxënësit nga familjet me gjendje të rënduar ekonomike theksojnë se po mbesin mbrapa nxënësve të tjerë, të cilët i kanë mundësitë dhe pajisjet e duhura të përcjellin mësimin në distancë;
- Ditët e punës të mësimdhënësve gjatë mësimin në distancë janë të ndryshme. Edhe sa i përket kohës së angazhimit (orëve të mësimin) në një ditë, që mësimdhënësit e kalojnë me nxënësit, në forma të ndryshme të mësimin në distancë/e-mësimin, ka dallime të theksuara. Në anën tjetër, një pjesë relativisht e madhe e nxënësve kanë deklaruar se janë të ngarkuar me detyra dhe angazhime dhe nuk marrin informata kthyesë të mjaftueshme nga të gjithë mësimdhënësit;

- Informatat kthyesë nga mësimdhënësit, për detyrat e bëra nga nxënësit, janë alternativë e rëndësishme së veçantë në kushtet e mësimit në distancë, përmes së cilave sigurohen mbështetja e të nxënësve të nxënësve, motivimi për mësim dhe nxitja për angazhim të mëtijmë gjatë mësimit në distancë, por edhe për vlerësimin e përparimit të tyre.
- Format e punës së mësimdhënëseve me nxënës gjatë mësimit në distancë janë të shumta dhe të ndryshme. Mësimi në distancë, në kushtet e shtëpisë, kërkon që format e punës së mësimdhënëseve të balancohen në raport me kohën e kontaktit të drejtpërdrejtë me nxënës dhe në raport me përmbajtjet mësimore thelbësore, që duhet të zhvillohen gjatë mësimit në distancë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen tej mase;
- Me gjithë gatishmërinë dhe mobilizimin e shprehur për angazhim në fillimet e mësimit në distancë, pjesa më e madhe e respondentëve nga shkollat ndajnë mendim të njëjtë sa u përket vështirësive, me të cilat janë duke u përballur gjatë realizimit të mësimit në distancë /e-mësimit, si: adaptimi me këtë formë të mësimit, përdorimi i aplikacioneve për mësim në distancë, mungesa e përmbajtjeve mësimore online - në përputhje me kurrikulën, interneti i dobët, realizimi i plan-programit mësimor, detyrat e shtëpisë etj.;
- Te nxënësit e grupeve të marginalizuara, vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e pajisjeve të TI për nxënës. Shumë familje nuk kanë asnjë laptop, tablet ose kompjuter, e shpesh disa fëmijë në një familje e kanë vetëm një telefon të mençur në dispozicion për mësim në distancë;
- Rreth 30% e prindërve vështirësitë për përfshirje dhe angazhim në mësimin në distancë të fëmijëve të tyre i ndërlidhin me mosfunksionimin e orarit të mbajtjes së mësimit në distancë përmes platformave online dhe formave tjera që i aplikojnë mësimdhënësit. Platformat online për komunikim përdoren shpesh edhe nga nxënësit e grupeve të marginalizuara, por shoqërohen me probleme shitesë, si mungesa e pajisjeve adekuate;
- Komunikimi i rregullt mësimdhënës–nxënës, mësimdhënës–prindër dhe anasjelltas, si dhe mundësia e sqarimeve dhe informatave kthyesë,



është dobia kryesore e formave shtesë të punës gjatë mësimit në distancë, si për nxënësit ashtu edhe për prindërit e tyre. Komunikimi i mësimeve me nxënës bëhet kryesisht për detyra, ndërsa format tjera të punës interaktive janë më të rralla, kryesisht për shkak të numrit të madh të nxënësve për mësime, sidomos atyre lëndorë, pajisjeve në përdorim dhe kompetencës digjitale të mësimeve;

- Ekziston pajtueshmëri e përfaqësuesve të komunitetit shkollor se orët mësimore që po shfaqen në RTK po i ndihmojnë nxënësit dhe se interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar përmes mësimit në distancë është në nivel. Duke marrë parasysh vështirësitë e nxënësve nga grupet e marginalizuara, përfshirë edhe qasjen në RTK, këta nxënës kanë nevojë për angazhim shtesë të mësimeve dhe prindërve të tyre, për të komunikuar me ta në baza të rregullta;
- Gjithashtu, ekziston një vlerësim i përbashkët i gjithë komunitetit shkollor se mësimi në distancë është një përvojë e re, e cila duhet përkrahur;
- Vazhdimi i mësimit në distancë dhe përmirësimi e avancimi i tij lidhen me nevojat për mbështetje të nxënësve dhe mësimeve që nuk kanë pajisje digjitale, ose qasje në TV dhe internet, për të ndjekur mësime. Nevoja për mbështetje profesionale, me trajnime për mësime dhe udhëzues për prindër dhe nxënës, për digjitalizimin e mësimit (platforma online, video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) edhe në lëndët mësimore që nuk mbulohen me RTK dhe në nivelin e tretë të arsimit, si dhe inovacion të sistemit arsimor, atij profesional dhe jo vetëm;
- Mësimi në distancë u mundëson prindërve të nxënësve nga grupet e marginalizuara të përfshihen më shumë në procesin e mësimit të fëmijëve të tyre, përfshirë ballafaqimin dhe trajtimin e problemeve, me të cilat përballen.

#### **4. Mësimet nga organizimi i mësimimit në distancë dhe e-mësimimit**

Organizimi ‘aksidental’ i mësimimit, ndryshimi i detyrueshëm i qasjes së mësimdhënies dhe të nxënimit, në kushte pandemie globale, për shumë shoqëri, edhe për ne, ishte një mësim i ri, prandaj nevojitet përfshirja e të gjithëve për të bërë punë të vlefshme, siç është organizimi i shkollimit në këso rrethanash.

Duke analizuar pjesëmarrjen dhe përgjigjet e dhëna nga aktorët kryesorë: nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe udhëheqësit e institucioneve arsimore, duhet nxjerrë mësimet në vijim për ta bërë më funksional dhe më të qëndrueshëm sistemin arsimor. Mësimet kryesore nga ky proces ishin: mobilizimi institucional, i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, nevoja për teknologji dhe zotërimin e saj, nevoja për ndryshime në sistemin e qasjes ndaj zhvillimit profesional të mësimdhënësve, nevoja për ndryshimin dhe avancimin e përgatitjes së mësimdhënësve në fakultet, nevoja për plotësimin e shkollave me pajisje të teknologjisë mësimore, nevoja për avancimin dhe promovimin e bashkëpunimit me prindër, nevoja për promovimin e bashkëpunimit ndërkolegial brenda dhe jashtë shkollës, nevoja për ndërtimin e institucionit të përgjegjësive dhe të llogaridhënies. Po ashtu, ndryshimi i sistemit të gradimit/diferencimit dhe të motivimit të mësimdhënësve, përfshirja e profesionistëve në hartimin e politikave arsimore, fuqizimi dhe promovimi i mekanizmave vertikalë dhe horizontalë për rritjen e cilësisë dhe të sasisë së bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kryesorë në kuadër të sistemit, sidomos ndërmjet mësimdhënësve dhe mësimdhënësve me prindër.

Sipas Jonathan Zimmerman (2020), mësimi në distancë, në këto rrethana, nuk është eksperiment në edukim. Është testim/provim i demokracisë sonë, gjithashtu.

Mund të konstatohet se sfida e organizimit të mësimimit në distancë në kushte pandemie globale paraqet një SWOT-analizë të funksionimit të sistemit arsimor dhe të mekanizmave përbërës të tij. Këtë duhet marrë në konsideratë në të ardhmen, jo vetëm në rrethanat e organizimit ‘aksidental’ të mësimimit, por edhe në rrethanat normale.

## **Rekomandimet kryesore**

Sipas K. Holly Shiflett (2020), një përvojë negative mund të shkaktojë një ndjenjë të frazës "kurrë më". Që të mos pësohet me një zhgënjim dhe venitje të punës gjatë mësimit në distancë, nevojitet sinergji ndërmjet gjithë faktorëve subjektivë të mësimit, mekanizmave të institucioneve arsimore dhe të profesionistëve pedagogjikë/arsimorë.

Rekomandimet nga ky studim do të ndihmojnë MASHTI-in dhe institucionet tjera arsimore, për të marrë masat e nevojshme, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive për realizimin e mësimit në distancë dhe në ngritjen e cilësisë së vazhdueshme të tij, në funksion të mbështetjes së të nxëniet të të gjithë nxënësve.

## **Rekomandimet për MASHTI-in dhe DKA-të janë si në vijim:**

- MASHTI, mbi bazën e evidencave të siguruara nga DKA-të dhe shkollat, për mësime dhënësit, nxënësit/familjet nga grupet e marginalizuara dhe me kushte të rënduara ekonomike, që nuk kanë pajisje bazike të teknologjisë informative, të gjejë mënyrat e pajisjeve të tyre, përmes sigurimit nga buxheti publik apo nëpërmjet krijimit të mekanizmave institucionalë për të nxitur dhurime nga donatorët privatë;
- MASHTI dhe DKA-të, në rast se nuk mund t'i pajisin mësime dhënësit me mjete bazike të teknologjisë informative, të analizojnë si mundësi hapjen e shkollave për mësime dhënësit dhe shfrytëzimin e pajisjeve ekzistuese në sholla (kompjuterët, laptopët, internetin), si dhe të hapësirave të shkollës në dispozicion, për përgatitjen dhe mbajtjen e mësimit në distancë nga ana e mësime dhënësit. Kjo mund të sigurojë edhe një koordinim më të mirë ndërmjet mësime dhënësit dhe aktiveve profesionale, për detyrat drejtuar nxënësve dhe aspektet tjera që lidhen me mësimin në distancë.
- Në periudhë afatshkurtër, konsiderohen si të rëndësishme mbledhja e saktë e të dhënave për të gjithë nxënësit që nuk marrin pjesë në mësimin në distancë dhe zhvillimi i një plani e programi pune për mënyrën e përfshirjes së tyre në mësime në distancë, si dhe për mënyrën e mësime dhënies për këtë grup të nxënësve me rastin e kthimit në shkollë;

- MASHTI të angazhojë ekipe të psikologëve dhe të pedagogëve që punojnë me fëmijë dhe të rinj me vështirësi në sjellje emocionale, pasi që, në mungesë të ambientit të duhur për përkujdesje, mund të kenë sfida dhe probleme që nuk mund të menaxhohen nga prindërit e tyre;
- MASHTI, DKA-të dhe shkollat duhet që t'u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të nxënësve dhe prindërve, për mbështetje dhe motivim të nxënësve gjatë mësimit në distancë, përfshirë edhe përgatitjen e udhëzimeve apo letrave informative të shkurtra dhe vizuale, që lidhen me angazhimin dhe motivimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë;
- MASHTI, në bashkëpunim me DKA dhe partnerët që mbështesin arsimin, të ofrojë udhëzues dhe trajnime për mësimdhënës lidhur me mënyrat dhe format e zbatimit të platformave dhe aplikacioneve online në procesin e mësimit në distancë. Nisur nga fakti që është vërejtur, se në përgjithësi ngarkesa e punës së mësimdhënësve është rritur, trajnimet në këtë fazë nuk duhet të jenë të detyrueshme;
- MASHTI të vazhdojë praktikën e suksesshme të udhëzimeve për përdorim të platformës ZOOM edhe me udhëzime tjera për përdorim të platformave online, si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit dhe prindërit e tyre, për të nxitur sa më shumë ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet fëmijëve dhe mësimdhënësve të tyre, sidomos për fëmijët nga grupet e marginalizuara;
- MASHTI të ndajë fonde emergjente për organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për fëmijët nga grupet e marginalizuara, me procedura të përsheptuara dhe me qëllim të ofrimit të menjëhershëm të shërbimeve bazë, që ndihmojnë procesin e mësimit në distancë.
- MASHTI të hartojë dhe të shpërndajë udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e tyre, lidhur me evitimin e abuzimeve online, në formate të kuptueshme dhe lehtë të qasshme, të nxisë raportimin e rasteve eventuale dhe të trajtojë me seriozitetin maksimal rastet e raportuara;
- Mësimi në distancë të shoqërohet me udhëzime për një sistem të qëndrueshëm monitorimi, raportimi dhe vlerësimi, që procesi të

përmirësohet dhe të arrihen qëllimet e mësimin në distancë, siç janë mirëqenia e fëmijëve dhe mbështetja e të nxënimit të tyre;

- Në periudhë afatshkurtër, konsiderohet e domosdoshme që MASHTI, me të gjitha institucionet arsimore të lidhura me mësimin në distancë, të zhvillojë një platformë se si do të zhvillohet mësimi në ditët dhe javët pas pandemisë, si do të priten nxënësit, në mënyrë që pritja e tyre të jetë e ngrohtë dhe e menaxhuar mirë;

### **Rekomandimet për mësimdhënësit e angazhuar në përgatitjen e video-ligjëratave për mësimdhënie elektronike në distancë:**

- Mësimdhënia në distancë, përkatësisht përgatitja video-materialeve dhe skenarit për njësinë mësimore, duhet të shoqërohet me udhëzime për mësimdhënësin. Para transmetimit të orëve mësimore, të shikohen xhirimet dhe të eliminohen gabimet e mundshme teknike e gjuhësore, sidomos kërkohet kujdes i shtuar në evitimin e gabimeve shkencore;
- Gjatë mësimdhënies përmes e-mësimin, përshtatshmëria, koherenca e përmbajtjeve dhe qasjes mësimdhënëse me parimet dhe kërkesat kryesore të kurrikulës së bazuar në kompetenca (KKK, 2016) të jenë të dukshme dhe praktike në video-materialet që transmetohen;
- Detyrat e shtëpisë, që jepen nga mësimdhënësit e ndryshëm të një klase, të harmonizohen, në mënyrë që të mos ngarkohen nxënësit tej mase në këto rrethana të mësimin. Ato duhet të jenë të orientuara drejt arritjes së një qëllimi të caktuar mësimor, drejt arritjes së rezultateve të të nxënimit të lëndës/temës mësimore dhe në funksion të arritjes së kompetencave. Të shmangen detyrat që kryesisht kanë riprodhim të njohurive dhe përmbajtjeve të dhëna në tekstet shkollore të lëndës përkatëse, sepse nuk e nxisin nxënësit për të mësuar në distancë;
- Vëmendje të veçantë nga mësimdhënësit duhet kushtuar aspekteve që lidhen me shkathtësitë komunikuese, korrektësinë e shprehjeve, përgatitjen e skenarit për njësinë mësimore, përdorimin e gjuhës standarde, dhe lidhjen e mësimin me jetën e përditshme të fëmijëve.

## **Rekomandimet për udhëheqës të shkollave dhe për mësime:**

- Shkollat të sigurohen që të gjithë nxënësit marrin pjesë në mësimin në distancë dhe të gjithë mësime të vazhdojnë t'i kryejnë detyrimet e veta profesionale, duke u fokusuar në lehtësimin e realizimit të mësimit online. Me mbështetje të DKA-ve dhe MASHTI-t, të shqyrtohen mundësitë e mbështetjes së nxënësve për të qenë pjesë e mësimit në distancë dhe mësime të tjerë që t'i ushtrojnë përgjegjësitë e veta;
- Në nivel shkollor dhe të aktiveve profesionale, të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse rreth mësimit në distancë brenda kësaj periudhe, të identifikohen anët e mira, vështirësitë, sfidat dhe ngeçjet. Të merren masat që mund të zbatohen në kushtet e mësimit në distancë, duke përfshirë mbështetjen e kolegëve që zotërojnë në nivel më të ulët kompetencën digjitale, trajnimet kolegjiale online, shkëmbimin e materialeve, dhe formave të tjera që mund të aplikohen në këto rrethana;
- Të zhvillohen materiale mësimore digjitale ndërvepruese, nga mësime të arsimit të mesëm të lartë, dhe të bëhet ngarkimi me platforma që mund të përdoren nga kolegët e tyre, për klasë dhe drejtime të njëjta;
- Pavarësisht ngarkesës që kanë mësime të realizimit të mësimit në distancë, në rrethanat e pandemisë, përfshirja e trajnimeve mbi aftësitë digjitale për mësime do të ndikojë në zvogëlimin e ngarkesave që lidhen nga mungesa e kompetencës digjitale;
- Mësime të gjatë zhvillimit të mësimit në distancë, kujdes të veçantë t'u kushtojnë mirëqenies dhe angazhimit të nxënësve, të tregojnë kujdes në ngarkesën me detyra dhe mos të vendosin në fokus realizimit të planit mësimor, i cili nuk mund të realizohet në kushtet e mësimit në distancë. Mësime të ofrojnë më shumë informata kthyesë për detyrat e bëra nga nxënësit, meqenëse përmes tyre sigurohen mbështetja e të nxënësve, motivimi për mësim dhe nxitja për angazhim të mëtejshëm gjatë mësimit në distancë;
- Shkollat të japin informacione me kohë për prindërit dhe t'i shpërndajnë në faqet zyrtare të shkollave dhe përmes mësime të bashkëpunojnë me mësime në distancë. Ndërsa, mësime të bashkëpunojnë me

prindër dhe të ofrojnë edhe informata kthyesë për angazhimin, detyrat dhe përparimin e fëmijëve të tyre;

- Dokumentimi i procesit të mësimit në distancë, i vlerësimit të përparimit të nxënësve dhe raportimi, janë kërkesa që duhet të plotësohen nga të gjitha shkollat;
- Në nivel të secilës shkollë të rishikohen format e bashkëpunimit me prindër dhe komunitetin në përgjithësi, në funksion të avancimit të cilësisë së punës së shkollës, duke i bërë ata aktorë dhe pjesë të përgjegjësisë në arsim. Si dhe të punohet më shumë për ndërgjegjësimin e nxënësve, për rolin e tyre në procesin e të nxënësve dhe në avancimin e proceseve në nivel shkolle.

### **Rekomandimet për nxënës dhe prindër:**

- Sugjerohet për kujdes të shtuar në përdorimin e teknologjisë informative gjatë mësimit në distancë. Përdorimi me orar i laptopit gjatë mësimit në distancë, gjithnjë me kujdesin për të larguar varësinë nga telefoni, është një sugjerim për nxënës, por edhe për prindër;
- Me prioritet nevojitet përgatitja dhe mbajtja e një orari ditor të nxënësit për mësim në shtëpi, si parakusht për shpërndarje të ngarkesës ditore, menaxhim të mirë të ditës dhe për angazhim dhe efikasitet në mësim;
- Për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin në mësim, konsiderohen me rëndësi të veçantë angazhimi dhe bashkëpunimi i nxënësve me mësimdhënësit, prindër dhe bashkëmoshatarë;
- Prindërit duhet t'u përmbahen udhëzimeve të MASHTI-t, që gjatë mësimit në distancë të jenë shumë më të angazhuar me fëmijët sesa gjatë mësimit të rregullt.
- Prindërit nuk duhet të paragjykojnë sjelljet e fëmijëve të tyre në rrethanat e pandemisë COVID-19, por t'i kuptojnë ata, përtej çdo paragjykimi, dhe t'i motivojnë në mënyrë të vazhdueshme për pjesëmarrje dhe angazhim në mësimin në distancë. Në kushtet e tanishme, qëllimet primare të vlerësimit janë mirëqenia e fëmijëve dhe nxitja e të nxënësve.

## **Rekomandimet afatmesëme për sistemin arsimor**

Në periudhë afatmesme, konsiderohen të domosdoshme zhvillimi dhe vendosja e standardeve për mësimin online, zhvillimi dhe vendosja e platformave online që përmbajnë kërkesat standarde të kurrikulës, dhe udhëzime për shkollat lidhur me mësimin online.

Gjithashtu, në periudhën afatmesme, konsiderohet e domosdoshme që të hartohet platforma kombëtare për transformimin digjital të shkollave dhe të arsimit, e cila duhet të shihet si një detyrim i dalë nga mësimet e kësaj periudhe të mësimin në distancë dhe nevojat për të ofruar edukim cilësor për të gjithë fëmijët.

Institucionet duhet të përgatiten për integrimin e mësimin online në sistemin arsimor të Kosovës.

Në raport me zhvillimin e mësimdhënësve dhe të mësimdhënies, rekomandohet që:

- 1. Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha nivelet e shkollimit parauniversitar në Kosovë;*
- 2. Të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së zbatimit dhe sfidave të KK të ri, me theks në cilësinë e përgatitjes së mësimdhënësve për këtë aspekt, cilësinë e trajnimeve dhe të informatave që kanë lidhur me kërkesat dhe qasjet e zbatimit të KK;*
- 3. Të rishikohen të gjitha politikat dhe programet e zhvillimit profesional të vazhdueshëm, të vlerësimit të performancës dhe të licencimit e gradimit të mësuesve;*
- 4. Politikat e regjistrimit të kandidatëve për mësimdhënës të harmonizohen me kahet e zhvillimeve në arsim, në vend dhe më gjerë.*
- 5. Të vendosen politika të qarta lidhur me rëndësinë/ domosdoshmërinë e përdorimit të teknologjisë në funksion të mësimdhënies dhe të nxënit, si burim i pazëvendësueshëm i njohurive;*

Realizimi i këtyre rekomandimeve do të ishte mësimi më i mirë nga gjendja që imponoi realizimin e-mësimin, e cila nxori në pah edhe nevojat e shumta për intervenim në sistem. Duke u bazuar në mësimet e dala nga ky proces, është një mundësi e mirë për t'u dhënë kahe politikave të zhvillimit të sistemit arsimor në të gjitha poret e tij.



## Lista e tabelave

<i>Tabela 1.</i>	<i>Mostra sipas gjinisë, vendit të shkollës, nivelit të arsimit publik dhe shkollave private</i>	<i>107</i>
<i>Tabela 2.</i>	<i>Numri i pyetjeve për mostrën e përzgjedhur</i>	<i>109</i>
<i>Tabela 3.</i>	<i>Përdorimi i platformave mësimore para COVID-19 sipas moshës së mësimdhënësve</i>	<i>130</i>
<i>Tabela 4.</i>	<i>Vështirësitë në përdorimin e platformave në mësimin në distancë sipas moshës së mësimdhënësve</i>	<i>131</i>
<i>Tabela 5.</i>	<i>Informimi për organizimin e mësimin në distancë /E-mësimi (%)</i>	<i>132</i>
<i>Tabela 6.</i>	<i>Vështirësitë e mësimdhënësve për realizimin e Mësimin në distancë dhe përkrahja për tejkalimin e vështirësive (%)</i>	<i>138</i>
<i>Tabela 7.</i>	<i>Informatat kthyesë dhe udhëzimet lidhur me mësimet dhe detyrat mësimore</i>	<i>185</i>
<i>Tabela 8.</i>	<i>Nevojat më të mëdha për mbështetje të nxënësve për realizimin e mësimin në distancë</i>	<i>188</i>

## Lista e grafikëve

Grafiku 1.	Zbatimi i aplikacioneve online para pandemisë COVID-19	130
Grafiku 2.	Platformat/aplikacionet e përdorura për mësimin në distancë	134
Grafiku 3.	Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve online në arsimin e obliguar	134
Grafiku 4.	Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve online në arsimin e mesëm të lartë	135
Grafiku 5.	Koha e angazhimit të mësimit në distancë sipas ditëve në javë dhe orëve të angazhimit për një ditë	136
Grafiku 6.	Përfshirja e nxënësve në forma të mësimin në distancë/e-mësimin sipas mësimit në distancë	137
Grafiku 7	Format e punës me nxënës në kuadër të Mësimin në distancë	138
Grafiku 8	Ndihma nga orët e shfaqura në RTK dhe përfshirja e nxënësve në orët mësimore të shfaqura në RTK	140
Grafiku 9	Bashkëpunimi ndërkolegial në mes të mësimit në distancë dhe bashkëpunimi me prindër	141
Grafiku 10	Kërkesat e mësimit në distancë për mbështetje teknike	143
Grafiku 11	Kërkesat e mësimit në distancë për mbështetje profesionale	144
Grafiku 12	Informacionet për organizimin e mësimin në distancë	174
Grafiku 13	Koha e angazhimit gjatë ditës në mësimin në distancë	178
Grafiku 14	Format e punës që mësimit në distancë aplikojnë gjatë mësimin në distancë /e-mësimin	180
Grafiku 15	Vështirësitë, me të cilat nxënësit përballen gjatë realizimit të mësimin në distancë	183
Grafiku 16	Vlerësimi i procesit të mësimin në distancë	187
Grafiku 17	Kohë në ditë që kalojnë fëmijët duke mësuar	197
Grafiku 18	Sa po ndihmojnë të nxënësit e fëmijëve orët mësimore që po shfaqen në RTK?	200

<i>Grafiku 19</i>	<i>Ndihma e orëve mësimore nga RTK-ja</i>	260
<i>Grafiku 20</i>	<i>Ndihma e udhëzimeve të mësimdhënësve</i>	261
<i>Grafiku 21</i>	<i>Interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar gjatë mësimit në distancë</i>	262
<i>Grafiku 22</i>	<i>Komunikimi dhe bashkëpunimi mësimdhënës/prindër - prindër/mësimdhënës</i>	263
<i>Grafiku 23</i>	<i>Vlerësimi i përgjithshëm për situatën aktuale të mësimit në distancë</i>	266

## HYRJJE

Zhvillimi i platformave digjitale për përdorim në procesin mësimor Ministria e Arsimit, Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), vite më parë, e ka prezantuar si prioritet me interes dhe si mundësi të mirë për zbatim të kurrikulës së re. Mirëpo, kjo nuk është arritur të bëhet përmes një sistemi, i cili do të ofronte mundësi, qasje dhe përdorim të lehtë nga të gjithë.

Në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19, është ndërprerë mësimi në të gjitha nivelet e sistemit tonë arsimor dhe u paraqit nevoja për organizimin e mësimin në distancë/ e- mësimin, për të gjithë nxënësit e Kosovës. Në përgjigje të rrethanave të krijuara, MASHTI, ashtu si sistemet tjera arsimore në Evropë dhe më gjerë, menjëherë ka filluar punën rreth organizimit të procesit të mësimin në distance/e-mësimin.

Me mbështetje të disa operatorëve ekonomikë, nga fusha e ICT-së, mediave dhe ofruesve të shërbimeve arsimore, si dhe bazuar në kapacitetet infrastrukurore dhe ekspertizës profesionale, MASHTI ka krijuar platformën për mësimin online në Kosovë <https://emesimi.rks-gov.net> dhe janë duke u publikuar materialet mësimore të hartuara nga mësimdhënës dhe ekspertë të angazhuar. Gjithashtu, është krijuar edhe vegëza për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’ dhe materialet janë organizuar sipas klasave. Transmetimi i këtyre materialeve bëhet në orare të caktuara edhe në Radio Televizionin e Kosovës - RTK1 dhe RTK4 (ritransmetim).

Për realizimin me sukses të mësimin në distancë, MASHTI ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e nivelit qendror (MASHTI-t), DKA-ve, shkollave dhe mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, si dhe u ka kërkuar që të vazhdojnë obligimet profesionale të gjitha instancave dhe individëve të sistemit arsimor kosovar (MASHTI, 2020 a), duke përfshirë edhe përvojat e mira të realizimit të mësimin online nga programe dhe platforma që janë lejuar nga MASHTI për institucionet arsimore publike, si School Me, Projekti e-edukimi etj.

Për ta hulumtuar nivelin e organizimit dhe zbatimit të mësimin në distancë/e-mësimin në fazën fillestare të tij: përgatitjet, efektin, sfidat, mundësitë dhe nevojat për mbështetje për këtë formë të mësimdhënies, Instituti Pedagogjik

i Kosovës ka marrë iniciativë të realizojë këtë hulumtim. Qëllimi i këtij hulumtimi është të mbështetet nisma e MASHTI-t, duke siguruar të dhëna nga komuniteti arsimor (drejtues të shkollave, mësime, nxënës dhe prindër) qysh në fazën e tanishme të zbatimit të mësimit në distancë/e-mësimit dhe të përvijohen rekomandime për institucionet arsimore, si referencë për ndryshim dhe për përshtatjen e politikave në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi për realizimin e mësimit në distancë.

**Parashtrimi i problemit të studimit.** MASHTI, nga viti 2009, ka bërë përpjekje për integrim të TIK-ut në mësime dhe atë përmes dokumenteve strategjike dhe disa projekteve, të financuara nga fondet qeveritare dhe nga donatorët e ndryshëm. Në mesin e këtyre projekteve vlen të përmenden projekti për trajnim të mësimeve në programin ECDL, projekti i Bashkimit Evropian për mësime elektronike, Programi Bazik i Arsimit, Projekti e-edukimi, projekti me KEC për platformën School Me etj.

Edhe në PSAK 2017-2021 MASHTI ka përfshirë aktivitete, të cilat do të mundësonin shfrytëzimin e pajisjeve të TIK-ut dhe të platformave digjitale në procesin mësimor. Në kuadër të objektivës së pestë strategjike të PSAK 2017-2021, që u referohet mësimeve dhe të nxënësve, MASHTI ka paraparë disa aktivitete, të cilat do të mundësojnë shfrytëzimin e teknologjisë digjitale në procesin mësimor, si: trajnimin e mësimeve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike, sigurimin e rrjeteve lokale që mbulojnë hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor në shkollë, sigurimin e qasjes në internet për të gjitha shkollat etj. (MASHTI, 2016). Mirëpo, kjo nuk është arritur të bëhet në mënyrën se si është planifikuar, edhe pse një gjë e tillë kërkohet edhe me Krrukulën e re.

Në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19, MASHTI është shtyrë që të fillojë organizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, në përpjekje për të ofruar mësime për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë. Me qëllim që të mbështetet nisma e MASHTI-t dhe të rritet cilësia e mësimit në distancë/e-mësimit, nevojiten studime të shumta në këtë fushë, duke përfshirë kontekstin vendor dhe përvojat e disa sistemeve arsimore në rajon dhe më gjerë. Këtë e ka si orientim edhe studimi mbi mësimin në distancë/e-mësime në arsimin parauniversitar në Kosovë, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19.

## **Qëllimi i studimit.**

Qëllimet e këtij studimi ishin: (i) të përshkruajë dhe të analizojë organizimin e mësimit në distancë dhe *e-mësimit* në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID–19, përfshirë edhe përvojat aktuale të disa sistemeve arsimore të rajonit dhe më gjerë; (ii) të pasqyrojë efektivitetin e mësimit në kushtet e shtëpisë, format e mësimit në këto kushte, sfidat, mundësitë dhe nevojat për mbështetje, nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve, mësimitdhënësve dhe drejtuesve të shkollave; dhe (iii) të nxitet dialogu në mes të komunitetit të shkollës dhe më gjerë, me qëllim përmirësimin e mësimit në distancë. Rekomandimet do t’u shërbejnë MASHTI-t dhe institucioneve të tjera arsimore, si referencë për orientimin dhe përshtatjen e politikave në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive për realizimin e mësimit në distancë, për ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe të organizimit cilësor në të gjitha hallkat e sistemit arsimor, në funksion të mësimitdhënies dhe nxënies cilësore për të gjithë nxënësit.

## **Pyetjet kërkimore.**

Hulumtimi synon t’u përgjigjet këtyre pyetjeve kërkimore:

- *Çfarë është duke ofruar sistemi në Kosovë për realizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, në arsimin parauniversitar, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19, dhe cilat janë përvojat e vendeve të rajonit?*
- *Çfarë është niveli i informimit, përgatitjes dhe organizimit të mësimit në distancë, si dhe çfarë është mbështetja e të nxënësve përmes e-mësimit?*
- *Cilat janë sfidat kryesore të zbatimit të mësimit në distancë në rrethanat aktuale?*
- *Çfarë është përfshirja e nxënësve në mësimin në distancë me mbështetje të mësimitdhënësve, a ka dallime të theksuara në nivele të arsimit, zona urbane dhe rurale, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe grupeve të marginalizuara?*
- *Cilat janë pritjet dhe mundësitë e zbatimit të mësimit në distancë për një kohë më të gjatë?*

# I. PJESA E PARË

## 1.1. ARSIMI NË DISTANCË

Bashkim Ali Azemi

Arsimi në distancë, me ndihmën e teknologjive, e ka fillimin me shpikjet themelore të elektricitetit dhe në teorinë e fushës elektromagnetike.

Në shekullin XX kërkesat në rritje për komunikim çuan në teknologji të reja, mjete të komunikimit për largësi të mëdha dhe shumë të mëdha. Ndërkohë që ne ecim nëpërmjet epokës së teknologjisë së informacionit, arsimi nuk mund të jetë imun ndaj këtyre ndryshimeve. Tashmë komunikimi në distancë ka marrë një përmbajtje të re edhe në fushën e mësimdhënies.

Fillet e arsimit në distancë i gjejmë në shekullin XX, përkatësisht në vitin 1963, kur ish- kryeministri i Anglisë, Wilson, kishte hedhur idenë e krijimit të “universitetit në ajër”. Me shpikjen e internetit, mundësia për të analizuar, vlerësuar e komunikuar mesazhe, në një larmi të madhe formash, fillon përfshirja e kompjuterëve në veprimtaritë mësimore, e mësimdhënies së përshkruar me teknologji. Brenda pak vjetësh, mësimdhënia e menaxhuar nga kompjuteri dhe mësimdhënia e ndihmuar nga kompjuteri po shtohen gjithnjë e më shumë, nga fakti se të gjitha mënyrat e mësimdhënies në shekullin 21 shfrytëzojnë ndonjë mjet teknologjie.

Brenda pak vjetësh, teknologjia kompjuterike për përdorime arsimore, mësimdhënies së përshkruar në teknologji, ka marrë një shtrirje të jashtëzakonshme. Po kështu mundësitë për mësimdhënien e ndihmuar nga kompjuteri po shtohen gjithnjë e më shumë (Willams, 200).

### **Teoritë për arsimin në distancë**

Për përkufizimi e mësimin në distancë disa autor përqendrohen në mësimdhënie (organizimi dhe drejtimi i mësimdhënies), e disa te nxënia nga nxënësi (përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive, si dhe vetëkontrolli dhe vetëvlerësimi), por që të dyja përkufizimet janë të ndërlidhura si procese. Në literaturë e gjejmë si arsimi në distancë, mësimi në distancë, mësimi

elektronik (e-learning), etj. Siç mund të shihet emërtimet kanë dallime sa u përket definicioneve. Disa prej tyre po i pasqyrojmë në pjesën në vijim.

**Arsim në distancë** është mënyrë arsimimi ku pjesa më e madhe e procesit mësimor kryhet kur mësuesi dhe nxënësi nuk janë zakonisht në të njëjtin vend, në të njëjtën kohë, dhe realizohet kryesisht me ndihmën e teknologjisë së komunikimit.

**Mësimdhënia në distancë** është mënyrë e arsimimit, e cila realizohet përmes teknologjive moderne të komunikimit dhe mësimit elektronik, me qëllim të mësuarit e nxënësve të vendosur në vende dhe largësi të ndryshme - jashtë ambientit tradicional të mësimit në shkollë dhe klasë. Kjo qasje arsimore është përshkruar si "proces i krijimit dhe ofrimit të qasjes për mësimnxënie kur burimi i informacionit dhe nxënësit janë të ndarë nga koha apo distanca, ose të dyja" (Honeyman, M. & Miller, G,1993), si pasojë e arsyeve të përgjithshme ose specifike të nxënësit.

**Mësimi elektronik (e-learning)** është mënyra e re e të mësuarit, e mundësuar nga teknologjia e komunikimit. Ai u referohet përdorimit të pajisjeve elektronike dhe teknologjive të sotme në proceset e mësimdhënies dhe nxënies (Gjokutaj, Hoti & Kadriu, 2016).

Përdorimi i teknologjive moderne të edukimit, gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies, nënkupton përdorimin e pajisjeve të ndryshme elektronike, si laptop, tablet e smartphone, të llojeve të ndryshme, dhe softuerë të ndryshëm, në mënyrë shumë produktive. Shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të nxënies dhe po ashtu përdorimin e platformave të ndryshme elektronike (Sharma & Sharma, 2006).

Referuar studiuesve Cattagni dhe Farris (2000), mësimi elektronik (e-learning) njihet edhe si mësim hibrid në internet dhe do të jetë një nga teknologjitë më të rëndësishme të mësimit. Tani, shumë institucione arsimore, në nivele të ndryshme të arsimit dhe në vende të ndryshme gjithandej botës, përdorin platforma të ndryshme mësimore për të mbështetur të nxënies.



Programet dhe platformat e mësimi në distancë ua mundësojnë mësimdhënësve dhe nxënësve të ndërveprojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet mjeteve kompjuterike, internetit, platformave të ndryshme, telefonave smartë, radiove, televizioneve dhe teknologjive të tjera.

*E-learning* është “mësimi i së nesërme”. Në këtë aspekt kemi të bëjmë me një perspektivë të re. “Nuk është më përdoruesi që shkon drejt informatës, por është informata që plasohet në bazë të njohurive të përdoruesit” (Tedesco & Falcioni, 2007).

Rrjeti i internetit tashmë ka një ndikim të veçantë në jetën e përditshme, në pjesëmarrjen sociale dhe politike, në mënyrat e njohjes, në identitetin tonë. Tashmë nëpërmjet *e-learning* ose *online learning*, por edhe *online education*, materiali i mësimi mund të ofrohet në çdo vend dhe kurdo, qoftë për të shtuar aftësitë për kompjuter, gjuhë apo matematikë, apo për arsimin gjatë gjithë jetës për të gjithë nxënësit.

### **Mënyrat e realizimit të arsimit në distancë**

*Arsimi në distancë* është proces i mësimdhënies nga largësia, që realizohet nga mësimdhënësi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, në mënyrë **sinkrone**, si grupe trajnimi virtuale, komunikime në kohë reale (chat), platformën ZOOM dhe vidiokonferencat, ku të gjithë nxënësit, në të njëjtën kohë, marrin pjesë në diskutim dhe përfitojnë nga diskutimi në grup me nxënësit e tjerë. Interaksioni personal është i rëndësishëm për një klasë online. Platforma online u lejon nxënësve të “dëgjojnë” pyetjet dhe përgjigjet, u ndihmon të gjithëve të kuptojnë më mirë dhe i inkurajon që të parashtrojnë pyetje tjera, si dhe në mënyrë asinkrone, ku secili nxënës ka qasje në mësimin elektronik, si e-mail, programe interneti ndëraktive dhe shkarkimi i materialeve audio ose video, por kohën e inkuadrimit e përcakton vetë dhe punon sipas ritmit të tij, pra nuk e ndien presionin e kohës.

Të mësuarit online në distancë, përveç në mënyrë sinkrone dhe asinkrone, ofrohet edhe si mësim hibrid (i përzier), alternim i mësimi të drejtpërdrejtë dhe atij online, me ndërmjetësimin e teknologjisë, ku mësimdhënësi dhe

nxënësit ndodhen në largësi një pjesë të kohës. Kjo mënyrë praktikohet në arsimin profesional dhe arsimin e lartë tanimë në disa vende evropiane.

Përdorimi i mësimit online, duke zgjedhur midis alternativave të ndryshme (mësimi online sinkron, asinkron dhe i përzier) nga potencialet e teknologjisë aktuale, lejon krijimin e një ambienti të nxënies për një numër të madh të nxënësve, duke i shkarkuar problemet e ballafaquara në distanca gjeografike dhe duke u përfshirë në një pjesëmarrje shumë të lartë interaktive.

### **Karakteristikat e mësimdhënies dhe mësimit në distancë**

Arsimi në distancë ka disa karakteristika të ndryshme nga arsimi i drejtpërdrejtë (ballë për ballë), në këtë punim do të mundohemi t'i theksojmë disa elemente të veçanta, të cilat e lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në distancë.

Disa nga karakteristikat e të nxënies elektronike ndërlidhen me transmetimin e përmbajtjes mësimore dhe procesin e të nxënies nga nxënësi, dhe si ndryshon mësimdhënia në largësi gjatë transmetimit të njohurive me ndihmën e teknologjisë, në krahasim me mësimdhënien e drejtpërdrejtë. Mësimdhënia në internet mund të variojë nga përdorimi i burimeve multimediale që nxirren nga arkivat digjitale, deri në kurset e plota mësimore (Freebody & Muspratt, 2007).

Arti i mësimdhënies konsiston në rezistencën ndaj formulave (sidomos në arsimin në largësi), andaj mësimdhënësit përdorin qasje të ndryshme gjatë procesit mësimor dhe ofrojnë orientime koherente e jokohërente (s'ka shabllon të orës mësimore) gjatë ndihmës për të mësuar nxënësit. Detyra e secilit mësues në arsimin në distancë është që të arrijë të gjejë mënyrë më të mirë për të përdorur teknologjinë, si dhe metodat dhe teknikat mësimore si nxitëse gjatë mësimdhënies në largësi.

Mësimdhënësi është mundësuesi në arsimin në distancë, pa mësimdhënësin nuk ka mësimdhënie, andaj mësimdhënia në distancë është veprimtari aktive dhe jo funksion teknik, edhe pse nga largësia. Mësimdhënësit ndihmojnë nxënësit online, me ndihmën e teknologjive të komunikimit, e këshillojnë

dhe i japin ide nxënësit në lidhje me objektivat e tij, njëkohësisht duke trajnuar atë, në mënyrë që të mësojë i pavarur.

Shkolla (mësonjëtorja) nuk është vendi, mjedisi, i vetëm ku nxënësi mëson. Mësimi me ndihmën e mjeteve teknologjike mund të realizohet edhe nga shtëpia, gjegjësisht nga mësimi në distancë, nëse ai realizohet mirë, me udhëheqjen dhe ndihmën e mësimdhënësit (të nxënët), përfitimet duhet të ishin të njëjta. Mësimi në distancë i referohet nxënësit, pjesëmarrjes së tij në të mësuar, pavarësisht rrethanave ku ndodhet (vendi ku mëson, ambientit familjar) në procesin mësimor, me ndihmën e teknologjive, si veprimtari aktive dhe jo si funksion teknik, edhe pse nga largësia.

Pra, është mësimdhënësi ai që njohuritë të nxënësit i bartë me ndihmën e teknologjive bashkëkohore të komunikimit, (nuk japin mësim klasik të drejtpërdrejtë në mësonjëtorë, por mësimdhënie me ndihmën e teknologjive nga largësia), planifikojnë dhe organizojnë mësimin, mbështesin dhe përfshijnë nxënësit në bashkëbisedim të vazhdueshëm, japin sqarime, duke mundësuar të kuptuarit e njohurive të reja dhe gjithashtu me anë të teknikave vlerësuese bëhet vlerësimi i performancës së nxënësve.

**Mjedisi i të nxënët në internet është shumë i veçantë, për shkak të mundësisë për të ndryshuar kohën e dhënies dhe vendin e dhënies së mësimt, krahasuar me mësimdhënien tradicionale (Jury, 2004).**

Gjatë realizimit të të nxënët elektronik, duhet të merret parasysh fakti se administrimi dhe konfigurimi dinamik i programit, si dhe aftësia për të nxënët bashkëpunues midis përdoruesve nga mësimdhënësi duhet të përfshijnë gjithashtu testimet online, korrigjimet online, monitorimin online, mbështetje për pyetjet, zgjedhjen e imazheve për mbështetje të pyetjeve, si dhe kontroll në hartimin dhe paraqitjen e programit.

Komunikimi asinkron midis mësimdhënësit dhe nxënësit, transferimi i përmbajtjes, dërgimi i detyrave, komunikimi me e-mail, vlerësimi, si dhe mbështetja gjatë mësimt janë gjithashtu karakteristike të mësimt në distancë. Megjithatë, mësimdhënia elektronike në internet po zhvillohet me shpejtësi dhe tani kemi në dispozicion mjetet e njëkohshme (sinkronike).

Mundësitë për të bërë gjykime në lidhje me përvojat e të mësuarit dhe realizimi i pritshmërive përfshihen në përvojën e të nxënësve, ngase koha është e shkurtër për shembuj nga mësimdhënësi. Nxënësve gjatë procesit të arsimit në distancë mësojnë më shpejt të përdorin monitorimin, vetëgjykimin dhe vetëkontrollin gjatë zgjidhjes së detyrave të reja.

Mësimdhënësit u shërbejnë më mirë nxënësve, duke i motivuar ata, në vend që të organizojnë mësimin në formën riprodhuese të njohurive, duke përdorur të nxënësve elektronik, **nxënësve mësojnë përmes hapave të njëpasnjëshëm në ndërtimin dhe përshtatjen e modelit të tyre.** Mësimdhënësia nuk mund të përbëhet thjesht nga të treguarit. Ajo duhet të përfshijë pjesëmarrjen aktive të nxënësve, sepse ajo përpunohet, mësohet (Tomlinson & Kalbfleisch, 1998). Kjo është pikërisht ajo çfarë ofron të nxënësve elektronik.

**Personalizimi i programeve mbi nevojat e nxënësve,** duke përdorur copëza të informacionit dhe transformim të teksteve mësimore tradicionale, ku përdoruesi lexon përmbajtjen nga një ekran në vend të fletës së librit, ku nxënësi është në gjendje të klikojë mbi një fjalë të panjohur për të gjetur më pas përkufizimin nga një faqe me të cilën lidhet (link), ose përdor një video për të parë një dukuri apo proces që kërkon ta mësojë. Janë karakteristikat kryesore, por jo të vetmet.

Mësimdhënësi përdor **qasje metodologjike në monitor, të transmetuara me ritëm të ngadaltë, për t'u mundësuar nxënësve në procesin e të nxënësve të kuptojnë në detyra dhe t'u përgjigjen pyetjeve që u kërkojnë.** Duke përdorur mësimin me bazë kompjuterin, procesin e mësimit e drejton mësimdhënësi. Ai gjatë tërë kohës mund të pyesë, të ridrejtojë pyetjet, të përsëritë dhe të inkudrojë nxënësve gjatë mësimit, të lavdërojë dhe të inkurajojë përgjigjet nga nxënësve. Të nxënësve bëhet më i përshtetshëm me përdorimin e kompjuterit në proces.

**Të nxënësve me ritëm personal,** së bashku me aftësinë për të përsëritur dhe për të marrë drejtime të ndryshme të të nxënësve, bazuar në kushtet paraprake, e bën të nxënësve potencialisht të realizueshëm për qëllimin e largët dhe ka më pak gjasa të dështojë.

**Qasja online po ashtu hap mundësinë për komunikim me mësuesin dhe njëkohësisht shfrytëzim të qasjeve në dokumentacione, harta, grafike dhe përmbajtje nga kompjuteri, të cilat ndihmojnë në reflektim nxënësin, nëse mësimitdhënësi arrin të diskutojë me nxënësit detyrat e përfunduara. Kjo i jep gjallëri të nxënimit online.**

Zgjidhja e materialit mësimor dhe **hartimi i programit për arsim në distancë ka rol vendimtar në efektivitetin e mësimitdhënies në distancë**, ngase aty duhet të kihet parasysh roli i mësimitdhënësit, nxënësit, mundësitë për reflektim, përzgjedhje personale, një rol të ndryshëm të mësimitdhënësit gjatë shpjegimit, që orientohet drejt mbështetjes së nxënësit dhe jo thjesht dhe vetëm transmetimit të njohurive.

Hartimi i mirë i përmbajtjes në të nxënimit elektronik ka nivele të larta të ndërveprimit. Nëse ky ndërveprim është i përshtatshëm, në mënyrë të ndjeshme rrit cilësinë e kujtesës, sepse ka mundësi për të rritur nivelin e stimulimit dhe ndërveprimi potencialisht mund të kryhet në nivele më të larta të përfshirjes kognitive. **Natyra e të nxënimit elektronik është i çliruar nga kufizimet artificiale të orarit të një programi.** Kjo do të thotë se është një element përforcues. Fakti që një përvojë e të nxënimit elektronik mund të përsëritet sipas kërkesës është një përparësi tjetër e këtij lloji të nxënimit.

Fatkeqësisht, ka një braktisje midis grupit të vijuesve të të nxënimit elektronik. Problemi kryesor qëndron në mërzitjen e nxënësve dhe largimin nga programi, sidomos në mjedise komplekse të të nxënimit dhe shkaku për këtë është motivimi. Mësimitdhënësi duhet t'i motivojë nxënësit gjatë mësimitdhënies në vend që të organizojnë mësimin në formën riprodhuese të njohurive. Në pajtueshmëri me pritshmëritë e nxënësve, kjo do të thotë se u jepet më shumë kënaqësi atyre për përmbushjen e detyrave.

### **Programet dhe pajisjet teknologjike për aplikim e arsimit në distancë**

Hartimi i programeve për arsimin në distancë është një punë goxha komplekse, e cila bëhet nga specialistë të mësimitdhënies, të cilët konsultohen me ekspertët e TI-së për përgatitjen e mënyrës së përcjelljes së njohurive, shkathësive dhe shprehive të nxënësit.

Programet e mësimit në distancë kërkojnë ekipe për përgatitjen e materialeve, ekspertë të mësimdhënies dhe ekspertë në lëndët akademike për përgatitjen e tyre, të cilët duhet të hartojnë përmbajtjet lëndore sipas moshës, synimit dhe zbatimit, si dhe të bëhet përshtatja e tyre me mësimin elektronik të integruar. Këta ekspertë planifikojnë, përpunojnë, krijojnë faqe të internetit e sekuenca mësimore dhe përputhin mënyrat e vlerësimit online për nxënësit.

Për të hartuar një program të arsimit në distancë duhet një personel mësimdhënësish të aftë dhe me përvojë, si dhe një staf mbështetës i specializuar për çështje të arsimit në distancë. Kompjuterët tashmë përmes internetit janë mjete të vlefshme mësimore që mundësojnë programe për nxënien në distancë përmes pajisjeve dhe platformave të ndryshme. “Mësimet mund të shpërndahen në formë të dokumenteve dhe aplikacioneve multimediale, duke i dhënë hapësirë për qasje në një formë inovative kujt do që kyçet në rrjet” (Tedesco & Falcioni, 2007).

Një program i arsimit në distancë për t’u realizuar nga një mësimdhënës dhe IT duhet të mbështetet nga instrumentet dhe pajisjet teknologjike, ku përfshihen tabela, projektori, audiot dhe videot, krahas testit, duke stimuluar vëmendje më të madhe mbi argumentet, përndryshe paraqitja (vizualizimi) është jashtëzakonisht i rëndësishme për nxënien. Pamjet me ngjyra dhe lëvizjet krijojnë një numër të madh të informatave, që vështirë do të mund të jepeshin në një formë tjetër.

### **Komunikimi në arsimin në distancë**

Komunikimi virtual nuk e zëvendëson atë ballë për ballë. Komunikimi është një segment dhe aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor edhe në arsimin në distancë. Komunikimi është mesazh dhe mesazhi në mësimdhënien në largësi duhet të jetë praktik, i faktuar, bindës (King et al. 2006; Jones 2000).

Strategjitë, metodat dhe teknikat, në arsimin në distancë synojnë të përfshijnë të dyja anët e procesit mësimor, mësimdhënien dhe të nxëniet. Kjo kërkon planifikim të mirëfilltë të metodave dhe teknikave që do të përdoren gjatë mësimdhënies në distancë për arritjen e efektivitetit të materialit mësimor nëpërmjet komunikimit.

Në këto raste, komunikimi mësues-nxënës, nëpërmjet kompjuterit ose pajisjes tjetër teknologjike, nxit nxënësit të marrin pjesë në diskutim dhe të përfitojnë nga diskutimi, në mënyrë që të nxënëit e tyre të mos jetë vetëm nga tekstet, por të nxënëit të bazohet edhe në ushtrime dhe studim rasti, në këtë rast duke përdorur teknologjinë e informacionit (ku janë të instaluar fjalorë, enciklopedi, leksione, kuriozitetet etj.).

Në varësi të dhënies e marrjes së mesazheve, komunikimi mund të jetë efektiv ose joefektiv, andaj mësimdhënësit duhet të përqendrohen tek teknikat e mësimdhënies, që janë të përshtatshme për një mësimdhënie në largësi. Mënyra e komunikimit ndërmjet mësimdhënësit dhe vijuesit ndryshon, për shumë arsye bëjnë mësuesin të qëndrojë efektivisht i lidhur me nxënësit gjatë gjithë kohës. Mënyra e komunikimit është në distancë (largësi) dhe bëhet me mjete bashkëkohore elektronike, andaj që ky komunikim të jetë efektiv mësimdhënësi duhet të kujdeset, në veçanti që:

- Mundësia e përqendrimit në materialin e kursit me qetësi u lejon nxënësve një nxënie më efektive;
- Interaksioni në mes të nxënësve në formë të diskutimit direkt ose vetëm duke dëgjuar pyetjet e bëra nga të tjerët.

Njohuritë mësimore u ofrohen nxënësve si komunikim me të gjithë nxënësit, deri te komunikimi me secilin nxënës veç e veç.




Figura 1. Procesi i përcjelljes së mesazhit

Fazat e kalimit të mesazheve gjatë procesit të komunikimit mësues-nxënës.

- Mësuesi ka një ide (mesazh) dhe dëshiron t'ia komunikojë atë nxënësit;
- Mësuesi e kodon idenë (mesazhin), duke zgjedhur fjalët, simbolet, stilin që i mendon si më të përshtatshme;
- Mësuesi e transmeton mesazhin nëpërmjet një kanali komunikimi;
- Mesazhi mbërrin te nxënësi, nëse nuk ndesh ndonjë barrierë gjatë rrugës (p.sh. mungesë vëmendje);
- Nxënësi e dekodon mesazhin, domethënë përpiqet të kuptojë idenë e tij. Nxënësi e interpreton mesazhin në mënyrë korrekte nëse ai u jep fjalëve dhe simboleve të njëjtin kuptim si mësuesi;
- Marrësi (nxënësi) dërgon një përgjigje (një feedback) mbi mënyrën si e kupton mesazhin e marrë. Përgjigjja (feedback-u) i marrë nga nxënësi na jep mundësinë të vlerësojmë efektivitetin e mesazhit të transmetuar nga mësuesi drejt nxënësit.

Më poshtë jashtë renditur **pesë** rekomandime të rëndësishme:

- Mesazhi (mësimdhënia) duhet të përcjell informacion praktik, pavarësisht nëse ka të bëjë me kuptimin e politikave të mësimdhënies, apo për nxitjen për kryerjen e një hapi të caktuar në mësimdhënie;
- Mesazhi (mësimdhënia) duhet të japë më tepër fakte dhe më pak përshtypje, duke përdorur shprehje konkrete, informacion të qartë, bindës, të saktë dhe etik;
- Mesazhi (mësimdhënia) duhet të përqendrohet tek informacionet, duke theksuar informacionet më të rëndësishme për një mësimnxënie të efektshme;
- Mesazhi (mësimdhënia) duhet të krijojë bindje te nxënësit. Mesazhi duhet të shpjegojë dhe përcjellë te nxënësit (dëgjuesit) se çfarë përfitimesh do të kenë nga përgjigjja ndaj mesazhit tuaj në mënyrën e dëshiruar.



Si përfundim, mund të themi se arsimit në distancë është variacioni i arsimit gjatë gjithë jetës, në kuadër të arsimit joformal (i cili po përfshihet tanimë në arsimin formal), ku të gjithë nxënësit mund të marrin pjesë në procese mësimore, me ndihmën e teknologjive nga largësi të mëdha, pra pa kontakt me mësimdhënësit.

Ky variacion çdo ditë përditësohet dhe pranon një numër risish teknologjike, të cilat bëjnë të mundur që të gjithë nxënësit të marrin mbështetje nga mësimdhënësi me metoda mësimore, që i orientojnë të gjithë nxënësit gjatë të mësuarit dhe vlerësojnë njohuritë e tyre përmes programeve kompjuterike.

Mësimdhënia me përdorimin e teknologjive informative të komunikimit në të ardhmen mund të jetë njëra nga opsionet e arsimit të fëmijëve, jo si një risi, por si (domosdoshmëri), pasojë e pandemive, të cilat mund të pllakosin edhe në të ardhëm shoqërinë njerëzore.

## Referencat

1. Paolo Tedesco, Marzia Falcioni (2007). "Gestione e tutoring".
2. Doc. Marco Trivelli (2006). "Educazione a distanza".
3. Gjokutaj, M.; Hoti, I.; Kadriu, D., Fjalor termash në edukim, Shtëpia Botuese "Dukagjini", Prishtinë, 2016.
4. Sharma, Y. K. & Sharma, M. (2006), Educational Technology and Management. Kanishka Publishers, Distributors, New Delhi-110 002. Vol-1. p.28, 31, 40-47, 57-58.
5. A.Cattagni & E.Farris. (2000). Computer aided learning in the United States. Marrë nga [http://www.ncrel.org/tech/elearn/ frameeork.htm](http://www.ncrel.org/tech/elearn/frameeork.htm) me datë:31.3.2020.
6. Honeyman, M; Miller, G (dhjetor 1993). "Agriculture distance education: A valid alternative for higher education?". *Proceedings of the 20th Annual National Agricultural Education Research Meeting: 67–73.*
7. Halitaj, Mehrije (2010), Arsimit në distancë - mundësi e studimeve pa kufij, Kërkime Pedagogjike, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.

8. Azemi, Bashkim (2010), Arsimi nga largësia dhe arsimi gjatë gjithë jetës, Kërkime Pedagogjike, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
9. Azemi, Bashkim (2014), Fjalori i Pedagogjisë, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
10. Salmon, G.(2000), E-moderating, The key to teaching and learning online. London, Kogan Page.
11. Anderson.T. and E. Fathi (2004), Theory and practise of online learning,Athabasca University, Creative Commons.

## 1.2. PËRMBAJTJA MËSIMORE E PLATFORMAVE EKZISTUESE ONLINE NË KOSOVË

Arbnisha Mexhuani

Për të realizuar mësimin në distancë, mësimdhënësit e shkollave të arsimit parauniversitar kanë gjetur mënyrat më të përshtatshme për të kontaktuar me nxënësit, përmes aplikacioneve të ndryshme online, të cilat i kanë shërbyer për të komunikuar dhe për të bashkëvepruar me njëri tjetrin, për menaxhimin e detyrave, video-konferenca, dhe për shërbime të tjera arsimore. Si burime mësimore, mësimdhënësit kanë përdorur edhe platforma online me përmbajtje mësimore të cilat janë në shërbim të sistemit arsimor parauniversitar.

Që nga viti 2016, në Kosovë ekzistojnë disa platforma online me përmbajtje mësimore që ofrojnë programe edukativo-arsimore, përmes internetit, dhe që u mundësojnë nxënësve dhe mësimdhënësve qasje të përhershme audio-vizuale, duke u bazuar në kurrikulën shkollore dhe në kërkesat e arsimit në Kosovë. Platformat ekzistuese janë një bazë e mirë për e-mësimin, por nuk mbulojnë gjithë arsimin parauniversitar dhe nuk i plotësojnë kërkesat standarde për mësim në distancë.

Në pjesën në vijim pasqyrohen disa nga platformat online me përmbajtje mësimore, dhe shërbimet që kanë ofruar para rrethanave të krijuara nga pandemia e Covid-19

**Platformat** online me përmbajtje mësimore zëvendësojnë përdorimin e „lapsit dhe të letrës” me “tastierën dhe ekranin”, lehtësojnë ndërveprimin aktiv të përdoruesve nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme mësimore, si: kuizeve, ushtrimeve, prezantimeve të ndryshme, situatave problemore, etj. Platformat online me përmbajtje mësimore përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit në klasë dhe në shtëpi, për nxënie ndërvepruese, dhe përdorimi i tyre mund të shërbejë edhe për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

Në Kosovë platformat online me përmbajtje mësimore, që kanë synim të ndihmojnë mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe administratën e shkollës dhe që janë në mbështetje të sistemit edukativo-arsimor, janë: platforma

mësimore *School Me education*, platforma zyrtare e MASHTI-t *Busulla.com*, platforma *Evaluo.org*.(Ecdl Kosova), platforma e lojërave ***Teacher Gaming***, që përdoret në Shkollën Finlandeze, dhe platforma *M3 e-Learning*, që përdoret nga shkolla „Mileniumi i Tretë”.

### ***Platforma School Me education***

Platforma online School Me education është platformë private (komerciale), mirëpo në këtë kohë të pandemisë Covidi-19, kur të gjithë nxënësit janë në shtëpi, kjo platformë njofton se më 17 mars ka pranuar 25.000 përdorues të rinj të regjistruar falas, nga Kosova dhe Shqipëria ([facebook.com/pg/schoolme.education/](https://facebook.com/pg/schoolme.education/)). Kontributi i kësaj platforme vlen për t’u vlerësuar nga të gjitha institucionet arsimore, nga MASHTI dhe e gjithë shoqëria.

Platforma online School Me është përgatitur nga specialistë të teknologjive të informacionit, akademikë, mësues, ekspertë britanikë dhe ndërkombëtarë, të formuar në Oxford, Cambridge, University of London, dhe menaxhohet nga Thames Online Education, një kompani me qendër në Londër, ndërsa themeluese për Kosovë është znj. Iris Ratkoceri Gjinovci. (gazeta:platforma-digjitale School.Me).

Në Kosovë, platforma digjitale School Me është zhvilluar nga profesionistë shqiptarë dhe evropianë, të profileve shkencore, si dhe është mbështetur nga një grup i mësimdhënësve shqiptarë. Kjo platformë është e konceptuar dhe zhvilluar për të ndihmuar mësuesit, nxënësit dhe prindërit, që të zbatojnë kurrikulën e re. Kjo platformë është dëshmuar si një platformë mësimore e fuqishme, shumë tërheqëse dhe efektive, me përmbajtje mësimore audiovizive cilësore, e standardizuar për të gjitha lëndët bazë, për klasat 1-9, dhe komunikim në kohë reale për çdo nxënës dhe mësues nëpërmjet forumit.

Në Kosovë, platforma School Me education, me logon “Më mëso mua”, është pilotuar në 23 shkolla, në vitet shkollore (2016-2017) dhe (2017-2018). Me këtë platformë janë shërbyer 700 mësues dhe 8000 nxënës të këtyre shkollave. Realizimin e këtij projekti e ka mbështetur Qendra për Edukimin e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me MASHT-in ([kecs.org/projects/meso-mua-School/](https://kecs.org/projects/meso-mua-School/)).

Përmes kësaj platforme, nxënësve u është mundësuar që, përveç librit, të përdorin edhe burime të tjera mësimore, në dobi të ngritjes së cilësisë së nxënies, nxënësit kanë pasur qasje të përhershme audio-vizuale në të gjitha aspektet kurrikulare.

Lëndët e nivelit arsimor 9-vjeçar shpjegohen në shqip nga mësues të regjistruar. Ato shoqërohen me video shkencore, filma, imazhe, dokumente, harta specifike etj. Platforma u ofron përdoruesve të saj mijëra video, të zhvilluara nga institucione arsimore e shkencore ndërkombëtare, për të thelluar dhe përfshirë në kurrikulë dijet e reja dhe metodat bashkëkohore të nxënies.

### ***Platforma Busulla.COM***

Platforma zyrtare e MASHTI-t, Busulla.COM, ofron mbështetje në procesin e këshillimit dhe orientimit në karrierë për përdoruesit. Platforma *Busulla.COM* është bërë funksionale në nëntor të vitit 2017, për të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe të larta publike në Kosovë. Aktualisht atë e shfrytëzojnë rreth 65,000 nxënës ([ictawards.org/2018/busulla-com](http://ictawards.org/2018/busulla-com)). Për këtë platformë fokusi primar janë nxënësit nga klasa e 8-të deri në klasën e 12-të, si dhe mësimdhënësit e lëndës Jeta dhe Puna, të cilët e ligjërojnë modulën e Orientimit në Karrierë.

Busulla.COM ofron mundësi shumë atraktive dhe efikase për eksplorimin e profesioneve të ndryshme. Për çdo profesion Busulla.COM specifikon një ditë tipike të punës së atij profesioni, specifikat e atij profesioni, pagën mesatare, aktualitetin në tregun e punës, mundësitë e avancimit në karrierë, si dhe cili është shtegu arsimor për atë profesion. Platforma Busulla.COM, po ashtu, e bën ndërlidhjen e këshilltarëve të karrierës me nxënës, të cilëve u ofrohet asistencë në pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë me karrierën dhe profesionin.

Platforma ofron informata dhe mësim për situata dhe tema të ndryshme, po ashtu ofron një hapësirë të sigurt për komunikim dhe shkëmbim rreth temave që ndërlidhen me karrierë dhe orientim profesional. Për ta lehtësuar qasjen në platformë, ajo është në dispozicion si ueb-faqe dhe si aplikacion mobil. Nxënësit, studentët dhe kandidatët e interesuar mund ta realizojnë njohjen e

vetvetes përmes testeve të karrierës, siç janë: Interesat, Vlerat, Aftësitë dhe Preferencat (IVAP); Testi për Vlerësim të Potencialit dhe Testi Certifikues Basic Check. Basic Check është një vlerësim neutral i nxënësve dhe organizohet në qendrat testuese, të akredituara për administrimin e këtij testi. ([/ictawards.org/2018/busulla-com](https://ictawards.org/2018/busulla-com))

### **Shërbimet që ofron Platforma Busulla.COM**

Platforma Busulla.COM nxënësve dhe studentëve u ofron mbështetje në administrimin procesit të orientimit në karrierë, të mësojnë më tepër rreth profesioneve të përshtatshme, ta gjejnë shkollën apo kolegjin / universitetin e duhur, të gjejnë mundësi për angazhim në punë të rregullt apo punë praktike dhe të këshillohen online.

***Përzgjedhja e profesioneve*** - Përmes platformës Busulla.Com, nxënësit bëjnë përzgjedhjen e profesioneve për orientim në karrierë. Për këtë, kandidatët e kanë mundësinë të informohen rreth pagës mesatare, kërkesës së tregut të punës për profesion, njohurive dhe shkathtësive të kërkuara, nivelit të kërkuar të shkollimit, aktiviteteve dhe përgjegjësive, etj. Gjithashtu, përmes kësaj platforme ofrohen video të secilit profesion, qëllimi i së cilave është njohja e kandidatit për së afërmi me ambientin e punës (<https://ictawards.org>).

***Identifikimi i shkollave*** – Përmes kësaj platforme nxënësit/studentët mund të bëjnë identifikimin e shkollave, kolegjeve / universiteteve për orientimin në karrierë. Busulla.Com ofron modulën me të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit, për të cilat, ndër të tjera, ofrohen informata rreth drejtimeve, profileve, lëndëve dhe pagesës.

***Puna dhe Praktika*** - „One stop shop” për nxënës dhe firma. Nxënësit dhe studentët përmes kësaj komponente të platformës kërkojnë biznese, të cilat ofrojnë praktikë dhe aftësim profesional në vendin e punës. Në të njëjtën kohë bizneset shfrytëzojnë mundësinë e publikimit të vendeve të lira të praktikës. Praktikë-kërkuesit mund të krijojnë portfoliot e tyre online dhe t'i specifikojnë preferencat e tyre.

***Identifikimi i vendeve të lira të punës*** - Identifikimi i vendeve të lira të punës dhe praktikës është moduli i platformës, i cili aktualisht përmban shpallje

për vende të lira të punës dhe praktikës. Bizneset mund t'i publikojnë shpalljet për vendet e lira të punës apo praktikës dhe përdoruesit kanë mundësi të aplikojnë përmes platformës.

***Këshillimi online*** - Këshillimi online është hapi i fundit i procesit, i cili administrohet përmes modulit 'Këshilltari online'. Ky modul ofron këshilla rreth orientimit në karrierë, ndërmarrësish, tregut të punës etj. Moduli po ashtu ofron forumin e diskutimit, videot e storieve të suksesit dhe këndin e pyetjeve të shpeshta.

***Si aksesohet Platforma Busulla.com*** - Platforma është në dispozicion si ueb-faqe dhe si aplikacion mobil për të gjitha pajisjet IOS dhe Android. Të gjitha palët e interesuara mund ta bëjnë regjistrimin vetvetiu për të fituar qasje në platformë. Qasja është e pakufizuar dhe si e tillë mund të bëhet në çdo kohë dhe lokacion.

### **Platforma Evoluo.ORG- ECDL Kosova (European Computer Driving License)**

***Platforma evaluo.org*** - Është një platformë gjithëpërfshirëse, e bazuar në „cloud”, që mbështet krijimet online dhe shpërndarjen e testeve të pasura në përmbajtje dhe profesionale. Me qëllim që mësimdhënësit të kenë mbështetje shtesë në këtë kohë të mësimin online, përgjegjësi i ECDL Kosova, z. Bekim Kasumi, është shprehur i gatshëm të ndihmojë mësimdhënësit e Kosovës në realizimin sa më të mirë të misionit të tyre arsimor, duke mundësuar kyçje falas në platformën EVALUO, që shërben për përpilimin e testeve, dërgimin e tyre, menaxhimin e kandidatëve, raportimin e rezultateve etj. Në platformë gjenden shumica e testeve të maturës të viteve paraprake dhe teste të përgatitura për vetëvlerësim (vetëkontrolluese) për nxënësit e klasave VI-XII, të orientuar kah rezultatet mësimore, konform kurrikulës së re. Veprimtaria e kësaj platforme është trevjeçare ([www.facebook.com/bekim.kasumi.1](http://www.facebook.com/bekim.kasumi.1)).

Po ashtu janë organizuar trajnim online për mësimdhënësit (pa pagesë) për përdorim të platformës, përpilimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e testeve online. Trajnimi, përmes Zoom-it, ECDL Kosova, këto shërbime që ua ka ofruar mësimdhënësit të Kosovës, ka kontribuar dukshëm në organizim cilësor të mësimin online në të gjitha institucionet arsimore.

## **Shërbimet që ofron platforma Evaluo.ORG**

**Platforma Evaluo.ORG** ofron mbështetje për më shumë se 15 lloje të pyetjeve, të cilat mund të përdoren për krijimin e lehtë të testeve dhe gjithashtu krijimin e bankës së pyetjeve.

**Bankat e pyetjeve** - Shërbejnë si depo për pyetjet e kategorive, llojeve të ndryshme dhe nivele të vështirësisë. Ato janë të krijuara një herë ose përgjatë kohës dhe janë të përcaktuara që në mënyrë automatike të gjenerojnë dhe shpërndajnë numër të pakufizuar të testeve, vetëm duke e përcaktuar numrin e pyetjeve për test dhe vështirësinë e nivelit. Platforma Evaluo, po ashtu, ofron mbështetje për lloje të ndryshme të pyetjeve dhe mënyra inovative për krijimin, klasifikimin dhe ripërdorimin e pyetjeve dhe gjenerim të testeve. Për çdo pyetje të krijuar, autorët mund gjithashtu të përfshijnë edhe referencat në sylabus, materialet e mësimit ose referenca të tjera. Në këtë mënyrë ata mund të krijojnë teste të cilat mund të përdoren si teste përgatitore ose vlerësuese. Në këtë format të kësaj platforme kemi përditësim dhe krijim shtesë të testeve, krijim të testit të shpejtë, të thjeshtë dhe intuitive të e-testeve. Po ashtu, kemi mbështetje të pyetjeve me tekst, foto, audio dhe video. ([evaluo.org/evaluo/#home](http://evaluo.org/evaluo/#home))

**Përfitimet nga platforma Evaluo** - Përfitimet e mësimeve nga kjo platformë janë të shumta: kanë qasje të lehtë në teste të ndryshme të disponueshme përmes kanaleve publike të evaluo, apo institucioneve ku është mundur qasje. Mbështetja për filtrime dhe përzgjedhje të testeve të disponueshme e të bazuara në kritere të ndryshme (kategori, gjuhë, shtet, autor, çmim, etj). Rritje të efikasitetit dhe efektivitetit të mësuarit dhe të vetë-vlerësimit. Mbështetje të krijimit të testeve të huaja. Po ashtu, përdoruesit kanë mundësinë të zgjedhin pyetje atraktive, intuitive dhe të pasura me (tekst, foto, audio dhe video). Testet evaluo janë të qasshme përmes Ios, Android dhe Web. ([evaluo.org/evaluo/#home](http://evaluo.org/evaluo/#home))

## **Platforma Mësimi përmes lojërave (Teacher Gaming) - Shkolla Finlandeze në Kosovë**

Shkolla Finlandeze është në Prishtinë, e cila mbështetet në sistemin finlandez të shkollimit. Shkolla Finlandeze mësimit e organizon në katër



nivele: në nivelin parashkollor, në nivelin fillor, në nivelin e mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë. Kjo shkollë u mundëson nxënësve të marrin njohuritë dhe shkathtësitë e kërkuara në treg, përmes metodave dhe formave të ndryshme të mësimnxënies.

Në vitin 2017 kjo shkollë ka filluar të përdorë platformën online Teacher Gaming (mësimi përmes lojërave ([kosovo.finnish.school/2017/](http://kosovo.finnish.school/2017/)), që është një platformë shumë e njohur në tërë botën dhe që shfrytëzohet nga shkollat më inovative, duke ofruar lojëra pothuajse për secilën lëndë dhe njësi mësimore. Shkolla Finlandeze e Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi me Teacher Gaming dhe nxënësit e kësaj shkolle kanë qasje të plotë në shfrytëzimin e këtyre lojërave për mësim. Teacher Gaming Desk është zgjidhje me një klikim për mësimin e bazuar në lojë dhe është projektuar për të bërë video-lojërat një mjet të qëndrueshëm mësimor për secilën klasë. ([kosovo.finnish.school/2017](http://kosovo.finnish.school/2017/))

Platforma Teacher Gaming Desk kombinon një portofoljo të lojërave me materiale mësimore të gatshme dhe analiza të fuqishme të të mësuarit. Edukatorët mund të zgjedhin lojëra për nevojat e nxënësve të tyre, të mësojnë një sërë lëndësh dhe të ndjekin përparimin e nxënësve të tyre në aspektin e aftësive të jetës reale. Kjo platformë u ofron edhe prindërve qasje të ndjekin progresin e fëmijëve të tyre gjatë gjithë kohës.

### ***Platforma online M3 e-Learning - Shkolla „Mileniumi i Tretë”***

Shkolla "Mileniumi i Tretë" është shkollë jopublike, e nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (klasat 0-1-12), e themeluar në vitin 2004/05. Në shkollën "Mileniumi i Tretë" puna zhvillohet sipas Kurrikulës të Kosovës. Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19, shkolla "Mileniumi i Tretë" më 16 mars ka filluar mësimin online, përmes platformës M3 e-Learning. Mësimi online organizohet në 6 fusha: 1) Gjuhë shqipe dhe Komunikim, 2) Matematikë dhe Informatikë, 3) Gjuhë angleze dhe Gjuhë gjermane, 4) Shkenca natyrore, 5) Shkenca shoqërore, 6) Shkathtësitë. ([/mileniumi3.net/?page\\_id=11400](http://mileniumi3.net/?page_id=11400)).

Përmbajtja mësimore në këtë platformë është e përgatitur për moshën e niveletë ndryshme, përmes formave: Google Forms (kuizeve) Power Point (prezantime), video e audio incizime, si dhe përmes Classtime (platforma online për vlerësim). Po ashtu, duhet cekur se në prezantime janë të dhëna udhëzimet për secilën detyrë, po ashtu në fund të mësimit ka udhëzime se si duhet dorëzuar detyrat të mësuesja klasore, apo të arsimtarët.

Shkolla “Mileniumi i Tretë”, edhe pse është shkollë private, ka përkrahur (mbështetur) të gjithë nxënësit e Kosovës, duke u mundësuar që ta përdorin platformën e tyre online, derisa MASHT-i të fillojë ofrimin e mësimit në distancë për të gjithë nxënësit e Kosovës.

### **Burime nga interneti:**

- [https://ictawards.org/2018/busulla-com-interviste-me-sherbimin-publik-te-vitit-ne-kosove-ne-edicionin-e-7-te-te- ict-awards/](https://ictawards.org/2018/busulla-com-interviste-me-sherbimin-publik-te-vitit-ne-kosove-ne-edicionin-e-7-te-te-ict-awards/)
- <https://kosovo.finnish.school/2017/08/10/mesim-permes-lojerave-ne-shkollen-finlandeze-te-kosoves/>
- [https://gazetamapo .al/platforma-digjitale-school-me-ne-sherbim-te-kurrikules-se-re/](https://gazetamapo.al/platforma-digjitale-school-me-ne-sherbim-te-kurrikules-se-re/)
- [https://mileniumi3.net/? page\\_id=11400 ://mileniumi3.net/](https://mileniumi3.net/? page_id=11400 ://mileniumi3.net/)
- <http://kec-ks.org/projects/meso-mua-school/>
- [www.facebook.com/pg/schoolme.education/](http://www.facebook.com/pg/schoolme.education/)
- <https://www.facebook.com/bekim.kasumi.1>
- <https://evaluo.org/evaluo/#home>

### **1.3. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË**

Selim Mehmeti

Në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu si të gjitha vendet e rajonit, BE-ja dhe vendet tjera të botës, u detyrua që nga data 12 mars 2020 t'i mbyllë të gjitha institucionet arsimore, të të gjitha niveleve të arsimit. Pas këtij vendimi të ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) filloi përgatitjet për organizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, në përpjekje për të ofruar mësim për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Rrethanat, në të cilat sistemi ynë është detyruar të fillojë mësimin në distancë në arsimin parauniversitar, përbejnë një sfidë të veçantë për gjithë sistemin arsimor në Kosovë, përfshirë MASHTI-n, DKA-të, shkollat, drejtuesit e saj, mësimdhënësit dhe, në mënyrë të veçantë, nxënësit dhe prindërit.

Në këtë kapitull përshkruhen shkurtimisht tri aspekte kryesore që lidhen me mësimin në distancë në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19: (i) Masat kryesore që janë ndërmarrë nga MASHTI për të filluar organizimin e mësimit në distancë; (ii) dokumentet e zhvilluara për realizimin e mësimit në distancë në arsimin parauniversitar dhe (iii) menaxhimi i mësimit në distancë.

#### **I. Masat kryesore që janë ndërmarrë nga MASHTI për fillimin e mësimit në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë**

Përgatitjet për fillimin e mësimit në distancë në kohë pandemie të papritur nuk ishin të lehta, sistemi i arsimit parauniversitar nuk ishte i përgatitur për një modalitet të tillë të mësimit dhe të mësimdhënies. As koncepti mësim në distancë apo arsim në distancë, në Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nuk është përdorur dhe rrjedhimisht nuk është zbrërthyer te neni i përkufizimeve për shprehjet e përdorura në këtë ligj (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2011).

Në anën tjetër, edhe pse MASHTI në (PSAK 2017-2021) kishte përcaktuar aktivitete, të cilat do të mundësonin shfrytëzimin e pajisjeve të TIK-ut dhe të platformave digjitale në procesin mësimor, si: trajnimin e mësimeve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike, sigurimin e rrjeteve lokale që mbulojnë hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor në shkolla, sigurimin e qasjes në internet për të gjitha shkollat etj. (MASHT, 2016), një gjë e tillë nuk ishte arritur të realizohet. Kjo bëri që mësimeve t'i gjejë të papërgatitur për zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve elektronike, gjë që ishte sfidë më vete për të filluar mësimin në distancë në këto rrethana.

Zëvendësministri e MASHTI-it, z. Thaçi dhe z. Rexhaj<sup>1</sup>, situatën në fillim të përgatitjeve për organizimin e mësimit në distancë e përshkruajnë kështu:

*Realisht, ne nuk kemi gjetur asgjë. Domethënë nuk kemi gjetur asnjë dokument që në mënyrë specifike i referohet mësimit online ose atij në distancë. Ne i kemi përdorur dokumentet ekzistuese që e rregullojnë mësimin në shkollë, si kalendari shkolle, UA për vlerësimin e nxënësve, kurrikula shtetërore (KKK),*

*Sfida kryesore ishte mungesa e shkathtësive të mësimeve për mësim në distancë. Pas kësaj vinin mungesa e teknologjisë, koha shkurtë, mungesa e strukturave përkatëse për mësimin në distancë, mungesa e përvojës së MASHT, procedurat e komplikuar për prokurim në MASHTI, mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë.*

*planet dhe programet mësimore, e të tjera. Sfida kryesore ishte mungesa e shkathtësive të mësimeve për mësim në distancë. Pas kësaj vinin mungesa e teknologjisë, koha shkurtë, mungesa e strukturave përkatëse për mësimin në distancë (për zëvendësim të funksionimit në shkollë), mungesa e përvojës së MASHTI-t, procedurat e komplikuar për prokurim në MASHTI, mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë. Realisht, pos kurrikulës, ne nuk kemi pasur asgjë tjetër. Po të mos ishin kompanitë e*

---

<sup>1</sup> Zëvendësministri Jusuf Thaçi është koordinator i mësimit në distancë, ndërsa Zëvendësministri Xhavit Rexhaj është përgjegjës për pjesën pedagogjike dhe për komunikimin me DKA – shkolla.

*teknologjive të reja (Kallxo. com, Gjirafa, Microsoft, Link Plus), ne nuk besojmë se do të guxonim as të fillojmë të bëjmë as një hap në drejtim të realizimit të mësimit në distancë.*

Masat kryesore që janë ndërmarrë nga MASHTI për fillimin e mësimit në distancë janë si në vijim<sup>2</sup>:

- Janë mbajtur dy mbledhje të gjata konsultimi me kompanitë që punojnë me teknologjitë e reja;
- Është vendosur komunikimi dhe pajtueshmëria me DKA-në në Prishtinë për të siguruar mësime të realizuar video–ligjërata mësimore;
- Është mbajtur një mbledhje organizative me kompani, OJQ, sektorët e MASHTI-t, kompanitë me platforma të mësimit online, e të tjerë;
- Krijimi i skicës së parë të mësimit të kërkuar dhe resurset e kërkuara për realizimin e tij;
- Krijimi i skicës dhe domeneve të para për realizimin e mësimit në distancë;
- Krijimi i platformës së mësimit në distancë (fillimisht në Gjirafë e pastaj në ‘YouTube’);
- Negocimi me kompanitë me platforma të gatshme të mësimit online;
- Negocimi dhe vendimi për fillimin e transmetimit të video-materialeve në RTK.

Referuar masave paraprake, më 17 mars MASHTI informoi se kanë gjetur mbështetje të konsiderueshme nga operatorë ekonomikë, nga fusha e ICT-së, medieve dhe ofruesve të shërbimeve arsimore, të cilët kanë ofruar kapacitetet e tyre infrastrukturore dhe ekspertizën profesionale për ta mbështetur

---

<sup>2</sup> Referuar përgjigjeve nga zëvendësministri Jusuf Thaçi, koordinator i mësimit në distancë dhe zëvendësministri Xhavit Rexhaj, përgjegjës për pjesën pedagogjike dhe për komunikimin me DKA – shkolla.

MASHTI-n në jetësimin e iniciativës për krijimin e platformës për mësimin online në Kosovë, e cila në këtë fazë pritet të jetë vetëm me video-materialet që përgatiten nga mësimdhënësit e lëndëve dhe klasave përkatëse. Gjithashtu, në këtë informim, MASHTI theksoi se platforma e mësimin në distancë (online) do të jetë në dispozicion për të gjithë nxënësit e institucioneve publike dhe atyre private, pa dallim. Gjithashtu u dha informacioni lidhur me shkollat private, të cilat veçse janë duke ofruar shërbimin e mësimin online për nxënësit e tyre, kanë të drejtë të ofrojnë shërbime edukative të digjitalizuara në mënyrë vetjake, gjithnjë duke pasur parasysh se mësimi zhvillohet në përputhje me planin dhe programin mësimor të aprovuar nga MASHTI<sup>3</sup>.

Prodhimi i materialeve mësimore filloi me mbështetjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe të mësimdhënësve të shkollave të Prishtinës. Më 22 mars 2020, MASHTI informoi publikun e gjerë në Kosovë se më 23 mars do të fillojë mësimi në distancë, fillimisht për klasat 1-5, përmes materialeve mësimore, video-materialeve të përgatitura me angazhim vullnetar të mësimdhënësve të komunës së Prishtinës. Opinioni i gjerë u informua që këto materiale mësimore do të transmetohen në televizionin publik RTK1 dhe RTK4 (ritransmetim), si dhe do të plasohen për publikun edhe përmes ueb-faqes zyrtare <https://emesimi.rks-gov.net>, përmes së cilës shkohet në kanalën e MASHTI-t në ‘YouTube’<sup>4</sup>.

Më 23 mars 2020 filloi mësimi në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë, fillimisht në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë për klasat e para deri në të pesta. Gjithashtu, MASHTI, nëpërmjet zëvendësministrit, z. Thaçi, informoi se “prodhimi i materialeve mësimore ka filluar mbështetur në planifikimet mësimore prej ditës kur është ndërprerë

*Me 23 mars filloj mësimi në distancë, fillimisht në nivelin e parë të arsimit, klasat 1-5 përmes materialeve mësimore, video-materialeve në lëndët gjuhën shqipe dhe matematikë të përgatitura me angazhim vullnetar të mësimdhënësve të komunës së Prishtinës.*

<sup>3</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/komunikate-42>

<sup>4</sup> <https://masht.rks-agov.net/article/mesazhi-i-ministres-hykmete-bajrami-per-fillimin-e-mesimit-ne-distance-2>

mësimi (“prejra”), duke e marrë për bazë Komunën e Prishtinës, meqë edhe mësimdhënësit e angazhuar janë nga kjo komunë.

Kjo nënkuptonte se disa komuna mund të jenë më përpara ose më mbrapa me plan-programe. Nuk kemi pasur mundësi që t’i përshtatemi secilës komunë veç e veç”.

Në fund të ditës së parë të fillimit të mësimit në distancë, duke parë interesimin e madh për përdorim të këtyre materialeve dhe nevojën që nxënësit të kenë sa më lehtë qasje në këto materiale, MASHTI informoi se ka vendosur që këto materiale të ofrohen si burim i hapur (open source) me kushtet në vijim<sup>5</sup>:

- *Këto materiale dhe përmbajtje mbesin pronë e MASHTI-t;*
- *Këto materiale dhe përmbajtje nuk mund të modifikohen;*
- *Këto materiale dhe përmbajtje nuk mund të monitizohen (nuk mund të përdoren për qëllime fitimprurëse).*

Çdo person fizik ose juridik që i përmbahet kushteve të sipër-përmendura mund t’i përdorë, t’i publikojë ose t’i transmetojë këto materiale dhe përmbajtje te publiku, përmes çfarëdo lloj mënyre, forme apo formati që ka në dispozicion.

Nga data 30 mars, ka filluar mësimi në distancë edhe në klasat 6-9, përmes video-ligjëratave, në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematikë. Po në këtë datë, në kuadër të procesit të zbatimit të mësimit në distancë për nxënësit kosovarë, MASHTI filloi

*Me 30 mars filloj mësimi në distancë në lëndët Gjuhë shqipe dhe Matematike dhe për klasat 6-9. Po me këtë datë, filloj mësimi në distancë për fëmijët turq dhe boshnjakë, në klasat 1-5 për lëndët Gjuhë Turke / Gjuhë boshnjake dhe Matematikë.*

transmetimin në RTK 2 të video-ligjëratave për lëndët Gjuhë turke dhe Matematikë, për klasat 1–5, dhe për fëmijët boshnjakë për lëndët Gjuhë boshnjake dhe Matematikë, për klasat 1-5. Edhe këto materiale mësimore transmetohen përmes ueb-faqes zyrtare <https://emesimi.rks-gov.net>, përmes së cilës shkohet në kanalën e MASHTI-t në ‘YouTube’ edhe në gjuhët turke

<sup>5</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/njoftim-32>

dhe boshnjake<sup>6</sup>. Më 6 prill 2020, në klasat 6-9, filloi mësimi në distancë, përmes video-ligjëratave, edhe në lëndët e fushave kurrikulare Shkencat e natyrës dhe Shoqëria dhe mjedisi. Me gjithë përpjekjet nga MASHTI që t'i përfshijë edhe shkollat e komunitetit serb në mësimin në distancë, një gjë e tillë nuk është arritur.

Përkrahja nga RTK-ja bëri që ky televizion të jetë transmetuesi zyrtar i mësimin në distancë për fëmijët e klasave 1 deri 9 dhe transmetimi i mësimin në distancë të bëhet edhe në kanal in e MASHTI-t në 'YouTube'. RTK-ja është kanal pa pagesë dhe i qasshëm në shumicën e familjeve kosovare. Megjithatë, mosfunksionimi i RTK 4 në disa lokacione, si dhe sinjali i dobët i transmetimit, mund të jetë sfidë për disa nxënës të Kosovës. Vende të ndryshme, si p.sh. Argjentina, Meksika dhe Xhamajka, kanë mundësuar që, përveç televizionit publik, orët mësimore të njëjta të transmetohen edhe në televizione tjera private dhe ato lokale, për të siguruar qasje sa më të gjerë në mësimin në distancë (BB1, 2020), gjë që te ne nuk ndodhi.

Sipas raporteve të MASHTI-it, DKA-ja e Prishtinës dhe ajo e Prizrenit, me mësimdhënësit e tyre, janë angazhuar drejtpërdrejt në përgatitjen e materialit mësimor virtual, duke punuar çdo ditë në shkollën "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe në shkollën "Emin Duraku" në Prizren.

Referuar udhëzimeve të hartuara nga MASHTI, për shkollat në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-12 të arsimit të mesëm të lartë (si në gjimnaze dhe në shkolla profesionale), mësimi në distancë në këtë nivel të arsimit filloi më 30 mars 2020. Mësimi filloi në mënyrë të decentralizuar, në nivel shkolle dhe mësimdhënësit në nivel klase. Realizimi i mësimin online në shkollat e mesme të larta është i fokusuar në disa lëndë të përgjithshme (Gjuhë, Matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore) (MASHT, 2020 c).

## **II. Dokumentet e zhvilluara për realizimin e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar**

Siç është përshtuar më lart, MASHTI para rrethanave të krijuara nga pandemia COVID – 19 nuk kishte asnjë dokument që në mënyrë specifike i referohej mësimin online ose atij në distancë, megjithëse janë zhvilluar disa

---

<sup>6</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/orari-dhe-permbajtja-per-javen-e-ardhshme-per-mesimin-ne-distance>



projekte dhe kanë qenë të planifikuara disa masa për trajnimin e mësimeve dhe zhvillimin e platformave mësimore online në PSAK 2017-2021.

Në fillimet e organizimit të mësimit në distancë, MASHTI u fokusua në përgatitjen e dokumenteve që qartësojnë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në procesin e organizimit të mësimit në distancë. Më 30 mars 2020, MASHTI publikoi në faqen zyrtare të MASHTI-it, E-mësimi <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>, katër dokumente me udhëzime.

### ***1. Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit në distancë***<sup>7</sup>

Dokumenti ofron udhëzime për: (i) Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), (ii) shkollat, (iii) mësuesit klasorë (1-5), (iv) kujdestarët e klasave (për klasat 6-9 dhe 10-12), (v) mësimeve (1-12), (vi) prindërit dhe (vii) tri paraqitje grafike për komunikimin: 1. Ndërmjet palëve të involvuara në realizimin e mësimit në distancë, duke filluar nga MASHTI deri te nxënësit, 2. Ndërmjet palëve të involvuara në realizimin e mësimit në distancë për klasat 1-5; 3. Ndërmjet palëve të involvuara në realizimin e mësimit në distancë për klasat 6-12.

### ***2. Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimit online, për shkollat e mesme të larta (SHML)***<sup>8</sup>

Dokumenti ofron qëndrimin e MASHTI-it për shkollat e mesme të larta, sipas të cilit MASHTI kërkon nga DKA-të të fillojnë përgatitjet dhe inkurajimin e shkollave që të zhvillojnë mësimin në distancë me nxënësit në mënyrë të decentralizuar në nivel shkolle dhe mësimeve në nivel klase. Pastaj, dokumenti ofron udhëzime për DKA-të dhe shkollat, si dhe format plotësuese me modalitete të tjera për të lehtësuar zbatimin e mësimit online në komunat dhe shkollat që nuk i kanë resurset e mjaftueshme njerëzore e teknologjike për këtë formë të mësimit.

---

<sup>7</sup> [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distancë-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distancë-mashti_1.pdf)

<sup>8</sup> [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtore-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtore-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf)

### ***3. Udhëzime për DKA për realizimin e mësimit online, për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës<sup>9</sup>***

Dokumenti në dy faqe ofron disa orientime se si duhet të realizohet mësimi në distancë në këtë nivel të shkollimit. Më këtë dokument qartësohet se MASHTI është përcaktuar për modalitetin e kufizuar të realizimit të mësimit për shkollat e mesme të larta profesionale, për shkak të specifikave të tyre.

### ***4. Përdorimi i platformës Zoom – Zoom - us<sup>10</sup>***

Dokumenti i përkthyer në gjuhën shqipe ofron të gjithë hapat që duhet ndjekur për të përdorur platformën Zoom.

Në grupin e parë të dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare e-mësimi, MASHTI nuk detajon udhëzime për zbatimin e kurrikulës, përcaktimin e temave kryesore që duhet të realizohen gjatë mësimit në distancë, ose vendim për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Kjo ka bërë që mësimi në distancë të vazhdojë nga aty ku është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë, për shkak të pandemisë COVID-19.

Dokumentet e para nuk ofrojnë edhe orientime se si do të organizohet dhe si do të ndihmohen gjatë mësimit në distancë nxënësit e grupeve të marginalizuara.

Referuar realitetit, pasi mësimi në distancë është sfidë edhe për prindërit, dokumentet e para kanë farë pak orientime, këshilla dhe udhëzime për punën e prindërve dhe përmbushjen e rolit të tyre gjatë mësimit në distancë. Ato janë plotësuar në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, të publikuar një muaj pasi që ka filluar mësimi në distancë. UNESCO ka prodhuar materiale të shkurta vizuale dhe lehtë të kuptueshme për elemente të ndryshme të mësimit në distancë në periudhën e pandemisë, përfshirë edhe për këshillim të prindërve se si t'i motivojnë fëmijët e tyre gjatë mësimit në distancë (UNESCO, 2020).

---

<sup>9</sup> [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtore-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtore-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf)

<sup>10</sup> [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf)

Në udhëzuesit e MASHTI-it ka mungesë të informative për nxënës me sugjerime e udhëzime se si duhet t'u qasen mësimëve dhe detyrave gjatë kohës së mësimit në distancë, si të bashkëpunojnë me prindërit, mësimdhënësit e tyre dhe me bashkëmoshatarët për zhvillimin e mësimëve dhe të projekteve që u ndihmojnë zhvillimin e kompetencave kryesore. Kjo më shumë ka mbetur përgjegjësi e shkollave, mirëpo as shkollat nuk janë sugjeruar të bëjnë një gjë të tillë dhe nuk janë udhëzuar si ta bëjnë.

Gjithashtu, në udhëzimet e MASHTI-t nuk janë përvijuar mjete dhe instrumente pune për mbajtjen e evidencave të mësimit online, në lëndët mësimore të klasave 1-9 që nuk janë të përfshira në platformën E-mësimi dhe në arsimin e mesëm të lartë.

Grupi i dytë i dokumenteve të zhvilluara u referohet punës me fëmijë me nevoja të veçanta dhe vlerësimin të nxënësve gjatë mësimit në distancë.

#### ***5. Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta***

Dokumenti është publikuar në faqen zyrtare E-mësimi, më 14 prill 2020. Dokumenti ofron udhëzime specifike për:

- *Mënyrat e ofrimit të mësimit në distancë për nxënësit me nevoja të veçanta në shkolla;*
- *Bashkëpunimin me Qendrat Burimore për ofrimin e mësimit në distancë;*
- *Mënyrat e zbatimit të mësimit në distancë në Qendra Burimore;*
- *Format e ofrimit të mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta.*

#### ***6. Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë***

Udhëzuesi është publikuar në faqen zyrtare E-mësimi më 24 prill 2020. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë në kushtet e pandemisë COVID-19, në mënyrë që të mbështetet përfundimi i vitit shkollor 2019/20 dhe të evidentohen arritjet individuale të nxënësve. Udhëzuesi nuk ofron zgjidhje të gatshme për

vlerësimin e nxënësve në kushtet e tanishme, por paraqet udhërrëfyes dhe ide për veprim, të cilat shkollat dhe mësimdhënësit duhet t'i zbatojnë duke iu përshtatur kontekstit dhe rrethanave. Sipas udhëzuesit, parimi udhëheqës në kushte të tanishme, apo qëllimi primar i vlerësimit është mirëqenia e fëmijëve dhe nxitja e të nxënësve, jo vlerësimi i përmbajtjes së mësuar<sup>11</sup>.

### ***7. Vendimi 25/01B, për procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë<sup>12</sup>***

Ky vendi i MASHTI ka rregulluar procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Vendimi është i ndërlidhur me Udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë.

---

## **Dokumentet e zhvilluara për realizimin e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë janë:**

---

- 1. Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë;*
  - 2. Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta (SHML);*
  - 3. Udhëzime për DKA-të për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës;*
  - 4. Përdorimi i platformës Zoom – Zoom – us;*
  - 5. Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimin në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta;*
  - 6. Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë;*
  - 7. Vendimi 25/01B, për procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë.*
- 

<sup>11</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>

<sup>12</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf>

Krahas këtyre dokumenteve, në faqen zyrtare E-mësimi, çdo javë publikohet orari i mësimdhënëse që transmetohen në RTK dhe në linkun për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’<sup>13</sup>.

Platforma E-mësimi në linkun për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’ është platforma e vetme mësimore online me përmbajtje në përputhje me kurrikulat dhe plan-programet, e centralizuar dhe e cila është e qasshme nga të gjitha llojet e pajisjeve teknologjike të mençura që kanë qasje në internet (PC, laptop, tablet, smart phone, smart TV etj.).

Platforma E-mësimi përmban udhëzuesit, dokumentet tjera të hartuara nga MASHTI dhe materialet e video-ligjëratave. Platforma e MASHT-it nuk i ka në dispozicion librat shkollorë, e kanë bërë disa nga shtetet tjera, si Sllovenia<sup>14</sup> dhe shumë vende të tjera, pavarësisht faktit që ato MASHTI i blen çdo vit nga shtëpitë botuese që kanë marrë leje për botimin e tyre.

Në anën tjetër, (MASHTI), në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe “Save the Children”, më 14 prill 2020, ka lansuar **platformën e parë online në Kosovë: “Edukimi në distancë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç.”** Platforma pritet që t’i mbështesë prindërit/kujdestarët ligjor dhe edukatorët në realizimin e aktiviteteve ditore/javore me fëmijët në kushte shtëpie. Me rastin e lansimit, u vlerësua se përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë platformë stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore, në varësi të moshës së tyre. Platforma, përveç informacioneve hyrëse, ofron aktivitetet ditore me fëmijë, tema mujore, materiale mbështetëse, informacione të rëndësishme për COVID-19, si dhe mundësi kontakti për informacione shtesë apo për udhëzime profesionale.<sup>15</sup>

Gjithashtu, MASHTI, me mbështetjen e organizatës “Save the Children”, më 29 prill 2020, ka bërë lansimin e platformës “Arsimi gjithëpërfshirës”, me qëllim të ofrimit të mundësive për zhvillim socio-emocional dhe njohës të fëmijëve me nevoja të veçanta. Platforma ofron aktivitete mësimore për

---

<sup>13</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/emesimi-per-kl-converted.pdf>

<sup>14</sup> <https://eucbeniki.sio.si/>

<sup>15</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/lansohet-platforma-online-edukimi-ne-distance-kujdesi-zhvillimi-dhe-edukimi-ne-femijerine-e-hershme-per-moshen-0-6-vjec>

fëmijë dhe materiale ndihmëse për prindër/kujdestarë ligjorë, mësimdhënës dhe asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Aktivitetet mësimore janë të ndara sipas fushave të kurrikulës dhe fushave të aktiviteteve. Gjithashtu, platforma ofron tema dhe njësi konkrete, materiale didaktike, këshilla, video, udhëzime audio-vizuale, fleta pune dhe fotografi për të gjithë fëmijët bazuar në nivelet dhe aftësitë individuale. Përveç aktiviteteve mësimore, platforma ofron informata dhe materiale ndihmëse lidhur me qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, metodat bazike, vlerësimin, dhe informata tjera të rëndësishme për zhvillimin social, emocional dhe psikofizik të fëmijës<sup>16</sup>.

### III. Menaxhimi i mësimin në distancë

Procesi i mësimin në distancë menaxhohet nga kabineti i ministres, znj. Hykmete Bajrami. Zëvendësministri Jusuf Thaçi është koordinator i mësimin në distancë, ndërsa zëvendësministri Xhavit Rexhaj është përgjegjës për pjesën pedagogjike dhe për komunikimin DKA–shkolla. Procesi menaxhohet sipas paraqitjes grafike për komunikimin ndërmjet palëve të involvuara në realizimin e mësimin në distancë, duke filluar nga MASHTI, paraqitje e cila është zhvilluar krahas me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive për realizimin e mësimin në distancë.

Sipas zëvendësministrave të MASHTI-t, z. Thaçi dhe z. Rexhaj, hapat e ndërmarrë për menaxhimin e mësimin në distancë nga MASHT u referohen themelimit të Grupit Profesional që shërben si rregullator pedagogjik e profesional i procesit<sup>17</sup>, hartimit të udhëzuesve që e rregullojnë funksionimin

---

<sup>16</sup> <https://masht.rks-gov.net/article/mashti-lanson-plattformen-arsimi-gjithperفشires-per-femijet-me-nevoja-te-vecanta>

<sup>17</sup> Detyrat e grupit profesional për mësimin në distancë:

- të hartojë udhëzuesin për vlerësim dhe
- të hartojë udhëzuesin për rolet dhe përgjegjësitë e faktorëve mësimorë të mësimin në distancë,
- të monotorojë mirëvajtjen e mësimin online me qëllim të sigurimit të cilësisë,
- të sigurohet që zgjidhjet e tanishme të inkorporohen në digjitalizimin e mësimin në Kosovë në plan afatmesëm,
- të hartojë politikat për mësimin në distancë dhe digjitalizimin e mësimin në Kosovë,

e të gjitha palëve dhe faktorëve mësimorë dhe ofrojnë udhëzime për mësimdhënës dhe aktorët të tjerë, vendosjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me DKA dhe donatorë, sigurimit të mësimdhënësve, përgatitjeve dhe realizimit të xhirimeve të orëve mësimore nga Kallxo.com (me ndihmën e 5 kameramanëve të RTK) në shkollën “Qamil Batalli” në Prishtinë dhe në shkollën “Emin Duraku” në Prizren (për komunitetet turke e boshnjake) dhe transmetimit të tyre në RTK dhe në linkun për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’. Po

ashtu, shërbimeve të logjistikës, që koordinohen dhe sigurohen nga zyra e sekretarit të përhershëm dhe shëndetit e sigurisë, që mbikëqyren nga policia, dhe drejtorët e dy shkollave ku bëhen përgatitjet e orëve mësimore.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësiive të përcaktuara nga MASHTI, DKA-të ua kanë ndarë detyrat dhe përgjegjësitë zyrtarëve arsimorë për organizimin e aktiviteteve që lidhen me mësimin në distancë, kanë krijuar rrjetet e komunikimit me drejtorë të shkollave dhe përmes tyre me mësimdhënës. Në linjë me kërkesat e MASHTI-it, në periudha javore, shkollat raportojnë në DKA, DKA-të e përgatisin dhe dërgojnë raportin javor në MASHTI dhe pastaj MASHTI përgatit raport javor në nivel vendi.

Raportet që dërgohen nga shkollat kryesisht kanë një strukturë, në të cilën pasqyrohen të dhënat e përgjithshme për nxënës, numrin e nxënësve të përfshirë në mësimin në distancë, numrin e nxënësve që nuk janë përfshirë në arsimin në distancë, arsyet specifike të mospërfshirjes, si: mungesa e pajisjeve, mungesa e internetit, fëmija punon, nuk ka interesim, fëmijë me nevoja të veçanta, mungesa e sinjalit për RTK 4, pamundësia e kontaktimit apo jashtë vendit. Në raporte nuk pasqyrohen masat që janë ndërmarrë nga java në javë për të rritur pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin në distancë dhe për motivimin e nxënësve për angazhim në mësim.

Megjithatë, nga MASHTI raportohet se mobilizimi i shkollave dhe DKA-ve është mbi pritjet. Ndërsa, prindërit e kanë tejkaluar vetveten. Pjesëmarrja e nxënësve në mësimin në distancë është mbi 90 %. Sfidat kryesore mbeten

- 
- të bëjë vendosjen e parametrave kryesorë të platformës për mësimin në distancë (ose mësimin e digjitalizuar në Kosovë).

cilësia e video-materialeve; vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimdhënësit dhe të nxënësit (familjet), mungesa e kushteve shkollore në shtëpi, mospjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga familjet me kushte të rënduara.

Çështjet në shqyrtim e sipër nga MASHTI, për të cilat duhen vendime për të vazhduar mësimin në distancë dhe për të përfunduar këtë vit mësimor, janë kryesisht testet e standardizuara, përfundimi i vitit mësimor/shkollor, si të sigurohet sa më shumë cilësi e shërbimeve arsimore; A të bëhet mësim plotësues? Kur do të rifillojë mësimi në shkolla? etj.

Ndërsa, orientimet e MASHTI-t për të ardhmen në arsimin parauniversitar, pasi të kalojë gjendja me pandeminë COVID-19, lidhen me integrimin e mësimin online në sistemin arsimor të Kosovës, për nevoja të fëmijëve në Kosovë dhe në diasporë.

## **KONKLUZIONE**

Përgatitjet për përgatitjen e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar nuk kanë qenë të lehta, për shkak të rrethanave të krijuara, pasi që sistemi arsimor nuk ishte i përgatitur për një modalitet të tillë të mësimin dhe të mësimdhënies.

Papërgatitja e mësimdhënësve për mësim në distancë, mungesa e teknologjisë për mësimdhënës dhe nxënës, koha e shkurtë, mungesa e strukturave përkatëse për mësimin në distancë, mungesa e përvojës së MASHTI-t, mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë, ishin sfidat kryesore që kërkojnë adresim të shpejtë për realizimin e mësimin në distancë.

MASHTI, me mbështetjen e mësimdhënësve të Komunës së Prishtinës, pastaj edhe të Prizrenit, të kompanive të teknologjive të reja (Kallxo.com, Gjirafa, Microsoft, Link Plus) dhe të RTK-së, brenda 10 ditësh nga ndërprerja e mësimin në shkollë, ka arritur që të fillojë mësimin në distancë, fillimisht për nivelin fillor ( klasat 1-5) dhe pastaj edhe për nivelin e dytë ( klasat 6-9), duke e ofruar atë në mënyrë të centralizuar, përmes RTK-së dhe kanalit të MASHTI-t në ‘YouTube’.



MASHTI ka nxjerrë shtatë dokumente, të cilat përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve dhe ofrojnë udhëzime për aspektet që mbulojnë lidhur me realizimin e mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në dokumentet e zhvilluara nuk detajon udhëzime për zbatimin e kurrikulës, përcaktimin e temave kryesore që duhet të realizohen gjatë mësimit në distancë, ose vendim për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Kjo ka bërë që mësimi në distancë të vazhdojë nga aty ku është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë, për shkak të pandemisë COVID-19.

MASHTI ka përgatitur skemën e menaxhimit të mësimit në distancë, në kuadër të kabinetit të ministres së Arsimit, me dy zëvendësministrat, të cilët i kanë ndarë përgjegjësitë për të koordinuar mësimin në distancë, përgjegjësitë për pjesën pedagogjike dhe për komunikimin me DKA-të dhe shkollat. Për ecurinë e mësimit në distancë, nga niveli i shkollës deri te MASHTI, përgatiten raporte javore, në përpjekje për të identifikuar nxënësit dhe mësime të cilat nuk marrin pjesë në mësimin në distancë dhe arsyet. Nuk ka të dhëna për masat që janë ndërmarrë deri më tani për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve dhe motivimin e tyre për mësime në distancë.

Sfida kryesore mbeten cilësia e mësimit në distancë, përfshirë cilësinë e video-materialeve dhe cilësinë e qasjeve të mësimeve që i praktikojnë mësime të cilat gjatë mësimit në distancë, pastaj vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimeve të cilat gjatë mësimit në distancë dhe të nxënësve (familjet), mungesa e kushteve shkollore në shtëpi, mospjesëmarrja në mësime të cilat gjatë mësimit në distancë nga familjet me kushte të rënduara.

Si përfundim, mësimi në distancë/e-mësimi, në këto rrethana, është një mundësi e mirë për të mësuar për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësime të cilat gjatë mësimit në distancë dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimit online në sistemin arsimor të Kosovës, i cili duhet të jetë në shërbim të të gjithë fëmijëve në Kosovë dhe në diasporë.

## Burimet dhe literatura:

1. Implikimet e koronavirusit të ri (COVID-19) në arsim dhe trajnime: Gjendja në shtetet anëtare (Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training: State-of-play in Member States), Presidenca Kroate e Këshillit të Bashkimit Evropian, Versioni i 9-të i 31.03.2020.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
3. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë*, [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti_1.pdf)
4. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta (SHML)*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf)
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Udhëzime për DKA për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf)
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Përdorimi i platformës Zoom – Zoom – us*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf)
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimin në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta*. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë*, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). *Vendimi 25/01B për procedurat realizimit të vlerësimin të nxënësve gjatë mësimin në distancë*. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf>

10. Motivimi i fëmijëve gjatë mësimit nga shtëpia, UNESCO 2020, <https://en.unesco.org/news/resources-parents-and-teachers-motivating-supporting-children-during-remote-learning>
11. Qeveria e Republikës së Kosovës (11 mars 2020). *Vendim për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet...*, <https://kryeministri-ks.net/dokumente/page/3/>
12. Udhëzues mbi mësimin në distancë & COVID19, versioni i 7 prillit 2020, Banka Botërore <http://documents.worldbank.org/curated/en/531681585957264427/pdf/Guidance-Note-on-Remote-Learning-and-COVID-19.pdf>
13. Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID0-19, versioni i 17 prillit 2020, Banka Botërore <http://documents.worldbank.org/curated/en/659411587145759242/pdf/Rapid-Response-Guidance-Note-Educational-Television-COVID-19.pdf>



## **1.4. ECURIA E ZHVILLIMI TË MËSIMIT NË DISTANCË NË DISA VENDE TË BE-së DHE NË VENDET E BALLKANIT**

Murteza Osdautaj

Epidemia, që u shfaq papritur në Evropë dhe në botë, i solli sistemet arsimore të vendeve të ndryshme para një sfide të paplanifikuar. Thuaja të gjitha vendet e botës u detyruan që t'i mbyllin shkollat dhe, si pasojë, të fillonin një lloj të ri të mësimin dhe një variant të ri të shkollës. Kjo bëri që të gjitha vendet të fillojnë mësimin në distancë dhe, duke e zhvilluar këtë proces, të zhvillojnë një formë të re të shkollës, versionin virtual.

Më poshtë do t'i paraqesim disa nga përvojat dhe masat që kanë pasur dhe kanë ndërmarrë disa vende të Ballkanit (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia) dhe disa vende të BE-së (Kroacia, Sllovenia, Lituania, Letonia) për zhvillimin e mësimin në distancë. Duke i parë sistemet dhe mënyrën e funksionimit të tyre, do të shohim se cilat ishin masat e ndërmarra, cilat ishin vështirësitë, mungesat, aktorët e angazhuar, si funksionon sistemi dhe sa dhe në çmasë po e arrin qëllimin e tij.

### **1. ORGANIZIMET SHTETËRORE TË DISA VENDEVE TE BALLKANIT NË LIDHJE ME APLIKIMIN E MËSIMIT Ë DISTANCË**

#### ***SHQIPËRIA***

Pas përhapjes së infektiveve me virusin Covid -19, Shqipëria menjëherë ndërmori masa emergjente, që ta parandalonte përhapjen e këtij virusi. Ndër masat e ndërmarra nga qeveria e vendit ishte mbyllja e menjëhershme e shkollave në të gjitha nivelet. Kjo bëri që të lindë nevoja e menjëhershme e zhvillimit të një procesi mësimor në rrethana dhe kushte shtëpie, i cili filloi më 9 mars 2020.

Në këto rrethana, pa shumë parapërgatitje paraprake, u bënë përpjekjet e organizimit të mësimin online, i cili së pari u zhvillua në nivel rrethesh e

shkollash e më vonë mori karakter gjithëkombëtar. Në përgjithësi, në Shqipëri mësimi është zhvilluar përmes programit të RTSH-së ‘RTSH shkolla’ dhe përmes medimeve të tjera, të cilat janë krijuar apo janë përshtatur më vonë, siç është angazhuar edhe një platforme që quhet Akademi.al, por edhe një numër i platformave të tjera virtuale dhe forma të kontaktit direkt nxënës-mësues, nëpërmjet Googl.class, Zoom, apo të ndonjë mediumi tjetër.

Për ta parë funksionimin e sistemit në Shqipëri, janë organizuara dy sondazhe, të cilat kanë pasur për qëllim konstatimin e gjendjes lidhur me mësimin online dhe lidhur me perceptimin në të cilin ka hasur kjo mënyrë e re e zhvillimit të mësimin.

Për të vlerësuar angazhimin e palëve në këtë proces, efektshmërinë e tij, si dhe mënyrat për përmirësimin e zbatimit të tij, ASCAP ka hartuar dhe, përmes DPAP-së, ka administruar një sondazh me mësues, nxënës dhe prindër për mësimin online. Sondazhi është administruar online dhe ka qenë i hapur për një periudhë 4-ditore. Sondazhi kishte për qëllim të shohë dhe të:

- të vlerësojë efektivitetin e mësimin në kushtet e shtëpisë dhe të formave të zhvilluara nga mësuesit, shikuar nga këndvështrimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve;
- të evidentojë përvoja pozitive dhe të bëjë shpërndarjen e këtyre përvojave;
- të orientojë vendimmarrje që mbështeten në të dhëna;
- të nxisë dialogun mes nxënësve, prindërve dhe mësuesve, me qëllim përmirësimin e mësimin në kushtet e shtëpisë.

Sipas raportit të publikuar online, në këtë sondazh kanë marrë pjesë 178 096 nxënës, 118 376 prindër dhe 25 439 mësues. Nga ky sondazh janë nxjerrë disa konkluzione, që lidhen me pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në mësimin në distancë, mësimet e transmetuara në “RTSH-Shkolla” dhe për aspekte të tjera që lidhen më mësimin në distancë në këto rrethana. Rezultatet e sondazhit janë pozitive sa i përket realizimit të mësimin në distancë, kryerjes së detyrave nga nxënësit, partneritetit me prindër etj. Si konkluzion ka dalë fakti se angazhimi i mësuesve në mësimin

online i përballi ata me sfida të reja. Ata duhet t'i përshtatin stilet e mësimdhënies, duke marrë parasysh nevojat dhe mundësitë e nxënësve, si dhe duhet të zotërojnë njohuri dhe aftësi në përdorimin e teknologjisë. Pavarësisht sfidave, mësimi online është e ardhmja për shkollat e shekullit XXI dhe me gjithë përballjen e menjëhershme të mësuesve dhe të nxënësve me këtë lloj mësimi, ai do të shërbejë në të ardhmen si burim i rëndësishëm i procesit të të nxënësve. Më gjerësisht mund të shikohet raporti i publikuar online<sup>18</sup>.

Ministria e Arsimit ka hartuar udhëzues për realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë<sup>19</sup>. Ky dokument i paraqet kushtet dhe mënyrat të cilat duhet të përdoren që mësuesi të jetë në gjendje të bëjë realizimin e planit dhe programit mësimor, vlerësimin e nxënësve në 'kushte të shtëpisë'.

Dokumenti përfshin disa aspekte të zhvillimit të procesit mësimor në kushte karantine dhe jep shpjegime dhe udhëzime për këto elemente:

- Vijueshmëria e mësimin në kushtet e shtëpisë;
- Realizimi i programit lëndor;
- Procedurat e vlerësimin të nxënësve në klasat 1-3;
- Procedurat e vlerësimin të nxënësve në klasat 4-12;
- Mbajtja e notave të periudhës gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë, si dhe raportimi i tyre te nxënësit dhe te prindërit;
- Nxënësit me aftësi të kufizuara etj.

### ***Disa aspekte që vërehen***

Në Shqipëri ka vështirësi të mëdha në klasat virtuale , sidomos me kontaktin mësues – nxënës, ngase më shumë se 90% të nxënësve, mësuesve dhe prindërve, për komunikim dhe për zhvillim të materies mësimore përdorin telefonat mobilë, ndërsa që një numër fare i parëndësishëm përdorin tabletë

---

<sup>18</sup> Shih Sondazhi i mësimin online, perceptime të nxënësve, prindërve dhe mësuesve, mars 2020 <file:///C:/Users/USER/Downloads/Sondazhi-i-m%C3%ABsimit-online.pdf>

<sup>19</sup> [https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-te-shtepise\\_.pdf](https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-te-shtepise_.pdf)

apo kompjuterë. Kjo ndikon në mbingarkesën e mësuesve dhe të nxënësve, por, gjithsesi, edhe të prindërve.

Situata ka filluar ta rëndojë buxhetin e mësuesve, ngase tash kanë filluar të ndalen beneficionet, të cilat mësuesit i merrnin në formë të shtesave.

Qëndrimet e ekspertëve dhe të analistëve të procesit mësimor në kushte shtëpie nuk janë në pajtim me dy sondazhet e kryera nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë. Në këtë analiza dhe deklarime paraqiten problemet e këtij lloji sistemi të arsimit, sidomos në përdorimin e teknologjive informative dhe të materialeve mësimore.

### ***MAQEDONIA E VERIUT***

Me rastin e rekomandimeve të OBSH-së, Qeveria e Maqedonisë ndaloi zhvillimin normal të procesit mësimor nëpër shkolla. Kjo bëri që të fillohet sa më shpejt në përgatitjen e sistemit paralel të mësimin në distance. Për këtë arsye, Maqedonia e Veriut rekomandoi Radiotelevizionin e Maqedonisë që, rregullisht, në baza ditore, të ndajë hapësirë për program edukativo-arsimor të dedikuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe nxënës të arsimit fillor, që do të përgatitet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit, në bashkëpunim me kuadrin edukativo-arsimor nga kopshtet për fëmijë dhe shkollat, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, UNICEF-in dhe të gjitha institucionet relevante arsimore. Gjithashtu, obligohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës që materialet edukative t'i shpërndajë në të gjitha rrjetet dhe kanalet sociale.

Deri tash kemi informacion se mësimi zhvillohet në të gjitha gjuhët në të cilat edhe më parë ishte zhvilluar sistemi i rregullt. Televizioni, në bashkëpunim me ministrinë maqedonase ka krijuar një platformë televizive që quhet 'TV Klasa', me një orar dhe një sistem orësh mësimore, të cilat ofrohen për të gjitha nivelet e shkollave para universitare dhe në të gjitha gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi dhe sidomos në maqedonisht dhe shqip.<sup>20</sup>

---

<sup>20</sup> <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/3134-intensifikohen-oret-ne-kuader-te-programit-edukativ-tv-klasa-ne-rtvm>



Maqedonia iu ka preferuar shkollave dhe mësuesve gjithashtu që të përdorin edhe mjete, platforma dhe aplikacione interneti, të cilat do t'ua lehtësonin punën e tyre edukativo-mësimore. Në këtë aspekt, ndihmë të mirë ka dhënë platforma e UNICEF-it në Maqedoni dhe mësuesit mund ta lehtësojnë punën e tyre mësimore duke përdorur mjetet dhe materialet që ofron kjo platformë.<sup>21</sup>

Pas paraqitjes së problemeve të vlerësimit, ministria maqedonase ka hartuar edhe udhëzimin për vlerësimin e fëmijëve që ndjekin mësimin në distancë<sup>22</sup>, në të cilin janë përcaktuar kritere dhe mënyra të vlerësimit.

Sipas të dhënave, përveç mësimin nga televizionet maqedonase, në shumë raste vërejmë përdorim të theksuar të aplikacioneve për komunikim, siç janë Viber, Zoom, Whatsup etj.

Duhet cekur se Maqedonia e Veriut, deri tash, nuk ka zhvilluar ndonjë studim apo sondazh për të parë së në ç'mënyrë dhe me sa sukses po zhvillohet mësimi në distancë në këtë vend.

## ***MALI I ZI***

Një nga vendet e organizuara të Ballkanit në lidhje me mësimin në distancë është Mali i Zi. Në këtë vend, që nga data 13 mars, janë marrë masa të menjëhershme për t'i zvogëluar pasojat e mundshme nga pandemia e virusit Covid-19.

Menjëherë pas vendimin për mbylljen e shkollave fillore dhe të mesme të vendit, shteti ka aktivizuar platformën shtetërore ‘, #UciDoma’ (#mëson'shtëpi). Kjo platformë u zhvillua dhe u funksionalizua përmes angazhimit dhe përfshirjes transmetimit të video-materialeve nga 14 lëndë, në përputhje me kërrikullin, në: matematikë, gjuhë, anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht dhe rasisht, histori, gjeografi, sociologji, kimi, biologji, fizikë dhe informatikë. Ligjëratat transmetohen në 3 kanale televizive - TVCG 2, MNE Sport 1 dhe MNE Sport 2, të cilat janë rriemëruar

---

<sup>21</sup> <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk>

<sup>22</sup> <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/3160-udhezim-per-mesimdhesisit-per-menyren-e-vleresimit-te-nxenesve-gjate-periudhes-se-realizimit-te-mesimit-permes-mesimit-ne-distanc-perkatesishte-mesimit-nga-shtepia>

në kanale të quajtura ‘UciDoma’, dhe do të kenë gati 100% mbulim në Mal të Zi, që do të thotë se, praktikisht, është bërë mbulim, thuaja i plotë, i hapësirës së Malit të Zi dhe janë krijuar kushtet për angazhimin e të gjithë fëmijëve të vendit.

Materialet do të jenë të disponueshme në një kanal të përgatitur posaçërisht në ‘YouTube’, i quajtur ‘#uci doma’, i cili është praktik dhe i arritshëm dhe i sinkronizuar sipas klasave. Për më tepër, përmbajtja arsimore për një pjesë të madhe të lëndëve profesionale do të sigurohet nga vetë shkollat, sipas planit për realizimin online të mësimdhënies të përgatitur nga Qendra për Arsim.

Gjatë ditës së parë të procesit #UciDoma, i transmetuar në RTCG2 u shikua nga 103.572 qytetarë. Ai kishte rreth 85,000 vizita nga 41,000 përdorues dhe që nga java e dytë pritet shifrat të kalojnë 60,000 përdorues dhe rreth 145,000 vizita. Më vonë u krijuan dy transmetime #ucidoma 1 dhe #ucidoma 2 dhe programi #LearnDLL.

Duhet cekur se kontribut të mirë kanë dhënë edhe portalet dhe institucionet tjera të vendit. Kështu vlen të përmendet se procesit i ka kontribuar shumë portali për mësues [www.skolskiportal.edu.me](http://www.skolskiportal.edu.me), por edhe shkollat individuale me faqet e tyre, në të cilat kanë vendosur materiale mësimore që i kanë prodhuar vetë.

Ditët e fundit, në bazë të kërkesave të mëdha nga nxënësit dhe arsimtarët, Shoqata e pedagogëve të Malit të Zi, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Arsimit, ka hartuar dhe ka publikuar një udhëzim të hollësishëm (Osnovne metodičke smjernice za organizaciju i sprovođenje učenja na daljinu u uslovima vanrednih okolnosti)<sup>23</sup> në lidhje me vlerësimin e nxënësve gjatë mbajtjes së procesit të mësimin nga largësia.

Udhëzimi është një dokument shumë i hollësishëm dhe përmban një varg udhëzimesh dhe teknikash, të cilat janë të standardizuara, por edhe të jashtëzakonshme, e të cilat duhet të merren parasysh në vlerësimin e nxënësve.

---

<sup>23</sup> <http://www.skolskiportal.edu.me/Lists/Novosti/Attachments/248/Prirucnik.pdf>

## **SERBIA**

Sipas të dhënave dhe dokumenteve në dispozicion, Serbia e ka filluar sistemin e saj arsimor nga distanca më 16 mars 2020. Me anë të një dekreti qeveritar, i cili u është shpërndarë shkollave dhe komunitetit shkollor, janë shpjeguar mënyrat dhe rrugët se si duhet të organizohet ky lloj mësimi në tërë territorin e Serbisë. Në bazë të kësaj shkrese<sup>24</sup>, organet shkollore të vendit obligohen t'i ndërmarrin të gjitha masat ashtu që të fillohet me këtë mënyrë të re të mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të vendit.

Ndër elementet që duhet t'i përmendim e që, në të vërtetë, janë masa të obligueshme janë këto:

- a) Drejtorët e shkollave duhet të sigurojnë kushtet e nevojshme teknike dhe të komunikimit për mësimdhënie në distancë për ata mësues që nuk i kanë këto kushte në shtëpi;
- b) Mësimdhënësit që kanë përvojë në aplikimin e TIK-ut në mësimdhënie mund të përdorin mjete të ndryshme për të vendosur teste njohurish, ushtrime praktike, vlerësim të detyrave të shtëpisë dhe produkte të tjera;
- c) Në një situatë kur nuk ka komunikim të drejtpërdrejtë midis mësuesve dhe nxënësve, duhet të hartohen dhe zbatohen mënyra të ndryshme të monitorimit indirekt të përparimit të nxënësve;
- d) Gjatë planifikimit të mësimin në distancë, mësuesit duhet të mendojnë gjithashtu për mënyrat për të monitoruar përparimin e nxënësve për secilën temë brenda kurrikulës, duke marrë parasysh aftësitë teknike të familjeve dhe studentëve.

Gjithashtu, nëpërmjet një dokumenti udhëzues të Ministrisë serbe të Arsimit, në të cilin flitet për përgatitjet e përgjithshme për fillimin dhe aplikimin e mësimin në distancë, janë përcaktuar disa nga kërkesat që ministria i ka parashtruar ndaj shkollave, nxënësve dhe prindërve, dhe masat që ajo i ka ndërmarrë në lidhje me zhvillimin e mësimin në distancë. Ndër masat e aktivitetet që i përmend dhe i ndërmerr ministria a atjeshme mund t'i

---

<sup>24</sup> <http://www.mpn.gov.rs/wp-content/uploads/2020/03/Nastava-na-daljiniu-u-vanrednom-stanju.pdf>

përmendim këto, të cilat konsiderojmë se e përbejnë boshtin kurrizor të tërë sistemit arsimor serb të mësimin në distancë:

- Në baza ditore, duke filluar nga ora 8.00, gjashtë ditë në javë, do të transmetohen përmbajtje arsimore të përgatitura dhe të adaptuara posaçërisht për nxënësit e shkollave fillore, të cilat përfshijnë njësitë e përpunuara të lëndëve të zgjedhura, në përputhje me kurrikulën;
- Orët do të transmetohen në RTS 3, sipas një orari të bazuar në bazë klase, i cili do të jetë i disponueshëm në faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik ([rasprednastave.gov.rs](http://rasprednastave.gov.rs)) një ditë para transmetimit;
- Përmbajtja arsimore do të transmetohet në blloqe prej dy orësh në ditë për të gjithë nxënësit në klasat 1-7;
- Për klasën e 8-të nxënësit do të marrin përmbajtje arsimore në blloqe prej tri orësh në ditë, dy prej të cilave gjithnjë do të jenë gjuhë serbe dhe matematikë dhe ora e tretë do të jetë prej një nga lëndët e marra në provimin përfundimtar. Kjo duhet të kihet parasysh kur planifikoni mbështetje shtesë për mësuesit e lëndëve (prezantime, detyra praktike);
- Shkolla online do të organizohet edhe për pakicat kombëtare.
- Për nxënësit që kanë nevojë për një qasje të strukturuar të individualizuar të punës, d.m.th. për Plan Individual të Edukimit (IOP), IOP-1, IOP-2 dhe IOP-3, mësuesit duhet të përgatisin materiale të veçanta mësimore dhe t'i bëjnë ato të arritshme për nxënësit në një farë mënyre ata pajtohen me prindërit e tyre;
- Ndërmerren masa informative për fëmijët që s'kanë qasje në internet në lidhje me orarin dhe mënyrën e ndjekjes së mësimin në distancë, etj.<sup>25</sup>.

---

<sup>25</sup> Shih në: Saopštenje ministarstva prosvete u vezi sa operativnim planom za nastavak rada škola u otežanim uslovima uz program učenja na daljinu za učenike osnovnih i srednjih škola

## **Platformat elektronike dhe televizive për zhvillimin e mësimit në distancë**

Sistemi serb i mësimit nga largësia ka tri burime themelore të mësimit në distancë, të cilat këtu po i quajmë platforma. E para dhe më e rëndësishmja është kanali i tretë i RTS, ku përgatiten dhe transmetohen sipas orareve të përcaktuara materialet mësimore, të cilat, në 90% të rasteve, kanë orë mësimore të mbajtura nga mësues të lëndëve që transmetohen në formë videoje. Pjesa e tjetër e materialeve të transmetuara janë vdeo-animime apo materiale të tjera, të cilat përdoren për ta konkretizuar materien mësimore. Enti për zhvillimin e arsimit në Serbi ka ofruar edhe një platformë shtesë, me të cilën ajo iu ofron mësuesve mjete për zhvillimin e mësimit nga largësia<sup>26</sup>.

Platformë tjetër është platforma online e internetit ‘Shkolla ime’ (Moja Skola <https://www.mojaskola.gov.rs>), në të cilën nxënësit dhe mësuesit mund të hapin llogari individuale dhe të kenë qasje në materiale mësimore të ndryshme, si tekste mësimore, orë mësimore, video- incizime për lëndë e tema të caktuara, si dhe aplikacione të ndryshme që ndihmojnë për zhvillimin e materieve mësimore.

Platforma e tretë është një rrjet që quhet ‘solidariteti digjital’ (<https://www.digitalnasolidarnost.gov.rs/>), në të cilin, pa pagesë, mund të qasesh në materiale që ofrohen nga të gjitha platformat e tjera, por edhe materiale që, specifikisht, ofrohen nga institucione dhe individë.

Interesante është se në të gjitha faqet e internetit të shkollave, gjithashtu, shpërndahen materiale specifike që krijohen nga mësues të shkollave specifike dhe kjo ka bërë që materialet mësimore të jenë të shumta dhe të llojllojshme.

Serbia ka arritur që ta konsolidojë shpejt sistemin e saj arsimor, për shkak të përgatitjeve dhe platformave që më parë ishin të përgatitura. Gjithashtu, ajo ka organizuar edhe organizime në nivele rajonale, komunale, të shkollave të profileve të njëjta dhe të shkollave individuale. E tërë kjo i ka mundësuar që të gjitha segmentet (transmetimet televizive, platformat online, platformat rajonale, të shkollave të profileve të njëjta dhe të shkollave individuale) të

---

<sup>26</sup> <https://zuov.gov.rs/alati/>

funksionojnë tepër mirë, ashtu që procesi mësimor të kalojë jo shumë më ndryshe se arsimi në kushte shkolle. Kjo formë gjithashtu e ka krijuar bazën që platformat serbe të mësimin online të jenë funksionale dhe të përgatitura edhe për funksionim në kushte normale.

## **2. ORGANIZIMET SHTETËRORE TË DISA VENDEVE TË BESË NË LIDHJE ME APLIKIMIN E MËSIMIT Ë DISTANCË**

### ***KROACIA***

Edhe Kroacia, si shumë vende të tjera, mësimin në distancë (nastavu na daljinu) e ka filluar më 16 mars, fillimisht në rajonin e Zagrebit e pastaj edhe në rajone të tjera. Qeveria, në ndërkohë, ka ndërmarrë të gjitha masat që ky sistem të funksionojë mirë, duke i angazhuar të gjitha institucionet e vendit, ato që kanë të bëjnë me teknologjinë informative dhe atë që kanë të bëjnë me transmetimet audio-vizuele.

Kroacia njihet që e ka të ndërtuar një sistem bukur të mirë të mësimin në distancë, i cili, edhe pse në kohën normale nuk ishte aq shumë i përdorur, u bë një mjet i pazëvendësueshëm në ditët kur filloi sistemi i mësimin nga largësia. Një nga projektet e Kroacisë është edhe platforma e e-shkollës (*e-skola*) që këto ditë është shumë funksionale. Angazhim të lartë po shënojnë edhe platformat dhe rrjetet digjitale si CARNET ([www.carnet.hr](http://www.carnet.hr)) dhe sidomos nënplatforma e këtij rrjeti shumë funksional, shkolla për jetën (*skola za zivot*). Televizioni shtetëror kroat HRTV dhe një varg televizioneesh tjera kombëtare dhe rajonale.

Në përgjithësi, Kroacia ka organizuar mësimin nga largësia nëpërmes nënprogramit të CARNET, që quhet klasa virtuale (virtualna ucionica). Në lidhje me këtë, Ministria e Kroacisë ka shpërndarë një udhëzues<sup>27</sup> se si duhet të jetë i organizuar mësimi dhe se si duhet të funksionojë sistemi.

Sipas këtij udhëzuesi, qeveria shkollat dhe mësuesit duhet të ndjekin një varg hapash, të cilët ndihmojnë riorganizimin e mësimin në distancë dhe i

---

<sup>27</sup> <https://mzo.gov.hr/vijesti/smjernice-osnovnim-i-srednjim-skolama-vezano-uz-organizaciju-nastave-na-daljinu-uz-pomoc-informacijsko-komunikacijske-tehnologije/3585>

njëti të ketë sukses. Po i paraqesim këtu disa nga çështjet kryesore që i përfshin ky udhëzues. Udhëzimi kërkon që drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme, bazuar në nivelin e tyre, të organizohen të gjithë në një klasë virtuale ku do t'i mbarshtrajnë aktivitetet e zhvillimit të procesit mësimor. Kërkesë tjetër e qeverisë është që të gjithë nxënësit e shkollave fillore të krijojnë sa më shpejt llogaritë e tyre në kuadër të platformës 'shkolla për jetën'. Gjithashtu, në udhëzues kërkohet që shkollat ta krijojnë 'dhomën e tyre të takimeve' në kuadër të Teams, Yammer, Moodle etj., dhe pastaj çdo mësues të hapë për nxënësit e tij klasën virtuale për ta zhvilluar mësimin lëndor, si dhe krijimin e grupeve për komunikim në mes të nxënësve dhe mësuesve, përmes aplikacioneve si Viber, WhatsApp, Facebook, e-mail, telefon etj.<sup>28</sup>

***Sondazhi i botuar për mësimin në distancë.*** Qeveria e Kroacisë ka dashur që ta masë dhe ta analizojë mbarëvajtjen dhe problemet që kanë dalë për periudhën sa është duke u aplikuar mësimi në distancë. Duhet të ceket se, për shkaqe ekonomikiteti, sondazhi i Kroacisë nuk është zhvilluar në tërë Kroacinë, por është kufizuar vetëm në rajonin e Zagrebit. Sondazhi i realizuar është publikuar më 6 prill 2020. Sipas këtij sondazhi, del se pothuajse të gjithë mësuesit dhe nxënësit (95%) janë plotësisht ose kryesisht të kënaqur me mësimin e zhvilluar në distancë. Pjesa më e madhe e mësuesve (90%) mendojnë se nxënësit e tyre e pranojnë mirë ose përgjithësisht mirë arsimin në distancë. Po sipas këtij sondazhi, ka dalë se mësuesit dhe nxënësit janë kryesisht të kënaqur me pajisjet që kanë. Përkatësisht, 93% e tyre janë të kënaqur ose kryesisht të kënaqur me pajisjet që i kanë në dispozicion në fushën e mësimin në distancë. Nxënësit dhe mësuesit kroatë, në mënyrë të veçantë, 87% besojnë se mbështetja që marrin nga CARNet dhe MM është e mirë. Sidoqoftë, duhet të theksohet se rreth 13% e tyre nuk janë të kënaqur me këtë mbështetje, sidomos të pakënaqur ishin në javën e parë të orëve të mësimin, kur pati probleme me lidhjet dhe hyrjen në klasa virtuale. Më gjerësisht shih raportin e publikuar online<sup>29</sup>.

---

<sup>28</sup> Shih për më shumë në linkun e paraqitur më lartë.

<sup>29</sup> Të gjitha rezultatet dhe përqindjet mund t'i gjkeni në: <https://skolazazivot.hr/rezultati-upitnika-o-izvodenju-nastave-na-daljnu-od-16-3-2020-do-2-4-2020/>

### ***Udhëzimi i vlerësimit të nxënësve që ndjekin mësimin në distancë***

Me qëllim të lehtësimit të punës së personelit mësimor në shkollat fillore dhe të mesme të Kroacisë, Ministria e Arsimit, më 3 prill, publikoi dokumentin e quajtur Udhëzime për vlerësimin dhe vlerësimin gjatë mëimit në distancë (Upute za vrednovanje i ocjenjivanje tijekom nastave na daljinu), në të cilin ka vënë një numër udhëzimesh se si të vlerësohet puna e nxënësve gjatë kësaj periudhe të mbajtjes së mëimit në distancë.

Për të mos analizuar dhe interpretuar tërë dokumentin, do t'i paraqes disa nga pikat kryesore të tij dhe elementet se ku është fokusuar shteti kroat.

- Në kapitullin e parë të udhëzimit paraqiten parimet e vlerësimit në distancë, në të cilin janë përshkruar disa nga parimet bazë në të cilat është bazuar dokumenti dhe në të cilat duhet të bazohen mësuesit;
- Pjesa e dytë paraqet elemente që duhet t'i kemi parasysh në vlerësimin e nxënësve në ambiente virtuale;
- Pjesa e tretë e dokumentit ndalet për t'i sqaruar metodat dhe qasjet, sipas së cilave duhet të kryhet vlerësimi i nxënësve;
- Pjesa e katërt e dokumentit përshkruan disa nga qasjet dhe propozimet inovative në vlerësimin e nxënësve, kurse në pjesën në vazhdim bëhen propozime të vlefshme se si dhe në ç 'mënyrë të bëhet vlerësimi dhe shpërblimi i punës dhe i aktivitetit të nxënësve;
- Në pjesët tjera shpjegohet vlerësimi në mësimin klasor, vlerësimi i shkathësive praktike të nxënësve, si dhe jepen disa premisa për organizimin e maturës shtetërore, nëse për këtë gjë shteti arrin t'i krijojë kushtet<sup>30</sup>.

### ***Dokumente dhe instrumente të tjera, të cilat Ministria kroate i propozon për mbarëvajtjen e mëimit në distancë***

Përveç dokumenteve kryesore, të cilat u prezantuan më lart, Ministria kroate propozon që të përdoren edhe një varg instrumentesh të tjera, në mënyrë që sistemi arsimor i vendit të arrijë efikasitet dhe efektivitet. Në këtë vazhdë

---

<sup>30</sup> Për më shumë rreth përmbajtjes specifike të dokumentit, ju lus ta vizitoni vegëzen: <https://skolazazivot.hr/upute-za-vrednovanje-i-ocjenjivanje-tijekom-nastave-na-daljinu/>



vlen të veçohen disa nga dokumentet dhe instrumentet që janë propozuar të përdoren nga shteti kroat.

Dokumenti i parë që propozohet të përdoret është udhëzimi për organizimin e ditës së punës së nxënësve gjatë kohës së organizmit të mësimin në distancë (Preporuke o organizaciji radnoga dana učenika tijekom održavanja nastave na daljinu)<sup>31</sup>, në të cilin jepen udhëzime të qarta se si dhe në ç'mënyrë shkolla dhe familja duhet ta organizojnë ciklin ditor të nxënësve dhe të angazhimit të tyre në mësim.

Për ngritjen e cilësisë propozohet që të shfrytëzohen koleksionet e videove, të cilat janë të disponoheshë në faqen <https://skolazazivot.hr/4-razred-ss/> si dhe ka krijuar dy shtojca me udhëzime ku jepen këshilla praktike se si të kalohet me sukses vlerësimi. Emrat e dokumenteve janë shtojca 1 dhe shtojca 2 (*Dodatak 1 dhe Dodatak 2*)<sup>32</sup>.

Në dokumentin në fjalë flitet edhe për instrumente dhe udhëzimet për përdorimin e instrumenteve, të cilat ndihmojnë zhvillimin e tërësishëm të mësimin dhe të vlerësimit. Ndër to përmenden dhe jepen udhëzime përdorimi për: <https://loomen.carnet.hr/>, <https://classroom.google.com/h>, <https://office365.skole.hr/>, <https://www.edmodo.com>, <https://www.matific.com/hr>, Socrative e shumë instrumente të tjera.

Si konkludim mund të themi se Kroacia e ka kaluar tepër mirë fazën e parë të mësimin online dhe tash është në fazë të konsolidimit. Kroacia i ka angazhuar të gjitha resurset shtetërore dhe private në të mirë të zhvillimit të mësimin në distancë dhe, në këtë aspekt, konsiderojmë se është një nga vendet e suksesshme në organizmin e mësimin nga largësia në Ballkan dhe ndër vendet e suksesshme në kuadër të vendeve të përmasave të njëjta në BE.

---

31

<https://mzo.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Vijesti/2020/Preporuke%20o%20organiza%20ciji%20radnog%20dana%20ucenika%20tijekom%20odrzavanja%20nastave%20na%20daljinu.pdf>

32 Dokumente mund të shkarkohen në vegëzat:

<https://skolazazivot.hr/wp-content/uploads/2020/04/Dodatak-A-Primjeri-vrednovanja-nau%C4%8Denog-na-daljinu-v2.pdf>, dhe

<https://skolazazivot.hr/wp-content/uploads/2020/04/Dodatak-B-Digitalni-alati-za-vrednovanje-nau%C4%8Denog-2-4-2020-1.pdf>

## **SLLOVENIA**

Që nga 16 marsi 2020, të gjitha institucionet arsimore në Slloveni kanë pezulluar aktivitetet pedagogjike brenda objekteve shkollore dhe pedagogjike duke i zëvendësuar ato me punë online dhe individuale. Gjithashtu, janë pezulluar edhe aktivitete pedagogjike dhe të kujdesit në të gjitha institucionet parashkollore dhe çerdhe. Në një situatë të tillë, komunave dhe komuniteteve lokale iu është kërkuar të ndihmojnë duke mobilizuar vullnetarët, për të siguruar kujdesin e fëmijëve mbi baza individuale.

Në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor në Slloveni, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Sportit ka vënë kontakt të rregullt me të gjitha institucionet shkollore dhe në mënyrë të vazhdueshme lëshon udhëzime me shkrim për të gjitha institucionet arsimore, kërkimore, sportive dhe të rinisë. Udhëzimet për të cilat po flasim, sipas deklarimeve nga MASHS të Sllovenisë, azhurnohen në kohë reale dhe bazuar me nevojat dhe problematikat që dalin. Shkollat janë udhëzuar të krijojnë kontakte të rregullta me të gjithë aktorët përkatës (d.m.th. stafin pedagogjik, këshillat e prindërve, sindikatat e mësuesve, këshillat shkollore). Për të qetësuar situatën e mediave, shkollave u janë dhënë udhëzime për të adresuar të gjitha pyetjet e mediave direkt në shërbimin PR të Ministrisë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Sportit, së bashku me Institutin e Republikës së Sllovenisë për Arsim, iu ka propozuar shkollave të vendit përdorimin e sistemit SIO (Slovenian Education Network -Rrjeti Slloveni i Edukimit) si burim i vetëm mbështetjeje për të mbështetur drejtorët dhe mësuesit në zhvillimin e mësimin në distancë. Përmbajtjet e vëna në këtë faqe interneti azhurnohen dhe plotësohen vazhdimisht dhe shkollat pajisen në baza ditore me përmbajtje mësimore.

Edhe pse në javët e para kishte probleme për shkak të ngarkesës dhe për shkak të organizmit, në Slloveni, në javën e tretë dhe të katërt të mësimin, vërehet një konsolidim i plotë i sistemit.

Mjetet më të përdorura deri tash janë email-at, klasat virtuale, faqet e internetit dhe rrjetet sociale. Në SIO, shkollat kanë hapur klasa virtuale për nxënësit e tyre dhe, në çdo situatë, ekspertë të Institutit të Edukimit të Sllovenisë kanë qenë gjithashtu në gatishmëri të mbështetjes së mësuesve.

E rëndësishme të ceket është se gjatë tërë kohës sa po vazhdon mësimi online, janë organizuar dhe po organizohen seminare online për mësuesit pa përvojë paraprake, si dhe për ata që janë më pak të aftësuar në përdorimin e kanaleve dhe të mjeteve të arsimit në distancë. Kjo ka bërë që problemet fillestare në lidhje me shkathtësitë teknologjike të mësuesve të stabilizohen dhe mësimi të vazhdojë pa probleme.

Në lidhje me oraret, specifiku shteti nuk ka vënë rregulla strikte, por është vërejtur se orët mësimore në internet mbahen më së shpeshti në mëngjes dhe mbrëmje. Në përgjithësi, pothuajse të gjitha shkollat fillore dhe të mesme kanë regjistruar mësimin në distancë.

Shkollat e AAP gjithashtu po e zhvillojnë mësimin në distancë. Sidoqoftë, mësimi i bazuar në punë praktike, aktualisht, nuk kryhet në asnjë formë të arsimit AAP, duke përfshirë praktikën. Për këtë Ministria po kërkon një zgjidhje për këtë pjesë të sistemit arsimor, ngase, duke qenë pjesë vitale e shkollimit, viti shkollor dhe shkollimi nuk mund të konsiderohet i kryer, kjo sidomos për nxënësit e klasave të fundit të arsimit profesional.

Për një tranzicion të qetë në mësimin në distancë, ministria ka rekomanduar përdorimin e mjeteve dhe veglave të mëposhtme online:

- Librat e e-teksteve (për 41 lëndë të ndryshme nga klasa e 4-të e shkollës fillore deri në vitin e tretë të shkollës së mesme) janë bërë të disponueshme në <https://eucbeniki.sio.si/>;
- Jason, ku janë vendosur materiale dhe udhëzime mësimi për shkollat e mesme: <https://jazon.splet.arnes.si/>;
- Udhëzimet për përdorimin e TIK-ut në lëndë individuale me një listë të materialeve elektronike të dobishme në: <https://www.zrss.si/professional-results/digital-bar>;
- Komunitete në internet të mësuesve për lëndë ose fusha individuale: <https://skupnost.sio.si/>

Përveç të gjithave më lart, në marrëveshje me kanalin kombëtar televiziv, përmbajtja arsimore për gjashtë nivelet e para të arsimit fillor transmetohet në TV dhe puna intensive po vazhdon çdo ditë për të prodhuar materiale të përshtatshme.

Shkollat u udhëzuan që të bien dakord për një metodë dhe fushën e veprimtarisë për secilin nxënës në shkollë dhe, për ta bërë këtë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ngarkesës ditore dhe javore të nxënësit me detyrime në lëndë individuale në shkollë. Tashmë mësuesit kanë filluar me kurse, me ç'rast ata kanë përgatitur materiale mësimore dhe janë aftësuar me këtë lloj pune.

Sfiduese ka qenë dhe është ende pajisja me teknologji informative për zbatimin e mësimin në distancë. Kjo ka bërë që pabarazitë midis nxënësve po rriten për shkak të qasjes së ndryshme në internet dhe për shkak se jo të gjithë kanë kompjuterë, tableta etj., veçanërisht për ata nxënës me sfond ekonomik jo të mirë. Për këtë arsye, ministria ka bërë të mundur që mësuesit të bëjnë punë individuale me nxënës si dhe që personeli tjetër të angazhohet dhe të jetë në kontakt dhe të punojë me nxënës të shtresave jo të avancuara sociale. Kështu është urdhëruar që të angazhohen të gjithë psikologët e shkollave dhe, për më tepër, ministria, gjithashtu, ka inkadruar studentë nga fakultetet e arsimit për të ndihmuar në zhvillimin e një mjedisi të sigurt dhe stimulues të të mësuarit për të gjithë. Edhe pse, bazuar në faktet se shkolla si vend fizik mbetet ambienti parësor për të ulur pabarazitë në terren, mbrojtja civile po ndihmon, gjithashtu, duke iu siguruar nxënësve pajisjet e nevojshme për IT(kompjuterë, tabletë, etj.).

Ministria e Arsimit së bashku me Institutin Kombëtar të Arsimit kanë përgatitur rekomandime për shkollat se në çfarë duhet të përqendrohen gjatë zbatimit të mësimin në distancë dhe se si ta monitorojnë dhe vlerësojnë punën e bërë, gjithashtu me qëllim të provimeve përfundimtare.

Në Slloveni, shkollat kanë hapur klasa në internet për nxënësit e tyre dhe ekspertë të Institutit të Edukimit të Sllovenisë kanë mbështetur dhe mbështesin vazhdueshëm stafin mësimor. Për më tepër, seminare në internet (webinar) kanë qenë të disponueshëm për mësuesit pa përvojë paraprake, si dhe për ata që janë më pak të aftë në përdorimin e kanaleve të mjeteve të arsimit në distancë.

Në sistem janë vërejtur, gjithashtu, disa sfida, sidomos në ato institucione që punojnë me fëmijë dhe të rinj me vështirësi në sjellje dhe emocionale, pasi atyre iu mungon ambienti i duhur për përkujdesje dhe prandaj është vendosur që ato, disa më kryesoret, të mbesin të hapura.

Javët e fundit, për shkak të natyrës së veçantë të shkollave artistike, janë zhvilluar angazhime për hartimin e dokumenteve ligjore për ndërhyrje specifike në shkollat fillore (cikli i ulët), shkollat e arteve dhe ato muzikore për të mundësuar funksionimin e tyre të qetë deri në fund të vitit.

Ministria e Arsimit, gjatë tri javëve të para, ka arritur të hartojë dokumente dhe udhëzues për të gjitha problemet e identifikuara në javët e para të zhvillimit të mësimin në distancë në Slloveni. Sllovenia ka hartuar udhëzime dhe dokumente të nevojshme, qoftë duke u angazhuar që asnjë nga fëmijët të mos mbetet jashtë sistemit arsimor, gjithashtu të mos mbetet edhe pa pajisjet e duhura për të pasur qasje në mësimin në distancë. Të njëjtën gjë shteti e ka bërë edhe për mësuesit dhe pjesëtarët tjerë në sistem. Kjo është bërë e mundur përmes një intervenimi buxhetor që e ka bërë shteti slloven në shumën prej 50 milionë euro shtesë, gjë që ka mundësuar një sistem efikas gjatë kohës së krizës. E veçantë është edhe angazhimi i shpejtë dhe i menjëhershëm i institucioneve shtetërore ashtu që mësimi në distancë të ketë sukses. Angazhimi i menjëhershëm i studentëve të mësuesisë iu ka dhënë një ndihmë të madhe tërë faktorëve të sistemit dhe sidomos fëmijëve të marginalizuar dhe në gjendje jo të mirë sociale.

## ***ESTONIA***

E hëna e 16 marsit është dita kur shteti i Estonisë vendosi t'i mbyllë të gjitha institucionet arsimore (shkollat fillore, shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta, shkollat profesionale, institucionet e arsimit të lartë, qendrat rinore dhe kurset shkollorë). I vetmi sektor që nuk u mbyll në tërësi ishin kopshtet. Fillimisht shteti nuk parashikoi asnjë datë përfundimtare në lidhje me mbylljen dhe kohëzgjatjen e shkollave, por vendosi që situata të rivlerësohet çdo 14 ditë, që të ndërmerren vendime të duhura.

Estonia, javën e parë, nuk e ndaloi tërësisht punën në shkolla, shteti ua mundësoi mësuesve që, nëse është e nevojshme, të mund të punojnë në ndërtesën e shkollës në klasat e tyre, për aq kohë sa t'iu shmangen tubimeve të mëdha. Kjo është bërë e lejueshme, më së shumti, për nxënësit që nuk kanë qasje në mësimin në distancë në shtëpi, të cilëve u është mundësuar ardhja në shkollë, duke shmangur kontaktin dhe duke mbajtur distancën.

Sa u përket arsimit të përgjithshëm dhe arsimit profesional, paraprakisht kanë ekzistuar disa platforma në internet për të lehtësuar komunikimin ndërmjet shkollave/mësuesve, me nxënës dhe prindër (e-shkolla; studium, etj.). Interesante është se të gjitha materialet mësimore të arsimit të përgjithshëm janë paralelisht të qasshme në letër dhe në internet. Kjo ka mundësuar që të gjithë fëmijët të kenë qasje në materialet mësimore të bazuara në internet (e-schoolbag; opiq.ee; foxcademy.com, etj.).

Edhe pse vitet e fundit është investuar shumë në qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit dhe të rrjetit të internetit, në fillim edhe Estonia kishte problemet e saj. Në fillim, disponueshmëria e lidhjes në internet ose nivelet e kërkuara të shpejtësisë dëshmuar se rrjeti kishte probleme ngarkese për disa familje / zona, por qeveria dhe sektori privat kanë punuar në mënyrë aktive për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Shkollat dhe komunat gjithashtu kanë siguruar pajisjet e nevojshme për mësim dhe mësimdhënie për të gjithë fëmijët. U krijuan nisma me bazë komunitare që i sjellin njerëzit në nevojë dhe donatorët së bashku, ndër to është grupi në Facebook "Çdo kompjuter për nxënësit e shkollës" (*Every Computer for Schoolchildren*), i cili ka bërë që shumë nxënës me mundësi të vogla ekonomike të pajisen me kompjuterë apo me tabletë.

Estonia gjithashtu ka shprehur gatishmërinë që të ndajë të gjitha mjetet e saj të arsimit digjital për të mbështetur sistemet e arsimit të vendeve të tjera gjatë krizës COVID-19. Për ta siguruar mirëvajtjen e procesit mësimor institucionet publike dhe private kanë organizuar webinar falas për të mbështetur arsimtarët në arritjen e rezultateve më të mira të mundshme. Aktualisht, kompani të ndryshme si [www.99math.com](http://www.99math.com), [www.Lingvist.com](http://www.Lingvist.com), [www.Clanbeat.com](http://www.Clanbeat.com), [www.Speakly.me](http://www.Speakly.me), kanë organizuar dhe ende mbajnë trajnime online për të gjitha shtresat e mësuesve të cilët kanë nevojë për aftësim apo riaftësim. Gjithashtu <https://alpa.ee/en/>, dhe [www.DreamApply.com](http://www.DreamApply.com) i janë bashkuar nismës për të ofruar zgjidhjet dhe mjetet e tyre falas.<sup>33</sup>

Udhëzimet mbështetëse dhe informacioni se si të organizohet mësimin në distancë ofrohen nga institucione të ndryshme, për grupe të ndryshme të

---

<sup>33</sup> Një numër mjetesh dhe aplikacionesh që ofrohen në baza ndërkombëtare mund të gjenden në: <http://education-nation.99math.com/>

synuara. Ministria e Arsimit dhe Kërkimit po siguron dhe azhurnon rregullisht informacionin, përfshirë udhëzimet për prindërit, mësuesit dhe menaxherët e shkollave, mbi masat në sistemin arsimor.<sup>34</sup> Kështu, pas konsolidimit të sistemit të mësimit online, shkollat iu kanë dërguar udhëzime të qarta nxënësve dhe prindërve se si të organizojnë mësimin në distancë në një institucion specifik, si dhe kontaktet nga ku prindërit mund të marrin informacione më shumë. Kjo ka mundësuar që:

- Prindërit dhe mësuesit mund të gjejnë ndihmë për zgjidhjen e problemeve që ndodhin gjatë mësimit online në faqen e internetit të HITSA;
- Kjo faqe dhe të tjerat, gjithashtu, organizojnë dhe organizuan webinar mbi organizimin e mësimit të bazuar në shtëpi me ndihmën e teknologjisë;
- Është formuar një grup publik në Facebook - "Mësimdhënia me bazë në shtëpi përmes teknologjisë", për të mbështetur mësuesit me këshilla dhe udhëzime me vlerë, se si ta kryejnë me sukses punën e tyre mësimore;
- Punë të mirë po bën edhe nga fondacioni Innove, i cili, gjithashtu, shpërndan informacione se si t'i mbështeten fëmijët gjatë epidemisë.<sup>35</sup>

Është vërejtur se, në përgjithësi, ngarkesa e punës së mësuesve është rritur. Prandaj, ata aktualisht nuk janë në gjendje të ndjekin trajnimet shtesë. Për fat të mirë, mësuesit tashmë janë njohur me të mësuarit digjital dhe posedojnë aftësi të nevojshme digjitale. Fenomeni pozitiv është që bashkëpunimi i mësuesve është rritur. Mësuesit po e pyesin dhe po e ndihmojnë njëri-tjetrin.

Situata e nxënësve me nevoja të veçanta dhe shkollave speciale është zgjidhur rast pas rasti dhe vendimet për organizimin e mësimit ndërmerren në bashkëpunim me shkollën, menaxherin e shkollës dhe prindërit. Në institucionet ku kalimi i plotë në mësimin në distancë nuk është i mundur,

---

<sup>34</sup> <https://www.hm.ee/en/spread-covid-19-recommendations-educational-institutions>

<sup>35</sup> <https://www.innove.ee/en/news/information-and-advice-for-parents-for-supporting-their-child-gjatë-e-covid-19-shpërthimit/>

mësimet organizohen, gjithashtu, rast pas rasti, në bashkëpunim me mësuesit e shkollës dhe stafin mbështetës, duke marrë parasysh individualitetin e secilit nxënës. Ministria e Arsimit dhe Kërkimit ka hartuar dhe ka dërguar udhëzime shtesë në shkollat speciale dhe i mbikëqyrë rregullisht ato.

Edhe vlerësimi i nxënësve ka qenë temë që është trajtuar nga Ministria e vendit. Në lidhje me këtë, mësuesit janë këshilluar që fokusi të mos përqendrohet aq shumë në vlerësimin numerik të rezultateve të të nxënësve të fëmijëve, por në organizimin e mësimit dhe përballimit të situatës së re. Është rekomanduar që, në vend të vlerësimit numerik, vlerësimi formues (verbal) është një mënyrë më e përshtatshme për t'i angazhuar dhe motivuar nxënësit.

## ***LETONIA***

Edhe Letonia që nga 12 marsi ka shpallur gjendje emergjente dhe të gjitha shkollat dhe institucionet shkollore, sipas informatave që vijnë nga vendi, janë mbyllur. Mësimi në distancë në këtë vend ka filluar më 13 dhe 14 mars, edhe pse, fillimisht, ky proces nuk ka filluar njëherësh në të gjitha shkollat, për shkak të mbylljes selektive të tyre.

Në javën e dytë, edhe Letonia mori vendim për mbylljen e shkollave në tërësi dhe për kalimin e tërë sistemit shkollos në vend në kushte të mësimit në distancë, gjë që ka bërë dhe ka imponuar që nxënësit të angazhohen në aktivitete shkollore nga distanca. Në përgjithësi, javët e para të mësimit në distancë kanë përfunduar me sukses, edhe pse kishte probleme me mjetet dhe rrjetet digjitale, probleme të cilat po zgjidhen në bashkëpunim me komunitat.

Në Letoni, fillimisht, shteti mori vendim që ky lloj mësimi të zhvillohet vetëm deri më 14 prill, por, për shkak të kushteve, procesi po vazhdon akoma. Gjatë kësaj kohe janë përdorur mjete dhe resurse, të cilat paraprakisht ishin të gatshme për mësimin në distancë. E-klasa (e-klase) është platforma kryesore për të gjitha informacionet më të rëndësishme, përfshirë udhëzimet për mësuesit për zhvillimin e mësimin në distancë dhe materialet mësimore për nxënës. Nxënësit ndjekin orarin e studimit, ndjekin



lëndët dhe marrin ushtrime duke përdorur forumin digjital. Një tjetër platformë që po përdoret gjerësisht është [www.soma.lv](http://www.soma.lv), që lejon nxënësit të kryejnë ushtrime online dhe të marrin përgjigje të menjëhershme.

Disa aplikacione pa pagesë, të tilla si WhatsApp, po përdoren, sidomos për kujdestarët dhe prindërit për komunikim të shpejtë dhe të thjeshtë, ndërsa platforma [www.Mykoob.lv](http://www.Mykoob.lv) - një rrjet shoqëror po ndihmon, gjithashtu, administrimin e procesit mësimor, shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin nëpër shkolla.

E-mailat përdoren për ata që nuk janë duke përdorur platforma digjitale.

Përmbajtja dhe materialet mësimore sigurohen duke përdorur mjetet Google Drive ose Dropbox. Edhe teknika e video-ligjëratave është një metodë që po përdoret me sukses në shumë shkolla. Është krijuar një bashkëpunim me Universitetin Teknik Riga, i cili ka siguruar mjete digjitale për mësimin e Fizikës. Këto mjete mund të gjinden në platformën [www.fizmix.lv](http://www.fizmix.lv), një platformë për materiale studimore të cilat mund të shfrytëzohen nga të gjithë pa pagesë. Në vend, propozohet edhe një platforme tjetër, e cila lehtëson punën për pyetësorë të menjëhershëm, teste ose aktivitete interaktive<sup>36</sup>.

Në Letoni platforma Microsoft Zoom (<https://zoom.us/>) është përdorur shumë për webinar, komunikim, takime virtuale etj. Nga një studim që u bë kohët e fundit doli se gati 3% e nxënësve nuk kishin mjete teknologjike (kompjuterë, tabletë etj.), kështu që, në bashkëpunim me disa operatorë privatë të internetit, u arrit që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë sistemit për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme për mësim. Gjithashtu, për fëmijët që nuk kanë qasje në rrjetet e internetit, mësuesit janë obliguar për përgatitjen materialeve të kopjuara, të cilat mund të merren nga prindërit personalisht. Në anën tjetër, shteti vendosi që, nëse një institucion arsimor nuk përdor/nuk ka qasje në ndonjë nga rrjetet digjitale, atëherë mësuesi ka të drejtë t'i testojë nxënësit pasi të kthehen në mjedisin e rregullt shkollor. Për ta zvogëluar sa më shumë mundësinë që dikush apo ndonjëra shkollë të mbetet pa qasje në internet, ofruesit më të mëdhenj të shërbimeve digjitale,

---

<sup>36</sup>Shih për këtë: [www. home.edurio.com/lv](http://www.home.edurio.com/lv)

gjithashtu, janë pajtuar të sigurojnë internet të pakufizuar për të gjitha shkollat dhe nxënësit.

Për një atmosferë më të lehtë dhe për një efikasitet më të mirë në zhvillimin e procesit janë hartuar 'hartat rrugore' dhe udhëzime për mësimin në distancë për mësuesit dhe prindërit. Këshilla për mësuesit dhe prindërit në lidhje me mundësitë dhe përdorimin e TIK janë në dispozicion në 3 gjuhë: LV, EN dhe RU.

Institucionet e AAP-së ofrojnë mbështetje për IT për ata nxënës që nuk e kanë atë - për të siguruar që ata të mund të studiojnë dhe mësojnë nga distanca.

Është arritur të krijohet, gjithashtu, një sistem për mbështetje psikologjike me anë të lidhjes telefonike por edhe në Chatbot për fëmijë dhe gjithashtu për prindërit. E tërë kjo udhëhiqet nga Inspektorati Shtetëror për të Drejtat e Fëmijëve. Ky shërbim, zakonisht, iu afrohet fëmijëve, por, në këto rrethana, edhe prindërit ftohen ta përdorin këtë mjet ndihmese për t'i kaluar vështirësitë e rastit.

Qeveria, në këtë kohë ka vendosur që provimet shtetërore të mos mbahen gjatë periudhës së situatës emergjente. Provimet e gjuhëve të huaja për klasën e 12-të shtyhen nga marsi në mes të majit. Testet provuese për klasën e 11-të në Fizikë dhe Kimi (të planifikuara për në prill) janë anuluar.

Problemin më të madh për vendin e ka shkaktuar arsimiti profesional, ngase në situatën kur shumë kompani kanë ndalë funksionimet e tyre dhe në situatën kur trajnimi në vend nuk është i mundur, as tutorët e kompanisë, as mësuesit e AAP-së, nuk mund ta plotësojnë këtë hendek me asnjë mjet në kuadër të mësimin në distancë. Për këtë arsye, disa institucione të AAP-së e kanë ndaluar trajnimin brenda ndërmarrjeve dhe për këtë ato po i rishtrukturojnë oraret e trajnimit duke ofruar më shumë përmbajtje teorike në kuadër të mësimin në distancë. Ky është problem, ngase në këtë vend, në arsimin profesional, sistemi i diplomave përbëhet nga dy pjesë dhe kjo, në këtë moment, është e pamundur.

### **3. Përfundime për ecurinë e zhvillimit të mësimin në distancë për vendet e diskutuara**

Nga një shikim i thjeshtë i aktiviteteve të ndërmarra nga shtete të ndryshme, mësimi i parë që mund të marrin është se jo të gjitha vendet, edhe të Ballkanit, edhe të BE-së, kanë qenë të përgatitura njësoj apo procesin e kanë zhvilluar njësoj.

Është vërejtur se shumëçka në organizimin e mësimin online ka qenë e varur nga gjendja ekonomike e vendit, nga përgatitjet e Ministrive të Arsimit, nga përgatitjet e stafit mësimor dhe nga gatishmëria e fëmijëve dhe familjeve për t'u përshtatur me një sistem të ri të shkollës.

Në këtë aspekt, disa vende, si Shqipëria, Kroacia, Estonia dhe Letonia, kanë kryer edhe sondazhe për të parë mënyrën e zhvillimit të sistemit arsimor në kushte shtëpie, por ka edhe vende, shumica e tyre, që janë bazuar në vendime administrative, në bazë të statistikave të njohura paraprakisht.

Një ndër problemet që mund të vërehen, p.sh. te Shqipëria, është se edhe mësuesit, edhe prindërit e edhe nxënësit, mjetin mbizotërues për zhvillimin e mësimin online e kanë telefonin mobil. Krahasuar me të dhënat që vijnë nga shtete tjera, del se, edhe pse të gjitha rezultatet e dy sondazheve dalin tejte pozitive (më mirë se sondazhet e Kroacisë dhe te Estonisë), rreth 97% e mësuesve, nxënësve dhe prindërve e përdorin telefonin mobil si mjet për zhvillimin e mësimin online. Vetë përdorimi i telefonit, i cili nuk i plotëson as kushtet minimale për përdorim të gjatë dhe sidomos për mësim online, është sinjal se në Shqipëri gjendja ekonomike e familjeve është tërësisht më e keqe se familjet në Kroaci (sipas sondazheve ka dalë se rreth 11% e nxënësve nuk kanë laptopë apo tabletë për zhvillimin e mësimin online), apo në Letoni dhe Estoni (ku është vërejtur se 5% respektivisht 3% të nxënësve nuk janë të pajisur me tabletë ose laptopë). Në anën tjetër, edhe pse shteti e ka aplikuar mësimin online në tërë vendin, nuk ka ndërmarrë asnjë masë që nxënësit dhe mësuesit të pajisen me mjete të IT, që ky proces të dalë me sukses. Ky fakt ka ndikuar që tek nxënësit, mësuesit dhe te familjet të shkaktohet mbingarkesë e jashtëzakonshme dhe stres. Vështirësi tjetër në Shqipëri ka qenë edhe mungesa e materialeve online për mësim në distancë, siç janë mjetet dhe tekstet mësimore digjitale. Në përgjithësi, sipas asaj që

është parë aty, ky vend procesin e ka zhvilluar dhe po e zhvillon me anë të video-ligjëratave në televizionin shqiptar dhe me anë të aplikacioneve telefonike ekzistuese, si Viber dhe Whatsup.

Gjendje përafërsisht e njëjtë është edhe në Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut. Edhe në këto vende procesi mësimor zhvillohet kryesisht përmes video-ligjëratave të incizuara, të shfaqura në televizion dhe përmes platformave online, të cilat janë zhvilluar në mënyrë urgjente (shembulli i Maqedonisë me platformën e krijuar nga UNICEF). Në këto vende nuk është zhvilluar ndonjë sondazh në lidhje me atë se si dhe në çfarë mase nxënësit kanë qasje në mësimin online dhe me cilat mjete e zhvillojnë mësimin. Duke e parë gjendjen ekonomike të të dyja vendeve, sigurisht se edhe ato kanë probleme të njëjta me Shqipërinë në aspektin mungesës së laptopëve dhe tabletave për nxënësit dhe familjet. Duhet të ceket se në Mal të Zi janë angazhuar edhe rrjetet e ndryshme të internetit, të cilat kanë ofruar kapacitete e tyre që materialet mësimore, por edhe ndërlihdja shkollë-nxënës-familje të jetë konstante dhe e përhershme. Me rëndësi është se edhe Shqipëria, edhe Mali i Zi, edhe Maqedonia, kanë zhvilluar një varg udhëzimesh, me të cilat kanë krijuar bazë legale, sidomos për vlerësimin e nxënësve në kohën sa zhvillohet mësimi në distancë.

Kroacia dhe Serbia kanë dalë dy vendet që kanë qenë më të përgatitura në këtë aspekt. Kjo ndoshta ka ndodhur pasi më herët i kanë pasur të krijuara platformat e tyre për zhvillimin e mësimin në distancë dhe në këtë kuadër kanë pasur dhe kanë resurse dhe përvojë më të mirë. Të dyja vendet dallohen për materialet mësimore, të cilat i kanë në dispozicion, dhe sidomos tekstet shkollore të digjitalizuara, të cilat gjatë tërë kohës janë në dispozicion të nxënësve dhe familjeve të tyre. Gjithashtu, kompani dhe institucione të këtyre vendeve janë angazhuar t'u dalin në ndihmë nxënësve dhe shkollave me mjete mësimore, me kompjuterë dhe laptopë, si dhe me instrumente dhe aplikacione, të cilat e kanë mundësuar dhe lehtësuar më shumë mësimin nga distanca. Në këto vende është shumë interesante se edhe shkollat e veçanta janë angazhuar në krijimin e materialeve mësimore dhe të njëjtat i kanë bërë të qasshme për tërë publikun. Televizionet e këtyre vendeve, shoqëria civile,

mbrojtja territoriale dhe mekanizma të tjerë, janë vënë në funksion të zhvillimit të mësimimit me bazë shtëpie.

Sllovenia dhe Kroacia janë vende ballkanike dhe anëtare të BE-së, por që kanë sisteme shumë më stabile dhe më të avancuara arsimore. Interesante është se edhe Sllovenia edhe Kroacia, në fillimet e procesit të mësimimit në distancë, u ballafaquan me probleme nga më të ndryshmet. Derisa në Kroaci u bë angazhimi i menjëhershëm i rrjeteve ekzistuese dhe platformave ekzistuese për realizimin e mësimimit në distancë, shumë prej tyre, në javën e parë, u sulmuan nga hakerët me viruse të ndryshme, që gati sa e bënë të papërdorshëm rrjetin e internetit për zhvillim të mësimimit. Derisa në Slloveni nuk kishte sulme hakerësh, aty pati probleme me ngarkesën e rrjetit, i cili në javën e parë nuk e duronte tërë ngarkesën e shkaktuar. Megjithatë, në javën e parë, të dyja vendet arritën ta konsolidojnë sistemin dhe të dyja, që në javën e dytë arritën që të vazhdojnë me zhvillimin e procesit mësimor. Ajo që vlen të ceket është angazhimi i një numri të madh institucionesh publike dhe private, të cilat ndihmojnë (si në Kroaci) dhe ndërhyrjet buxhetore për ta zhvilluar procesin (si në Slloveni). Gjë me rëndësi në këto vende është materiali digjital i krijuar para pandemisë, i cili ishte një ndihmesë shtesë në këto kohë të vështira për të gjitha sistemet arsimore. Element që është parë, gjithashtu, në këto vende është angazhimi profesional dhe me profesionalizëm i kompanive dhe platformave private, të cilat kanë dhënë kontribut të pazëvendësueshëm në zhvillimin e mësimimit nga distanca.

Edhe Estonia dhe Letonia kishin problemet dhe përparësitë e tyre. Derisa Estonia kishte përgatitje paraprake më të avancuara në kuadër të mësimimit dhe materialeve digjitale shkollore, Letonia, në shumë aspekte, kishte probleme të theksuara në zhvillimin e mësimimit në distancë, por të cilat brenda dhjetëditëshit të parë arriti t'i tejkalojë me sukses. Problemi i parë që kishin këto dy vende, por edhe shumë vende të tjera, ishte ngarkesa e sistemit dhe rënia e rrjetit të internetit për shkak të ngarkesave të padurueshme dhe qarkullimit të madh në rrjet.

Në javët në vazhdim vendet për të cilat po flasim e konsoliduan sistemin, duke i forcuar rrjetet e internetit dhe duke e bërë angazhimin e shumë resorëve shtetërore dhe private në ndihmë të procesit. Vendet me një

shpejtësi të madhe arritën që t'i zgjidhin problemet me fëmijët që jetonin në territore të largëta apo që, për ndonjë arsye, nuk kishin qasje të mirë në internet, apo që ishin në gjendje të tillë ekonomike dhe nuk posedonin mjete të nevojshme për marrjen e materialeve mësimore. Shumë organizata në këto vende u futën në ndihmë, duke furnizuar me kompjuterë dhe mjete tjera nxënësit në nevojë dhe, në raste të veçanta, u angazhuan edhe studentët e fakulteteve të mësuesisë në tërë procesin mësimor online.

Duke e parë se mësimi nga distanca kërkonte thujtë dyfish angazhim të mësuesve dhe të nxënësve, Estonia dhe Letonia krijuan një udhëzues për masën e materialeve mësimore që do të zhvilloheshin.

Interesante është se të dyja vendet, në kohë reale, për çdo problem që hasej në procesin mësimor, hartonin dhe shpërndanin udhëzime të ndryshme, që kishin të bënin me trajtimin e materieve mësimore, procedurat mësimore, trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, apo vlerësimin e mësimor (rast është vënia e një vlerësimi të ri, që u quajt vlerësimi i aktivitetit, i cili kishte për qëllim aktivizimin më të madh të nxënësve në proces).

Duhet të ceket se asnjëri prej vendeve për të cilët po flasim nuk kishte një sistem të standardizuar të mësimor në distancë. Gjithsesi, disa nga vendet kishin bërë më shumë apo më pak në ndërtimin e këtij sistemi, në bazë të projekteve të ndryshme, por që nuk kishin arritur ta ngrenë tërë infrastrukturën e nevojshme për një sistem efikas e funksional të mësimor në distancë.

Si përfundim, duhet të thuhet se, derisa vendet ballkanike i kanë përfituar përvojat e para të këtij lloji sistemi mësimor, ato, me ndryshime dhe me nivele të ndryshme, duhet të bëjnë më shumë në ndërtimin dhe stabilizimin e këtij sistemi. Po kështu edhe vendet e BE-së, edhe pse me zhvillime të mira në fushën e TIK-ut, megjithatë kanë hasur në vështirësi të ndryshme dhe edhe ato duhet të bëjnë më shumë që të arrijnë në një sistem të mirëfilltë të mësimor nga distanca.

Megjithatë, kjo periudhë është një mësim dhe rast i mirë për të gjitha vendet dhe për të gjithë ne, se çka duhet dhe cilët hapa duhet t'i ndërmarrim për ndërtimin dhe standardizimin e të plotë të sistemit të mësimor në distancë.

## LITERATURA

1. Ministria e Arsimit, e Sportit dhe Rinisë (Mars, 2020). Sondazhi për mësimin online, perceptime të nxënësve, prindërve dhe mësuesve. MASR – Tiranë. [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Sondazhi-i-m%C3%ABsimit-online-11581.pdf?fbclid=IwAR255FEBISPO-I9rdPeKRmbRLATWRu4aKED\\_NJsCbr9uo8KHqQ-N79-zhUg](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Sondazhi-i-m%C3%ABsimit-online-11581.pdf?fbclid=IwAR255FEBISPO-I9rdPeKRmbRLATWRu4aKED_NJsCbr9uo8KHqQ-N79-zhUg;);
2. [https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-te-shtepise\\_.pdf](https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Udhezues-vleresimi-ne-kushte-te-shtepise_.pdf);
3. <https://mzo.gov.hr/vijesti/smjernice-osnovnim-i-srednjim-skolama-vezano-uz-organizaciju-nastave-na-daljiniu-uz-pomoc-informacijsko-komunikacijske-tehnologije/3585>;
4. <https://skolazazivot.hr/rezultati-upitnika-o-izvodenju-nastave-na-daljiniu-od-16-3-2020-do-2-4-2020/> ;
5. <https://skolazazivot.hr/upute-za-vrednovanje-i-ocjenjivanje-tijekom-nastave-na-daljiniu/>
6. <https://mzo.gov.hr/UserDocsImages/dokumenti/Vijesti/2020/Preporuke%20o%20organizaciji%20radnog%20dana%20ucenika%20tijekom%20odr-zavanja%20nastave%20na%20daljinu.pdf>;
7. <https://skolazazivot.hr/wp-content/uploads/2020/04/Dodatak-A-Primjeri-vrednovanja-nau%C4%8Denog-na-daljiniu-v2.pdf>;
8. <https://skolazazivot.hr/wp-content/uploads/2020/04/Dodatak-B-Digitalni-alati-za-vrednovanje-nau%C4%8Denog-2-4-2020-1.pdf>;
9. <http://www.mpn.gov.rs/wp-content/uploads/2020/03/Nastava-na-daljiniu-u-vanrednom-stanju.pdf>;
10. Vlada Serbioje: Saopštenje ministarstva prosvete u vezi sa operativnim planom za nastavak rada škola u otežanim uslovima uz program učenja na daljinu za učenike osnovnih i srednjih škola;
11. <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/3134-intensifikohen-oret-ne-kuader-te-programit-edukativ-tv-klasa-ne-rtvm>
12. <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk>;
13. <http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/2014-07-23-14-03-25/vesti-i-nastani-alb/3160-udhezim-per-mesimdhesisit-per-menyren-e-vleresimit->

[te-nxenesve-gjate-periudhes-se-realizimit-te-mesimit-permes-mesimit-ne-distance-perkatesishte-mesimit-nga-shtepia;](#)

14. <http://www.skolskiportal.edu.me/Lists/Novosti/Attachments/248/Prirucnik.pdf>
15. [http://education-nation.99math.com/;](http://education-nation.99math.com/)
16. <https://www.hm.ee/en/spread-covid-19-recommendations-educational-institutions>
17. [https://www.innove.ee/en/news/information-and-advice-for-parents-for-supporting-their-child-gjatë-e-covid-19-shpërthimit/;](https://www.innove.ee/en/news/information-and-advice-for-parents-for-supporting-their-child-gjatë-e-covid-19-shpërthimit/)
18. Raporti i vendeve të BE-së për kryesuesen e radhës, Kroacinë:  
Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training;
19. [https://arsimi.gov.al/ministria/;](https://arsimi.gov.al/ministria/)
20. [http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/;](http://www.mon.gov.mk/index.php/AL/)
21. <http://www.mpin.gov.me/ministarstvo;>
22. [http://www.mpn.gov.rs/;](http://www.mpn.gov.rs/)
23. <https://mzo.gov.hr/vijesti/nastava-na-daljину-raspored-3629/3629;>
24. [https://www.gov.si/drzavni-organi/ministrstva/ministrstvo-za-izobrazevanje-znanost-in-sport/;](https://www.gov.si/drzavni-organi/ministrstva/ministrstvo-za-izobrazevanje-znanost-in-sport/)
25. <https://www.hm.ee/en/news/pan-european-hackathon-develop-innovative-solutions-overcome-societal-challenges-related;>
26. <https://www.izm.gov.lv/en/highlights/3954-situation-caused-by-covid-19-in-latvia>
27. Creative Methods of Assessment in Online Learning. Dostupno na:  
<https://ctl.learninghouse.com/creative-methods-of-assessment-in-online-learning/>Darby, F. How to Be a Better Online Teacher. Dostupno na:
28. <https://www.chronicle.com/interactives/advice-online-teaching> Flipped classroom. Dostupno na: [https://en.wikipedia.org/wiki/Flipped\\_classroom](https://en.wikipedia.org/wiki/Flipped_classroom)



## II. PJESA E DYTË

### 2.1. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Selim Mehmeti, Haxhere Zylfiu & Ismet Potera

Mbledhja dhe analiza e të dhënave është realizuar përmes qasjes hulumtuese të përzier sasiore dhe cilësore, për të marrë përgjigje në pyetjet kërkimore të këtij studimi. Qasja sasiore e hulumtimi është realizuar me anën e pyetësorëve online, me nxënës, mësimdhënës dhe prindër, përmes të cilëve u mblodhën të dhënat dhe u përdorën më pas si një bazë për të analizuar situatën aktuale dhe për të zhvilluar analiza krahasuese. Ndërsa qasja cilësore cilësore e hulumtimi është realizuar përmes intervistave dhe pyetësorëve me pyetje të hapura për drejtorë të shkollave, mësimdhënës, prindër, nxënës, si dhe përmes protokollit të vëzhgimit për analizë të orëve mësimore të transmetuara në RTK4 dhe linkun për kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’.

Objekt studimi ishin mësimi në distancë/e-mësimi, gjegjësisht organizimi i mësimit në distancë/e-mësimit, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemisë, përgatitja dhe gatishmëria e mësimdhënësve, pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja gjatë realizimit të mësimit në distancë. Gjithashtu pjesë e hulumtimit ishen edhe problemet në realizimin e mësimit në distancë, sfidat, mundësitë vazhdimet të realizimit të mësimit në distancë dhe nevojat për mbështetje të mësimdhënësve për këtë formë të mësimdhënies, prandaj e gjithë metodologjia është përshtatur me nevojat e këtij studimi, duke marrë parasysh rrethanat e realizimit të tij.

#### **Popullata dhe mostra**

Popullatën e studimit e përbëjnë përfaqësuesit e komunitetit të shkollës: nxënësit, prindërit mësimdhënësit, dhe drejtuesit e shkollave, të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, në të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë

edhe nxënësit dhe prindërit nga grupet e marginalizuara. Nga kjo popullatë, është planifikuar që të kemi dy mostra. Mostra e parë përfshin popullatën e drejtorëve të shkollave, në të cilën janë përfshirë 38 drejtorë të shkollave, në 15 komuna të ndryshme të Kosovës, të cilët janë përzgjedhur nga një listë e shkollave që gjatë dy-tri viteve të fundit kanë realizuar vlerësimin e brendshëm të shkollës, dhe pjesa më e madhe e tyre e kanë realizuar edhe vlerësimin e jashtëm të shkollës nga Inspektorati i Arsimit. Ndërsa, mostra e dytë i referohet popullatës së nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve, e cila përfshin nga 5 përfaqësues nga secila shkollë e listës prej 38 shkollave. Nga një shkollë janë përfshirë: një nxënës- përfaqësues nga Këshilli i Nxënësve, një prindër – përfaqësues nga Këshilli i Prindërve dhe 3 mësimdhënës, si dhe një numër të papërcaktuar të këtyre popullatave përmes përfshirjes me pyetësorë online, platformës Google Forms.

**Pjesëmarrja e nxënësve.** Gjithsej janë përgjigjur (N= 2838) nxënës, prej tyre 54% femra, ndërsa mbi 20% e tyre i takojnë shkollave të fshatit, ku i vijojnë mësimet e rregullta. Nxënësit përfaqësojnë dy nivele të arsimit parauniversitar, nga arsimit mesëm i ulët (6-9) kanë marrë pjesë (n=1522) nxënës ose 54%, nga gjimnazet (klasat 10-12) kanë marrë pjesë (n=608) nxënës ose 21%, kurse nga shkollat profesionale (10-12) (n=708) nxënës ose 25%. Sa u përket komunave, mostra e nxënësve vjen nga 26 komuna. Ndërsa nga shkollat private, janë përfshirë rreth 1% e totalit të nxënësve të përfshirë në këtë studim. Pjesë e studimit janë edhe 9 nxënës nga grupet e ndjeshme, me gjendje jo të mirë ekonomike, raste sociale, nxënës të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe nxënës me nevoja të veçanta.

**Pjesëmarrja e prindërve.** Gjithsej kanë marrë pjesë (N=1805) prindër, prej tyre 69% femra, ndërsa mbi 30% e tyre i kanë fëmijët duke i vijuar mësimet e rregullta në shkollat e fshatit. Rreth 98% e prindërve fëmijët i kanë në shkollat publike, kurse rreth 2% i kanë në shkollat private ose në publike dhe private. Mbi 56% e prindërve i kanë fëmijët në këtë vitit shkollor (2019/2020) në dy nivele të arsimit parauniversitar. Sa u përket komunave, mostra e prindërve vjen nga 24 komuna. Ndërsa, sa i përket nivelit të arsimit, rreth 60% e prindërve janë me shkollim të mesëm dhe fillor, kurse rreth 40 % janë me nivele të ndryshme të arsimit universitar.

Pjesë e studimit janë edhe 22 prindër nga grupet e ndjeshme dhe 10 prej tyre i kanë fëmijët në Qendrat Burimore, ndërsa 12 të tjerë janë prindër që i kanë fëmijët në shkollë dhe janë me gjendje jo të mirë ekonomike, raste sociale, prindër të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe nxënësve me nevoja të veçanta. Prindërit që nuk i kanë fëmijët në Qendrat Burimore, janë nga komunat Gjakovë, Dragash, Prizren, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Prishtinë- Vranjevc. Në mesin e tyre ka prind që ka deri në 4 fëmijë në shkollë.

**Pjesëmarrja e mësimitdhënësve.** Mostra e mësimitdhënësve që i është përgjigjur këtij studimi përfshin numrin prej (N=1939) mësimitdhënës. Në strukturën e mostrës dominon gjinia femërore e mësimitdhënësve të përgjigjur (F=59%). Rreth 60% prej tyre punojnë në shkollat e fshatit dhe 32,5% në shkollat e qytetit, ndërsa 7,5% e mësimitdhënësve punojnë në të dy lokacionet. Rreth 3% e mësimitdhënësve punojnë në shkollat private ose publike dhe private. Sa i përket shpërndarjes gjeografike, mostra e mësimitdhënësve vjen nga 26 komuna, ku në raport me shpërndarjen e mostrës në shtatë rajonet e Kosovës kemi këtë shpërndarje: Mitrovicë 30,5%; Prishtinë 29,1%; Prizren 14,3%; Gjilan 11%; Gjakovë 6,9%; Ferizaj 6,6% dhe Pejë 1,6%.

Dominon mostra e mësimitdhënësve të moshës 31- 40 vjeç me 32,3% dhe 21-30 vjeç me 23,4%, pjesa tjetër e të përgjigjurve rezultoi të jetë: 41- 50 vjeç me 20%; 51- 60 vjeç me 19,2%, mbi 60 vjeç me 5,10%. Referuar nivelit arsimor në të cilën mësimitdhënësit punojnë, kemi dominim nga arsimi i mesëm i ulët ( klasa 6-9) me 48,3%, pastaj arsimi fillor (klasat 1-5) me 36,3%; Shkollat Profesionale (klasa 10-12) me 6,6%; Gjinnazet (klasa10-12) me 5,7% dhe klasat parafillore (mosha 5-6 vjeç) me 3,1%. Sipas fushave kurrikulare që mbulojnë, në përqindje më të lartë i kemi të përfaqësuar mësimitdhënësit e fushës Gjuhët dhe komunikimi (21,3% ). Pjesë e mostrës së mësimitdhënësve janë edhe 16 mësimitdhënës nga Qendrat Burimore, ku 5 prej tyre janë mësimitdhënës udhëtues që mbështesin mësimitdhënësit në shkollat e rregullta në punën me fëmijë me nevoja të veçanta.

**Pjesëmarrja e drejtorëve të shkollave.** Janë përgjegjur 38 drejtorë të institucioneve arsimore, prej tyre 2 janë nga Institucionet parashkollore, 19 drejtorë nga arsimi bazë (klasat 1-9), 7 drejtorë të Gjinnazeve, 5 drejtorë të Shkollave Profesionale dhe 5 drejtorë të Qendrave Burimore. Sa i përket të dhënave tjera demografike, ato janë si në vijim, 33% e drejtorëve i takojnë gjinisë femërore, 42% janë drejtorë në shkollat e fshatit, rreth 58 % janë në moshë mbi 50- vjeçare, pjesa tjetër nën këtë moshë, rreth 55 e drejtorëve, janë të certifikuar së paku një program që lidhet me përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie, kurs të tjerët, rreth 45 %, nuk kanë asnjë program trajnimi në fushën e TIK-ut.

Përbërja e mostrës sipas gjinisë, vendit të shkollës, nivelit të arsimit publik dhe shkollave private, pasqyrohet në tabelën në vijim.

Tabela 1. Mostra sipas gjinisë, vendit të shkollës, nivelit të arsimit publik dhe shkollave private

Nr.	Struktura e respondentëve të përfshirë në studim	Gjithsej	Gjinia		Vendi i shkollës		Nivelet e arsimit publik ku janë të përfshirë nxënësit						Shkolla private
			F	M	Fshat	Qytet	Parashkollor Klasa paraf.	Arsimi fillor (klasat 1-5)	Arsimi i mesëm j ulët (6-9)	Gjimnazi (10-12)	Shkollat profesionale	Qendra Burimore	
1.	Nxënës	2838	54 %	46%	20%	80%	/	/	54%	21%	25%	/	1%
1.1.	Nxënës nga grupet e ndjeshme	9	67%	33%	22%	78%	/	/	78%	11%	11%	/	/
2.	Prindër	1805	69%	31%	30%	70%	18%	32%	27%	13%	9%	/	2%
2.1.	Prindër nga grupet e ndjeshme	22	55%	45%	23%	77%	5%	18%	23%	5%	5%	45%	/
3.	Mësimdhënës	1939	59 %	41 %	60 %	40 %	3%	36 %	48%	6 %	7 %	1%	3%
4.	Drejtore të shkollave	38	34%	66 %	42%	58%	5.3%	50%	18%	13%	13%	/	

Gjithsej: 6051 respondentë nga komuniteti i shkollës (nxënës, prindër mësimdhënës dhe drejtues e shkollave të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar)

**Përfaqësues të tjerë.** Në këtë studim kanë dhënë kontribut, përmes pjesëmarrjes dhe dhënies së mendimeve të tyre, në mënyrë të pavarur, dy zëvendësministrat e MASHTI-t, katër zyrtarë arsimorë në DKA dhe katër përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kryesisht merren me mbështetjen e grupeve të ndjeshme.

### **Metodat dhe instrumentet e hulumtimit**

Me anë të desk research – studimit kabinetik, është bërë analiza gjithëpërfshirëse e të gjitha dokumenteve të përgatitura nga MASHTI për organizimin e mësimit në distancë/ e-mësimit, analiza e vendeve të rajonit dhe BE-së për masat që kanë ndërmarrë për organizimin e mësimit në distancë, si përgjigjet ndaj situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID–19. Ndërsa, hulumtimi me respondentët nga komuniteti i shkollës është realizuar me pyetësorë online, të hartuar posaçërisht për nevoja të këtij hulumtimi, dhe përmes intervistave e pyetësorëve të realizuar drejtpërdrejt, me platforma të komunikimit online, me drejtorë të shkollave, prindër, nxënës, mësimitdhënës, përfshirë edhe nxënësit dhe prindërit e grupeve të marginalizuara, si dhe me përfaqësues të MASHTI-t, DKA-ve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Pyetësorët online, me përfaqësuesit e komunitetit të shkollës për mësimitdhënës, janë ndërtuar kryesisht me pyetje të tipit të mbyllur dhe respondentët që janë përgjigjur pozitivisht kanë pasur mundësi të zgjedhin njërin nga opsionet e ofruara si përgjigje në pyetjen përkatëse (përfshirë edhe mundësinë për të argumentuar përgjigjen për ndonjë pyetje që kërkohet). Pyetësorët janë hartuar me pyetje të ndryshme, varësisht nga dedikimi, ndërsa janë organizuar në kategoritë vijuese:

Tabela 2. Numri i pyetjeve për mostrën e përzgjedhur

Nr.	Kategoritë e pyetjeve	Numri i pyetjeve për:			
		Nxënës	Prindër	Mësimdhënës	Drejtorë të shkollave
1	Të dhënat demografike	4	6	8	5
2	Mësimi në distancë/e-mësimi , para situatës së krijuar me Covid -19	/	/	4	3
3	Informimi për organizimin e mësimit në distancë /e-mësimin, si përgjigje ndaj situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID – 19	3	3	4	3
4	Fillimi i mësimit në distancë /e-mësimit, si përgjigje ndaj situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID – 19	5	4	9	6
5	Pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimit në distancë /e-mësimit	11	9	9	8
6	Parashikimet për zbatimin e mësimit në distancë/e-mësimit, mundësitë dhe nevojat për mbështetje	3	4	6	6
<i>Gjithsej</i>		26	26	40	31

Këto kategori të pyetjeve ishin bazë edhe për intervistat dhe pyetësorët e realizuar drejtpërdrejt me drejtorë të shkollave, prindër, nxënës dhe mësimdhënës, përfshirë edhe nxënësit dhe prindërit e grupeve të marginalizuara, si dhe me përfaqësues të MASHTI-t, DKA-ve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Një instrument tjetër i përdorur në këtë studim është listë-kontrolli për vëzhgimin e orëve mësimore, video-ligjëratave që shfaqeshin në RTK në

kanalin e MASHTI-t në 'YouTube'. Listë-kontrolli përbëhet nga aspektet që u përcaktuam se çka të vëzhgohej, si: metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies, si dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës.

### ***Procedura e mbledhjes së të dhënave***

Mbledhja e të gjitha të dhënave për këtë studim është bërë në gjysmën e parë të muajit prill 2020. Të dhënat nga pyetësoni online, me përfaqësuesit e komunitetit të shkollës (nxënës, prindër dhe mësimdhënës), janë mbledhur përmes Google Forms. Plotësimi i pyetësorit online ka marrë kohë rreth 10-15 minuta. Pyetësorët kanë qenë të hapur për plotësim në periudhën 08.04.2020 deri më 16.04.2020. Nga plotësimi i të gjitha kërkesave bazike të pyetësorit, të dhënat janë mbledhur në mënyrë automatike në bazën e krijuar përmes Google Forms. Ndërsa, të dhënat nga intervistat dhe pyetësorët me pyetje të hapura janë marrë përmes platformave të komunikimit, si Zoom, Skype, Viber, E-mail, në kohëzgjatje nga 30-40 minuta, si dhe me telefon pa internet, ku janë përfshirë disa respondentë nga grupet e marginalizuara. Kurse, procedura e përcjelljes dhe e vëzhgimit të mësimin ndodhi çdo ditë kur transmetimi bëhej në RTK dhe në kanalin e MASHTI-t në 'YouTube', nga datat 01 - 20 prill.

### **Procedura e analizës së të dhënave**

Sipas Grbich (2007), analiza është procesi i segmentimit, kategorizimit dhe rilidhjes së aspekteve të të dhënave përpara interpretimit të tyre përfundimtar (cituar nga Matthews & Ross, 2010). Për analizën e të dhënave u përdorën qasja tematike e orientuar nga baza e të dhënave sipas kategorive të pyetjeve të vendosura në metodat dhe instrumentet e hulumtimit. Pastaj, brenda kategorive të pyetjeve u bënë analiza statistikore përshkruese të nevojshme për natyrën e modelit të këtij studimi, për të faktuar situatën lidhur me organizimin dhe realizimin e mësimin në distancë. Analiza e të dhënave të siguruara nga dokumentet që lidhen me mësimin në distancë/e-mësimin dhe nga përcjellja dhe vëzhgimi i e-mësimin në RTK dhe në kanalin e MASHTI-t është bazuar në metodën e analizës së përmbajtjes (Gläser & Laudel, 2013).



## **Aspekti etik i studimit**

Studimi është kryer duke iu përmbajtur etikës hulumtuese për të marrë të dhëna relevante për objektin e studimit – organizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, si përgjigje ndaj situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID – 19. I gjithë informacioni i mbledhur nga instrumentet është përdorur vetëm për qëllimet e studimit dhe për përgatitjen e këtij raporti të studimit në kuadër të Institutit Pedagogjik të Kosovës. Tre pyetësorëve online, të shpërndarë përmes Google Forms, u parapriu një hyrje, e cila ka ofruar informacion për qëllimet e studimit, përdorimin e të dhënave dhe ka siguruar nxënësit, prindërit dhe mësuesit për mosmbledhjen e të dhënave personale. Hulumtuesit e përfshirë në këtë studim nuk kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit, prindërit dhe mësuesit e përfshirë përmes pyetësorëve online. Ndërsa, të intervistuarit dhe subjektet tjera, përmes së cilave kemi komunikuar lidhur me pyetjet e këtij studimi, ishin në dijeni të temës së bisedës dhe informacionit të kërkuar. Të gjithë e ndanë informacionin pa asnjë lloj hezitimi.

## **Kufizimet e studimit**

Studimi është kryer për një kohë të shkurtër, për më pak se një muaj, në rrethanat e pandemisë COVID-19. Të dhënat e këtij studimi përfaqësojnë kryesisht mendimet dhe përvojat e përfaqësuesve të komunitetit të shkollës (nxënësve, prindërve, mësuesve dhe drejtuesve të shkollave). Për më tepër, mostra e nxënësve, prindërve dhe mësuesve, është mostër e varur nga mundësia për ta parë thirrjen online për pjesëmarrje në studim dhe nga interesimi dhe përkushtimi për të kontribuar në këtë studim. Dhe, për rrjedhojë, nuk kemi një mostër që balancon aspektet demografike që lidhen me shtrirjen gjeografike, përfaqësimin e barabartë në bazë të numrit të nxënësve në shkollat urbane dhe rurale etj. Pavarësisht se mostra e mësuesve është e konsiderueshme në raport me popullatën, nuk është siguruar shpërndarja e njëjtë në raport me nivelet e arsimit, klasat, strukturën gjinore, dhe përfaqësimin e mësuesve nga komunitetet. Një kufizim tjetër lidhet me sinqeritetin në përgjigjet e tyre dhe ne nuk mund të jemi në

dijeni sa kanë qenë realë respondentët, ose të përmbajtur për të pasqyruar në mënyrë të drejtë çështjet e trajtuara në këtë studim.

Pavarësisht nga këto kufizime, mendojmë se ky studim i kryer në rrethanat e pandemisë COVID-19, mbetet një burim i mirë informacioni për institucionet përgjegjëse që ndërlidhen me këtë tematikë të hulumtuar, i bazuar në një numër të gjeturash nga evidencat e siguruara nga analiza e dokumentacionit, video-xhirimeve të orëve mësimore dhe raporteve për mësimin në distancë dhe nga pikëpamjet dhe qëndrimet e përfaqësuesve të komunitetit të shkollës dhe përfaqësuesve tjerë arsimorë, të cilët i referohen përvojës së tyre për rreth një muaj me realizimin e mësimin në distancë.

### **III. PJESA E TRETË - REZULTATET E STUDIMIT**

#### **3.1. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

Agim Bujari & Bekim Morina

Sipas udhëzimeve të MASHTI-it për realizimin e mësimit në distancë, drejtorët e shkollave vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre karshi mësimit dhe nxënësve të shkollës së tyre. Në përputhje me detyrat e punës, koordinojnë organizimin e mësimit në distancë dhe u raportojnë rregullisht DKA-ve. Sipas udhëzimeve të MASHTI-t, secili drejtor i shkollës duhet të krijojë një grup virtual arsimor me Këshillin e Shkollës dhe me kryetarët e aktiveve profesionale, për të lehtësuar mirëvajtjen e mësimit online në shkollë (MASHTI, 2020a).

Nisur nga roli, detyrat dhe përgjegjësitë që ka menaxhmenti i shkollave në realizimin e mësimit në distancë, në këtë studim kemi përfshirë, me pyetësorë dhe intervista, 33 drejtorë të institucioneve arsimore/shkollave, të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, të komunave të ndryshme të Kosovës<sup>37</sup>. Qëllimi i hulumtimit ishte të marrim perceptimet e drejtorëve lidhur me përvojën e shkollave në përdorimin e platformave mësimore para dhe gjatë situatës së krijuar me Covid -19: informimin, fillimin e mësimit online, organizimin, pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin online, mbështetjen, mundësitë, sfidat dhe nevojat për realizimin me sukses të mësimit në distancë.

#### **Mësimi online para situatës së krijuar me Covid -19**

Për të parë se cilat janë përvojat e deritanishme të shkollave në shfrytëzimin e platformave online para situatës së krijuar me Covid -19, drejtorëve të shkollave u kërkua të shprehnin mendimin lidhur me përdorimin e

---

<sup>37</sup> Rezultatet e studimit me drejtorët e Qendrave Burimore, trajtohen në kapitullin: Mësimi në distancë/E-mësimi nga perspektiva e Qendrave Burimore.

platformave mësimore online, llojet e platformave që kanë përdorur mësimdhënësit e shkollave të tyre dhe format e komunikimit online me nxënës.

Sipas shumicës së drejtorëve të shkollave, gjatë kohës së mbajtjes së mësimin në shkollë (para pandemisë), është një numër relativisht i vogël i mësimdhënësve që kanë përdorur platforma mësimore online, për faktin se nuk kanë qenë pjesë e ndonjë programi të veçantë të zhvillojnë kapacitetet për përdorim e platformave mësimore. Drejtorët e shkollave të arsimit bazë, që kanë qenë pjesë e programit School Me, konfirmojnë se një pjesë e mësimdhënësve të tyre gjatë mësimin në shkollë, në orë të ndryshme mësimore, e kanë përdorur këtë platformë mësimore, për qëllime të shpjegimit të njësive të reja mësimore, por edhe për ushtrime dhe përsëritje.

Ndërsa, sa i përket komunikimit online me nxënës nga ana e mësimdhënësve, drejtorët e shkollave mendojnë se një pjesë e madhe e mësimdhënësve i kanë përdorur disa aplikacione të komunikimit online, si: Viber, E-mail, MsN, Skype, Zoom, Google Classroom, në mënyrë të veçantë mësimdhënësit me shkathtësi të mira për përdorim të TIK-ut. Format e tilla të komunikimit online drejtorët e shkollave shprehen se edhe vetë i kanë përdorur, kryesisht gjatë komunikimit me mësimdhënësit, me DKA-të dhe institucione të tjera.

Përdorimi i platformave mësimore online ndërlidhet edhe me kapacitetet e mësimdhënësve dhe të drejtorëve të shkollave për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe udhëheqje arsimore. Mbi 55% e drejtorëve të shkollave të përfshirë në këtë studim kanë thënë se janë të certifikuar në ndonjë program trajnimi për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe në ndonjë program për mësimin në distancë/e-mësimin, si ECDL dhe krijimi i përmbajtjeve mësimore elektronike, SITOS/Admin, School Me, Excel, E-learning, UBT Plus, E-mësimi etj. Ndërsa, pjesa tjetër kanë thënë se nuk kanë pasur rastin të jenë pjesë e ndonjë programi të trajnimit në këtë fushë dhe rrjedhimin edhe nuk janë të certifikuar, por zotërojnë shkathtësi relativisht të mira për përdorimin e TIK-ut në udhëheqje të shkollës.

## **Informimi i drejtorëve të shkollave për organizimin dhe fillimin e mësimit në distancë /e-mësimit**

Pezullimi i përkohshëm i mësimit të drejtpërdrejtë në shkolla, më 11 mars 2020 (Qeveria e Republikës së Kosovës, 2020) dhe fillimi i përgatitjeve nga MASHTI për organizimin e mësimit në distancë, i mobilizoi të gjitha institucionet arsimore që të ndër marrin masa në nivel shkolle, për informimin e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve lidhur me organizimin e mësimit në distancë, për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë në këtë proces, dhe për organizimet në nivel shkolle. Fillimi i zbatimit të mësimit në distancë varej shumë nga niveli i informimit të vetë drejtorëve të shkollave.

Pothuajse të gjithë drejtorët e shkollave kanë deklaruar se janë informuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, nga MASHTI dhe mediet, qysh në fillim të përgatitjeve për organizimin dhe realizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, për mënyrën e zhvillimit të mësimit online, si dhe organizimin dhe transmetimin e mësimit në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).

Në pyetjen se çfarë informacionesh kanë marrë, 59% e drejtorëve kanë thënë se janë informuar për orarin e orëve mësimore që shfaqen në RTK; 38% për mundësitë e realizimit të kurrikulës/programit mësimor; 81% kanë thënë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në punën me mësimitdhënës, nxënës dhe prindër; 62% për mënyrat dhe format e punës me mësimitdhënës, nxënës dhe prindër; dhe 25% janë shprehur se kanë marrë edhe informata tjera.

Informacionet që kanë marrë nga Drejtoritë Komunale të Arsimit për organizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, 52% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim i konsiderojnë të mjaftueshme, 15% i konsiderojnë të pamjaftueshme, 24 % të plota dhe praktike dhe 9% deri diku të qarta. Informacionet e marra nga

*Informacionet nga DKA-të dhe udhëzimet nga MASHTI për organizimin e mësimit në distancë si dhe informacionet për orarin javor të transmetimeve të orëve mësimore në RTK kanë pasur efekt pozitiv në informimin e drejtorëve.*

MASHTI për gjysmën e drejtorëve të shkollave (51%) janë të mjaftueshme, për 21% deri diku të qarta, 18% të plota dhe praktike dhe 3% të pamjaftueshme. Ndërsa, informacionet e siguruar nga mediumet publike vetëm 36% e drejtorëve të shkollave i konsiderojnë të plota dhe praktike.

Për organizimin e mësimit në distancë/e-mësimit, informim dhe komunikim me mësime të mësimdhënës, prindër dhe organe tjera të shkollës, drejtorët janë duke përdorur platforma të ndryshme. 75% kanë thënë se po e përdorin platformën Zoom, Viberin 69% e drejtorëve, 30% Skype, 27% Google classroom, Teams 12% dhe 18% aplikacione të tjera.

Shkaku i situatës së krijuar dhe mungesës së përvojës, fillimi i mësimit në distancë është pritur me shqetësim, stres dhe frikë, por shumica janë shprehur të gatshëm të angazhohen në këtë proces. 61% e drejtorëve kanë thënë se fillimin e mësimit në distancë e kanë pritur të mobilizuar, të interesuar dhe të gatshëm për angazhim, 31% kanë deklaruar se e kanë pritur me qetësi, të interesuar dhe të gatshëm për t'u angazhuar, dhe vetëm 3% kanë thënë se e kanë pritur me shumë shqetësim, stres dhe frikë. Po ashtu, 3% kanë thënë se e kanë pritur pak të shqetësuar dhe me stres. “Kisha aq shumë pyetje për veten, se çfarë duhet të bëj, si duhet të bëj, sa... etj”, shprehet një drejtor shkolle.

*Mësimi në distancë ka filluar qysh në javën e parë pas ndërprerjes, por në disa shkolla ka filluar që nga dita e fillimit të shfaqjes në Radio Televizionin e Kosovës dhe në kanalin e MASHT në 'Youtube'*

Në shumicën e shkollave kjo formë e mësimit ka filluar të mbahet menjëherë pas ndërprerjes së mësimit nga Qeveria e Kosovës. 51% e drejtorëve të shkollave kanë thënë se mësimin online e filluar në javën e parë të ndërprerjes së mësimit, përmes platformave online, ndërsa 45% nga dita kur ka filluar të shfaqet mësimi në RTK dhe në kanalin 'YouTube' (drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta).

## Organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimit në distancë /e-mësimit

Sa i përket organizimit të mësimit, drejtorët e shkollave kryesisht u janë përmbytur udhëzimeve të MASHTI-t. Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9) mësime të mësimdhënësit janë obliguar që t'i përcjellin orët e mësimit në lëndët mësimore që transmetohen në RTK dhe të mbajnë kontakte me nxënës, sipas dinamikës që e kanë përcaktuar së bashku me nxënësit dhe prindërit. Në lëndët që nuk mbulojnë në transmetimet në RTK dhe në kanalën e MASHTI-t në YouTube<sup>38</sup> mësime të mësimdhënësit e këtyre lëndëve, së paku një herë në dy javë, organizojnë aktivitete përmes mësimit online.

Platformat/aplikacionet që janë duke i përdorur mësime të mësimdhënësit për realizimin e mësimit në distancë/e-mësimit janë të shumta dhe të ndryshme. Në numër më të madh, sipas drejtorëve të shkollave, mësime të mësimdhënësit janë duke përdorur platformën Zoom (78%), pasuar nga Viber (69%), Google classroom (54%), Skype (27%), Teams (15%) dhe të tjera (3%).

*Aktualisht, platformat më të përdorura nga mësime të mësimdhënësit për realizimin e mësimit në distancë janë: Zoom, Viber, E-mail, Google Classroom, Skype...*

Për të kuptuar se cilat platforma/aplikacione dhe forma të punës po i përdorin mësime të mësimdhënësit, 72% e drejtorëve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se informohen në bazë të raporteve që i marrin nga mësime të mësimdhënësit, 60% nëpërmjet bisedave me telefon, 57% në bazë të mbledhjeve online që i mbajnë, 45% kanë deklaruar se janë pjesë e platformave që i përdorin mësime të mësimdhënësit dhe 36% në bazë të kontakteve që kanë me përfaqësues të prindërve.

Sipas drejtorëve të shkollave, mësime të mësimdhënësit i aplikojnë platformat e mësimit në distancë/e-mësimit për qëllime të ndryshme. 66% e drejtorëve kanë thënë se përmes platformave online mësime të mësimdhënësit e bëjnë shpjegimin e përmbytjeve dhe detyrave mësimore, 65% dërgimin e përmbytjeve mësimore dhe detyrave, 60% kanë deklaruar se i këshillojnë nxënësit për

<sup>38</sup><https://emesimi.rks-gov.net>

detyrat mësimore dhe 51% e tyre kanë thënë se mësimdhënësit ua dërgojnë nxënësve detyrat dhe prezantimet e video-incizimeve të lidhura me përmbajtjet mësimore.

Sa u përket përgatitjes dhe gatishmërisë së mësimdhënësve për të mbajtur mësim online, shumica e tyre, sipas drejtorëve, janë të gatshëm, por jo të gjithë janë të përgatitur plotësisht për mësim nga distanca/e-mësim. 81% e drejtorëve kanë thënë se mësimdhënësit në masë të mirë janë të përgatitur dhe të gatshëm të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre për realizimin e mësimin në distancë /e-mësimin, sipas udhëzimeve të MASHTI-t, 12% deri në njëfarë mase dhe vetëm 7% kanë thënë se janë të përgatitur dhe të gatshëm plotësisht.

Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë ndarë me drejtorët e shkollave modele të raporteve, sipas së cilave duhet të raportojnë rregullisht, dhe, që nga fillimi i mësimin në distancë, shkollat përgatisin raporte javore për pjesëmarrjen e mësimdhënësve dhe nxënësve në mësimin në distancë, të cilat tregojnë se 90% e mësimdhënësve janë duke organizuar mësim në distancë /e-mësim, në një formë apo tjetër.

Sipas këtyre raporteve, të cilat dorëzohen rregullisht te drejtorët e shkollave nga kujdestarët e klasave dhe mësimdhënësit e tjerë, edhe përqindja e nxënësve që marrin pjesë në mësimin në distancë/E-mësimin është mjaft e lartë, rreth 90%.

*Bazuar në evidencat që posedojnë drejtorët e shkollave, pothuajse të gjithë mësimdhënësit janë duke organizuar mësimin në distancë, kurse pjesëmarrja e nxënësve, në forma të ndryshme të e-mësimin është mbi 90%.*

Drejtorët e shkollave vazhdojnë t'i kryejnë obligimet e tyre karshi mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollës së tyre. Në përputhje me detyrat e punës, koordinojnë organizimin e mësimin në distancë dhe i raportojnë rregullisht DKA-së për sfidat dhe vështirësitë, me të cilat përballen mësimdhënësit dhe nxënësit (MASHTI, 2020a).

Vështirësitë e mësimdhënësve gjatë realizimit të mësimin në distancë /e-mësimin janë të natyrave të ndryshme. Më shumë se gjysma e drejtorëve, apo



shprehur në përqindje 55 %, kanë thënë se realizimi i planit dhe programit mësimor sipas planifikimit të bërë është vështirë të arrihet nga mësimdhënësit, ndërsa përshtatjen e mësimdhënësve me këtë formë të mësimin e shohin të vështirë 51% e tyre. Mungesën e internetit të qëndrueshëm e kanë përmendur si vështirësi 39% e drejtorëve, përdorimin e aplikacioneve për mësim në distancë 36%, mungesën e përmbajtjeve mësimore online në përputhje me kurrikulën 30%, menaxhimin e komunikimit me nxënës detyrave të nxënësve - ofrimin e informatave kthyesë për detyrat 27% dhe vështirësi të tjera 15% e drejtorëve.

Për realizimin e mësimin në distancë/e-mësimin dhe tejkalimin e sfidave dhe vështirësive, mësimdhënësit ndihmohen, në forma të ndryshme, nga shkollat dhe DKA-të. 72% e drejtorëve kanë thënë se ata vetë u ndihmojnë mësimdhënësve, 48% kanë thënë se u ndihmojnë mësimdhënësit e TIK-ut, 24% kanë thënë se po u ndihmojnë prindërit, 18% Drejtoritë Komunale të Arsimit, dhe 27% dikush tjetër (nga familja apo shoqëria).

Sipas drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, orët mësimore që po shfaqen në RTK dhe kanalin 'YouTube' po ndihmojnë mjaft, pasi nxënësit janë gjithmonë të angazhuar me detyra dhe janë afër librave, 7% e drejtorëve kanë thënë po ndihmojnë shumë, 54% kanë thënë se po i mobilizojnë në masë të madhe nxënësit dhe prindërit, 27% kanë thënë deri diku po ndihmojnë, dhe 12% kanë deklaruar se po ndihmojë pak apo fare.

Disa nga drejtorët kanë thënë se nuk janë të kënaqur me mënyrën e realizimit të mësimin në RTK, pasi, sipas tyre, po mungojnë sqarimet dhe informatat kthyesë dhe nuk ka përputhje të planeve dhe programeve. Po ashtu, disa njësi mësimore tashmë janë realizuar gjatë mësimin të rregullt, apo edhe janë prapa, dhe kjo po u paraqet probleme nxënësve dhe mësimdhënësve. Këto mangësi po mundohen t'i plotësojnë mësimdhënësit gjatë komunikimit, pasi detyrë e mësimdhënësve është përcjellja e mësimin online, përkujdesja për aktivizimin e rregullt të

*Duke ua sqaruar mësimet që përcillen nëpërmjet RTK-së, mësimdhënësit po ua plotësojnë nxënësve mangësitë dhe nevojat për të nxënë dhe po i mobilizojnë...*

nxënësve, për kryerjen e detyrave të shtëpisë, këshillimin e nxënësve për tejkalimin e sfidave, shpjegimin e pjesëve më të vështira, mbajtjen e evidencave e të tjera (MASHTI, 2020a).

*“Përpos transmetimit të njërive mësimore në RTK, nga koordinatori i cilësisë së shkollës është hartuar orari mësimor në platformën ZOOM, përmes së cilës çdo klasë ka qasje me mësimdhënësin e lëndës përkatëse”, shprehet një drejtor.*

Angazhimi i nxënësve nga ana e mësimdhënësve të tyre, dhënia e detyrave të shtëpisë dhe sqarimeve, po ndihmon shumë, pasi po i mban aktivë dhe po i mobilizon të punojnë. 56% e drejtorëve kanë thënë se mësimdhënësit po i mobilizojnë në masë të madhe, 19% kanë thënë se po ndihmojnë shumë, kurse 25% kanë deklaruar se po ndihmojnë deri diku.

*“Nuk ka përputhje në plan-programe, në disa lëndë shkolla jonë është përpara e në disa prapa. Kryesisht pjesën teorike nxënësit po e përcjellin nga RTK-ja, ndërsa pjesën tjetër po ua sqarojnë mësimdhënësit, duke u dhënë detyra ,e njëkohësisht edhe sqarime, pasi mungojnë informatat kthyesë”, thotë një drejtor shkolle.*

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, MASHTI e ka lënë në përgjegjësi të komunave organizimin e mësimin në distancë. Drejtorët e shkollave të mesme të larta shprehen se janë duke e organizuar mësimin online sipas udhëzimeve të MASHTI-t, në mënyrë të decentralizuar, në nivel shkolle dhe mësimdhënësit në nivel klase (MASHTI, 2020b), mirëpo ata shprehen se një numër i mësimdhënësve kanë vështirësi në organizimin e mësimin, për shkak të njohurive jo të mira në aplikimin e platformave/aplikacioneve.

Të dhënat e siguruara nga drejtorët e shkollave të mesme tregojnë se nuk ka unifikim në nivel vendi sa i përket mënyrës së organizimit të mësimin në distancë, pasi shkollat kanë nisur mbajtjen e mësimin me iniciativa vetjake dhe janë të lira të vendosin vetë për platformat, gjithmonë duke iu përmbajtur rekomandimeve të Ministrisë gjegjëse dhe Drejtorive Komunale të Arsimit. Disa komuna kanë zhvilluar platforma të veçanta për mësimin online.

Bashkëpunimi i mësimdhënësve me njëri-tjetrin dhe bashkëpunimi me prindër në këtë situatë dhe qasje të re të mësimdhënies është bërë i domosdoshëm, prandaj shumica e mësimdhënësve dhe prindërve janë mobilizuar dhe janë duke bashkëpunuar mjaft mirë.

Rreth 60% e drejtorëve të shkollave kanë thënë se mësimdhënësit çdo ditë e më shumë po bashkëpunojnë ndërmjet vete, 24% kanë thënë se mësimdhënësit janë mobilizuar shumë, 10% kanë thënë deri diku po bashkëpunojnë dhe 6% kanë deklaruar se disa mësimdhënës nuk po shprehin interesim.

*Bashkëpunimi ndërkolegial ndërmjet mësimdhënësve, si dhe bashkëpunimi me prindërit, është rritur në masë të madhe dhe në shumicën e komunave është në nivel.*

Sipas tyre, edhe bashkëpunimi me prindër duhet çmuar, sidomos në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët.

41% kanë thënë se prindërit çdo ditë e më shumë po bashkëpunojnë dhe po aq kanë thënë se deri diku po bashkëpunojnë, 10 % kanë deklaruar deri diku po bashkëpunojnë, ndërsa vetëm 6% e drejtorëve kanë deklaruar se disa prindër nuk po shprehin interesim të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë nxënësit në këtë proces.

Në nivelin fillor (I-V) dhe mesëm të ulët (VI-IX) nxënësit janë më aktivë në kryerjen e detyrave dhe përgjigjen në kërkesat e mësimdhënësve, ndërsa në nivelin e mesëm të lartë kërkohet të insistohet më tepër në përfshirjen e nxënësve. Për të përfshirë të gjithë nxënësit, mësimdhënësit, përveç komunikimit me nxënësit, në mënyrë individuale dhe në grupe, janë duke komunikuar intensivisht edhe me prindërit, por mungesa e internetit dhe teknologjisë për përdorimin e platformave online në disa zona rurale po e bëjnë më të vështirë funksionimin e trekëndëshit prind-nxënësmësimdhënës.

## **Mundësitë e vazhdimit të zbatimit të mësimin në distancë /e-mësimin dhe nevojat për mbështetje**

Mësimi në distancë/e-mësimi është një përvojë e re, prandaj, për të qenë efektiv, duhet të mbikëqyret dhe të përkrahet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet qendrore dhe lokale. Përvojat e fituara duhet të shfrytëzohen në të ardhmen nga shkollat, duke u fokusuar në përparësitë dhe përfitimet, pasi është arritur të krijohet shprehi e punës online, si nga mësimdhënësit, po ashtu edhe nga nxënësit, në të gjitha nivelet e arsimit.

Rreth 78% e drejtorëve të shkollave të përfshirë në hulumtim e vlerësojnë mësimin në distancë/e-mësimin një përvojë që duhet të përkrahet, 15% e shohin si një mundësi për të dhënë maksimumin, 6% kanë thënë se presin të përmirësohet dhe asnjë nga drejtorët nuk është shprehur i pakënaqur me këtë formë të mësimdhënies.

Përparësi e madhe konsiderohet përdorimi i platformave të ndryshme, duke avancuar njohuritë e mësimdhënësve dhe nxënësve në përdorimin e teknologjisë, meqenëse mësimi online në shkollat tona është qasje e re e mësimdhënies dhe nxënies dhe disa mësimdhënës, veçmas ata që janë më afër pensionimit, kanë vështirësi në përdorimin e TIK-ut dhe nuk kanë njohuri të mjaftueshme për strategjitë e mësimin elektronik.

Mësimi online/e-mësimi, sipas drejtorëve të shkollave, përveçse ka rritur bashkëpunimin e organeve të shkollës: udhëheqjes së shkollës, mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, i ka nxitur të hulumtojnë më tepër dhe të shfrytëzojnë materiale të ndryshme nga interneti dhe burime të tjera relevante. Po ashtu, mësimdhënësit kanë fituar kompetenca të reja të ligjërimit nga distanca dhe përdorimit të platformave/aplikacioneve të panjohura deri më tani nga ta. Është fituar një përvojë e re, e cila do të

*Mësimi në distancë nxjerr në pah nevojën e drejtorëve, mësimdhënësve, edukatorëve, nxënësve dhe prindërve për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. Po ashtu, fokusi i MASHTI-t dhe DKA-ve të jetë furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike.*

ndihmojë mësimdhënësit dhe nxënësit në të ardhmen (pasi të normalizohet situata nga pandemia).

Procesi edukativo-arsimor nga distanca, përmes platformave të ndryshme, si Google classroom, Zoom etj., ofron mundësi të shumta të mësimdhënies dhe nxënies, nëpërmjet bashkëbisedimit, diskutimit, ligjërit, punës me projekte të vogla, si dhe mundësinë e vlerësimit, me gojë dhe me teste, në të gjitha nivelet e arsimit.

Përveç arsimit fillor dhe të mesëm, edhe për institucionet parashkollore mësimi në distancë ka vështirësitë dhe përparësitë e veta, si për edukatorët po ashtu edhe për fëmijët. Për edukatorët është një mundësi e mirë që të avancohen edhe më shumë rreth përdorimit të mësimin elektronik – platformave online, ndërsa fëmijët po qëndrojnë me familjarët e tyre dhe në të njëjtën kohë prindërit/kujdestarët po udhëzohen nga profesionistët se si t’u qasen dhe si të zhvillojnë aktivitete të përshtatshme për moshën e tyre, në kushte shtëpie. Gjatë lojës dhe realizimit të aktiviteteve me prindërit/kujdestarët, largohen sadopak nga TV-të dhe pajisjet tjera teknologjike, që janë të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e tyre.

*“Institucioni ynë ka përpiluar orarin e edukatores mbështetëse, e cila do të jetë në gatishmëri për të bashkëpunuar me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me edukatorët, për t’u dhënë udhëzime se si të punojnë. Gjithashtu, jemi në gatishmëri të plotë t’u japim këshilla profesionale prindërve, të cilët shprehin ndonjë shqetësim sa i përket zhvillimit emocional të fëmijëve të tyre gjatë kohës sa do të jenë në izolim”, (drejtoreshë e institucionit parashkollor).*

Për të zhvilluar mësimin online me sukses dhe përfshirje të të gjithëve, nevojiten pajisje teknologjike, internet në gjithë vendin, si dhe shkathtësi bazë në përdorim të aplikacioneve të ndryshme nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Mungesa e pajisjeve të nevojshme (laptopit, ipodit, telefonit smart), rrjeti i pamjaftueshëm i internetit dhe mungesa e trajnimeve adekuate për përdorimin e platformave online, janë disa nga pengesat në zhvillimin e mësimin nga distanca.

Sipas drejtorëve, edhe nëse do të përfshiheshin të gjithë nxënësit në procesin mësimor, sfida mbeten realizimi i programit, puna praktike, interaktiviteti, zhvillimi i mendimi kritik, socializmi, dhe vlerësimi i nxënësve, prandaj kjo formë e mësimit mund të këtë edhe pasoja në të ardhmen. Sa i përket vlerësimit të nxënësve, për të cilin kanë shfaqur shqetësim dhe dilema shumica e drejtorëve, por jo vetëm, MASHTI ka nxjerrë

*Disa nga problemet dhe pasojat nga kjo qasje e mësimdhënies do të jenë: Gjithpërfshirja, socializmi, pajisjet teknologjike, aktivitetet praktike, vlerësimi dhe praktika profesionale - sidomos për shkollat profesionale..*

një vendim, i cili rregullon procedurat e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (MASHTI, 2020g).

Po ashtu, pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, si udhërrëfyes për veprimet që duhet zbatuar, duke iu përshtatur kontekstit dhe rrethanave (MASHTI, 2020f). Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë në kushtet e pandemisë COVID-19, në mënyrë që të mbështetet përfundimi i vitit shkollor 2019/20 dhe të evidentohen arritjet individuale të nxënësve.

Mësimi online mund të shkaktojë edhe probleme të shëndetit mendor dhe efekte psikologjike, si pasojë e presionit, ankthit, frikës dhe shqetësimeve tjera, ngase krijohet ndjenja e izolimit, si dhe mungojnë demonstrimet praktike, ndërveprimi me bashkëmoshatarët dhe prezenca fizike e mësimdhënësve, të cilët krijojnë mjedis edukativ.

*Për mbështetje të mësimdhënësve dhe nxënësve në realizimin e mësimit në distancë /E-mësimit nevojiten Udhëzimet për harmonizimin e planifikimeve dhe Udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.*

Nëse do të vendoset që deri në fund të vitit mësimor të mbahet mësimi në distancë/e-mësimi, sipas 78% të drejtorëve të shkollave, mësimdhënësit do të kishin nevojë për laptop dhe 31% për kompjuter, kurse sipas 71% të

drejtorëve mësimdhënësit do të kishin nevojë për trajnime dhe udhëzime si t'i përdorin platformat online.

Po ashtu, 46% e tyre kanë thënë se edhe drejtorët do të kishin nevojë për udhëzime më të qarta për rolin e tyre në këtë proces, 40% kanë paraqitur nevojën për koordinim më të mirë me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe 37% kanë thënë se do të kishin nevojë për internet dhe mjedis më të përshtatshëm për mësim në distancë/e-mësim, nëse kjo gjendje do të zgjasë edhe më tutje.

Megjithatë, për 84% të drejtorëve të shkollave të përfshirë në hulumtim, mbështetja e mësimdhënësve me udhëzimet për vlerësimin e nxënësve është shumë e nevojshme, për 66% janë të nevojshme udhëzimet për harmonizimin e planifikimeve për mësimin në distancë/e-mësimin; 60% e shohin të nevojshëm publikimin e materialeve mësimore (video-ligjëratave, ilustrimeve, udhëzimeve, ushtrimeve, detyrave, pyetjeve), ndërsa 18% kanë thënë se kanë nevojë për informata paraprake për njësitë mësimore që do të shfaqen në RTK.

Njëkohësisht, kërkohet angazhim i shtuar profesional, i pedagogut dhe psikologut, për mbështetje dhe këshillime profesionale të fëmijëve-nxënësve, e mbase jo vetëm këtyre, për pasojat e mundshme që sjell mbyllja në shtëpi (vetmia), qoftë edhe pas periudhës së izolimit dhe kthimit në institucione edukativo-arsimore. Lidhur me përkrahjen e nevojshme, disa drejtorë janë shprehur se:

*Mësimdhënësit kanë pasur hamendje se si të veprohet dhe sa do të ketë efekt mësimi online, në mungesë të përkrahjes dhe udhëzimeve profesionale për këtë qasje të re të mësimdhënies, prandaj nevojitet një platformë unike për të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit, në të cilën do të mund të kishin qasje të gjithë, me linkun e njëjtë për klasat përkatëse.*

*Në shkollat tona është e nevojshme të krijohet një sektor për të ndihmuar procesin e të mësuarit online, apo të caktohet një person përgjegjës, sepse shumica e mësimdhënësve të TIK-ut nuk janë*

*mjaftueshëm të përgatitur t'u ndihmojnë mësimdhënësve dhe nxënësve të përdorin platformat online.*

*Kërkohe organizim i mirëfilltë, me ekspertë të fushave kurrikulare dhe ekspertë të IT-së, për përgatitjen dhe organizimin e testeve të semimaturës dhe maturës.*

## **Përfundime dhe rekomandime**

**Përfundimet kryesore** mbi bazën e gjetjeve të studimit lidhur me mësimin në distancë/e-mësimin, nga perspektiva e drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore, janë:

- Para situatës së krijuar nga pandemia me Covid -19), mësimdhënësit kanë përdorur platforma me përmbajtje të mësimin online, por me intensitet më të ulët;  
Është për t'u përshëndetur puna e bërë nga institucionet qendrore dhe lokale gjatë organizimit të mësimin në distancë, pasi, megjithëse në rrethana të jashtëzakonshme, është arritur të bëhet mobilizimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve;
- Drejtorët e shkollave kanë informacione për pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin në distancë, mirëpo nuk kanë informacione të mjaftueshme për përmbajtjen e punës së mësimdhënësve me nxënës;
- Drejtorët janë njoftuar nga Drejtoritë Komunale të Arsimit, nga MASHTI dhe mediet, për organizimin e mësimin në distancë dhe janë të kënaqur me informacionet e marra;
- Mbajtja e mësimin në distancë nuk ka filluar njëkohësisht në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë. Në shumicën e shkollave (sidomos në SHFMU) mësimi në distancë ka filluar në javën e parë pas ndërprerjes, kurse në pjesën tjetër nga dita kur ka filluar të transmetohet në RTK, por ka shkolla që kanë filluar edhe më vonë;
- Pjesa më e madhe e shkollave kanë përdorur platformat Zoom, Google Classroom dhe Viber, të cilat janë shfrytëzuar për komunikim e ligjërim, si dhe për dërgimin dhe kontrollimin e detyrave;



- Drejtorët, për shkak të mungesës së përvojës, e kanë pritur me frikë dhe stres këtë formë të mësimit online, pasi jo të gjithë mësime të mësimit online kanë qenë të përgatitur të mbajnë mësime në distancë, nëpërmjet platformave online;
- Kjo formë e mësimit mund të merret si një lloj trajnimi/avancimi profesional për drejtorët dhe mësime të mësimit online, duke e ditur se kanë shfrytëzuar platforma të ndryshme të mësimit online dhe materiale të shumta nga interneti.
- Mbajtja e mësimit online mund të ndikojë pozitivisht, pasi drejtorët e shkollave, mësime të mësimit online, nxënës dhe prindërit kanë fituar një përvojë që nuk e kishin deri më tani në përdorimin e platformave;

### **Rekomandimet kryesore për realizimin e mësimit në distancë**

- Udhëzimet për rolin e drejtorëve në këtë proces të jenë më të qarta dhe të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet MASHTI-t, DKA-ve dhe shkollave;
- Kjo përvojë t'u shërbejë MASHTI-t, DKA-ve dhe shkollave, si mësime që në të ardhmen trajnimet të orientohen në teknologjinë informative - përgatitjen e mësime të mësimit online për përdorim të platformave online;
- T'u krijohet mundësia të gjithë nxënësve të marrin pjesë në mësime online, duke u siguruar qasje në internet dhe duke u kujdesur që të mos u mungojnë pajisjet e nevojshme. Të gjenden mundësitë për pajisje të mësime të mësimit online me laptop, tablet, si dhe të bëhet digjitalizimi i librave/teksteve shkollorë;
- Të krijohen platforma online për organizimin e mësimit në distancë, në pajtim me kurrikulën;
- Të angazhohen ekspertë profesionalë (pedagogë dhe psikologë), me qëllim të këshillimit dhe përkrahjes së mësime të mësimit online dhe nxënësve në këtë proces;
- Shkollat të krijojnë një databazë për pjesëmarrjen e mësime të mësimit online dhe nxënësve në mësime online, me të arriturat, sfidat dhe vështirësitë e paraqitura gjatë mësimit në distancë.



## **3.2. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E MËSIMDHËNËSVE**

Haxhere Zylfiu, Amantina Pervizaj & Selim Mehmeti

Mësimi në distancë në Kosovë në kushtet e pandemisë, si edhe në shumicën e vendeve të rajonit, ka filluar pa përgatitje të duhura (MASHTI, 2020f), gjë që ka sfiduar gjithë sistemin arsimor në Kosovë, në mënyrë të veçantë mësimdhënësit. Ata janë ballafaquar me një përvojë të re të mësimdhënies dhe me sfida në përmbushjen e rolit të tyre në këtë proces. Për këtë, një fokus i veçantë i studimit lidhet me mësimdhënësit dhe përvojën e tyre në realizimin e mësimi në distancë. Mostra e përfshirë në studim përfshin 1923 mësimdhënës, detajet e së cilës janë prezantuar në kapitullin për metodologjinë e studimit.

Në fokus të hulumtimit me mësimdhënës, gjetjet që pasqyrohen në këtë pjesë janë aspekte që ndërlidhen me përvojat e-mësimi para situatës së krijuar më Covid-19, informimin, fillimin e mësimi në distancë, organizimin, pjesëmarrjen e nxënësve, mbështetjen, mundësitë, sfidat dhe nevojat për realizimin me sukses të mësimi në distancë.

### **1. E-mësimi para situatës së krijuar me Covid -19**

Për të parë se cilat janë përvojat e deritanishme të mësimdhënësve në shfrytëzimin e platformave për mësim në distancë para situatës së krijuar me Covid -19, atyre iu kërkua të deklarohen në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të platformave, llojet e platformave që kanë përdorur dhe format e komunikimit online me nxënës.

Sa i përket përdorimit të platformave për mësimdhënie dhe nxënie në distancë para situatës së krijuar me Covid -19, rezultoi të ishte kryesisht një përvojë e re për mësimdhënësit tanë, meqenëse 68,1% prej tyre nuk kanë përdorur platforma të ngjashme më parë (asnjëherë=65,1% ose vetëm në ndonjë rast=3%). Janë 31,9% e mësimdhënësve që kanë përdorur platforma të ndryshme në procesin arsimor. Specifikuar moshën e mësimdhënësve, përqindjen më të lartë të përdorimit të platformave para COVID-19 e kemi


nga mësimdhënësit e grupmoshës 20-30 vjeç, me 36,2%, tek alternativa çdoherë, tabela 3.

Tabela 3. Përdorimi i platformave mësimore para COVID-19 sipas moshës së mësimdhënësve

Mosha	Çdoherë	Ndonjëherë	Shpeshherë
21-30 vjeç	36,2	21,2	20,4
31-40 vjeç	29,8	35,6	35,9
41-50 vjeç	14,9	23,2	20,4
51-60 vjeç	8,5	17,9	22,5
Mbi 60 vjeç	10,6	2,1	0,7

Platformat mësimore të përdorura nga mësimdhënësit para pandemisë rezultuan të jenë: *School Me* 46,8%, pastaj *Microsoft Showcase Classroom 365* me 35,6% dhe *Busulla.com* me 30,3%. Ndërsa, komunikimi online me nxënës në procesion e mësimdhënies dhe nxënies para pandemisë, sipas mësimdhënësve, kryesisht është realizuar përmes Viber, me disa raste të rralla që kanë përdorur edhe aplikacionet Zoom, Skype etj.

Qëllimi kryesor i përdorimit të platformave dhe aplikacioneve online para pandemisë COVID-19, sipas mësimdhënësve, ka qenë këshillimi i nxënësve për detyrat mësimore, me 70,9%.



Grafiku 1. Zbatimi i aplikacioneve online para pandemisë COVID-19

Aspekt pozitiv i deklaruar është që në përqindje më të lartë mësimsdhënësit ndihen të përgatitur mjaftueshëm për aplikimin me lehtësi (40%) ose me shumë lehtësi (25,7%) të një ose disa platformave për mësim në distancë/e-mësim, përderisa të tjerët (34,3%) ndihen se nuk janë të përgatitur ose kanë vështirësi në aplikimin e platformave në këtë proces. Nga kjo përqindje, krahasuar me moshën e mësimsdhënësve të përgjigjur, vështirësi më të mëdha në përdorimin e platformave për mësim në distancë kishin mësimsdhënësit e grupmoshës 51-60 vjeç (61,6%).

*Tabela 4. Vështirësitë në përdorimin e platformave në mësimin në distancë sipas moshës së mësimsdhënësve*

Mosha	Nuk jam fare i/e përgatitur për të përdorur asnjë platformë	Jam shumë pak i/e përgatitur për ta përdorur vetëm një platformë
21-30 vjeç	13,1	15,9
31-40 vjeç	18,9	25,0
41-50 vjeç	21,7	13,6
51-60 vjeç	34,3	27,3
Mbi 60 vjeç	12,0	18,2

Përdorimi i platformave mësimore është lidhur edhe me kapacitetet e mësimsdhënësve për përdorimin e TIK-ut në mësimsdhënie. Rreth 59% e mësimsdhënësve të këtij studimi u shprehën se janë të certifikuar në ndonjë program trajnimi për përdorimin e TIK-ut në mësimsdhënie dhe në ndonjë program për mësimin në distancë/e-mësimin. Në përqindje më të lartë kemi mësimsdhënës të trajnuar për programin ECDL, me 44,7%, Word, Excel dhe Power Point me 16,4% dhe Busulla.com me 4%, si dhe programe të tjera në fushën e TIK-ut.

## **2. Informimi i mësimsdhënësve për organizimin dhe fillimin e mësimit në distancë**

Mësimi në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë ka filluar të realizohet që nga data 23 mars 2020. Për realizimin e mësimit në distancë/e-mësimin në këto rrethana, mësimsdhënësit janë informuar për procesin dhe mundësitë e zbatimit. Udhëzimet e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI-

t (<https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>) për organizimin e mësimit në distancë dhe informacionet për orarin javor të transmetimeve të orëve mësimore në RTK kishin efekt pozitiv në informimin e mësimeve. Sipas tyre, aspektet kryesore për të cilat ata janë informuar ndërlidhen me orarin e orëve mësimore që shfaqen në RTK (77,5%) dhe për detyrat dhe përgjegjësitë e mësimeve për punën me nxënës dhe prindër (72,3%). Në përqindje më të vogël, mësimeve kanë deklaruar informim për mënyrat dhe format e punës me nxënës dhe prindër (53,8%), si dhe për mundësitë e realizimit të kurrikulës/programit mësimor (38,0%). Në përqindje më të lartë të deklaruarve, në nivel të mjaftueshëm informimi për mësimin në distancë është ofruar nga udhëheqësit e shkollës, DKA-të, MASHTI dhe mediet publike, përderisa ka munguar informimi nga strukturat profesionale në nivel shkolle, në këtë rast nga kryetarët e aktiveve profesionale në shkollë.

*Tabela 5. Informimi për organizimin e mësimit në distancë /E-mësimi (%)*


<i>Informimi nga:</i>	Tejet të shpërndara dhe të paqarta	Informata të pamjaftueshme me	Deri diku informatat kanë qenë të qarta	Të mjaftueshme me	Të plota dhe praktike
Udhëheqësit e shkollës	11,5	16,8	13,7	30,5	27,5
Kryetari/ja e aktivitetit profesional	13,3	27,7	15,3	21,3	22,3
Drejtorja Komonale e Arsimit	13,4	21,1	18,1	29,4	18,0
Ministria e Arsimit	12,3	16,2	15,7	29,7	26,1
Mediet publike	13,2	15,5	16,2	32,4	22,8

Edhe pse përvojë e re ofrimi i mësimit në distancë/e-mësimi, në përqindje më të lartë fillimin e kësaj forme të mësimit mësimeve e pritën me qetësi, interesim dhe gatishmëri për angazhim (53,4%) dhe mobilizim, interesim dhe gatishmëri për angazhim (30,9%). 15,7% e mësimeve treguan shqetësim, stres për angazhim në këtë formë të mësimit, dhe nga kjo përqindje, 61,1% e mësimeve ishin të gjinisë femërore.

Realizimi i aktiviteteve të mësimin në distancë nga një numër i madh i mësimitdhënësve filloi që në javën e parë të ndërprerjes së mësimin në shkollë (38,5% ) ose me fillimin e transmetimit të orëve mësimore në programin e RTK-së (54,2%). Në përgjithësi, mësimitdhënësit u janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të MASHTI-t dhe institucioneve tjera arsimore për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre për realizimin e mësimin në distancë. Megjithatë, sipas mësimitdhënësve, rreth 2,5 % e tyre akoma nuk u janë përgjigjur kërkesave për mësim në distancë, ndërsa rreth 5% të tjerë këto ditë kanë filluar t'u përgjigjen kërkesave.


Sipas udhëzimeve të MASHTI-t, detyra e mësimitdhënësve (klasat 1-12) është përcjellja e mësimin online, përkujdesja për aktivizimin rregullt të nxënësve, përkujdesja dhe përcjellja e kryerjes së detyrave të shtëpisë, këshillimi i nxënësve për tejkalimin e sfidave, shpjegimi i pjesëve më të vështira, mbajtja e evidencave, e të tjera. Për klasat 1, 2 e 3, MASHTI udhëzon mësuesit që të krijojnë grupe virtuale (në Facebook ose Viber) me prindërit e fëmijëve të paraleles së vet. Për klasat 4-12, MASHTI udhëzon mësimitdhënësit që të përdorin aplikacione si Zoom, Microsoft Teams, Facebook, Google Meet, Google Classroom, për të mbajtur mësim në distancë, sipas udhëzimeve të MASHTI-t (*MASHTI, 2020a*).

Për të mësuar se sa mësimitdhënësit janë duke u bazuar në udhëzimet e MASHTI-it për krijimin e grupeve virtuale dhe përdorimin e aplikacioneve për të mbajtur mësim, kemi shtruar pyetje për mësimitdhënësit lidhur me këto kërkesa. Sipas mostrës së mësimitdhënësve të përfshirë në këtë hulumtim, platformat dhe aplikacionet më të përdorura nga mësimitdhënësit për realizimin e mësimin në distancë/e-mësimin ishin kryesisht Viber (84,9%) dhe Zoom (54,4%).



Grafiku 2. Platformat/aplikacionet e përdorura për mësimin në distancë

Referuar nivelit arsimor në të cilin mësimdhënësit japin mësim, platformat dhe aplikacionet më të preferuara në mësimin në distancë ishin Viber, ZOOM dhe Google Clasroom. Në klasën parafillore, aplikacioni më i përdorur ishte Viber, me 75,9%. Edhe në arsimin fillor (klasat 1-5) kemi dominim të përdorimit të aplikacionit Viber me 50,5%, përderisa te arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9) përqindje më të kartë kemi te kombinimi i aplikacioneve Zoom, Viber dhe Googe Clasroom, me 32,1%.




Grafiku 3. Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve online në arsimin e obliguar

Edhe në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), përdorimi i aplikacionit Zoom ishte i lartë dhe përafërsisht me përqindje të njëjtë në gjimnaze dhe në shkolla profesionale, përderisa të kombinuara në gjimnaze kemi përdorimin



e aplikacioneve Zoom dhe Google Classroom (26,2%), ndërsa në shkolla profesionale kemi Zoom dhe Viber (21,8%).




Grafiku 4. Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve online në arsimin e mesëm të lartë

**Sjellja e nxënësve gjatë mësimin online – përdorimit të platformave dhe aplikacioneve online.** Sipas mësimdhënësve, gjatë realizimit të mësimin në distancë, nxënësit kryesisht shfaqin qasje dhe sjellje korrekte në përdorimin e platformave dhe aplikacioneve online, por që ka edhe raste kur nxënësit i keqpërdorin këto qasje online, jashtë formave dhe qëllimeve të përdorimit të tyre në këtë proces (20,8%). Referuar lokacionit ku mësimdhënësit punojnë, keqpërdorimet më të shpeshta janë deklaruar nga mësimdhënësit që punojnë në shkollat e fshatit (56,8%), sesa të punësuarit në shkollat e qytetit (43,2%). Në kushtet e mësimin në distancë, është e rëndësishme të parandalohen ato përmes bashkëpunimit me vetë nxënësit, por edhe përmes bashkëpunimit me prindër. Keqpërdorimet eventuale të nxënësve në platformat online duhet të trajtohen seriozisht nga mësimdhënësit, prindërit dhe bashkëmoshataret e tyre.

**Përdorimi i pajisjeve të komunikimit nga mësime të distancës.** Pajisjet e komunikimit që mësime të distancës i përdorin për realizimin e mësimit janë kryesisht telefoni i mençur (89,8%), laptopi (71,8%), TV (45,2%), kompjuteri (13%) dhe tableti (5,3%). Sa i përket lidhjes me rrjetin e internetit, 89,2% e mësime të distancës kanë deklaruar se kanë internet përmes wireles të rregullt në shtëpi dhe 6,8% që kanë lidhje përmes telefonave celularë/Hotspot. Janë rreth 4% e mësime të distancës që kanë deklaruar se kanë probleme me qasjen në internet. Mësime të distancës me vendbanim në fshat (60,5%) më shumë kanë probleme me qasjen në internet dhe rrjedhimisht edhe në punën e tyre me nxënës gjatë mësimit në distancë.


**Angazhimi sipas ditëve të javës dhe angazhimi ditor i mësime të distancës.** Edhe pse sipas udhëzimeve të MASHT-it mësime të distancës 1-12 janë të obliguar të vazhdojnë kryerjen e detyrimeve të veta profesionale duke u fokusuar në lehtësimin e realizimit të mësimit online, sipas gjetjeve të studimit, mësojmë se rreth 30% e mësime të distancës mbajnë mësime dhe aktivitete lehtësuese për nxënës nga 1-3 ditë në javë, ndërsa pjesa tjetër 4 dhe 5 ditë në javë. Kurse, sa u përket orëve të angazhimit brenda një dite, ato janë të shpërndara, vetëm 23% e mësime të distancës angazhohen më shumë se 4 orë në ditë gjatë mësimit në distancë. Grafiku në vijim i pasqyron dallimet sa u përket ditëve të punës dhe orëve ditore të angazhimit.



*Grafiku 5. Koha e angazhimit të mësime të distancës për realizimin e Mësimit në distancë sipas ditëve në javë dhe orëve të angazhimit për një ditë*

### 3. Pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimit në distancë /e-mësimit


Pjesëmarrja e nxënësve në forma të ndryshme të mësimit në distancë/e-mësimit është e monitoruar nga mësuesit e tyre, këtë e thonë mbi 97 % e mësuesve të përfshirë në këtë studim, të cilët janë duke mbajtur mësime në forma të ndryshme. Pjesëmarrja e nxënësve në mësimin në distancë, sipas mësuesve, dallon në përqindje të shkallës së pjesëmarrjes. Sipas 25% të mësuesve, shkalla e pjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në distancë është nën 70%, rreth 48% e mësuesve thonë se pjesëmarrja e nxënësve të tyre në mësime ishte nga 70% -90%, ndërsa 27 % e mësuesve shprehën se mbi 90 % e nxënësve të tyre marrin pjesë në mësimin në distancë. Grafiku në vijim i prezanton këto detaje.



Grafiku 6. Përfshirja e nxënësve në forma të mësimit në distancë/e-mësimit sipas mësuesve

Interesimi dhe angazhimi i nxënësve gjatë mësimit në distancë. Sa i përket vlerësimit të mësuesve për interesimin dhe angazhimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, në përgjithësi vlerësimi i mësuesve është se interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar përmes mësimit në distancë është në nivel të mirë (46.4%) dhe në nivel të lartë (37.5%). Ka një përqindje rreth 12% që vlerësojnë se interesimi dhe angazhimi i nxënësve është në nivel shumë të lartë, kurse pjesa tjetër e mësuesve (rreth 4%) vlerësojnë se interesimi i nxënësve është i ulët apo tejet pasiv.

**Format e punës me nxënës në kuadër të mësimit në distancë.** Ndërlidhen me komunikimin e drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve (64%) dhe udhëzimet për detyrat e shtëpisë që dalin nga orët mësimore (63,1%).



*Grafiku 7. Format e punës me nxënës në kuadër të Mësimit në distancë*

Vështirësitë që mësime dhënësit i kanë në realizimin e aktiviteteve me nxënës kryesisht ndërlidhen me realizimin e planit dhe programit mësimor të planifikuar (42%), përderisa përkrahjen më të madhe për tejkalimin e vështirësive mësime dhënësit e kanë pranuar nga familja (41%).


*Tabela 6. Vështirësitë e mësime dhënësvë për realizimin e Mësimit në distancë dhe përkrahja për tejkalimin e vështirësive (%)*

Realizimin e plan-programit mësimor sipas planifikimit të bërë (42%)	Përkrahje nga:
Mungesën e internetit të qëndrueshëm (29%),	- askush (49,5%)
Menaxhimin i detyrave të nxënësve, ofrimi i informatave kthyesë për detyrat (28%)	- familja (41%)
Mungesa e përmbajtjeve mësimore online, në përputhje me kurrikulën (26 %)	- kolegët (22 %)
Adaptimi me këtë formë të mësimit (26%)	- prindër të nx. (1,6%)
Menaxhimi i komunikimit me nxënës (23%)	
Përdorimi i aplikacioneve për mësim në distance (15%)	

**Mësimi në distancë me nxënës me nevoja të veçanta.** Në rrethanat e pandemisë, është një sfidë tjetër, prandaj i kemi pyetur mësimdhënësit në shkolla të rregullta që punojnë me nxënës me nevoja të veçanta, se si i qasen punës me këtë grup të nxënësve dhe cilat janë sfidat e tyre. Rreth 15% e mësimdhënësve pjesëmarrës në studim kanë deklaruar se në klasat e nxënësve me të cilët punojnë ka edhe nxënës me nevoja të veçanta, të cilët, sipas mësimdhënësve, po mbështeten prej tyre në bashkëpunim me prindërit, si dhe po mbështeten prej shokëve/shoqeve të klasës. Mirëpo, mbi 21% e mësimdhënësve që kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre shprehen se nxënësit me nevoja të veçanta nuk kyçen fare në mësimin online, ndërsa rreth 5% mësimdhënësve deklarojnë se është e pamundur të punohet me këta nxënës në rrethanat e krijuara. Pjesa tjetër e mësimdhënësve deklarojnë se punojnë me PIA, përdorin platforma të ndryshme, video-xhirime apo telefonin për kontakt dhe punë me këta nxënës.

Mësimdhënësit u pyetën: *Sa po ndihmojnë orët mësimore që po transmetohen në RTK dhe kanalën e MASHTI-t në 'YouTube' në mbështetje të të nxënësve?* Në këtë kontekst rreth 19% e mësimdhënësve deklarojnë se orët mësimore që shfaqen në programin e RTK-së po i ndihmojnë shumë ata në punën e tyre dhe po ndihmojnë të nxënësve, përderisa një përqindje më e madhe (40%) vlerësojnë se këto shfaqje deri diku, pak dhe aspak nuk po e ndihmojnë punën e tyre. Sipas mësimdhënësve, mësimet në RTK po i mobilizojnë në masë të madhe nxënësit dhe prindërit (41%), meqenëse 70,7% e mësimdhënësve kanë informata nëse nxënësit e tyre i përcjellin këto orë mësimore të shfaqura në programin RTK.


Përqindja më e lartë e nxënësve që sipas mësimdhënësve i përcjellin orët mësimore, të cilat shfaqen në RTK, ishte ajo mbi 90% deri në 100% me 32% e mësimdhënësve të deklaruar. Ndiheja nga orët e shfaqura në RTK dhe përfshirja e nxënësve.



Grafiku 8. Ndhimja nga orët e shfaqura në RTK dhe përfshirja e nxënësve në orët mësimore të shfaqura në RTK

**Bashkëpunimi ndërkolegial ndërmjet mësimit dhe bashkëpunimi me prindër.** Sipas udhëzimeve të MASHTI-it për realizimin e mësimit në distancë, mësimit janë udhëzuar që të komunikojnë dhe bashkëpunojnë ndërmjet vete, nëpërmjet aktiveve profesionale dhe organeve tjera të shkollës, me qëllim të realizimit të mësimit në distancë, tejkalimin e problemeve, përcjellin realizimin e mësimit (përmes komunikimit virtual në Zoom.us, Facebook, Viber ose platforma tjera) (MASHTI, 2020a). Aspektin e bashkëpunimit kolegial të mësimit dhe të bashkëpunimit të tyre me prindër e kemi trajtuar me mësimit e përfshirë në këtë hulumtim.

Në përgjithësi, bashkëpunimi ndërkolegial, në kuadër të realizimit të mësimit në distancë, po ndodh. Sipas të përgjigurve, mësimit komunikojnë dhe shkëmbejnë materiale në mes vete (49,2%) dhe janë të mobilizuar për përkrahje njëri-tjetrit (35,9%), përderisa ka edhe prej tyre që deklarojnë mungesë të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërkolegial (14,9%). Edhe bashkëpunimi me prindër ka rezultuar të jetë gjithnjë e më shumë në rritje (42%), edhe pse një pjesë e tyre nuk shprehin interesim për bashkëpunim (15%).



Grafiku 9. Bashkëpunimi ndërkolegial në mes të mësimit dhe bashkëpunimi me prindër

Referuar grafikut, pjesës së bashkëpunimit të mësimit me prindër, shohim se mbi 57 % e mësimit shprehen se gjatë mësimit në distancë është rritur bashkëpunimi me prindër, ndërsa pjesa tjetër shprehen se deri diku po bashkëpunojnë (28%) ose prindërit nuk kanë interesim për bashkëpunim (15%). Sipas mësimit, prindërit edhe kërkojnë nga ta mbështetje për punën me fëmijët e tyre. Ata kryesisht kërkojnë sqarime për detyrat që dalin nga orët mësimore që prezantohen në RTK (56%), informata kthyesë për detyrat e fëmijëve të tyre (53%), detyra të reja për fëmijët e tyre (21%) dhe shpjegimin e njësive të reja mësimore (19%).

#### 4. Mundësitë e vazhimit të mësimit në distancë /e-mësimit dhe nevojat për mbështetje

Vazhdimi i mësimit në distancë/e-mësimit në rrethanat e krijuara nuk do të jetë i lehtë. Andaj, për këtë i kemi diskutuar disa pyetje me mësimit dhe përfshirë në studim. Realizimin e mësimit në distancë/e-mësimit mësimit vlerësojnë si një përvojë të re, që duhet përkrahur (61,9%) dhe njëkohësisht si një mundësi shumë të mirë, e cila mund të shndërrohet në një formë standarde të mësimit në distancë në të ardhmen (19,3%). Ka

edhe të tillë që vlerësojnë se kjo formë nuk i përngjan mësimdhënies (8,60%) dhe që presin të përmirësohet më tutje (10,2%).

Megjithatë, kjo formë e mësimit në rrethanat e pandemisë COVID-19 i ka edhe përparësitë, mangësitë, sfidat dhe përfitimet e veta.

Sipas mësimdhënësve, **përparësitë e mësimit në distancë** janë të shumta, si:

- Angazhimi i prindërve në mbështetjen e fëmijëve të tyre dhe si rezultat rritja e bashkëpunimit nxënës, mësimdhënës dhe prindër;
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit në procesin arsimor dhe përvetësimi i shfrytëzimit të aplikacioneve online për qëllime të mësimit;
- Orientimi i përqendrimit të fëmijëve/nxënësve te detyrat mësimore, jo te pandemia COVID-19;
- Përfitimi i përvojës, prindërit tani e vlerësojnë më shumë punën e mësimdhënësve;
- Vazhdimi dhe mosndërprerja e mësimit, përfundimi i vitit shkollor përmes qasjes online, vetëdijesimi për mundësitë e bashkëpunimit në funksion të rezultateve më të mira etj.

**Ndërsa, si mangësi të përdorimit të qasjes online** në procesin mësimor mësimdhënësit kanë përmendur:


- Keqkuptimet e shpeshta dhe pamundësia për t'i sqaruar me prezencë (live);
- Mospraktikimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara, pamundësinë për t'i testuar me prezencë;
- Vlerësimin e nxënësve, sfidë vlerësimi real dhe i shumanshëm;
- Mungesën e përvojave në përdorimin e platformave dhe aplikacioneve online nga të gjithë të angazhuarit (mësimdhënësit, nxënësit, prindërit);



- Mungesën e pajisjeve, teknologjisë, jo të gjithë nxënësit kanë mundësi t'i kenë këto pajisje;
- Mungesën e kontaktit dhe shoqërimit ndërmjet nxënësve etj.


Për fund, mësime të mësuara i kemi pyetur që në kushtet e qëndrimit në shtëpi, në rast se vendoset që viti shkollor deri në fund të realizohet përmes mësimit në distancë/e-mësimit, cilat do të ishin nevojat e tyre për mbështetje.

Në aspektin teknik, mbështetja më e madhe nga mësime të mësuara është kërkuar për pajisjen e tyre me shërbime të teknologjisë së informacionit, si laptop, kompjuter (PC) dhe rrjet interneti, si dhe shërbime të tjera mbështetëse, grafiku 11.



*Grafiku 10. Kërkesat e mësime të mësuara për mbështetje teknike*

Sa i përket mbështetjes profesionale për realizimin me sa më shumë sukses të mësimit në distancë/e-mësimit, mësime të mësuara kanë deklaruar nevojën për të pasur udhëzime për vlerësimin e nxënësve (71,2%), grafiku 11.



*Grafiku 11. Kërkesat e mësimeve për mbështetje profesionale*

**Mbështetje shtesë të kërkuara nga mësimeve për realizimin me sukses të mësimit në distancë është edhe :**

- Bashkëpunim më të madh nga ana e prindërve dhe angazhim më i madh i nxënësve në këtë formë të mësimit;
- Trajnime online për realizimin e mësimit në distancë dhe përdorimin e TIK-ut në këtë proces;
- Qasja e MASHTI-it në diskutimin e përmbajtjeve mësimore sipas planit;
- Udhëzime konkrete nga DKA dhe MASHTI, jo bazimi vetëm në komunën e Prishtinës;
- MASHTI-i përmes DKA-ve do të duhej të merrte mendimet e mësimeve lidhur me mënyrën e punës dhe asaj se çfarë ka nevojë të përmirësohet;
- Transmetimi edhe i lëndës së Gjuhës angleze në RTK, sepse nuk është e lehtë të punohet pa mbështetje;
- Stimulimi dhe mbështetja nga organet më të larta të shtetit për të kthyer kredibilitetin e mësimeve;
- Promovime vetëdijesuese për prindër, në mënyrë që ata të inkurajojnë më tepër fëmijët e tyre për këtë formë të mësimit;

- Sistem unik për shpërndarjen e literaturës përmbajtjesore dhe për vlerësimin e nxënësve;
- Promovimi i një platforme/ditari online, në të cilën mund të kenë qasje edhe prindërit për verifikimin e notave të fëmijëve të tyre (pa mundësinë për ndërhyrje!);
- Qasje online në librat shkollorë;
- Krijimi i faqeve për mësim online nga secila shkollë, etj.

## **5. Përfundime dhe rekomandime**

Përfundimet kryesore mbi bazën e gjetjeve të studimit, lidhur me mësimin në distancë/e-mësimin nga perspektiva e mësimdhënësve, janë si në vijim:

- Mësimi online/e-mësimi para situatës së krijuar me Covid -19 ka qenë i kufizuar në mesin e mësimdhënësve, bëjnë përjashtim mësimdhënësit që kanë praktikuar mësimin online me vetiniciativë. Rrjedhimisht, mësimdhënësit, ashtu si i gjithë sistemi, janë gjendur para një situatë mjaft sfiduese për të zbatuar një qasje të re të mësimdhënies që nuk e kanë provuar asnjëherë. Ka sfida të shumta për mungesë të pajisjeve, internetit të qëndrueshëm, por edhe për mungesë të përvojës e të shkathtësive të mësimdhënies përmes TIK-ut;
- Mësimi në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë ka filluar më datën 23 mars 2020;
- Pavarësisht nivelit të mirë të informimit të mësimdhënësve për realizimin e mësimin në distancë, i cili në masë të madhe është plotësuar nga dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të MASHT-it, mësimdhënësit akoma kanë mungesë informacioni në lidhje me realizimin e programit mësimor, përtej asaj që shfaqet përmes transmetimit në RTK dhe për vlerësimin e nxënësve;
- Komunikimi i mësimdhënësve me nxënës, mësimi dhe format tjera të angazhimit në mësimin në distancë, realizohen përmes aplikacioneve të ndryshme, kryesisht të atyre aplikacioneve të sugjeruara edhe nga MASHTI. Dallimet janë të dukshme në mesin e mësimdhënësve, pasi një pjesë e tyre përdorin edhe 2-3 aplikacione. Në nivelin parashkollor

dhe fillor dominon përdorimi i Viberit. Një pjesë e mësimdhënësve, aplikacionet përdoren vetëm për komunikim të shpejtë, ndarje të detyrave apo për kthim të informacioneve për detyrat. Rreth 30 % e mësimdhënësve komunikimin dhe mësimin me nxënës e mbajnë vetëm me telefonin e mençur. Kjo përbën një sfidë për mësimin në distancë, përdorimin e platformave mësimore online, për qasjen ndaj mësimdhënies etj.;

- Pjesëmarrja e nxënësve në mësimin në distancë, sipas mësimdhënësve, dallon në përqindje në shkallës së pjesëmarrjes. Sipas 25% të mësimdhënësve, shkalla e pjesëmarrjes/përfshirjes së nxënësve të tyre në mësimin në distancë është nën 70%, ndërsa sipas 48% të mësimdhënësve pjesëmarrja e nxënësve të tyre në mësim është nga 70% -90%, pjesa tjetër e mësimdhënësve janë shprehur se kanë pjesëmarrje të nxënësve mbi 90%;
- Koha e të mësuarit, e mësimdhënies, është një element thelbësor për suksesin e nxënësve dhe ajo dallon në mesin e mësimdhënësve që ishin pjesë e studimit. Një pjesë e madhe e mësimdhënësve, gjatë mësimin në distancë, janë të angazhuar më pak se 3 ditë të javës dhe po ashtu një pjesë e madhe e tyre janë të angazhuar me nxënës më pak se tri orë në ditë, dhe një pjesë të cilët fare nuk janë duke mbajtur mësim. Kjo situatë bie ndesh me kërkesat dhe udhëzimet e MASHT-it, me parimet e etikës së mësimdhënies dhe mund të demotivojë nxënësit për mësim;
- Në përgjithësi, vlerësimi i mësimdhënësve lidhur me ndihmën për nxënës, të nxënësve të tyre, që u ofrojnë orët mësimore që po shfaqen në RTK, është pozitiv, mirëpo, sipas tyre, ka edhe një përqindje e madhe e mësimdhënësve që nuk e ndajnë këtë mendim dhe shprehen se një pjesë e tyre nuk po i përmbushin kërkesat bazike të një orë mësimore dhe nuk po ndihmojnë sa duhet nxënësit në të nxënësve të tyre. Ky grup i mësimdhënësve kërkojnë që mësimdhënësit e angazhuar të jenë me interaktivë me nxënës, pavarësisht distancës, dhe të bëjnë ndërlidhje më të mirë të rezultateve, kurrikulave lëndore;
- Mësimdhënësit në përgjithësi kanë vlerësim relativisht të lartë për interesimin dhe angazhimin e nxënësve për të mësuar përmes mësimin

në distancë, mirëpo ka shenja se lakorja e interesimit të nxënësve për mësim, në javët e fundit ka filluar të bjerë ngadalë. Kjo është një e dhënë që bën thirrje që mësimdhënësit t'i qasën me kujdes punës me nxënës gjatë mësimin në distancë, t'i bëjnë atraktive aktivitetet dhe udhëzimet me nxënës, të jenë më të kujdesshëm ndaj cilësisë së informatave kthyesë për detyrat e nxënësve, në mënyrë që të rritet shkalla e interesimit dhe motivimit të nxënësve për mësim;

- Marrë në përgjithësi, ka sinjale të mira që qasja e mësimdhënësve ndaj përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie po ndryshon dhe po i përshtatet realitetit të mësimin nga shtëpia. Mirëpo, mungesa e pajisjeve elektronike (rreth 30% e mësimdhënësve mbajnë komunikim dhe mësim me nxënës përmes telefonit), cilësia e dobët e internetit në disa lokalitete, mungesa e platformave online dhe materialeve mësimore në përputhje me kurrikulat lëndore, po e sfidojnë atë në masë të madhe. Kërkesat e mësimdhënësve për përkrahjen e tyre me trajnime, pajisje, gjithashtu janë një tregues që sistemi duhet të ofrojë më shumë mbështetje për mësimdhënës në këto rrethana, në mënyrë që të kontribuohet sado pak në efektshmërinë e mësimin në distancë;
- Pra, në kushtet e qëndrimit në shtëpi, në rast se vendoset që viti shkollor deri në fund të realizohet përmes mësimin në distancë/e-mësimin, nevoja e mësimdhënësve për mbështetje në aspektin teknik është pajisja me shërbime të teknologjisë së informacionit, si laptop, kompjuter (PC) dhe rrjet interneti, ndërsa në aspektin profesional mësimdhënësit kanë deklaruar nevojën për të pasur udhëzime për vlerësimin e nxënësve dhe trajnime në përdorimin e aplikacioneve dhe platformave mësimore.

Referuar gjetjeve kryesore nga analiza e mendimeve të mësimdhënësve për mësimin në distancë/e-mësimin, u identifikuan rekomandimet e mëposhtme:

- DKA-të dhe shkollat përkatëse duhet të sigurohen që të gjithë nxënësit marrin pjesë në mësimin në distancë dhe të gjithë mësimdhënësit vazhdojnë t'i kryejnë detyrimet e veta profesionale, duke u fokusuar në lehtësimin e realizimit të mësimin online. Shkollat dhe DKA-të rekomandohen që në mundësi të shpejta të identifikojnë nxënësit që nuk

marrin pjesë në mësim, nuk i kryejnë detyrat dhe angazhimet e lidhura me mësimin, të identifikojnë shkaqet dhe të gjinden të gjitha mundësitë e mbështetjes së tyre për të qenë pjesë e mësimin në distancë. Gjithashtu, duhet identifikuar edhe mësimdhënësit që nuk janë duke u angazhuar gjatë mësimin në distancë, arsyet, dhe të gjinden format e mbështetjes që edhe ata të ushtrojnë përgjegjësitë e veta.

- Në nivel shkolle dhe të aktiveve profesionale, të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse rreth mësimin në distancë brenda kësaj periudhe, të identifikohen anët e mira, vështirësitë, sfidat dhe ngecjet dhe të merren masa që mund të zbatohen në kushtet e mësimin në distancë dhe që i kontribuojnë efektshmërisë së mësimin në distancë, duke përfshirë mbështetjen e kolegëve që kanë më pak kompetencë digjitale, trajnime kolegjiale onile, shkëmbim të materialeve online dhe formave të tjera që mund të aplikohen në këto rrethana.
- Mësimdhënësit, gjatë zhvillimit të mësimin në distancë, kujdes të veçantë t'u kushtojnë mirëqenies dhe angazhimit të nxënësve. Të tregojnë kujdes në ngarkesën me detyra dhe mos të vendosin në fokus realizimin e programit mësimor që nuk mund të realizohet në kushtet e mësimin në distancë. Mësimdhënësit të ofrojnë më shumë informata kthyesë për detyrat e bëra nga nxënësit, meqenëse përmes tyre sigurohen mbështetja e të nxënësve, motivimi për mësim dhe nxitja për angazhim të mëtejshëm gjatë mësimin në distancë.
- Shkollat të identifikojnë rastet e keqpërdorimeve në përdorimin e qasjes online nga ana e nxënësve dhe, në bashkëpunim me prindërit dhe institucionet kompetente, të ndërmarrin masa për evitimin e këtyre keqpërdorimeve.
- MASHTI në bashkëpunim me DKA-të dhe partnerët që mbështesin arsimin të ofrojnë udhëzues dhe trajnime për mësimdhënësit lidhur me mënyrat dhe format e zbatimit të platformave dhe aplikacioneve online në procesin e mësimin në distancë, si dhe udhëzues për nxënës dhe prindër për mësim në rrethanat e mësimin në distancë.

- Krijimi i platformave online të lidhura me mësimin në distancë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje), me qasje dhe lehtësi për përdorim, do të ndihmonte mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit në realizimin me sukses të qasjes online të mësimin.
- Kërkesa e veçantë e mësimdhënësve, për udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë, tanimë është plotësuar nga MASHTI, me nxjerrjen e vendimit për procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë (datë 24.04.2020). Ky proces duhet të monitorohet në forma të ndryshme, që të shihet se sa mësimdhënësit u përmbahen parimeve dhe rekomandimeve të vendosura në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë.
- Në rast se do të vendoset që deri në fund të vitit shkollor të mbahet vetëm mësimi në distancë/e-mësimi dhe meqenëse 91,8% e mësimdhënësve kanë raportuar nevojën për mbështetje me pajisje dhe shërbime të teknologjisë së informacionit, si laptop, kompjuter (PC) dhe rrjet interneti, MASHTI-i, DKA-të, shkollat dhe donatorët e ndryshëm, duhet të shohin mundësinë e ofrimit të këtyre pajisjeve dhe shërbimeve për mësimdhënësit. Në rast se kjo nuk mund të ofrohet për të gjithë mësimdhënësit, të konsiderohet si mundësi hapja e shkollave për mësimdhënësit dhe shfrytëzimi i pajisjeve ekzistuese në shkolla (kompjuterit, laptopit, internetit), si dhe hapësira e shkollës në dispozicion. Kjo mund të sigurojë edhe një koordinim më të mirë ndërmjet mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale për detyrat drejtuar nxënësve dhe aspektet tjera që lidhen me mësimin në distancë.





### 3.3. MËSIMDHËNIA ELEKTRONIKE NË DISTANCË E-MËSIMI

Ismet Potera, Luljeta Shala & Selim Mehmeti

*“Ai njeri që i bën të lehta edhe gjërat e vështira, është vetëm mësuesi”*

*Ralph Waldo Emerson*

Me qëllim të dhënies së kontributit për sfidën me të cilën po ballafaqohet njerëzimi, me pandeminë, nisma për organizimin e mësimit në distancë u prit mirë dhe u bë modalitet i mësimit në sistemet arsimore kudo, në rajon, në BE dhe më gjerë, por edhe në Kosovë.

Nisma për ta vëzhguar dhe përcjellë mbarëvajtjen e mësimit në distancë, përmes orëve mësimore që transmetohen në RTK dhe që publikohen në platformën E-mësimi.rks-gov.net, mbështetet në projektin e studimit të IPK-së: *Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19*. Qëllimi i përcjelljes dhe vëzhgimit të e-mësimit, por edhe marrja e mendimit të mësuesve të përfshirë në këtë proces, nuk ishte vlerësimi apo gjykimi i tij, nxjerrja e mësimave nga një proces i papritur, por analiza e përvojave dhe mësimave gjatë e-mësimit, identifikimi i aspekteve që mund/duhet të përmirësohen gjatë përgatitjes së video-materialeve në javët në vijim dhe nxjerrja e rekomandimeve për aspektet, ndaj së cilave duhet reaguar në të ardhmen e afërt nga mekanizmat e sistemit të përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit dhe gjatë shërbimit.

Procedura e përcjelljes dhe e vëzhgimit të e-mësimit ndodhi çdo ditë kur transmetimi bëhej në RTK (nga data 01 -20 prill). Paraprakisht u vendos se çka të vëzhgohej dhe si të mblidhen shënimet. objekt i vëzhgimit ishin këto aspekte: metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës.

Përveç vëzhgimit të e-mësimit, gjithsej 100 orë mësimore dhe 50 mësimdhënës, klasat 1-5 dhe 6-9, edhe 20 mësimdhënësve ua dërguam një

pyetësor me 5 pyetje të hapura për të marrë mendimin e tyre lidhur me sfidat dhe çështjet tjera rreth organizimit të kësaj forme të mësimdhënies, për herë të parë nga ana e tyre dhe në vend. Përgjigjet e tyre kanë qenë me interes për hulumtimin. Kërkuam mendim edhe nga zyrtarë të kurrikulës në MASHTI, por nuk u përgjigjen.

### **Analizë e të dhënave nga vëzhgimi i e-mësimeve**

Organizimi i mësimit në distancë nxori në shesh gjëra me interes, si shfrytëzimi i burimeve të ndryshme për mësimdhënie dhe nxënie. Thyerja e shabloneve dhe stereotipave mësimore, se vetëm mësimdhënia në klasë është më e mira, ka dëshmuar të kundërtën. Dëshira dhe guximi për t'u sfiduar edhe me këtë formë të mësimdhënies ishin një test për mësimitdhënësit, të cilët nuk hezituan që t'i përgjigjen thirrjes për mbajtjen e e-mësimit.

*Thyerja e shabloneve dhe stereotipave mësimore, se vetëm mësimdhënia në klasë është më e mira, ka dëshmuar të kundërtën. Dëshira dhe guximi për t'u sfiduar edhe me këtë formë të mësimdhënies ishte një test për mësimitdhënësit, të cilët nuk hezituan që t'i përgjigjen thirrjes për mbajtjen e e-mësimit.*

Në fokus të vëzhgimit, përveç tjerash, ishin edhe shkathtësitë metodike e komunikuese të mësimitdhënësve të angazhuar. Sa i përket këtij aspekti të vëzhgimit, mësimitdhënësit e vëzhguar mund të ndahen në dy grupe kryesore: me shkathtësi dhe gjuhë të përshtatshme, të mira, dhe mësimitdhënës që shprehnin mangësi të theksuara në këtë aspekt të mësimdhënies.

Gjithashtu, element që nuk mund të anashkalohet gjatë mësimdhënies është edhe përshtatshmëria, koherenca, e përmbajtjeve dhe qasjes mësimitdhënëse me parimet dhe kërkesat kryesore të kurrikulës së bazuar në kompetenca (KKK, 2016). Edhe këtu kemi dy grupe kryesore të mësimitdhënësve, përjashtojta ata të cilët ende punojnë me kurrikulën që nuk është e bazuar në kompetenca (klasat 4,5 dhe 9): mësimitdhënës që bënin përpjekje për ta shtjelluar temën sipas KK të re, por edhe mësimitdhënës që nuk dallonin nga

mësimdhënia tradicionale. Por kishte edhe prej atyre që synim kishin kurrikulën e re, ndërsa mësimdhënia ishte tradicionale, ose edhe ngatërrim të koncepteve; fushës kurrikulare me lëndë mësimore, rezultatet e të nxëniet me rezultate të pritura, rezultatet për kompetenca me rezultatet e lëndës etj.

Të gjithë emrat e mësimdhënësve janë të njohur, por nuk do të përmenden këtu, për të ruajtur etikën e hulumtimit. Vëzhgimi është bërë nga ditët e para të fillimit të e-mësimit. Mesatarisht janë vëzhguar pesë orë të shkollës fillore paradite dhe 5 orë në SHMU pasdite. Disa mësimdhënës janë vëzhguar në më shumë se një orë mësimore, me qëllim të vërejtjes së ndryshimeve eventuale në lëndë të ndryshme (te fillorët), ndërsa në SHMU në klasë të ndryshme.

Ashtu siç është pritur, për shkak të rrethanave dhe mungesës së përvojës, orët e para të gjithë mësimdhënësit, kryesisht mësueset, ishin të ndrojtura dhe të frikësura para kamerës<sup>39</sup>, sigurisht për shkak të mungesës së përvojës dhe ndjenjës së përgjegjësisë se një mësim të këtillë do ta përcjellin nxënësit, prindërit dhe kolegët. Për këtë duhet të përgëzohen ata që pranuan një sfidë të tillë. Megjithatë, në pah dolën edhe një varg lëshimesh dhe mangësish, që ndërliken me rrethanat psikologjike dhe teknike, me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit, por edhe me sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve, si dhe me shkathtësitë metodike, profesionale e pedagogjike të një numër mësimdhënësish.

Bazuar në shënimet e grumbulluara gjatë vëzhgimit të këtyre mësimdhënësve, janë evidentuar një varg lëshimesh e mangësish që kanë të bëjnë me shkathtësinë komunikuese të mësuesve, korrektësinë e shprehjeve, përgatitjen e skenarit për njësinë mësimore, anën teknike të përgatitjes së skenarit të orës, përdorimin e lokalizmave, mësimin larg nga jeta e përditshme e fëmijëve, ofrimin e shumë informatave të nivelit të njohurive, shmangien nga arritja e rezultateve të të nxëniet dhe kompetencave të dhëna në KK, dhënien e detyrave të shtëpisë pa ndonjë qëllim të caktuar, ose jo adekuate, ngatërrimin e njësisë mësimore me leximin e tregimit, përdorimin

---

<sup>39</sup> Gjatë bisedës me telefon me një mësimdhënës, i cili ishte pjesë e e-mësimit, u ankua se kanë pasur presion, por edhe nënçmim nga ekipi që xhironin dhe organizonin procesin (Kallxo.com).

jo me vend të teknikave mësimore (klaster, pesëvargëshi...), mungesën e përcaktimit të qëllimit të orës mësimore se çka synohet të arrihet nëpërmjet njësisë mësimore, mungesën e madhe e kreativitetit, intonacion joadekuat, mësimdhënien tepër rigjide, statike.

*Lëshimet dhe mangësitë e evidentuara nga vëzhgimi i e-mësimeve ndërlidhen me nivelin e ngarkesës nga rrethanat e pandemisë, presionin kohor dhe kushtet teknike, me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit, por edhe me sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve, si dhe me shkathtësitë metodike, edhe profesionale e pedagogjike, të një numri mësimdhënësish.*

*Evidentimi i tyre është bërë me qëllim të japin një ndihmesë modeste në procesin e përgatitjes së video-materialeve në javët në vijim dhe për sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim.*

Në shumicën e rasteve problemat matematikor zgjidhen pa dhënë sqarime adekuate për procedurat se si ndodh ose pse kjo zgjidhje është kështu, dallime midis mësueseve sa i përket përdorimit të termave mësimorë për të njëjtën lëndë, përdorimi i shprehjeve dhe koncepteve jo në përputhje me moshën e nxënësve dhe mossqarimi i tyre, kalimi nga një fazë e orës në tjetrën të njësisë mësimore pa bërë lidhjen logjike midis tërësive, përdorimi joadekuat i shembujve në formë digresioni, gjoja për nxehjen e nxënësve për mësim (gjëegjëza, enigma..., që s'kishin të bënin fare me përmbajtjen e temës, fokusimi në të dhëna, data pa bërë ndërlidhjen e tyre me kompetencat e nxënësve, si mendimi kritik, të nxënit për të nxënë...) etj.

### **Disa shembuj nga mësuesit dhe orët mësimore**

Gjatë përcjelljes së e-mësimit u identifikuan dy grupe mësuesish: një grup i përgatitur mirë nga aspekti profesional dhe pedagogjik, me shkathtësi të mira metodike, me gjuhë të përshtatshme dhe të sigurt gjatë realizimit të (shtjellimit) njësisë mësimore. Gjithashtu, ky grup kishte edhe njohuri të mira për qasjen që kërkon kurrikula e re dhe

*Dy grupe kryesore të mësimdhënësve u identifikuan: me përgatitje profesionale-pedagogjike të mira; dhe me përgatitje profesionale-pedagogjike të dëshirueshme.*

në fund nëpërmjet detyrave adresonin synimin për arritjen e rezultateve të të nxënësve për lëndën dhe për kompetencat kryesore. Pra, treguan nivel të mirë të zhvillimit profesional-pedagogjik. Grupi tjetër i mësimdhënësve shfaqnin zbrastësi të ndryshme, pasiguri, komunikim jo të përshtatshëm, me pasaktësi kuptimore, të cilat shkaktojnë paqartësi dhe hutë të nxënësve, sidomos tek ata të klasave fillestare. Disa nga këto elemente të vërejtura mund të jenë edhe pasojë e formës së mësimdhënies, presionit të kohës, presionit nga xhirimi, ndjenjës së përgjegjësisë etj. Shembujt nga mësimdhënësia në arsimin fillor (klasat 1-5).

### **Përcaktimi i qëllimit të mëimit apo përcaktimi i rezultateve të të nxënësve dhe lidhja me kompetencat kryesore**

Një nga këshillat për mësimdhënës, të promovuara nga UNESCO (2020) për motivimin e fëmijëve gjatë mëimit në distancë<sup>40</sup>, është vendosja e qëllimit të mëimit gjatë mëimit në distancë. UNESCO këshillon mësimdhënës të sqarojnë për nxënës qëllimin e secilit mësim dhe ta lidhin atë me qëllimet e të mësuarit afatgjatë të nxënësve, të ndërlidhin në segmente domethënëse për nxënës dhe të përdorin strategji të ndryshme në funksion të qëllimit të përcaktuar. Këto këshilla u përgjigjen kërkesave dhe parimeve të kurrikulës sonë, të cilat janë referenca edhe për planifikimin e mësimdhënies, në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave kryesore.

Si duket, nga presioni i xhirimeve të video-materialeve, nga mendimi që nxënësve gjatë mëimit në distancë kryesisht do t'u referohen librit bazë dhe fletoreve të punës, të gjithë mësimdhënësve, të cilët nuk kishin përzgjedhur RN/L, por jo edhe të gjithë ata që tregojnë se cilat janë RN/L, shfaqin paqartësi në arritjen e qëllimit/rezultateve të të nxënësve: pse një njësi mësimore është e rëndësishme për nxënësve të klasës përkatëse, çka i duhen në jetën e tyre ato njohuri që ua

*Përcaktimi i drejtë dhe i saktë i qëllimit të njësisë mësimore /rezultateve të të nxënësve ishte pjesa më e dëshirueshme për ta identifikuar.*

<sup>40</sup> <https://en.unesco.org/neës/resources-parents-and-teachers-motivating-supporting-children-during-remote-learning>

ofronte mësuesja/i gjatë orës mësimore nëpërmjet njësisë mësimore. “Shpresoj se mendimet tuaja për iriqin do të jenë këto (një klaster me fjalë për iriqin)”, por shprehjet që shpreson se janë mendimet e nxënësve ishin pjesë e tregimit: “iriqi zvarritej drejt detit...”. Këtu kërkesa do të duhej të bëhej ndryshe, duke shtyrë nxënësit në analizë, krahasim, zbulim, mendim kritik etj.

Një dukuri, si ndikim i një përvoje të tejkaluar tanimë, ishte promovimi i leximit të shkëputur në klasë të parë: L-u-l-ja, etj. Kjo formë e leximit krijon shprehi jo të mirë në zhvillimin e të lexuarit normal, të rrjedhshëm, të fëmijëve. Në vend të identifikimit të shkronjës dhe të pozitës së saj në fjalën e dhënë, fjala ndahet në rrokje: Njo-lla. Ndarja në rrokje vinte më vonë, ndërsa qëllimi i shembullit të dhënë ishte tingulli i ri (shkronja), gjendet në pozita, vende të ndryshme në fjalët: në fillim, në mes, në fund etj. (ose krijimi i hutisë: në vend të nënvizo shkronjën në fjalë, kërkohej: “nënvizoj fjalën me shkronjën...” ndërsa ishte vetëm një fjalë.

Tek emërtimi i tingujve dhe shkronjave kishte qasje të ndryshme. “Grafiku i shkronjës...” nuk është emërtimi i saktë për dukjen, formën apo grafinë e shkronjës që mësohej. Gjithashtu, përpjekja për të veçuar dallimin midis tingujve Ç-q, Xh-gj ishte joadekuat: q- e butë, ose xh- e fortë. Në vend se të bëhej dallimi në të shqiptuarit e tingujve dhe nuancat dalluese midis tyre.

Gjithashtu, në mësimin e matematikës u vërejtën disa nevoja për përmirësim. Gjuha matematikore veçohet në këtë aspekt, sidomos nga përdorimi jo i drejtë i koncepteve shkakton paqartësi dhe huti te nxënësit. “... llojet e trupave gjeometrikë kanë formë, madhësi dhe ngjyra (!) të ndryshme. Ngjyra nuk kishte të bënte fare me llojet e trupave gjeometrikë, por në tekst ishin dhënë për t’i dalluar, e jo për ta përcaktuar formën ose llojin e tyre. Ngjyra nuk mund ta përcaktojë formën ose llojin e një trupi gjeometrik.

Derisa ndonjë mësimdhënës i paralajmëron ushtrimet, ai/ajo i porositi nxënësit se kjo temë nuk gjendet në librin e matematikës, prandaj kujdes<sup>41</sup>.

---

<sup>41</sup> Shënim: Në një deklaratë në tv njëra nga këto mësuese thotë: kemi pasur vështirësi pasi që disa njësi mësimore nuk gjenden në Kurrikulë (!) dhe është dasht t’i marrim nga burime të tjera. Kjo dëshmon se ka mësimdhënës që nuk e njohin Kurrikulën. Kurrikula

(Pse të merren tema nga jashtë librit matematika 1, kur ka shembuj të mjaftueshëm. Kur synon të bëjë krahasimin midis kubave, më i madh, më i vogël, më i rëndë, më i lehtë, bën gabime logjike: madhësia e trupit ose ngjyra nuk e përcakton peshën. Shembulli i marrë, Molla dhe Balona, demantoi se madhësia përcakton peshën e trupave. Përdorimi i kubit si njësi matëse mbeti i paqartë për nxënësit. As qëllimi përse u bë ky ndryshim nuk ishte i qartë, pasi që munguan koncepti dhe procesi i krahasimit. Te njësia mësimore (klasa I) matja e gjatësisë u vërejtën pasaktësi, si p.sh. “1 cm afërsisht sa një gisht”, por në foto tregohet gjerësia e gishtit, sepse gishti është më i gjatë. Ose decimetrin e shënojmë me simbolin dm. “Druri, tregohej një shufër nga druri, është i gjatë 6 lapsa” ose “Druri i gjatë 6 lapsa të verdhë”, pra nuk sqarohet se përse bëhet dhe kur bëhet kjo matje, çfarë na duhet kjo matje. Ngjyra e lapsit nuk ishte përcaktues i gjatësisë, por kur nuk kemi njësi të sakta, siç është metri. Gjatësi e ... është sa tre lapsa, do të ishte shprehja adekuate. Sikur doli se edhe lapsi, pa e ditur gjatësinë e saktë të tij, është njësoj mjet matës, sikurse metri.

Zgjidhja e problemave matematikorë në shumicën e rasteve bëhej pa treguar procedurën, rrugën se si duhet të bëhet. Problemat jepeshin, zgjidheshin duke shpejtuar se kaq dhe aq bëjnë kaq. Vazhdimisht folja bëj përdoret gabimisht, në vend të fjalës baras me...(2+2 bëjnë...). Mungonte përdorimi i mjeteve të konkretizimit për të sqaruar gjërat abstrakte. Derisa shpjegonte segmentet, nuk bënte krahasim me objektet që mbante në dorë: lapsi, shkopi.

Duke demonstruar baraspeshën, demonstroi një punim, të cilin e lëviz me dorë, jo si rezultat i humbjes së baraspeshës nga rritja e njëres anë, por si pasojë e lëvizjes me dorë e humb të kuptuarit e konceptit. Nxënësi i klasës së parë nuk e sheh këtë si baraspeshë apo ‘balanca’, siç thoshte mësuesja (baraspeshë- pesha e njëjtë në të dyja anët, kjo nuk u tha).

Edhe gjatë orës mësimore në shtjellimin e njësive mësimore Njeriu dhe natyra (klasa I) u përsëritën shmangie të ngjashme. Gjatë shtjellimit të njësive mësimore Qeniet e gjalla nuk u bë ndonjë krahasim i drejtë midis tyre, për t’i spikatur veçantitë. Sipas kësaj, doli se të gjitha qeniet e gjalla

---

lëndore nuk i përcakton njësitet mësimore, por temat mësimore dhe rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)

lindin të vegjlit e tyre (edhe shpezët, edhe flutura). Përpyekja për ta nxjerrë porosinë apo qëllimin e njësisë mësimore e nxirrte jashtë qëllimit kryesor: vizato kafshën që keni në shtëpi (nëse keni). Dhe “Ju duhet të kujdeseni për kafshët”. Ose njësia tjetër nga e njëjta lëndë, Mjedis dhe ndotja, ndërsa lëndën e quan Shoqëria dhe mjedisi, fushë kurrikulare, nuk u sqarua mirë qëllimi kryesor: ndotja e mjedisit, kujdesi ndaj mbeturinave, menaxhimi i mbeturinave (seleksionimi thoshte), apo përse Toka ishte e mërëzitur. Këto elemente nuk u bashkuan mirë dhe nuk u sqaruan drejt.

Orët e vëzhguara të klasës së parë nuk dallojnë shumë nga njëra-tjetra. Nuk dallohej shumë nga mësimdhënia tradicionale. Mungonte qartësia e përcaktimit të qëllimit të synuar pas shtjellimit të njësisë mësimore. Kishte edhe shprehje të cilat nuk ishin në harmoni me moshën e fëmijëve 6-7-vjeçar. Shumica e shembujve të demonstruar u mungonte kreativiteti dhe lidhja me punën dhe jetën e fëmijëve. Dhënia e detyrave të shtëpisë nuk kishte ndonjë qëllim të caktuar, se përse duhet ta bëjnë një detyrë të tillë, por kishte edhe raste të detyrave të shtëpisë jo në harmoni me moshën e tyre, si p.sh.: “Po të fliste toka çfarë do t’i thoshte njeriut- shkruaj! Vizato veprimet që ke bërë për mbrojtjen e natyrës”. Është e rëndë për këtë moshë të fëmijëve.

**Mësimdhënia e-mësimi për klasën e dytë** nuk dallon shumë në qasje nga mësimdhënia në klasën e parë. Shumica e çështjeve të cekura për klasën e parë ishin të pranishme edhe te mësimdhënëset e kësaj klase, sidomos përcaktimi jo i qartë i qëllimit, ngatërrimi i lëndës me fushën kurrikulare, përdorimi i shembujve joadekuatë, gjuhë jo e përshtatshme- komunikim shumë rigjid, si në shembujt në vijim. Ishte interesant se te shumica e mësimdhënësve të vëzhguar leximi i një tregimi, proze, poezie titulli emërtohej si Njësia mësimore. Por, nga shtjellimi i mëtejshëm dilte ndonjë qëllim tjetër gjuhësor ose letrar, i cili mund të ishte njësia mësimore. Pra, ngatërrohej me qëllimin e vërtetë mësimor të leximit të një tregimi, pjese letrare. Nga leximi i tregimit “Tedi dhe Lepurushi” nuk u mor vesh se cili ishte synimi kryesor: kultura e leximit, shprehia e leximit, apo dallimi i ëndrrës nga imagjinata. Aspekti analitik mungonte plotësisht. Edhe kur kërkohet ndonjë analizë, bëhej riprodhim i përmbajtjes e jo analizë e tekstit.



Edhe pse dihet që nëpërmjet kësaj lënde ndihmohet zhvillimi i kompetencës komunikimi dhe të shprehurit, pak shembuj u dhanë, e të cilët ndërlihdeshin, ose synonin arritjen e kësaj kompetence. Mësimdhënia mbetej në nivelin e njohurive. Aspekt më i zbehtë mbeti zbërthimi i elementeve gjuhësore. Shtjellimi i njësive mësimore folja, mënyra dhe kohët e foljes, përemrat, emrat dhe mbiemrat. Shembujt e dhënë kryesisht nga teksti shkollor përkatës, me definicione, e të ngjashme.

Shtjellimi i njësive mësimore nga matematika përcillej me shumë mangësi. Pothuajse asnjë sqarim, zbërthim i procedurës së zgjidhjes së problemave matematikore me cilindo veprim, por thjesht interpretim i asaj që gjendet në libër. Fare pak ndërlihdeshin shembujt, veprimet matematikore me shembuj nga puna dhe jeta e fëmijëve. Pse nuk mund të pjesëtohet një numër me zero, ishte shumë e thjeshtë për ta sqaruar: nëse nuk ke asnjë, ose (0) a mund ta ndash me të tjerët? Pra, nuk bëhej ndërlihdja, krahasimi i zeros me mungesën e asaj që kërkohet (para, fruta etj.). Njësoj veprohej kur bëhej fjalë për shumëzimin e numrave me zero. Shprehja/pyetja “sa është  $0:2=?$  Besoj se e dini 0, por së pari duhet t’i bëjmë llogaritë tona!”. Në shumë raste paraqitja dhe zgjidhja e problemave bëhej në formë ‘recitimi’.

Një veprim në matematikë, shumë i rëndësishëm, në të cilin edhe të rriturit shpesh gabojnë, është radha e veprimeve matematikore. Në vend se të sqarohej dhe arsyetohej se përse një veprim duhet të kryhet i pari dhe të tjerët sipas radhës, përqendrimi ishte në zgjidhjen e problemave të ndryshëm. Qëllimi kryesor ishte të sqarohej, argumentohej radha e veprimeve matematikore. Detyrat do ta plotësonin këtë në vazhdim. Kishte edhe raste ngatërrimesh, si p.sh. ‘6 a pjesëtohet me 5? Jo, përgjigjet (duhet a plotëpjesëtohet me 5, sepse mund të pjesëtohet, por për këtë nivel është herët). Qëllimi i njësive mësimore, gjetja e ndërlihdjes midis veprimeve matematikore, nuk u zbehtë, sepse mbeti në nivelin e zgjidhjes së problemave, e jo të kuptuarit e rregullit, se ka ndërlihdje midis veprimeve matematikore, për ta mësuar logjikën e kësaj ndërlihdjeje. Ndërlihdja e këtillë me anë të veprimeve:  $72:9=8$ ;  $72:8=9$ , dhe  $8 \times 9=72$  u nënkuptuan si veprime më vete e jo si ndërlihdje pjesëtim - shumëzim. Ndërsa, kur synonin ta zgjidhnin një problemë me të panjohur, kur njëri mbledhor nuk dihej,

thuhej “shuma zbritet me mbledhorin e parë” – duhet kur nuk e dimë njërin mbledhor, këtu të dytin, atëherë nga shuma zbresim mbledhorin e parë për ta gjetur mbledhorin e fshehur ose që na mungon. Bëhej zgjidhja e problemave pa rregullin se si dhe pse ky veprim. Njësoj veprohej edhe te veprimi i zbritjes. Detyrat nuk ndërlidheshin me shembuj nga praktika. Kishte raste edhe të kapërcimit të nivelit, si p.sh. ‘e kemi x e panjohur’ e të ngjashme.

Orët e realizuara nga lënda Njeriu dhe natyra ishin tepër formale. Mundësitë e zgjerimit të njohurive nga kjo lëndë, disa i thoshin Shoqëria dhe mjedisi, janë të shumta për arritjen e kompetencave përkatëse. Njësitë mësimore si Pasuritë natyrore të Kosovës, Mjedisi natyror, Bimët dhe kafshët që na rrethojnë etj., përveç sasisë së informatave, nuk arritën të realizojnë ndonjë qëllim të caktuar, që ndihmon arritjen e kompetencave. Sasia e madhe e informatave sa që fëmijët nuk arrijnë ta kuptojnë se përse iu duhet të gjitha ato. P.sh., te njësia mësimore Mjedisi natyror u përmendën thuaja të gjithë përbërësit e mjedisit, deri te specifikat e mjediseve të caktuara, si kontinenti, sahara, liqeni, bjeshka, moçali, për të cilat zor se fëmijët do të kenë pasur nevojë. Në fund edhe dy video nga Paketa e Gjelbër, të cilat flasin për ndotjen e mjedisit, e të cilat nuk ishin në funksion të njësisë mësimore.

Marrë në përgjithësi, mësimdhënia që realizohet gjatë mëimit në distancë, edhe në këtë klasën e dytë është në masën më të madhe tradicionale, ofrim i njohurive, por jo edhe gjërat e nevojshme që ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve të kësaj moshe. Mësimdhënia ishte jo në harmoni të plotë me kërkesat e kurrikulës së re për arritjen e kompetencave bazë.

**Orët e vëzhguara për klasës III** ishin kryesisht lëndët mësimore Gjuhë amtare, Matematikë dhe Njeriu e natyra. Pothuajse në të gjitha nivelet përpunimin, leximin e një tregimi, e emërtojnë si njësi mësimore, por si qëllim del diçka tjetër, si analizë teksti, gjetja e foljeve, kohët e saj, apo ndonjë kërkesë tjetër gjuhësore. Si zakonisht, qëllimi i përmbajtjes mësimore që trajtohej nuk dihej me saktësi: çfarë synonin të arrinin në fund, cili ishte mësimi kryesor që synohej ta nxënë nxënësit. Në shumë raste, që në fillim, para se të bëhej leximi i tregimit, vjershës, përdorej teknika Pesëvargëshi. Por, si do ta dinë nxënësit se cilat janë fjalët kryesore të një

përmbajtjeje ende të palexuar? Kur jepeshin detyrat e shtëpisë, në shumicën e rasteve, dilte në shesh qëllimi i orës mësimore. Por, arritja e qëllimit nëpërmjet detyrave të shtëpisë, e jo gjatë shtjellimit të njësisë mësimore, paraqet vështirësi për nxënësin.

Kishte telashe gjatë përpunimit të teksteve, tregimeve, ku në vend se të bënin analizë, bënin riprodhim të tekstit, gjegjësisht përmbajtjes së tregimit, personazheve apo ngjarjes që zhvillohej në tregim. ‘Çka po mendoni për...?’ dhe përgjigjet: ‘Është pikërisht ajo që po mendoni!’ Përdorimi i gjuhës së qartë gjatë mësimdhënies është me rëndësi të veçantë, sepse është e domosdoshme që të mos lëmë dilema, si p.sh. ‘shpejt- nga sot e tutje do t’i themi ndajfolje’. Si i paskemi thënë deri sot kësaj fjale, ose fjalëve të tjera.

Nëse nxënësit i pyesim: Përse shërbejnë fjalët me ngjyrë të kuqe në fjali? (përgj.) Na shërbejnë për t’i lidhur dy fjalë brenda fjalisë’, ndërsa njësia mësimore ishte për parafjalët. Nëse mbetet kështu, atëherë shtrohet pyetja po lidhëzat, për çka na duhen?! Shembujt e këtillë nuk ishin pasojë e ngarkesës, por e mospërgatitjes paraprake për njësinë mësimore.

Përmbajtjet matematikore bëhen edhe më abstrakte po që se nuk konkretizohen, nuk ndërlihen me punën dhe jetën e përditshme të fëmijës dhe njeriut në përgjithësi. Sikurse në klasat paraprake, edhe në klasën e tretë parashtrimi dhe zgjidhja e problemave bëheshin pa u thelluar në zbërthimin dhe shtjellimin e procedurave për një zgjidhje të bërë. Nëse kësaj i shtohet edhe ngatërrimi i koncepteve e shprehjeve, atëherë si do të bartet porosia te nxënësit. Shembujt e vëzhguar flasin shumë për këtë.

Nëse duhet të kuptohet drejt logjika e vargut numerik, ose ndonjë shprehje tjetër, duhet pasur kujdes për qartësinë, e jo ‘shohim se si rriten kutizat’ (?), ndërsa fjala ishte për numrat në kutiza, jo për kutizat! Ose ‘Vargu u numrave trekëndorë (!), ndërsa fjala ishte se numrat ishin të dhënë në pllaka në formë trekëndëshi. Qasja e këtillë e pakujdesshme shkakton huti te nxënësit, por edhe paqartësi: për kë ishte fjala?

Te trajtimi i matjes së kohës u vërejtën disa paqartësi logjike dhe metodike, të cilat ndikojnë në të kuptuarit e drejtë të konceptit matje e kohës. ‘Dita e

nata kanë nga 12 orë. Dita ka 24 orë'. Po nata, ku mbeti? Kur bëhej fjalë për çerekun 'Ndaj gjysmën e 30 minutave, 15 min. Atëherë ky është çereku: gabim! Çereku është  $\frac{1}{4}$  e tërësisë, orës, e jo  $\frac{1}{2}$  e gjysmës (30).

Orët nga Njeriu dhe natyra, disa shënonin fushën kurrikulare si lëndë dhe vërehej se ishin dytësore. Nuk thelloheshin në konceptet apo dukuritë që shtjellonin, por vetëm informata lidhur me to. Nuk bëhej analizë, krahasim, përshkrim e të ngjashme, në mënyrë që ta nxisë të menduarit analitik të nxënësve. Kjo ndodhte edhe kur simuloheshin prova të ndryshme, për të cilat kishte përmbajtje të mjaftueshme për analizë, krahasim, përshkrim etj. Një kërkesë e tillë nuk bëhej as kur jepeshin detyrat e shtëpisë. Prandaj, edhe këtu përcaktimi i qartë i qëllimit, nëpërmjet rezultateve të të nxënësve për lëndë, mbeti shumë i zbehtë.

Është interesante se si nga klasa III, IV, e tutje, disa herë është shtjelluar njësia mësimore ndajfolja. As në *mësimdhënien e vëzhguar te mësimdhënësit e klasës IV* nuk vërehej ndonjë dallim cilësor. Edhe në këtë klasë vërehen dy nivele përgatitjesh të mësimdhënësve: me shkathtësi e përgatitje profesionale të mira dhe të dëshirueshme të pjesa tjetër. Edhe mësueset e kësaj klase dëshmonin përgatitje të përafërt pedagogjike e profesionale me ato të klasave paraprake. Por, edhe lëshimet dhe shmangiet ishin thuajse të njëjta. Në disa raste u përsërit përpjekja për ta bërë hyrjen në njësinë mësimore me anë të një gjëegjëze ose të ndonjë thënie nga autorë të njohur (Ajnshtajni, Naimi etj). Por, në rast se përmbajtja dhe porosia e saj nuk ndërlidhet me përmbajtjen e njësisë mësimore, ose nuk përçon te nxënësit ndonjë porosi që ndërlidhet me të, atëherë kjo ose përdoret kot, ose mund ta çorientojë vëmendjen e tij.

Pothuajse në të gjitha orët/lëndët e vëzhguara (përcjella): Gjuhë amtare, Matematikë, Njeriu dhe natyra, Edukatë qytetare, kanë një emërues të përbashkët: ofrimin e sasisë së njohurive faktike, paqartësi në përcaktimin e qartë të qëllimit dhe referimit në arritjen e rezultateve të të nxënësve për lëndë apo për kompetenca. Njësoj lexohej tregimi, ose poezia, dhe në vend të analizës bëhej një reprodukim i përmbajtjes, i asaj që kishte thënë autori, e jo analizë e frazeologjisë, figurave stilistike, stilit të shkrimit, llojit të

shkrimit, apo i aspekteve të tjera që lidhen me rezultatet e të nxënit. Pyetjet e parashtruara si për detyrë shtëpie, ashtu edhe për t'u përgjigjur aty (përgjigjeshin vetë), ishin kërkesa riprodhuese të përmbajtjes, jo nxitëse të mendimit analitik apo kritik. Kërkesat 'Komento...', ishin kërkesa reproduko' përmbajtjen e dhënë. Siç shihet, nuk e kanë të qartë kërkesën për 'komento njësinë mësimore, ose pjesë të saj. Kjo konstatohet nga shembujt e dhënë.

Shumë njësi mësimore ishin të ilustruara, ilustrime nga teksti shkollor ose të huazuara nga interneti, diku kishin mbetur emrat në anglisht, por demonstrimi i tyre, si dhe kërkesat për interpretim e analizë të tyre, në shumicën e rasteve, mbeteshin të zbehta, nuk përçonin porosi konkrete, të cilat do ta ndihmonin të kuptuarit dhe të menduarit kritik e analitik të nxënësve. Ilustrime të këtilla përdorshin mjaftueshëm në lëndët Njeriu dhe natyra, Matematikë etj. Rëndësia e ilustrimit, skicës, fotos etj., në mësimdhënie është për ta konkretizuar përmbajtjen e një procesi apo dukurie, nëpërmjet angazhimit pamor. Në lëndën e Matematikës përqendrimi i mësuesve kryesisht ishte në zgjidhjen e problemave, por edhe në këtë klasë ngjante në një recitim matematik, pa u thelluar në sqarimin e procedurave, por vetëm në zgjidhjen e sa më shumë detyrave.

Se shumica e mësimdhënësve që punojnë në shkollimin fillor (klasat 1-5) janë të një shkolle dhe sistemit të njëjtë të përgatitjes së tyre, tregon ngjashmëria në mësimdhënie dhe përafërsia e shkathtësive metodike. Prandaj, të gjitha aspektet, specifikat e shënuara te orët e vëzhguara (1-4), janë prezent edhe tek orët e klasës V. Edhe pse nxënësit këtu janë më të rritur dhe më të përgatitur, përdoret thuajse komunikim i përafërt, sikurse në klasat paraprake.

*Të gjitha aspektet, specifikat e shënuara te orët e vëzhguara (klasat 1-4) janë prezent edhe tek orët e klasës V. Edhe pse nxënësit këtu janë më të rritur dhe më të përgatitur, përdoret thuajse komunikim i përafërt, sikurse në klasat paraprake.*

Në të gjitha orët e vëzhguara dominojnë forma e ligjërimit dhe ofrimi i sa më shumë informatave për njësinë mësimore, por pa u kujdesur për lidhjen

logjike të tyre, rëndësinë praktike për jetën e nxënësve, pa përcaktuar një qëllim të qartë se përse këto informata, njohuri, i shërbejnë nxënësit, se si këto ai mund t'i përdorë në jetën dhe punën e përditshme të tij, çka i shërbejnë ato për të ardhmen, ose sa ndihmojnë këto në zhvillimin e mendimit kritik dhe analitik etj.

### **Veçantitë e mësimdhënies në nivelin 6-9**

Orët e vëzhguara ishin kryesisht nga lëndët mësimore Gjuhë amtare (Gjuha shqipe), Matematikë, Histori, Gjeografi, Fizikë, Kimi, TIK dhe Edukatë qytetare. Dallimi ndërmjet mësimdhënësve lëndorë dhe mësuesve qëndron në dy rrafshë: të parët - lëndorët shfaqin njohje më të thelluar të lëndës, tregojnë siguri dhe qartësi në sqarimin e përmbajtjeve, ndërsa të dytët - mësuesit 1-5, veçohen për qasje metodike, përdorim të teknikave dhe shembujve më të përshtatshëm për të kuptuarit e përmbajtjes të njësive mësimore që shtjellojnë. Për të dyja grupet janë disa gjëra të përbashkëta: mungesa e qartësisë në përcaktimin e qëllimit të njësive mësimore, si dhe qasja në ofrimin e sa më shumë informatave pa e bërë një përzgjedhje të më kryesoreve. Disa veçanti të mësimdhënësve lëndorë do të ilustrohen.

Leximin e pjesës Luli i Vocërr (6), e emërtuar si njësi mësimore, e përcollën mangësi të shumta. E para, kohë e tepërt iu kushtua biografisë së shkrimtarit, gjë që ia humbi qëllimin nëse ishte autori pjesa kryesore apo porosinë që duhej të përcilleshin te nxënësit. Paraqitja në fillim e pikturës, ku shihej një fëmijë i mërziur, nuk përfaqësoi përmbajtjen e tregimit, siç ishte varfëria që pasqyrohet nëpërmjet Lulit. Interpretimi që i bëhej përmbajtjes nuk kishte ndonjë gjë më shumë sesa ajo që kishte thënë autori. Porosia në fund, në formë detyre: 'Pyet prindërit për njerëzit që kanë qenë të varfër dhe janë bërë të pasur dhe të zotët.' Cila është më e vlefshme, pasuria shpirtërore a materiale?', ishin në shpërputhje me mësimin kryesor që duhej të dilte nga ky tregim, siç është paraqitja e gjendjes sociale të kohës së Migjenit dhe përpjekja për dije edhe në ato rrethana.

Një praktikë e tillë hetohej edhe te mësimdhënësit e tjerë të kësaj lënde. Edhe kur mëtohej analizë e veprës apo ndonjë tregimi, Xha Gorio, p.sh.,

mësimdhënësit nuk bënin analizë, siç ishte njësia mësimore, por riprodhim të thjeshtë të përmbajtjes, frazave e mendimeve të dhëna nga autori. Sipas kërkesës për analizë, ato frazeologji, mendime të dhëna nga autori, duhej të zërtheheshin duke sheshuar edhe anën estetike e stilistike të tyre. Nëse ia shtojmë kësaj edhe përpjekjen e mësimdhënësit që nga kjo të nxjerrë edhe çështje të gjuhës, si p.sh., gjej foljet, ndajfoljet etj., ndryshonte tërësisht qëllimin e proklamuar të njësisë mësimore.

Mësimdhënësit e Matematikës tregonin njohuritë e veta për matematikën. Kishte shembuj shumë të mirë, por shumë prej tyre, sikurse në nivelin fillor, bënin zgjidhjen e problemave matematikore, pa u përkujdesur për sqarimin e procedurës, si erdhi deri te rezultati. Nga pjesa e gjeometrisë përpiqeshin të konkretizonin me mjete të ndryshme, por jo të gjithë. Brenda një ore nuk kishte nevojë të zgjidheshin aq detyra e të mos sqarohen procedurat e veprimeve matematike. Të kuptuarit e procedurave është kryesore në të kuptuarit e logjikës së veprimeve matematike. Kishte raste kur mësimdhënësia ngjante me ligjëratat në fakultete, kur ata tanimë kanë formuar të menduarit dhe shkrim-leximin matematik. Edhe pse në RNL synohej zbatimi i..., nuk ofrohej ndonjë shembull të zbatimit në praktikë të asaj që mësohej, p.sh. Teorema e Pitagorës etj.

Në lëndët Kimi, Fizikë, TIK mësimdhënësit mëtonin që edhe në kushte të e-mësimit të demonstrojnë prova të ndryshme, të cilat konkretizonin përmbajtjen e njësisë mësimore. Por, nga ato prova nuk nxirreshin porositë për zhvillimin e mendimit analitik dhe kritik të nxënësve: përshkruaj procesin, çka vërejtët, pse ndodhi kështu, çfarë mendon për procesin e..., etj. Kryesisht ofroheshin të dhëna në nivel njohurish.

Gjithashtu, në lëndët Edukatë qytetare, Gjeografi dhe Histori, edhe pse disa prej tyre kishin veçuar rezultatet e të nxënësve, disa *rezultate të pritura*, për lëndën, mbetën vetëm në nivel të njohurive. Arritja e rezultateve në mënyrën se si mbarështrohen orët nga e-mësimi është vështirë të konfirmohet. Sidomos në Histori dhe Gjeografi ofrohen aq shumë të dhëna brenda një njësie mësimore sa që është e pamundur të përvetësohen nga ana e nxënësve. Këtu mungonte një përparim i çështjeve më të rëndësishme për t'i prezantuar dhe të cilat do të ndihmonin të kuptuarit e proceseve në histori dhe të

dhënave gjeografike. Kishte aq shumë të dhëna, humbje kohe për sqarim, të panevojshme për nxënësit, të cilat shumë lehtë janë të qasshme në internet, si p.sh. të dhëna për bujqësinë, ekonominë, hidrografinë etj., të vendeve të ndryshme. P.sh. e gjithë Amerika të shpjegohet për një orë mësimore, me të gjitha elementet, është e tepërt. Edhe detyrat e shtëpisë nga këto lëndë ishin kryesisht riprodhim i asaj që shpjegohej, e jo analizë, reflektim, shprehje mendimi, krahasim e të ngjashme, nëpërmjet së cilave ndihmojmë arritjen e kompetencave bazë të KK.

### **Disa veçanti të evidentuara gjatë realizimi të e-mësimit**

Te pjesa dërmuese e mësimdhënësve të e-mësimit të këtij niveli (1-9) vërejtëm disa aspekte të komunikimit me lëndën mësimore dhe me nxënësit, të cilat me pak përpjekje do të përmirësohen ose të shmangen. Në mesin e zhargonit të përdorur kishte lokalizma, fjalë të huaja, por edhe formulime të pasakta. Disa prej tyre do të prezantohen, por vargu i tyre është shumë më i gjatë.

*Te pjesa dërmuese e mësimdhënësve të e-mësimit të këtij niveli (1-9) vërejtëm disa aspekte të komunikimit me lëndën mësimore dhe me nxënësit, të cilat me pak përpjekje do të përmirësohen ose të shmangen.*

Një pjesë e madhe e mësuesve përdornin shprehjen pyetëse: A më kuptuat?, në vend të a isha i/e qartë, vetia komutative e mbledhje (II), pa sqaruar domethënien e fjalës, Xhuxhat u socializuan me..., (I), gjilpëra magnetike tregon nëse një trup është i magnetizuar ose jo!, jo e saktë (III), Dublin në vend të Dablin, ‘duhet empati ndaj luleve’, Përshkrimi i një teksti të çfarëdoshëm, përvetësimi i njohurive të marra (njësi mësimore), vazhdojta, puzzle, domethanun, “A ju duket e besueshme përmbajtja e këtij teksti? Besoj se po, sepse autori po paraqet mallin... (KONICA). “Me shumicë e pakicë, siç thotë populli!), brinjë kongruente, ose të barabarta, fonti i shkronjave ose numri i madhësisë së shkronjave (TIK).

Vida (vidhë, duhet) – makinë e thjeshtë (nëse kështu është në tekst është gabim), çka po shihni në foto? (sqaron çka) në vend si e komentoni? Çfarë po ndodhë? Çka mendoni për?... , a shkon 6 në 3? (pjesëtimi) JO? Pyetje



gabim - duhet a plotpjesëtohet 3 me 6? Sepse edhe 3 pjesëtohet  $3:6=0.5$ , ‘Kuptimi i fjalëve’ (njësi mësimore, V), ku gjatë gjithë kohës paraqet rëndësinë e përdorimit të disa fjalëve në tekst, por asnjëherë nuk u sqaruan të kuptuarit, domethënia e fjalëve të paraqitura në shembuj. Shembujt e paraqitur këtu janë vetëm një pjesë e vogël e atyre që përdorëshin gjatë e-mësimdhënies. Me pak kujdes dhe përkushtim, të gjitha këto dhe të tjera që nuk u cekën mund të eliminohen. Eliminimi i tyre ia shton artin dhe funksionalitetin mësimdhënies, por edhe rrit nivelin dhe cilësinë e të kuptuarit të përmbajtjes mësimore. Gjithashtu, kultura, qartësia dhe saktësia e komunikimit ndikojnë në zhvillimin dhe begatimin e kësaj kulture edhe të nxënësit.

*Rreth përdorimit të hartës së mendjes/koncepteve, disa mësimdhënës përdorën këtë teknikë mësimore. Përdorimi i kësaj harte bëhet për ta parë ndërlidhjen midis koncepteve shkak-pasojë. Kjo nuk u vërejt te 90% e prezantimeve të analizuara.*

### **Lidhur me detyrat për në shtëpi**

Në shumicën e rasteve ngarkesa me detyra për në shtëpi ishte jo e orientuar mirë drejt arritjes së një qëllimi të caktuar mësimor, apo rezultati mësimor. Në shumicën e rasteve u bë shmangia nga REN, qoftë për lëndën, po edhe më shumë për arritjen e kompetencave. Nëpërmjet detyrave mësimore për në shtëpi, në rastet e e-mësimit, është mundësia më e mirë e arritjes së kompetencave kryesore. Rastet e shënuara gjatë vëzhgimit të e-mësimit, edhe sa i përket angazhimit në shtëpi, ishin kryesisht riprodhim i njohurive e përmbajtjeve të dhëna në tekst shkollor të lëndës përkatëse. Ja disa shembuj: ndajfoljet e dhëna (disa) ndani në tri shtylla sipas mënyrës, vendit..., shkruani fjali duke përdorur ndajfolje, varet nga ju se cilat ndajfolje i përdorni (?), Ilustro: çfarë keni kuptuar nga tregimi (asgjë për komentimin), Shkruaj një tekst duke përdorur sa më shumë folje?, Gjeni situata retorike në teksti, f... Janë tri detyra që i kemi ne (!). Çka mësuam sot?, keni për ta shkruar një tekst me përmbajtje edukative (TIK), A mendoni se fabrikat e zëvendësojnë prodhimin artizanal? Dhe formulime të ngjashme.

## **Aspekti teknik i realizimit të e-mësimit**

Për shkak të situatës së ngutshme për përgatitjen dhe realizimin e e-mësimit, u evidentuan një varg mangësish teknike. Këto mangësi ishin jo vetëm pasojë e mjedisit dhe teknologjisë së realizimit, por edhe përgatitjes së ‘skenarëve’ mësuesorë nga mësuesit. Sipas një anketimi, me pyetje të hapura, të bërë me disa mësues, të cilët kontribuuan në këtë proces, nuk kishin pasur përvojë, por edhe udhëzime paraprake për përgatitjen e skenarëve mësuesorë. Duke u përpjekur që pamjet rrëshqitëse (slide) të duken më bukur ishin ngarkuar me lule etj., të cilat në këto raste shpërqendrojnë nxënësin. Shumë prezantime ishin tepër të ngarkuara me tekst dhe me shkronja të vogla, të cilat vështirë lexoheshin, kishte prapavijë me ngjyrë, gjë që vështirësonte të lexuarit e përmbajtjes. Kishte edhe përgatitje shumë profesionale. U pa se mësimdhënësit, pjesa më e madhe e tyre, nuk kishin njohuri dhe përvojë në përgatitjen e prezantimit në Power Point. Janë disa rregulla që duhen ndjekur me këtë rast.

## **Disa vlerësime nga mësimdhënësit realizues të e-mësimit**

Nga 20 mësimdhënës/e, të cilëve ua dërguam pyetësorin e shkurtër me pyetje të hapura, u përgjigjen vetëm 12. Mendimet e tyre ishin kryesisht lidhur me sfidat e situatës, me paraqitjen vullnetare, me mungesën e përvojës për këtë formë të mësimdhënies, por edhe për anët pozitive, siç përmenden: bashkëpunimi me kolegët, aktivizimi i prindërve, pjesëmarrja e nxënësve në takimet drejtpërdrejt, e të ngjashme, por edhe një mësim/ përvojë nga kjo situatë. Disa prej tyre i shkëputëm dhe po i japim në origjinal.

*Çdoherë ekziston hera e parë, prej së cilës mëson. Ka ndryshim të madh nga ora që mbahet aty dhe nga ora në klasë. Ka shumë emocione që askush nuk mund t'i përshkruajë. Është përgjegjësi e madhe, sepse ke qindra njerëz para ekraneve televizive që të ndjekin. Nuk i ke nxënësit afër për të bërë komunikimin, i cili e bën orën më atraktive, mungon kreativiteti, spontaniteti, i cili shpesh varet nga përgjigjet e nxënësve të papritura, nga konteksti, thjesht nuk je vetvetja. Vetë pyet vetë përgjigjesh, (deklarata e një mësuesi pjesëmarrës në e-mësim)*

Një mësimdhënës tjetër shprehet kështu lidhur me procesin e realizimit të e-mësimin:

*Mendoj se në fillim ka qenë konfuze se si t'i përmbledhim këto, më pastaj vështirësitë e ndërlydhjes së mësimdhënies, sepse ka pasur shumë njësi mësimore që kanë kërkuar aktivitet të nxënësit dhe kjo gjë ka qenë shumë e vështirë, që të përgatitet njësi mësimore. Ka shumë orë mësimore që në rrethana të tjera do i bëja ndryshe, por mundësitë kanë qenë të limituara.*

Ndërsa lidhur me vështirësitë e paraqitura gjatë realizimit njëri shprehet:

*Vështirësitë kanë qenë të vazhdueshme, shpeshherë në koherencë, që është dashur të përgatiten shpejt e shpejtë, me një tension të madh sa i përket ndikimit të faktorëve të gjendjes pandemike.*

Gjithashtu një mësimdhënëse shprehet:

*Presioni kohor. Është kërkuar nga ne që të punohet pa përsëritje, pa korrigjime, në kohë sa më të shpejtë, që ndikon direkt në ngritjen e shqetësimeve dhe pasigurinë gjatë xhirimeve.*

*Pra, presioni i kohës ka qenë në nivelin e lartë dhe ka ndikuar direkt në kualitetin e prezantimit të mësimëve. Që do të thotë se pas xhirimit nuk ka pasur asnjë mundësi për të ndryshuar, apo korrigjuar njësinë mësimore.*

Besojmë se mendimet e paraqitura këtu përfaqësojnë më së miri gjendjen e mësimdhënies, cilësinë e prezantimeve gjatë mësimdhënies, por edhe nivelin e ngarkesës së tyre gjatë këtij procesi. Këto mendime paraqesin më së miri edhe sfidën e tyre për të kontribuar në një gjendje të tillë, me të cilën po përballemi jo vetëm ne. Gjithashtu, kjo tregon edhe gatishmërinë e tyre për t'iu gjendur afër nxënësve të Kosovës. Me gjithë mangësitë e evidentuara, meritojnë respekt. Ata dëshmuar dinjitet të lartë.

## **Konkluzione**

Për t'i nxjerrë disa konkluzione, iu referuam aspekteve, të cilat ishin objekt i vëzhgimit: metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies, si dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës.

- E-mësimi, me gjithë vështirësitë, ka krijuar mundësi që mësimitdhënësit e angazhuar të tregojnë dhe të dëshmojnë se mësimitdhënia përmes e-mësimit është një mundësi që duhet shfrytëzuar. Qasja e mësimitdhënësve të angazhuar po ndryshon dhe po i përshtatet ngadalë realitetit të e-mësimit;
- Shumica e mësimitdhënësve që punojnë në shkollimin fillor ( klasat 1-5) janë të një shkolle dhe sistemit të njëjtë të përgatitjes së tyre, këtë më së miri e tregon ngjashmëria në mësimitdhënie dhe përafërsia e shkathtësive metodike;
- Dallimi ndërmjet mësimitdhënësve lëndorë dhe mësuesve qëndron në dy rrafshë: të parët - lëndorët shfaqin njohje më të thelluar të lëndës, tregojnë siguri dhe qartësi në sqarimin e përmbajtjeve, ndërsa të dytët - mësuesit 1-5, veçohen për qasje metodike, përdorim i teknikave dhe shembujve më të përshtatshëm për të kuptuarit e përmbajtjes të njësisë mësimore që shtjellonin;
- Dy grupe kryesore të mësimitdhënësve u identifikuan: me përgatitje profesionale-pedagogjike të mira dhe me përgatitje profesionale-pedagogjike të dëshirueshme;
- Qasja nga mësimitdhënia elektronike në distancë është e lidhur më shumë me përmbajtjen e teksteve shkollore. Kjo tregohet me shembujt, pyetjet, detyrat dhe me qasjen e mbarështrimit të orëve mësimore;
- Harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e kurrikulës reflektohet të jetë një nga sfidat kryesore të mësimit në distancë;
- Pjesa më e madhe e lëshimeve dhe mangësive të evidentuara në orët mësimore nga e-mësimi ndërlidhen me nivelin e ngarkesës, presionin kohor dhe kushtet teknike me të cilat janë ballafaquar mësimitdhënësit gjatë xhirimit të video-materialeve, por edhe me sistemin e përgatitjes së mësimitdhënësve, si dhe me shkathtësitë metodike, profesionale dhe pedagogjike, të një numri mësimitdhënësish.

## Rekomandime

Referuar gjetjeve kryesore nga analiza e mendimeve të mësimit të mësimit në distancë/e-mësimin, u identifikuan dy nivele të rekomandimeve: rekomandimet që duhet të merren në konsideratë nga organizatorët dhe mësuesit e angazhuar gjatë vazhdimin të përgatitjeve të video-materialeve për mësim në distancë dhe rekomandimet që duhet të merren në konsideratë në nivel të politikave.

Bazuar në nevojën për përmirësim dhe avancim të përgatitjeve të video-materialeve për mësim në distancë, u identifikuan rekomandimet e mëposhtme:

- Mësimdhënia në distancë, përkatësisht përgatitja video-materialeve dhe e skenarit për njësinë mësimore, duhet të shoqërohet me udhëzime për mësuesin. Para transmetimit të orëve mësimore, të shikohen xhirimet dhe të eliminohen gabimet e mundshme, sidomos gabimet shkencore;
- Gjatë mësimit përmes e-mësimin, përshtatshmëria, koherenca, e përmbajtjeve dhe qasjes mësimdhënëse me parimet dhe kërkesat kryesore të kurrikulës së bazuar në kompetenca (KKK, 2016) të jetë e dukshme dhe praktike në video-materialet që transmetohen;
- Detyrat për në shtëpi që jepen nga mësuesit e ndryshëm të një klase të harmonizohen, në mënyrë që të mos ngarkohen nxënësit tej mase në këto rrethana të mësimit. Ato duhet të jenë të orientuara mirë, drejt arritjes së një qëllimi të caktuar mësimor, drejt arritjes së rezultateve të të nxënës të lëndës/temës mësimore, për më shumë ato duhet të jenë në funksion të arritjes së kompetencave. Të shmangen detyrat që kryesisht kanë riprodhim i njohurive e përmbajtjeve të dhëna në tekst shkollor të lëndës përkatëse, sepse ato nuk e nxisin nxënësit për të mësuar në distancë;
- Vëmendje të veçantë nga mësuesit t'u kushtohet aspekteve që lidhen me shkathtësitë komunikuese, korrektësinë e shprehjeve, përgatitjen e skenarit për njësinë mësimore, përdorimin e gjuhës standarde, lidhjen e mësimit me jetën e përditshme e fëmijëve.

Për t'i nxjerrë rekomandimet udhërrëfyese në nivel të politikave, se çfarë duhet bërë në të ardhmen, pas kalimit të pandemisë, çfarë duhet ndryshuar dhe ku duhet të përqendrohen nevoja dhe kërkesa politike dhe profesionale për ndryshim dhe avancimin e cilësisë së mësimdhënies, duhet kërkuar përgjigje në pyetjet, si:

A ishte mësimdhënia nëpërmjet e-mësimit pasqyrim i mësimdhënies së zakonshme në shkollë? Sa ishte shtjellimi i njësive mësimore në funksion të zbatimit të KK? Sa ishin në funksion të realizimit të kërkesave për arritjen e kompetencave bazë? A duhet me prioritet të ndryshojë politika e përgatitjes së mësimdhënësve, duke pasur parasysh kahet e zhvillimeve në teknologji dhe përmbajtje mësimore (KK)? Cilat mësimë duhet të nxirren nga kjo përvojë e organizimit të e-mësimit për t'u dhënë përgjigje pyetjeve paraprake?

Besojmë se mësimdhënësit, mësimdhënia e të cilëve ishte objekt i kësaj analize, pasi që ta kenë lexuar dhe përpunuar, do të reflektojnë për të gjitha çështjet e cekura këtu. Nëse secili mësimdhënës/e, pas leximit të kësaj analize, do ta bëjë një vetreflektim për orët e realizuara në e-mësimi, dhe jo vetëm, jo vetëm që do t'i menjanonte shumë gjëra të evidentuara këtu, por edhe do ta ndihmonte shumë zhvillimin personal profesional-pedagogjik. Ky ishte edhe qëllimi kryesor i kësaj analize, assesi gjykimi i punës së tyre

### 3.4. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E NXËNËSVE

Skender Mekolli & Zehrije Plakolli

Pas ndërprerjes se mësimit në shkolla, Ministria e Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit vendosi që mësimi për të gjitha nivelet të bëhet në distancë. Ndryshimi i procesit të mësimit nga mësimi i zhvilluar në klasë, në realizimin e mësimit në kushte shtëpie, nxiti nevojën e realizimit të këtij studimi edhe me nxënës, i cili është konceptuar si analizë, që pasqyron gjendjen aktuale në terren nga perspektiva e nxënësve, lidhur me informimin, fillimin, organizimin, mbështetjen, mundësitë, sfidat dhe nevojat për realizimin me sukses të mësimit në distancë.

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve online, me 2838 nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të shkollave të mesme të larta (gjimnaze e shkolla profesionale) dhe me intervista të drejtpërdrejta me nxënës të 31 shkollave, kryetarë ose anëtarë të Këshillit të shkollave<sup>42</sup>.

#### 1. Informimi i nxënësve për organizimin e mësimit në distancë /e-mësimin

Pas mbylljes se shkollave dhe krijimit të gjendjes së jashtëzakonshme, në mënyrë emergjente, ka filluar puna dhe, pas një pauze relativisht të shkurtër, janë informuar nxënësit për organizimin e mësimit në distancë/e-mësimin, i cili nuk filloi në të njëjtën kohë për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Aspektet kryesore të informimit për këtë proces kanë qenë të ndërlidhura më orarin e orëve mësimore që emetohen në RTK, fillimin e mësimit në distancë, organizimin e tij, detyrat dhe udhëzimet që marrin nga mësimdhënësit, si dhe platformat dhe pajisjet që do të përdoren.


Pa përjashtim, të gjithë nxënësit kanë pohuar se janë informuar me kohë. Pjesa më madhe e tyre kanë deklaruar se informatat kanë qenë të plota dhe

---

<sup>42</sup> Detajet e mostres së nxënësve dhe qasjes hulumtuese, janë prezantuar në kapitullin Metodologjia e studimit.

të mjaftueshme, kurse për rreth 20% këto informata deri diku janë të mjaftueshme. Të pamjaftueshme dhe sipërfaqësore informatat janë për një numër të vogël nxënësish. Ata janë njoftuar më së tepërmi nga mësuesi/ja apo kujdestari i klasës, sidomos nxënësit e nivelit të dytë. Rol të rëndësishëm në informimin e tyre për orarin e orëve mësimore që shfaqen në RTK, për mënyrën e të mësuarit gjatë qëndrimit në shtëpi, detyrat dhe angazhimet që do të merren nga mësuesi, si dhe për mënyrën e përdorimit të platformave të ndryshme online, kanë pasur edhe mediat. Shkollat dhe MASHTI, po ashtu, kanë kontribuar në informimin më të plotë dhe të gjithanshëm, e sidomos MASHTI me udhëzimet e publikuara në faqen zyrtare të tij. Burim tjetër informimi për nxënësit, sidomos ata të nivelit të dytë, kanë qenë prindërit e pastaj edhe DKA-të.

Informacionet kryesore që nxënësit i kanë marrë në shkallën më të lartë kanë të bëjnë me mënyrën e përdorimit të platformave online, mënyrën e të mësuarit gjatë qëndrimit në shtëpi, si dhe për detyrat dhe angazhimet që do ata do t'i marrin nga mësuesi (shih grafikun në vijim).



Grafiku 12. Informacionet për organizimin e mësimit në distancë

## 2. Fillimi i mësimit në distancë /e-mësimit

Edhe pse gjendja e krijuar ishte e paparashikuar dhe ishim krejtësisht të parapërgatitur për këto rrethana, mësimi në distancë/e-mësimi arriti të marrë formën e tij dhe të transmetohet nga RTK, vetëm pas 10 ditësh. Shkollat në



Kosovë u mbyllën më 12 mars, kurse mësimi filloi më 23 mars, me klasat 1-5, ndërsa më 30 mars me klasat 6-9. Nxënësit e arsimit të obliguar 1-9 mësimin në distancë e përcjellin që nga dita kur ka filluar të transmetohet në RTK, kurse për nxënësit e shkollave të mesme MASHTI nuk ka arritur ende të krijojë ndonjë platformë.

Për t'iu përgjigjur mësimin në distancë shkollat e mesme të larta, MASHTI ka kërkuar nga DKA-të të fillojnë përgatitjet dhe inkurajimin e shkollave që të zhvillojnë mësimin në distancë me nxënësit, në mënyrë të decentralizuar në nivel shkolle dhe mësimdhënësit në nivel klase (MASHTI, 2020b). Ndaj kësaj kërkesë janë përgjigjur pozitivisht DKA-të dhe shkollat, ku kanë filluar mësimin me orare të përgatitura nga shkollat dhe me forma e aplikacione për të cilat kanë mundësi t'i përdorin mësimdhënësit dhe nxënësit e tyre. Po ashtu, bazuar në të dhënat e nxënësve, është intensifikuar komunikimi me mësimdhënës, bashkëpunimi më përmbajtjesor me prindër dhe mbështetja e tyre në punim të detyrave dhe nxënie.

Sa i përket pranueshmërisë nga ana e nxënësve, ata, edhe pse po përjetonin për herë të parë diçka të tillë, në bazë të përgjigjeve të tyre, këtë mënyrë të procesit mësimor e kanë pranuar me qetësi, interesim dhe gatishmëri, shumica e tyre (53.8% ), kurse rreth 19 % e kanë pritur me mobilizim, interesim dhe gatishmëri për angazhim në mësim. Një pjesë e nxënësve kanë deklaruar se deri diku kanë pasur një farë frike lidhur më aplikimin e mësimin në distancë, kurse te rreth 7 % prej tyre manifestohen shqetësimi, stresi dhe frika.

Kalimi nga shkolla te mësimi në kushte shtëpie është pritur mirë nga nxënësit. Megjithatë mësimi në distancë nuk mund ta zëvendësojë mësimin në klasë, ai megjithatë ka krijuar mundësi që nxënësit të punojnë dhe të krijojnë të pavarur në kushtet e shtëpisë.

*“Jemi shumë të interesuar dhe e vlerësojmë shumë këtë formë alternative mësimi, sepse deri diku po e kompensojmë mësimin e rregullt në shkolla, të mbyllura tashmë për shkak të pandemisë”, shprehet një nxënës.*

*“Çdo ditë e më shumë jemi më të angazhuar që të mos mbetemi mbrapa. Mësimi në distancë nuk e zëvendëson mësimin në klasë, sepse ai ka edhe*

*plot specifika tjera si socializimi, p.sh., por në një masë megjithatë e kompenson atë”, deklaroi një nxënës tjetër.*

Pas ndërprerjes së mësimin në shkolla, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, numri më i madh i nxënësve, apo rreth 60 % prej tyre, ka filluar të përcjellë mësimin që nga dita kur kanë filluar të shfaqen orët mësimore në RTK, kurse të tjerët në javën e parë të ndërprerjes së mësimin. Pak mbi 6% janë shprehur se sapo kanë filluar mbajtjen e mësimin në distancë, kurse më pak se 1 % janë informuar nga mësimdhënësit e tyre se janë duke u përgatitur për të filluar.

Mësim në distancë nuk ka filluar të mbahet në të gjitha lëndët. Në javën e parë është filluar mësimin në Gjuhën shqipe dhe Matematikë, nga klasa 1 deri në 5, që transmetohet në RTK1 dhe RTK4, për të vazhduar pastaj në javën e dytë më atë për klasat 6-9 dhe me shtimin e numrit të lëndëve.

Sipas përgjigjeve të nxënësve të anketuar të nivelit të dytë dhe gjimnazeve, rezulton se mësimi në distancë realizohet pothuajse në të gjitha lëndët më përjashtim të lëndës së Edukatës fizike. Edhe nxënësit e shkollave profesionale kanë deklaruar se mbajnë shumicën e lëndëve të parapara për klasën përkatëse. Një numër i vogël prej tyre mbajnë vetëm lëndët e përgjithshme, kurse pjesa praktike në shkollat profesionale, për shkak të rrethanave, nuk mbahet fare.

Në mënyrë që nxënësit të mos mbeten prapa me mësim dhe të krijohet mundësia për përfundimin e vitit shkollor, po aplikohen dy forma kryesore mësimore. Njëra formë është regjistrimi dhe transmetimi i njësive mësimore nga RTK-ja, kurse forma tjetër është puna mes nxënësve dhe mësimdhënësve përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (Google classroom, Zoom etj.).

Platformat funksionale për realizim të mësimin në kushte shtëpie janë: E-mail, Viber, Geogle classroom, Zoom, Skype etj. Vlen të theksohet se shkollat e mesme e kanë më të pasur numrin e platformave, sepse ata komunikimin me mësimdhënësin e kanë burimin kryesor të instruksioneve për mësim.

Mësimi në distancë mbahet përmes platformave të shumta, por ajo që dominon në përgjigjet e nxënësve është platforma ZOOM. 83.84% prej tyre kanë deklaruar se mbajnë mësim në distancë përmes kësaj platforme, e përcjellë nga Google classroom me 50.73%. Edhe Viber-i dhe E-mail-i përdoren mjaft shumë, me rreth 37%. Platformat Skype, Google hangouts, Google meet Edmodo, Edukimi.net dhe Busulla.net janë më të rralla.


Mësimi në distancë ndërthet në vete aktivitete të shumta ditore, siç janë mësimi duke përcjellë orët mësimore në RTK, angazhimi për detyrat e dhëna nga mësimdhënësi (mësim online), mësimi më mbështetjen e prindërve/familjes, mësimi i pavarur, i organizuar nga vetë nxënësi dhe shpesh edhe mësim/projekte në bashkëpunim me shokët/shoqet e klasës.

Nga gjetjet e hulumtimit rezulton se 20% të nxënësve akoma nuk kanë filluar të mësojnë, e po aq prej tyre nuk mësojnë më shumë se një orë në ditë, kurse rreth 40% mësojnë 1-2 orë në ditë, duke përcjellë orët mësimore në RTK. Vetëm 14.48% mësojnë më shumë se 3 orë. Një pjesë të madhe të kohës nxënësit e kalojnë me angazhim lidhur me detyrat e dhëna nga mësimdhënësi (mësim online) 33.84% mësojnë 1-2 orë, kurse rreth 50% prej tyre kalojnë më shumë se 2 orë gjatë ditës në zgjidhjen e detyrave. Në komentet dhe vërejtjet që kanë theksuar më së shumti nxënësit është ngarkesa e tyre me detyra të shumta që atyre u japin mësimdhënësit.

*“Na stërngarkojnë me detyra. Nuk i marrin parasysh pengesat tona, siç është ndërprerja e energjisë elektrike, rrjeti i dobët, mungesa e pajisjeve si telefoni kompjuteri etj.”*, shkruan një nxënësi.

Një pjesë të kohës, nxënësit e kalojnë duke mësuar me mbështetjen e prindërve, meqë një numër i konsiderueshëm i tyre gjenden në shtëpi, si pasojë e rrethanave aktuale, apo edhe më mbështetjen e anëtarëve tjerë të familjes. 33.9% të respondentëve kanë deklaruar se gjatë ditës ata kanë ndihmën dhe mbështetjen e familjes 1-2 orë. Më të njëjtën përgjigje përfaqësohen edhe nxënësit që kalojnë me më pak se 1 orë gjatë ditës. Shumica e nxënësve, për mësim të pavarur, të organizuar nga vetë ata, kalojnë 1-2 orë në ditë. Vetëm 11% e tyre e bëjnë këtë më shumë se 3 orë gjatë ditës. Mësim/projekte në bashkëpunim me shokët/shoqet e klasës është një angazhim për të cilin shumica e nxënësve kalojnë 1-2 orë në ditë.

Grafiku në vijim paraqet më në detaje kohën e kaluar brenda ditës për secilin aktivitet.



Grafiku 13. Koha e angazhimit gjatë ditës në mësimin në distancë

### 3. Organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimin në distancë /e-mësimin

Çështje të një rëndësie të veçantë për organizimin e mësimin në distancë janë përshtatja dhe koordinimi i orarit mësimor dhe mundësia e realizimit të lëndëve mësimore, të cilat fillimisht janë transmetuar te nxënësit vetëm ato që janë primare, e gradualisht është shkuar me rritjen e numrit të tyre.

Shumica e nxënësve deklarojnë se orari i mbajtjes së mësimin në distancë përmes platformave online dhe formave tjera që i aplikojnë mësimmshënësit përgjithësisht po funksionon mirë, që shprehur në përqindje është rreth 40%. Po aq prej tyre pohojnë se orari i mbajtjes së mësimin po funksionon shumë mirë.

Format e punës që mësimmshënësit janë duke i aplikuar gjatë mësimin në distancë /E-mësimin janë të shumta, por, megjithatë, disa prej tyre aplikohen në një shkallë më të madhe. Tri janë format kryesore që kanë veçuar nxënësit: prezantimi i njësive mësimore dhe detyrave të nxënësve më

51.97%, komunikimi i drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve me 51.10% dhe dërgimi i përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes aplikacioneve online me 47.84%. Ofrimi i ligjëratave të shkurtra për njësitë e reja mësimore, sipas nxënësve, radhitet në pozitën e katërt, me 31.87%, kurse dhënia e udhëzimeve për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK dhe dërgimi i video-incizimeve të lidhura me përmbajtjet mësimore kanë shkallë të njëjtë përfaqësimi me rreth 23%. Komunikim individual i mësimdhënësit me nxënësin, sipas këtij të fundit, mbetet në shkallën më të ulët, më 6.55%.

*“Të gjithë mësimdhënësit duhet të jenë të interesuar për këtë mënyrë të mëimit dhe të bëjnë maksimumin për dhënien e informatave për mësimet. Angazhimi i disa profesorëve është shumë joprofesional dhe i çrregullt. Dërgojnë detyra në mënyrë jokonsistente (1 ditë 10 palë detyra me afat të shkurtër, pastaj nuk dërgojnë fare për 1 javë), ofrimi i materialit mësimor nga ta është shumë i varfër dhe joprofesional, e po ashtu disa prej tyre refuzojnë të mbajnë orë online në Zoom”, shprehet një nxënës.*

*“Mendoj se kjo metodë e mëimit nuk është edhe aq problematike nëse zhvillohet në mënyrën e duhur. Mendoj se profesorët duhet të angazhohen më shumë dhe të jenë të arsyeshëm në dhënien e detyrave, për shkak se deri më tani e tërë përgjegjësia ka rënë tek ne, nxënësit, duke na ngarkuar me detyra për njësitë mësimore, të cilat nuk janë shpjeguar fare nga ana e tyre. Sikur profesorët të mbanin orë mësimore në platforma si për shembull Zoom dhe do e shpjegonin mësimin, kjo do ta lehtësonte sadopak punën e nxënësve dhe do kishim vullnet më të lartë në kryerjen e detyrave”, pohon tjetri.*


Në vërejtjet dhe komentet e nxënësve ka edhe komente të shumta që pranojnë dhe vlerësojnë angazhimin e mësimdhënësve të tyre dhe organizimin e procesit mësimor në përgjithësi.

*“Mësimi mbahet në mënyre shumë të mirë dhe mësimdhënësit tanë japin maksimumin për të na ndihmuar në arritjet e rezultateve. Kjo formë e re e mëimit mua personalisht po më pëlqen, përveç faktit që arsimtarët po na japin pak më shumë detyra”, deklaron një nxënës.*

*“Faleminderit të gjithë arsimtarëve/profesorëve që po bëjnë të pamundshmen për ne. Kështu jemi duke kompensuar mësimin e rregullt në klasë pa asnjë problem”, shton tjetri.*

*Tej mase po angazhohen. Arsimtarët po japin maksimumin në këtë kohë pandemie. FALEMINDERIT!, Jam e lumtur që kanë zgjedhur këtë formë të organizimit të mësimin, në pamundësi për vijimin e tij në shkolla, komentojnë me radhë shumë nxënës.*

Grafiku në vazhdim paraqet format e punës që mësimsdhënësit janë duke i aplikuar gjatë mësimin në distancë /e-mësimin dhe shkallën e realizimit të tyre sipas nxënësve.



*Grafiku 14. Format e punës që mësimsdhënësit aplikojnë gjatë mësimin në distancë /e-mësimin*

I rëndësishëm për organizimin dhe realizimin e mësimin në shtëpi është edhe fakti që, situata e krijuar, ka ndërgjegjësuar të gjithë qytetarët por në veçanti prindërit, të cilët, sipas informatave nga nxënësit, janë shumë të angazhuar me nxënien e fëmijëve të tyre, ndjekin mësimin në TV, ndihmojnë në detyra, në instalim dhe kyçje të platformave të reja digjitale, kanë përforcuar raportet/komunikimin me mësimsdhënësit, gjithnjë në favor të e-mësimin).

Sipas deklarimeve të nxënësve, në funksion të realizimit të mësimin është shtuar edhe ndërveprimi dhe komunikimi nxënës-nxënës, lidhur me

paqartësitë dhe vështirësitë e mundshme në situatat e reja, të krijuara në mësim dhe në jetën në shtëpi.

*“Gjatë kësaj periudhe të mësimin online, pa dyshim që një pjesë e nxënësve kemi vështirësi, kjo për shkak ndoshta edhe mungesës të ndërveprimit të drejtpërdrejtë me mësimdhënësit apo mungesa e komunikimit individual. Por edhe ngarkesa e punës është më e madhe se në mësimin në shkollë”, shprehet një nxënës.*

Disa nga vështirësitë e shprehura nga nxënësit, lidhur me këtë proces të imponuar mësimor, të imponuar nga rrethanat, janë: adaptimi, mungesa e pajisjeve të TIK-ut, interneti i dobët, mungesa e përmbajtjeve mësimore online, kurse më e theksuara është mbingarkesa me detyra.

Ndër problemet kryesore më të cilat ballafaqohen nxënësit në vijimin e mësimin në distancë është mungesa e internetit apo interneti i dobët. Këtë shqetësim e deklarojnë 44.11% e nxënësve të anketuar. Arsyeja e mosmbajtjes së mësimin online, sidomos në disa vendbanime rurale, është mungesa e internetit. Ka shumë shpesh reduktime të internetit dhe nganjëherë edhe të energjisë elektrike.

Dy vështirësitë më të cilat përballen nxënësit dhe që janë pothuajse të barabarta, janë adaptimi me këtë formë të mësimin dhe ngarkesa me detyra të shtëpisë nga pjesa më e madhe e mësimdhënësve. Shumica e nxënësve mendojnë se janë të ngarkuar përtej mase me to dhe angazhimin rreth tyre.

*“Kjo formë e re e mësimin mua personalisht po më pëlqen, përveç faktit që arsimtarët po na japin më shumë detyra sesa kur kemi vijuar mësim në shkollë dhe mua personalisht nuk po më mbetet fare kohë e lirë që të relaksohem, sepse e tërë dita po më shkon duke bërë detyrat. Mendoj se duhet të kemi më pak detyra”, deklaron një nxënës.*

Sa i përket nivelit të ngarkesës së nxënësve me detyra dhe angazhime të tjera gjatë mësimin në distancë, një pjesë madhe e tyre mendojnë se janë shumë të ngarkuar ose deri diku të ngarkuar (rreth 45%), kurse 19.56% prej tyre deklarojnë se nuk janë të ngarkuar. 20.86% e të anketuarve vlerësojnë se ngarkesa është plotësisht e arsyeshme, sepse kjo është në funksion të arritjes së rezultateve.

Në komentet dhe vërejtjet e nxënësve, ajo që ata kanë theksuar më së shumti, është ngarkesa me detyra që atyre u japin mësimit.

*“Nuk duhet assesi të ngarkohemi aq shumë me teste apo detyra. Unë vetë jam në klasën e 7-të edhe çdo lëndë duhet t’i kushtoj nga 30 minuta duke zgjidhur detyra, e kjo paraqet shumë ngarkesë për mua. Mësimi zhvillohet mirë, por kemi shumë lëndë, e secila lëndë ka 4-5 detyra, kjo është shumë për ne. Mosdërgimi i detyrave pason me notë të keqe, e përveç kësaj, disa s’kanë mundësi t’i dërgojnë ato te mësimit, sepse nuk kanë të gjithë telefona. Unë nuk kam laptop, por as 90% e nxënësve në Kosovë s’kanë”, shprehet një nxënës i klasës së 7-të.*

Edhe mungesa e pajisjeve të TIK-ut për mësim në shtëpi paraqet pengesë jo të vogël për vijimin e mësimit në distancë nga nxënësit. Në shumë raste, brenda familjes ka më tepër se një nxënës që përcjellë mësimin apo duhet të bëjë detyra e nuk më shumë se një kompjuter apo telefon të mençur. Po ashtu, mungesa e hapësirës/këndit për mësim në shtëpi lidhet me gjendjen socio-ekonomike të familjes dhe paraqet vështirësi në vijimin e rregullt të mësimit.

Sipas nxënësve, edhe përdorimi i aplikacioneve për mësim në distancë paraqet vështirësi nëse nuk përdoret aplikacioni i përshtatshëm për aktivitete apo edhe lëndë të caktuara.


*“Mua së bashku me nxënësit e tjerë nuk po na konvenon mënyra në të cilën mësojmë përmes Viberit, pasi që në lëndët si në matematikë p.sh. kemi shumë nevojë për më shumë sqarime, sepse ka edhe detyra më të vështira online, të cilat kërkojnë sqarime më të plota”, shprehet një nxënës.*

*“Gjatë komunikimit përmes Viberit kur po futemi në grup më shumë se 10 veta në call, po ngarkohet rrjeti, kështu që nuk po mund të mbajmë më mësim me këtë aplikacion. Për këtë arsye, do të ishte më mirë që për grupe më të mëdha, mësimi të mbahet me Zoom, me ç’rast kemi mundësi të përdorim edhe screenshare ose kamerën”, pohon nxënësi tjetër.*

*“Disa mësimit duhet të trajnohen për përdorimin e pajisjeve dhe njohjen e aplikacioneve për mësim në distancë. Lus MASHTI-n që të ndërmarra masa për trajnimin e tyre, në mënyrë që ata të mos kenë pengesa gjatë përdorimit të këtyre aplikacioneve”, shton tjetri.*



Një numër më i vogël i nxënësve kanë kërkuar që përmbajtjet mësimore për njësitë mësimore që po shpjegohen të publikohen në një platformë, ku do të kishin qasje të gjithë të interesuarit. Grafiku në vijim paraqet vështirësitë, me të cilat nxënësit përballen gjatë realizimit të mësimin në distancë



Grafiku 15. Vështirësitë, me të cilat nxënësit përballen gjatë realizimit të mësimin në distancë

Për tejkalimin e këtyre vështirësive, shumica e nxënësve kanë pasur mbështetjen dhe ndihmën e kujdestarit të klasës. Më një përqindje të njëjtë, 39.71%, kanë ndihmuar edhe prindërit e tyre. Një numër i madh i nxënësve (37.43%) shprehen se nuk kanë nevojë për ndihmën e askujt dhe vetë përpiqen t'i tejkalojnë vështirësitë. Ndhimja nga shokët/shoqet e klasës dhe motrave dhe vëllezërve në përballimin e këtyre vështirësive është pak më vogël, 28.11% përkatësisht 18.36%. Në rrethana të tilla, për ta orientuar drejtë mbështetjen dhe motivimin e nxënësve nga ana e mësimdhënësve dhe prindërve, është shumë e dobishme të përgatiten udhëzime apo letra informative të shkurtra dhe vizuale, siç ka përgatitur (UNESCO, 2020).

Nga përgjigjet e nxënësve rezulton se ata po ndihmojnë shumë dhe po mobilizojnë në masë të madhe nxënësit, kurse rreth 30% shprehen se ata po ndihmojnë deri diku. Një numër i vogël i të anketuarve thonë se ndihmojnë pak ose aspak.

Për lëndët mësimore që mbahen gjatë mësimit në distancë, mësime të ndryshme përdorin metoda të ndryshme të vlerësimit. Nxënësit vlerësohen më detyra individuale, punë në grupe, projekte e teste të ndryshme. Shumica e nxënësve, apo 63.93%, pohojnë se ata vlerësohen me detyra individuale. Më pyetje të hapura/ese dhe detyra në formë projekti, vlerësohen në shkallë të barabartë më nga 40% të nxënësve. Testimet në formë quizi, detyrat për punë në grupe dhe testet me shkrim përfaqësohen me një përqindje prej 14 deri në 19%.

Situata e krijuar me aplikimin e mësimit në distancë ka vetëdijësuar të gjithë dhe ka ngritur bashkëpunimin mësues – nxënës. Mësime të ndryshme, përmes platformave të ndryshme, çdo ditë e më shumë japin informata kthyesë dhe udhëzime shtesë lidhur me mësime dhe detyrat mësimore në arritjen e rezultateve. Vetë nxënësit deklarohen se mësime të ndryshme çdo ditë e më shumë po japin informata kthyesë dhe udhëzime shtesë lidhur me mësime dhe detyrat mësimore (37%, kurse 32.42% prej tyre përgjigjen se mësime të ndryshme janë mobilizuar shumë dhe po e japin maksimumin në këto rrethana. Një pjesë tjetër e nxënësve vlerësojnë se deri diku po marrin informata kthyesë dhe udhëzime shtesë (21.6%), kurse 5.46% e tyre shprehin se këto ditë jemi duke marrë pak informata kthyesë dhe udhëzime nga mësime të ndryshme për mësime dhe detyrat mësimore. Vetëm 3.52% e të anketuarve përgjigjen se mësime të ndryshme fare nuk u dërgojnë udhëzime shtesë dhe informata kthyesë për detyrat mësimore.

*“Kërkoj që mësime të ndryshme të kenë seriozitet më të madh në lidhje me vlerësimin dhe kthimin e përgjigjeve ose rezultateve pas detyrave”, deklaroi një nxënës.*

*“Mësime të ndryshme të kthejnë përgjigje në e-mailat e tyre kur ne i pyesim në lidhje me orarin apo notat”, shton tjetri.*

Tabela në vijim paraqet dhënien e informatave kthyesë dhe udhëzimeve lidhur me mësime dhe detyrat mësimore që i marrin përmes mësimit në distancë.

Tabela 7. Informatat kthyesë dhe udhëzimet lidhur më mësimet dhe detyrat mësimore

	N	%
Këto ditë, mësimdhënësit fare nuk na dërgojnë udhëzime shtesë dhe informata kthyesë për detyrat mësimore	100	3.52
Këto ditë, pak jemi duke marrë informata kthyesë dhe udhëzime nga mësimdhënësit për mësimet dhe detyrat mësimore	155	5.46
Deri diku po marrim informata kthyesë dhe udhëzime shtesë	613	21.60
Mësimdhënësit çdo ditë e më shumë na japin informata kthyesë dhe udhëzime shtesë lidhur më mësimet dhe detyrat mësimore	1050	37.00
Mësimdhënësit janë mobilizuar shumë dhe po e japin maksimumin për në këto rrethana	920	32.42

Hulumtimi me nxënës është fokusuar edhe në keqpërdorimet eventuale të platformave online. Pjesa më e madhe e nxënësve apo më saktësisht 30.13% nuk kanë informacion për keqpërdorimet e mundshme. Një pjesë e nxënësve vlerësojnë se ndodhin nga njëherë edhe keqpërdorime të aplikacioneve online gjatë mëimit në distancë nga nxënësit. 15% nga ta shprehen se këto keqpërdorime bëhen rrallë. Vetëm 4.58% mendojnë se keqpërdorimet e këtyre aplikacioneve janë të shpeshta.

*“Klasa jonë ka shumë nxënës dhe gjatë mëimit kjo platformë po keqpërdoret nganjëherë. Në këto raste mendoj unë se është mirë që nxënësit që pengojnë orën, të largohen nga ora, e jo t’u ndalet të gjithë nxënësve mikrofonit, për shkak të një nxënësi, siç vepron një profesoreshë jona, e cila na ndalon mikrofonat që nga kyçja në fillim në mësim e deri sa përfundon ora”,* pohon një nxënës.

Pas ndërprerjes së mëimit në shkolla, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, numri më i madh i nxënësve ka filluar të përcjellë mësimin që transmetohet përmes RTK-së. Orët e emetuara nga RTK-ja sipas pjesës dërmuese së nxënësve po ndihmojnë shumë dhe po i mobilizojnë në masë të madhe nxënësit. Rreth 20 % prej tyre vlerësojnë se mësimet e transmetuara përmes televizionit po ndihmojnë pak ose fare dhe theksojnë disa nga


lëshimet që bëhen me këtë rast, duke filluar që nga salla, paqartësia e tekstit të sllajdeve, distanca e madhe nga monitori, e deri të koha dhe hapësira e pamjaftueshme, sidomos për zgjidhjen e detyrave të matematikës.

*“Mendoj se gjithçka është në rregull, vetëm duam që mësimdhënësit që japin mësim përmes TV-së të japin më shumë shembuj, shprehet një nxënës. Mendoj që është një gjë e mirë që arsimtarët, të cilët shfaqen në TV, të jenë më të lirë, në mënyrë që mësimi të jetë më i kapshëm, sepse mendoj se arsimtarët në TV po flasin si përmendësh”, pohon një nxënës tjetër.*

Interesimin dhe angazhimin për të mësuar përmes mësimin në distancë shumica e nxënësve e vlerësojnë si të mirë (45.60%), të lartë 26.22% kurse shumë të lartë rreth 17% prej tyre. Vetëm 3.14% e nxënësve mendojnë se interesimi dhe angazhimi i tyre për të mësuar përmes kësaj formë është tejet pasiv.

#### **4. Vazhdimi i mësimin në distancë/e-mësimin dhe nevojat e nxënësve për mbështetje**

Me gjithë komentet dhe vërejtjet e një numri të konsiderueshëm të nxënësve për vështirësitë që kanë hasur në vijimin e mësimin në distancë, ngarkesën me detyra dhe angazhime të shumta, mungesës së pajisjeve dhe mungesës së internetit apo interneti i dobët, ata e vlerësojnë lart procesin e realizimit të kësaj forme të mësimin. Për 35.24% të tyre kjo është një përvojë e re, që duhet përkrahur, kurse për 28.47% mësimi në distancë është një mundësi shumë e mirë për të dhënë maksimumin. Presin që të përmirësohet 17.69 e të anketuarave, kurse 10.50% e tyre konstatojnë se kjo formë deri diku i ngjan mësimdhënies. Se organizimi i kësaj forme të mësimin, fare nuk i ngjan mësimdhënies deklarojnë 5.10% e nxënësve. Grafiku në vijim paraqet vlerësimin e procesit të mësimin në distancë nga ana e nxënësve.



*Grafiku 16. Vlerësimi i procesit të mësimit në distancë*

Mundësitë për realizim të mësimit në distancë, sipas nxënësve, janë të shumta, të llojllojshme dhe të përshtatshme për zbatim. Por, krahas kësaj, janë evidente edhe disa aspekte të këtij procesi mësues, të cilat kanë nevojë për mbështetje, si: publikimi i materialeve mësuese në një platformë të lehtë për përdorim, ku mund të kenë qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje); dërgimi i përmbajtjeve të mësimeve me e-mail nga mësuesit; dërgimi i detyrave me e-mail nga mësuesit; mësimi i drejtpërdrejtë online me mësuesit e vetë; burime tjera (faqe interneti, tekste online, kuize, teste provuese, etj.) me përmbajtje dhe detyra të lëndëve mësuese që i mësojmë; informata kthyes nga mësuesit për detyrat mësuese; dërgimi i përmbajtjeve mësuese dhe detyrave përmes platformës online, më të lehta për t'i përdorur etj.

Siç shihet nga tabela e mëposhtme, nevoja më e madhe për mbështetje të nxënësve për realizimin e mësimit në distancë është publikimi i materialeve mësuese në një platformë ku mund të kenë qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) të lehtë për përdorim (37.65%) e pasuar pastaj me mësime të drejtpërdrejtë online me mësuesit e klasës së tyre (32.38%), dërgim i përmbajtjeve mësuese dhe detyrave përmes platformës online, më të lehta për ta përdorur (30.235).

*Tabela 8. Nevojat më të mëdha për mbështetje të nxënësve për realizimin e mësimit në distancë*

Nevojat më të mëdha për mbështetje të nxënësve për realizimin e mësimit në distancë	N	%
Publikimi i materialeve mësimore në një platformë ku kemi qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) të lehtë për përdorim	1036	37.65
Dërgimi i përmbajtjeve të mësimoreve më email nga mësuesit	542	19.69
Dërgim i detyrave me email nga mësuesit	620	22.53
Mësim të drejtpërdrejtë online me mësuesit e mi	891	32.38
Burime të tjera (faqe interneti, tekste online, kuize, teste provuese, etj.) me përmbajtje dhe detyra të lëndëve mësimore që i mësojmë	525	19.08
Informata kthyesë nga mësuesit për detyrat mësimore	712	25.87
Dërgim i përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes platformës online, më të lehta për t'i përdorur	832	30.23

Disa aspekte tjera që kanë nevojë për mbështetje, sipas nxënësve, janë koordinimi i mësuesve për orarin duke marrë parasysh mbingarkesën që u bëhet nxënësve, duke qëndruar kohë të gjatë para ekraneve ose pranë pajisjeve teknologjike në dispozicion, krijimi i një orari të rregullt dhe eliminimi i konfuzionit me orarin aktual, përpjekja për gjithëpërfshirje të nxënësve, sepse një pjesë e tyre, sidomos ata të vendbanimeve rurale, nuk kanë rrjet e as pajisjet e duhura.

## **5. Përfundime**

Dy janë format kryesore të organizimit të mësimit në distancë. Njëra formë është regjistrimi dhe transmetimi i njësive mësimore nga RTK-ja, kurse forma tjetër është puna mes nxënësve dhe mësuesve përmes platformave të ndryshme të komunikimit apo rrjeteve sociale që mundësojnë krijimin e klasave virtuale ( Google classroom, Zoom, Skype, viber etj.).

Kalimi nga shkolla te mësimi në kushte shtëpie është pritur mirë nga nxënësit. Megjithëse nuk mund ta zëvendësojë mësimin në klasë, ka krijuar mundësi që nxënësit të punojnë dhe të krijojnë të pavarur në kushtet e shtëpisë.

Mësimi online mbahet përmes platformave të shumta, por ajo që dominon në përgjigjet e nxënësve është platforma ZOOM. 83.84 % prej tyre kanë deklaruar se mbajnë mësim në distancë përmes kësaj platforme, e përcjellë nga Google classroom me 50.73 %. Edhe Viber-i dhe E-mail-i përdoren mjaft, me rreth 37%. Platformat Skype, Google hangouts, Google meet Edmodo, Edukimi.net dhe Busulla.net janë më të rralla.

Sipas nxënësve të anketuar të nivelit të dytë dhe gjimnazeve, rezulton se mësimi në distancë realizohet pothuajse në të gjitha lëndët, me përjashtim të lëndës së Edukatës fizike. Edhe nxënësit e shkollave profesionale kanë deklaruar se mbajnë shumicën e lëndëve të parapara për klasën përkatëse. Një numër i vogël prej tyre mbajnë vetëm lëndët e përgjithshme, kurse pjesa praktike në shkollat profesionale, për shkak të rrethanave, nuk mbahet fare.

Format e punës që mësimdhënësit janë duke i aplikuar gjatë mësimin në distancë /e-mësimin janë të shumta, por, megjithatë, disa prej tyre aplikohen në një shkallë më të madhe. Tri janë format kryesore që kanë veçuar nxënësit: prezantimi i njësive mësimore dhe detyrave të nxënësve me 51.97%, komunikimi i drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve me 51.10% dhe dërgimi i përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes aplikacioneve online me 47.84%.

Ndër problemet kryesore, me të cilat ballafaqohen nxënësit në vijimin e mësimin në distancë, është mungesa e internetit apo interneti i dobët. Këtë shqetësim e deklarojnë 44.11% e nxënësve të anketuar. Arsyeja e mosmbajtjes së mësimin online, sidomos në disa vendbanime rurale, është mungesa e internetit.

Situata e krijuar me aplikimin e mësimin në distancë i ka vetëdijësuar të gjithë dhe ka ngritur bashkëpunimin mësimdhënës – nxënës. Mësimdhënësit, përmes platformave të ndryshme, çdo ditë e më shumë japin informata kthyesë dhe udhëzime shpesh lidhur me mësimet dhe detyrat

mësimore në arritjen e rezultateve. Vetë nxënësit deklarohen se mësimdhënësit çdo ditë e më shumë po japin informata kthyesë dhe udhëzime shtesë.

Për lëndët mësimore që mbahen gjatë mësimit në distancë, mësimdhënësit përdorin metoda të ndryshme të vlerësimit. Nxënësit vlerësohen me detyra individuale, punë në grupe, projekte e teste të ndryshme. Shumica e nxënësve, apo 63.93%, pohojnë se ata vlerësohen me detyra individuale. Me pyetje të hapura/ese dhe detyra në formë projekti vlerësohen në shkallë të barabartë, me nga 40% të nxënësve.

Me gjithë komentet dhe vërejtjet e një numri të konsiderueshëm të nxënësve për vështirësitë që kanë hasur në vijimin e mësimit në distancë, ngarkesën me detyra dhe angazhime të shumta, mungesës së pajisjeve dhe mungesës së internetit apo interneti i dobët, ata e vlerësojnë lart procesin e realizimit të kësaj forme të mësimit. Për 35.24% të tyre kjo është një përvojë e re që duhet përkrahur, kurse për 28.47% mësimi në distancë, është një mundësi shumë e mirë për të dhënë maksimumin.

Janë disa aspekte të këtij procesi mësimor, të cilat kanë nevojë për mbështetje, si: publikimi i materialeve mësimore në një platformë të lehtë për përdorim, ku mund të kenë qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje); dërgimi i përmbajtjeve të mësimave me e-mail nga mësimdhënësit; dërgimi i detyrave me e-mail nga mësimdhënësit; mësimi i drejtpërdrejtë online me mësimdhënësit e vetë; burime tjera (faqe interneti, tekste online, kuize, teste provuese, etj.) me përmbajtje dhe detyra të lëndëve mësimore që i mësojmë; informata kthyesë nga mësimdhënësit për detyrat mësimore; dërgimi i përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes platformës online, më të lehta për t'i përdorur etj.

## **Rekomandime**

Rekomandimet kryesore për realizimin e mësimit në distancë, referuar gjetjeve kryesore nga perspektiva e nxënësve, janë si në vijim:



- Të koordinohen ndërmjet veti mësimeve të klasës, gjegjësisht aktivitetet profesionale, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen tej mase me detyra, mësime, angazhime e projekte;
- Mësimeve të kenë qasje motivuese ndaj nxënësve për mësime dhe t'i bëjnë ata pjesëmarrës aktivë në detyra dhe aktivitete tjera mësimore;
- MASHTI të angazhojë ekipe të psikologëve dhe pedagogëve që iu përgjigjen nxënësve dhe prindërve për mbështetje dhe motivim të nxënësve gjatë mësimit në distancë, përfshirë edhe përgatitjen e udhëzimeve apo letra informative të shkurtra dhe vizuale që lidhen me angazhimin dhe motivimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë;
- Të fillojë transmetimi i gjuhës angleze (në mungesë tashmë edhe të kurseve);
- Mësimeve, përmes trajnimeve, të zhvillohen profesionalisht në përdorimin e aplikacioneve për mësimin në distancë;
- Të investohet në ngritje të kapaciteteve të mësimeve për realizim të platformave digjitale;
- Të investohet në infrastrukturë digjitale, jo vetëm në shkolla, por edhe në familjet në nevojë;
- Të zhvillohen materiale mësimore, ndërvepruese, mes mësimeve dhe të shkarkohen ato në platforma mësimore si pako praktike më të afërta me nxënësit.

Bazuar në reflektimet e nxënësve, mund të konstatohet se të mësuarit në shtëpi është i pranueshëm për ta dhe se kjo për rrethanat aktuale ishte zgjidhja më e mirë dhe se janë në përpjekje të vazhdueshme për avancim të mësimeve. Kjo dëshmon se angazhimi dhe aktivizimi i madh i mësimeve, prindërve dhe nxënësve, ka mundur që në masë të konsiderueshme të kompensohet mësimi i shkollës, mirëpo duhet pasur kujdes në menaxhimin e situatës, motivimin e nxënësve për mësime.



### 3.5. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E PRINDËRVE

Lirije Bytyqi, Mevlude Aliu & Safete Shala

Sipas udhëzimeve të MASHTI-it, prindërit, sidomos ata që kanë fëmijë të moshës së re (klasat 1-3), janë pikëmbështetja kryesore për realizimin e mësimit online. Po ashtu, prindërit janë faktori më i rëndësishëm për realizimin e mësimit edhe në nivelet tjera të arsimit parauniversitar (MASHTI, 2020a). Nisur nga kjo, në mostër janë përfshirë 1805 prindër, që kanë fëmijë në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, me qëllim që të marrim perceptimet e tyre lidhur me informimin, fillimin, organizimin, mbështetjen, mundësitë, sfidat dhe nevojat për realizimin me sukses të mësimit në distancë<sup>43</sup>.

#### **Informimi për organizimin e mësimit në distancë /e-mësimit**

Lidhur me informimin e prindërve dhe rolin e tyre për organizimin e mësimit në distancë /e-mësimit, të dhënat e studimit tregojnë se prindërit janë të informuar, por dallon niveli i informimit të tyre. Shumica e prindërve theksojnë se për organizimin e mësimit në distancë dhe rolin e tyre në cilësinë e prindit kanë marrë informata të mjaftueshme (47.9 %) dhe informata të plota (23,6%). Mirëpo, kemi një numër të konsiderueshëm të prindërve, të cilët vlerësojnë se nuk janë informuar mjaftueshëm, ngase informatat që kanë ata janë informata deri diku të qarta (19.3%), informata tejet sipërfaqësore (4,7%) dhe informata të pamjaftueshme (4,5%).

Për organizimin e mësimit në distancë prindërit më së shumti informata kanë marrë nga mësuesi/ja apo kujdestari i klasës dhe nga mediat, ndërsa nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Inovacionit, nga shkolla dhe nga Drejtoria Komunale e Arsimit ishin më pak të informuar. U informuan edhe nga fëmijët e tyre, nga prindërit tjerë, nga miqtë dhe familjarët. Një pjesë e

---

<sup>43</sup> Detajet e mostrës së prindërve dhe të qasjes hulumtuese me prindër janë prezantuar në kapitullin Metodologjia e studimit.

prindërve gjithashtu theksuan që disa prej mësimdhënësve kishin filluar mësimin online para se të fillojnë të shfaqen orët mësimore në RTK. Disa prindër deklarohen që janë vetë mësimdhënës dhe prandaj ata ishin njoftuar shumë mirë për gjendjen aktuale. Rrjetet sociale, e në veçanti Facebook-u, ka rezultuar të jetë një vend shumë i pëlqyer për marrjen e informacioneve për e/mësimin, ku janë krijuar shumë grupe për mbledhjen e informatave.

Informatat e prindërve kryesisht ishin për orarin e orëve mësimore që shfaqen në RTK (29.74%), për mënyrën dhe orarin e realizimit të mësimin në distancë (24.37%), për detyrat mësimore të nxënësve (21.09%), për mënyrën dhe orarin e konsultimeve me mësimdhënës (12.69%), si dhe për rolin e prindërve me fëmijë gjatë mësimin në distancë (12.11%), sidomos për prindërit e fëmijëve në arsimin fillor, nga mësimdhënësit janë dhënë udhëzime edhe për platformën Zoom dhe përdorimin e saj për mësim.

### **Fillimi i mësimin në distancë /e-mësimin**

Pas ndërprerjes së mësimin në shkollë, për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19, sipas të dhënave të prindërve, disa prej fëmijëve mësimin në distancë e kanë filluar që në javën e parë pas mbylljes së shkollës (20.5%). Mirëpo, shumica e prindërve pohojnë se fëmijët e tyre kanë filluar të ndjekin mësimin në distancë/e-mësimin nga dita kur kanë filluar të shfaqen orët mësimore në RTK (74.1%). Sipas tyre, pasi që janë dhënë informacionet që mësimi do të fillojë përmes transmetimit në RTK, fëmijët janë treguar kureshtarë se kur do të fillojë mësimi, si do të realizohet dhe si do të angazhohen ata.

Prindërit besojnë se fëmijët e tyre fillimin e mësimin në distancë e kanë marrë me qetësi, interesim dhe gatishmëri për angazhim në mësim. Mirëpo, ka edhe prindër që pohojnë se fëmijët e tyre fillimin e mësimin në distancë/e-mësimin e kanë prituri deri diku me shqetësim, stres dhe frikë. Ata shprehen se vazhdimisht po mundohen që t'i përkrahin fëmijët e tyre që ta përballojnë këtë situatë. Kjo përkrahje mbetet sfidë, kur kemi parasysh se institucionet arsimore në Kosovë nuk kanë përgatitur udhëzues të veçantë për prindër se si t'i përkrahin fëmijët e tyre gjatë pandemisë COVID 2019, siç ka vepruar Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në përgatitjen Udhëzuesit për prindër dhe

kujdestarë për përkrahjen e shëndetit mendor dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve gjatë pandemisë së COVID-19.

Për mësimin në distancë/e-mësimin prindërit pohojnë se fëmijët e tyre përdorin aplikacione e platforma të ndryshme, si: RTK, e-mail, WhatsApp, Google classroom, Skype, Messenger, Instagram, Cisco Webex, Scooler, TeamLink, etj., mirëpo si aplikacione dhe platforma që përdoren më së shumti veçojnë aplikacionin Viber dhe platformën Zoom.

Me mësimin në distancë/e-mësimin janë angazhuar edhe fëmijët parashkollorë dhe për këtë prindërit shprehin falënderim për edukatorët, për angazhimin dhe mundësitë që ato po gjejnë për fëmijët. Bashkëpunimi edukatore-prind në masë të konsiderueshme realizohet duke e shfrytëzuar komunikimin me telefon, e një pjesë e madhe e edukatoreve po e shfrytëzojnë aplikacionin edhe viberin. Disa prej edukatoreve u angazhuan që prej fillimit të ndërprerjes së mësimin, duke dhënë rregullisht udhëzime për prindër lidhur me aktivitetet ditore të fëmijëve në shtëpi (prind nënë, edukimi parafillor, komuna Prishtinë). Po ashtu, me anë të Viberit, prindërit e fëmijëve parashkollorë informohen edhe për aktivitetet ditore nga platforma online për moshën 0-6 vjeç (<https://edukimihershem.rks-gov.net/>).

Prindërit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët deklarojnë se fëmijët e tyre në masë të madhe përcjellin orët mësimore që shfaqen në RTK dhe pasi të shikojnë orët mësimore në RTK, mësimdhënësit në grup i sqarojnë detyrat e pastaj fëmijët i punojnë dhe i dërgojnë te mësimdhënësit individualisht, ku edhe marrin informatë kthyesë rreth detyrave. Po ashtu, për sqarime të tjera të nevojshme mbajnë takime në Zoom. *“Me Zoom mban mësim online, ndërsa me Viber dhe e-mail marrin sqarime e i përcjellin detyrat e shtëpisë”*, (prind, arsimit fillor, qytet- Prishtinë). Por, ka edhe prindër të cilët pohojnë se për shkaqe të ndryshme fëmijët e tyre detyrohen të zgjedhin forma tjera, jashtë grupit me klasën. *“Shumica punojnë edhe me Zoom, por unë vetëm me Viber sepse nuk po më bënë Zoom-i”*, shprehet një prind, nënë e tre fëmijëve, në të tri nivelet: edukim parafillor, arsim fillor, arsim të mesëm të ulët, në qytetin e Podujevës, e të tilla deklarime ka edhe nga prindër të tjerë.

Por, përdorimi i disa platformave po duket jo e thjeshtë, ngase disa prindër mendojnë se do të duhej të ishte vetëm një platformë ku fëmijët do të kenë mundësi të ndjekin mësimin, të sqarohen më hollësisht, sipas nevojës, me mësimdhënësit e tyre, të komunikohet rreth detyrave etj., sepse qasjen në disa platforma e shohin si procedurë komplekse. *“Kishte me qenë mirë sikur të ishte një platformë për të gjitha, e jo të shpërndara, shpjegimi në RTK, pastaj detyrat në e-mail, shkruaj, fotografo, dorëzo... shumë procedurë komplekse”*, (prind, arsimit i mesëm i ulët, shkollë private, komuna Prishtinë).


Prindërit gjithashtu shfaqin edhe shqetësimet e tyre lidhur me platformat, të cilat aktualisht po përdoren, dhe ndërprerjeve të shpeshta gjatë realizimit të mësimin. *“Megjithëse nxënësit janë aktivizuar në mësimet e tyre në distancë, mendoj se aplikacionet gjegjësisht platformat ekzistuese nuk po tregohen edhe aq kualitative në zhvillimin e mësimëve për shkak të ndërhyrjeve të shumta gjatë zhvillimit mësimor”*, (prind, arsimit i mesëm i ulët, qyteti i Mitrovicës).

Madje ka prindër që mendojnë se *“është për të ardhur keq që ministria nuk ka ende një platformë, në nivel komunal apo edhe shtetëror!”*, (prind i dy fëmijëve, arsim fillor dhe të mesëm të ulët, Prishtinë).

Bazuar në të dhënat e dala nga prindërit, mësimi në distancë/e-mësimi nuk është duke u zbatuar në të gjitha shkollat dhe nga të gjithë mësimdhënësit. Prindërit shprehen të pakënaqur me angazhimin e disa mësimdhënësve;

*“Vetëm njëri nga tre fëmijët e mi mban mësim me mësimdhënësen, dy të tjerët vetëm përmes mësimin në RTK (me vetiniciativë), as detyrat nuk i kontrollojnë mësimdhënësit”*, (prind i tre fëmijëve, një në arsim fillor dhe dy fëmijë arsim të mesëm të ulët, fshat-komuna e Dragashit). *“Nuk mban mësim me mësuesen në asnjë formë, përveç detyrave që i dërgon në Viber”*, (prind, arsimit fillor, qytet-Prishtinë).

Sa i përket kohës në ditë, që mesatarisht fëmijët e kalojnë duke mësuar, nga prindërit kemi marrë këto përgjigje:



Grafiku 17. Kohë në ditë që kalojnë fëmijët duke mësuar

Nga përgjigjet e dhëna shohim se fëmijët kalojnë rreth një orë duke i përcjellë orët mësimore në RTK, 1-2 orë me angazhim dhe detyra të dhëna nga mësimdhënësi (mësim online), 1-2 orë mësim me mbështetje të prindërve/familjes, si dhe rreth një orë mësim të pavarur, të organizuar nga vetë fëmijët.

Rezultatet tregojnë se një numër jo i vogël i prindërve mendojnë se fëmijët akoma nuk kanë filluar me mësimin në distancë/e-mësimin, e ky është një rezultat shqetësues, sepse nëse këta fëmijë nuk kanë filluar akoma mësimin, është një kohë më gjatë se një muaj dhe shkëputja nga mësimi për një kohë aq të gjatë është humbje e madhe për ta.

### **Organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimin në distancë /e-mësimin**

Nga prindërit e përfshirë në studim morëm edhe opinionet e tyre për organizimin dhe mbështetjen në realizimin e mësimin në distancë/e-mësimin, e që fokusi ishte në orarin e mbajtjes së mësimin, format e realizimit, vështirësitë me të cilat përballen gjatë realizimit të mësimin, si dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit për tejkalimin e vështirësive.

Lidhur me funksionimin e orarit të mbajtjes së mësimin në distancë përmes platformave online dhe formave tjera që i aplikojnë mësimdhënësit e

fëmijëve, nga shumica e prindërve kemi përgjigje se përgjithësisht mirë po funksionon orari i mësimit (42.9%), shumë mirë po funksionon orari i klasës së fëmijës (40.9%), po ka edhe prind të cilët pohojnë se deri diku po funksionon orari i mësimit në distancë (11.3%), e disa edhe ankohen që fëmijët ende nuk kanë një orar të caktuar. Problemet me funksionimin e orarit mësimor sipas disa prindërve kanë ndikuar në humbjen e interesimit për mësim.

*“Çdo ditë kemi një rënie të interesimit për mësim, për shkak se mësimdhënësit nuk kanë një orar të caktuar të mësimit, atë e ndërrojnë kur atyre iu konvenon, nuk i përmbahen orarit që ishte në shkollë. Duhet të dihet që tani shtëpia është shkollë dhe mësimi duhet të bëhet në një orar që fëmijët tanë të përfshihen dhe të jenë aktiv në mësim”, (prind në SHML, Prishtinë).*

Sa u përket formave të punës që mësimdhënësit e fëmijëve janë duke i aplikuar gjatë mësimit në distancë /e-mësimit, shumica e prindërve kanë dhënë përgjigje se mësimdhënësit u japin fëmijëve udhëzime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK. Po ashtu, një numër i madh i prindërve janë deklaruar për dy forma të punës, me udhëzime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK dhe komunikim të drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve. Nuk është i vogël numri i prindërve të cilët pohojnë se mësimdhënësit dërgojnë përmbajtje mësimore dhe detyra përmes aplikacioneve online, si dhe përdorin disa forma të organizimit të punës me fëmijët e tyre.

Disa prindër mendojnë se mësimi në distancë/e-mësimi është duke u realizuar pa vështirësi të mëdha dhe në bashkëpunim të ngushtë me mësimdhënësit.

*“Nuk ka vështirësi, përkundrazi fëmijët e kanë marrë me shumë kreativitet mësimin nga distanca. Herë pas here u dërgojmë mësuesëve incizime të shkurta me prezantime detyrash ose recitim, e cila po e bënë më interesante interaksionin mes fëmijëve dhe mësuesëve”, (prind i dy fëmijëve në arsimin fillor, Prishtinë).*

Por, shumica prej prindërve pohojnë se fëmijët përballen me plot vështirësi. Vështirësitë me të cilat janë duke u përballur fëmijët gjatë realizimit të mësimit në distancë /e-mësimit janë të ndryshme, si: adaptimi me këtë formë të mësimit, interneti i dobët, ngarkesa me detyra të shtëpisë nga pjesa më e



madhe e mësimdhënësve dhe mungesa e pajisjeve të TIK-ut për mësim në shtëpi. *“Nuk kemi laptop ose kompjuter, gjithashtu interneti është i dobët, ndonjëherë ndalet edhe rryma elektrike”*, (nënë e dy fëmijëve në arsim të mesëm të ulët, qytet Vushtrri).

Prindërit ankohen jo vetëm për rrjetin e dobët të internetit dhe mungesën e mjeteve teknologjike për dy-tre fëmijë në familje, por edhe për kualitetin e shpjegimeve në orët mësimore të RTK-së, si shumë të shkurtra, pa sqarime të nevojshme, pa shpjeguar si vjen deri te rezultati i detyrës (Matematikë), etj., si dhe për ngarkesat me detyra të shtëpisë, që sipas shumicës së prindërve fëmijët po ngarkohen shumë me detyra nga të gjitha lëndët, e sidomos në Matematikë, e që prindërit shpesh nuk mund t'i ndihmojnë fëmijët në sqarimin e detyrave.

*“Në këtë rast flas për shumicën e fëmijëve, është ngarkesë nëse shpjegimi i një njësie të re bëhet për 2-3 minuta, duke e pasur parasysh se ka përmbajtje që prindërit nuk e njohin që të mund t'i ndihmojnë fëmijës së vet”*, (prind, dy fëmijë në arsim fillor, Prishtinë).

*“Shpesh nxënësit ngarkohen për së tepërti me detyrat e shtëpisë, nga pjesa më e madhe e lëndëve mësimore, sidomos në lëndën e matematikës”*, (prind, një fëmijë në arsimin fillor, një fëmijë arsim të mesëm të ulët, Podujevë).

Ngarkesa e madhe me detyra fëmijëve u shkaktojnë stres dhe shqetësim. *“Kanë stres për detyra”*, (prind i dy fëmijëve në arsimin fillor, Mitrovicë). *“Vetë situata është stresuese, ambienti shtëpiak nuk është edhe më i volitshmi për mësim, mungojnë stimujt, si shokët, shkolla, mësuesja etj.”*, (prind i dy fëmijëve në arsim fillor, Prishtinë). *“Afatet e shkurta ditore për dorëzim të detyrave po shkaktojnë stres te fëmijët dhe në familje”*, (prind i dy fëmijëve, një në arsim fillor dhe një në arsim të mesëm të ulët, Prishtinë).

Prindërit ankohen edhe për kohën e gjatë që atyre u duhet të kalojnë me fëmijët e tyre për angazhimet në mësim. *“Pasi që në familje kemi katër fëmijë që ndjekin mësimet online, e tërë dita na kalon duke u marrë me mësim, nuk kemi pajisje për të tre fëmijët”*, (prind i tre fëmijëve: arsim fillor, arsim të mesëm të ulët dhe arsim profesional, qytet-komuna Vushtrri).


Lidhur me atë se kush po i ndihmon fëmijët në përballimin e këtyre vështirësive, shumica deklarojnë se ata vetë, pra prindërit, po u ndihmojnë

fëmijëve të tejkalojnë vështirësitë, pastaj prindërit, në bashkëpunim me mësimmhënësit, si dhe motrat e vëllezërit e tyre, ndërsa një numër më i vogël i prindërve pohojnë se fëmijët po i tejkalojnë vetë vështirësitë.

*“Edhe pse i rritur prapë ka nevojë për mbështetjen e prindërve dhe kujdestares, por më së shumti merret motra e tij në klasën e nëntë sepse ia kuptojnë botën njëri-tjetrit”, (prind i dy fëmijëve në arsimin e mesëm të ulët, Podujevë).*

Por, prindërit shprehin edhe dilemat e tyre lidhur me mbështetjen e tyre për fëmijët, edhe për shkak të kohës që ata kanë në dispozicion, ngase, sipas tyre, është vështirë t’u ndihmohet fëmijëve kur edhe vet duhet të punojnë nga shtëpia. *“Edhe ne po punojnë nga shtëpia, shumë të vështirë po e kemi me u dalë ndihmë të gjithë fëmijëve në mësim”, (prind i pesë fëmijëve në të gjitha nivelet e arsimit nga një fëmijë, qytet Prishtinë).*

Lidhur me pyetjen se sa po ju ndihmojnë fëmijëve orët mësimore që po shfaqen në RTK, nga prindërit kemi marrë përgjigje të ndryshme. Se sa po i ndihmojnë të nxëniet e fëmijëve, orët mësimore që po shfaqen në RTK, mendimet e prindërve i pasqyron grafiku i mëposhtëm:



Grafiku 18. Sa po ndihmojnë të nxëniet e fëmijëve orët mësimore që po shfaqen në RTK?

Përqindja e prindërve që kanë dhënë përgjigje pozitive, se orët mësimore në RTK, po u ndihmojnë shumë fëmijëve, si dhe përqindja e prindërve që kanë dhënë përgjigje se deri diku po ndihmojnë orët mësimore në RTK, është

shumë e përafërt, ndërsa një pjesë e mirë e prindërve mendojnë se orët mësimore në RTK, po i mobilizojnë në masë të madhe nxënësit.

Vlerësimet e prindërve janë të ndryshme, si për orët e mësimimit që po shfaqen në RTK ashtu edhe për format tjera të mësimimit në distancë.

Lidhur me orët e mësimimit që po shfaqen në RTK, ka vlerësime pozitive nga prindërit, si:

*„Orët e mësimimit në RTK, po i mobilizojnë fëmijët sepse ata po e marrin obligim këtë orar mësimi e gjithashtu po ndiejnë përgjegjësi për t'ia dërguar detyrat mësueses-arsimtarëve saktë dhe me kohë”, (prind i dy fëmijëve në arsim fillor dhe një në arsim të mesëm të ulët, qytet-Prishtinë).*

*“Mendoj se orët mësimore që po shfaqen rregullisht në RTK, po i ndihmojnë në masë të madhe nxënësit, janë shumë efikase dhe po i orientojnë nxënësit në mësim”, (prind i një fëmije në arsim fillor, një në arsim të mesëm të lartë, gjimnaz, qytet-Prishtinë).*

*”Për kohën në dispozicion, ligjëratat janë mjaft të qarta dhe mësimdhënësit janë në nivelin e duhur, ku përveç ligjëratave kemi kombinim me ilustrime e shembuj dhe janë të kuptueshme për fëmijët”,(prind i një fëmije në arsimin fillor, qytet- Mitrovicë).*

Mirëpo, për orët e mësimimit që po shfaqen në RTK prindër nga komunat tjera jashtë Prishtinës pohojnë se nuk mund t’i përcjellin, sepse nuk përputhem me planet dhe programet e mësimdhënësve.

*„Mësimi në RTK po ndihmon deri diku, për shkak se fëmijët nuk janë të adaptuar me mënyrën e mësimimit të atyre mësimdhënësve dhe disa mësimore edhe i kanë mësuar më herët në shkollë”, (prind i dy fëmijëve në arsim fillor, fshat, Mitrovicë).*

*„Plan-programi në RTK është shumë mbrapa me plan-programin e shkollës ku janë fëmijët tanë”, (prind i një fëmije në arsimin fillor, një fëmijë në arsim të mesëm të ulët, qytet-Prizren).*

*„Programi në RTK nuk përputhet me njësinë mësimore sipas planit të mësueses së fëmijës tim, andaj ne nuk e përcjellim mësimin në RTK, por vetëm mësuesen tonë, me të cilën komunikojmë në Zoom dhe Viber. Deri tani gjithçka ka ecur shumë mirë. Përveç kësaj, programi në RTK është tej*

*mase i dobët, përfshirë edhe mësimdhënësit që ligjërojnë orët mësimore”, (prind, një fëmijë në arsim fillor, shkollë private, qytet- Prizren).*

Për orët e mësimi që po shfaqen në RTK, nga prindërit fëmijëve që po i përcjellin ato, ka edhe mjaft vërejtje, ankesa dhe kërkesa, si:

*„Orët mësimore që po shfaqen në RTK janë të shkurta. Duhet të jenë gjithashtu më interaktive, sidomos për klasat e ulëta”, (prind i një fëmije në arsim fillor, një fëmijë në arsim të mesëm të ulët, qytet- Prishtinë).*

*„Do të doja të ishin më të gjata videot ku shpjegohet mësimi, nëse nuk mund të shfaqen të gjitha në TV, atëherë të krijohet një ueb-faqe, apo diçka e ngjashme, ku do të shfaqen më gjerësisht”, (prind i një fëmije në parafillor dhe një në arsim fillor, qytet- Ferizaj).*

*„Njësitë mësimore që po i shtjellojnë mësimdhënësit të kenë kujdes e të mos lëshojnë gabime, ngase po krijojnë huti te fëmijët. Derisa mësimdhënësit janë në xhirim, ata kanë edhe mundësinë e verifikimit të videove të shfaqura para se ato t’ua servojnë fëmijëve, të bëhen sqarime më të qarta dhe jo në formë të ligjërit apo edhe vetëm të leximit të sllajdeve në ekran”, (prind i një fëmije në arsim fillor, fshat- komuna e Drenasit).*

Disa prej prindërve kanë vërejtjet e tyre edhe për format tjera të mësimi në distancë/e-mësimin, që ofrohen nga mësimdhënësit e shkollës.

*„Mësimi online ka qenë i duhur në këtë situatë, mirëpo asnjëherë nuk e zëvendëson mësimin në klasë. E keqja e kësaj është se shumë mësimdhënësit nuk po angazhohen më shumë, përveç kontrollimit të detyrave”, (prind i një fëmije në arsim fillor, qytet Obiliq).*

Përveç kësaj, prindërit që kanë fëmijë me nevoja të veçanta pohojnë se fëmijët e tyre po mundohen të marrin pjesë në mësim, por e kanë të vështirë të përcjellin orët e mësimi që shfaqen në RTK, për shkaqe të ndryshme. Njëri nga prindërit shprehet se fëmija i tij ka probleme me shikimin dhe e ka të pamundur t’i kuptojë të gjitha vetëm me të dëgjuar, pasi i mungon edhe materiali, si: monitori zmadhues, laptopi etj. (prind i një fëmije në arsim fillor, një në arsim të mesëm të ulët dhe një në arsim të mesëm të lartë, gjimnaz, qytet- Prishtinë).

Prindërit e fëmijëve parashkollorë/parafillorë mendojnë se është shumë herët të përgjigjen për platformën online të edukimit të hershëm, sepse ka vetëm disa ditë që shfaqet në platformë.

Ka prindër që mendojnë se kjo formë e mësimi duhet të vazhdojë të praktikohet edhe në të ardhmen, përveç mësimi në shkolla.

*„Do të ishte mirë që kjo formë e mësimi të aplikohet edhe më tutje”, (prind i një fëmije në edukim parafillor, një fëmijë në arsim fillor, fshat – komuna- Ferizaj).*

Sipas prindërve, orët mësimore në RTK po u ndihmojnë fëmijëve të largojnë vëmendjen nga gjendja e pandemisë Covid 19, sepse po përqendrohen në mësim.

*„Po i bëjnë fëmijët të largojnë mendjen nga kjo situatë që ndodhemi, gjithashtu po i largojmë nga kjo monotoni”, (prind i katër fëmijëve, nga një në secilin nivel të arsimit, qytet- Ferizaj).*

Prindërit mendojnë se për lëndët që shfaqen në RTK nuk është shumë problem, sepse aty po marrin informata, por për lëndët që nuk shfaqen në RTK janë problematike, sepse as fëmijët nuk i marrin seriozisht, të angazhohen vetë për ato, dhe mund të kenë ngecje.

*„Për lëndët që po jepen mësimet në e-mësimi është në rregull, ndërsa për lëndët tjera kam frikë se do të mbesin mbrapa”, (prind i një fëmije në arsim parafillor, dy fëmijë në arsim fillor dhe një fëmijë në arsim të mesëm të ulët, qytet- Podujevë).*

Lidhur me atë se sa po u ndihmojnë fëmijëve në të nxënë format e tjera të punës që po organizohen nga mësimdhënësit, shumica e prindërve mendojnë se këto forma të mësimi online po ndihmojnë shumë dhe për këtë meritat iu atribuojnë mësimdhënësve, si për angazhimin ashtu edhe për motivimin dhe përkrahjen e fëmijëve.

*„Gjithçka është përshtatur shumë mirë, në këtë situatë të vështirë, në të cilën ndodhemi. Të paktën për fëmijët të mësuarit po vazhdon shumë mirë dhe meritat kryesore u takojnë mësimdhënësve, të cilët i udhëzojnë, përkrahin, motivojnë fëmijët në çdo mënyrë për të vazhduar me mësimet”, (prind i një fëmije në arsim fillor, shkollë private, qytet-Prizren).*

*„Edhe takimet online me mësuesen po i ndihmojnë shumë, si në mësim edhe në aspektin moral e psikik të fëmijës gjatë përballimit të kësaj situate”, (prind i një fëmije në arsim fillor, një fëmijë në arsim të mesëm të lartë, qytet-Prishtinë).*

Nuk është i vogël as numri i prindërve që mendojnë se deri diku po ndihmojnë mësimdhënësit dhe se përdorimi i platformave po i mobilizojnë në masë të madhe në të nxënë fëmijët e tyre.

*„Fëmijët po angazhohen, mësimdhënësit po kanë mundësi t'i përcjellin secilin gjatë orëve mësimore, përmes videokamerave, si pjesëmarrjen ashtu edhe angazhimin. Mandej komunikimi direkt me mësimdhënësit po u jep mundësi nxënësve të sqarojnë çdo dilemë që kanë. Detyrat e shtëpisë jepen vetëm në rast se janë të domosdoshme, por edhe për të nxënësit po kanë mundësi të kërkojnë sqarime përmes grupit të klasës me mësimdhënësit”, (prind i një fëmije në edukim parafillor dhe një fëmijë në arsim fillor, qytet-Prishtinë).*

*„Nëse nuk do ishin edhe udhëzimet e mësimdhënësitve, fëmija im nuk do i kuptonte njësitet mësimore”, (prind i një fëmije në arsim fillor, dy fëmijëve në arsim të mesëm të ulët dhe një në arsim të mesëm të lartë, qytet-Podujevë).*

Ngarkesa e fëmijëve duket të jetë është shumë problem, sidomos për fëmijët që i kanë prindërit të punësuar, që domosdo duhet të jenë në punë dhe që kanë disa fëmijë në shtëpi, e që nuk mund t'i ndihmojnë në mësim.

*„Fëmijët janë shumë të ngarkuar, sidomos këta që i kanë të dy prindërit e punësuar dhe i kanë disa fëmijë në shkollë”, (prind i një fëmije në edukim parafillor, dy fëmijë në arsim fillor, fshat- Mitrovicë).*

Nga prindërit ka edhe disa ankesa se mësimdhënësit nuk po bëjnë sa duhet për të ndihmuar fëmijët në të nxënë, duke shfrytëzuar vetëm RTK dhe që pranojnë detyra të fëmijëve të gatshme, pa dhënë shpjegime të nevojshme.

*„Do të ishte mirë që edhe mësimdhënësit të dërgonin nga një video, duke shpjeguar detyrat që kanë për të bërë fëmijët, sepse me të vërtet më shumë mund të them se jemi duke u marrë ne prindërit gati me gjithçka dhe mësimdhënësit gjithçka po iu shkon e gatshme”, (prind i një fëmije në edukim parafillor dhe një në arsim fillor, qytet-Ferizaj).*

*„Një numër i madh i profesorëve nuk komunikojnë fare me nxënësit, vetëm bëjnë foto të njësive mësimore, ndërsa nxënësit i ngarkojnë me detyra. Këto detyra janë të paqarta përderisa nuk gjejnë mundësi të caktojnë takime online për të sqaruar paqartësitë e nxënësve. Shumica nga profesorët ankohen se nuk kanë kohë për t'u marrë me ta”, (prind i një fëmije në shkollë të mesme të lartë, qytet-Prishtinë).*

Nga prindërit ka ankesa edhe lidhur me përdorimin e teknologjisë, por edhe me qasjen e mësimdhënësve gjatë komunikimit me nxënësit, si p.sh.

*“Në klasën e parë, ku vajza ime vijon mësimet, është për të ardhur keq. Mësuesja se ka idenë e shfrytëzimit të platformës Zoom, nuk ka formë të organizimit të orës mësimore, tingëllon ashpër e fare profesioniste, nuk merr iniciativa për të bërë ndonjë lojë, kuiz apo edhe çfarëdo aktiviteti që do i angazhonte fëmijët”, (prind i dy fëmijëve në arsimin fillor, qytet-Prishtinë).*

Nga prindërit ka edhe kërkesa që të prezantohen edhe informata se si të punojnë prindërit me fëmijët. Kështu shprehet një prind:

*“Prezantoni një kurs edhe për prindërit si me u sjell me fëmijë”,(prind i një fëmije në parafillor, një fëmije në arsim të mesëm të ulët, fshat- Podujevë).*

Lidhur me atë se si e vlerësojnë prindërit interesimin dhe angazhimin e fëmijëve të tyre për këtë formë të mësuarit, shumica e prindërve interesimin dhe angazhimin e fëmijëve për mësimin në distancë e vlerësojnë të mirë (42.6%), në nivel të lartë (33.5%), në nivel shumë të lartë (19.6%), ndërsa një numër i vogël i prindërve interesimin dhe angazhimin e fëmijëve të tyre për këtë formë të mësuarit e vlerësojnë të ulët (3.2%) apo tejet pasiv (1.1%).

Arsyetimin për këtë vlerësim prindërit e lidhin me angazhimin e fëmijëve dhe shpesh e lidhin edhe me angazhimin e tyre si prind, që i qëndrojnë afër dhe i ndihmojnë fëmijëve. Ka edhe prindër që e vlerësojnë interesimin e vetë fëmijëve, por ka edhe të atillë që mendojnë se duke qenë në kushte të tilla çfarë jemi, fëmijët nuk po mund të mësojnë si duhet, duke i marrë si obligative vetëm kryerjen e detyrave, e në përmbajtje nuk thellohen sa duhet.

Sipas disa prindërve, mësimi në distancë është formë e re, ndryshim i cili u ka sjellë interes të madh fëmijëve, ka ndihmuar të largojnë ngarkesën e fëmijëve dhe familjarëve nga gjendja e pandemisë.

*„Në përgjithësi fëmijëve po u duket relaksuese dhe interesante kjo formë”, (prind i një fëmije në arsim fillor, dy fëmijëve në arsim të mesëm të ulët, qytet-Prishtinë).*

*„Me pa durim presin të dëgjojnë mësimin online dhe t’i zbatojnë rregullat e detyrave, të cilat mësueset ua ofrojnë”, (prind i një fëmije në edukim parafillor, dy fëmijëve në arsim fillor, qytet-Mitrovicë).*

Ka edhe prej prindërve të cilët nuk janë në gjendje të vlerësojnë angazhimin e fëmijëve, për shkak të pamundësisë së përcjelljes së tyre.

*„Meqë jam i angazhuar shumë në punë, nuk jam i sigurt që fëmija im i kryen 100% me përgjegjësi obligimet e tij. Mund të më ikën diçka edhe unë nuk mund ta kontrolloj 100%”, (prind i një fëmije në arsimin fillor, një fëmije në arsim të mesëm të ulët, qytet- Dragash).*

Ndërsa, një pjesë e prindërve vlerësojnë se angazhimi i fëmijëve të tyre është i ulët, për shkak të ngarkesës së madhe me detyra, por edhe për shkak të vështirësive për t’u adaptuar me këtë formë të mësimdhënies.

*“Fëmija im kryesisht mendjen e ka në zgjidhjen e problemeve apo detyrave me të cilat ngarkohet, por jo edhe vullnetin për t’i përcjellë me pasion ato”, (prind i një fëmije në arsim fillor, fshat- komuna e Drenasit).*

Vlen të theksohet se prindërit kanë paraqitur angazhimin e fëmijëve edhe stresues, rreth detyrave, kohës për t’i dërguar, për t’i fotografuar etj., sidomos tek angazhimet e fëmijëve në nivelin parafillor dhe në arsimin fillor.

*„Angazhim i madh për ta, sidomos vajzën që e kam në parafillor shumë problem po e kam me angazhu, sepse ka shumë stres dhe s’ka aspak dëshirë t’i bëjë foto apo video gjatë mësimit”, (prind i një fëmije në edukimin parafillor dhe një fëmije në arsim të mesëm të ulët, fshat- komuna e Ferizajt).*



*„Ka interesim konstant, edhe pse janë prezent edhe intervalet stresuese nga volumi i detyrave”, (prind i një fëmije në arsim fillor, qytet, Mitrovicë).*

Lidhur me bashkëpunimin e prindërve me mësimdhënës në këtë qasje të re në mësimdhënie, mësimi në distancë /e-mësimi nga shtëpia, prindërit pohojnë se mësimdhënësit çdo ditë e më shumë po bashkëpunojnë me ta dhe me nxënës (40.2%), mësimdhënësit janë mobilizuar shumë dhe po e japin maksimumin në këto rrethana (35%), por ka edhe prindër që nuk janë të kënaqur me bashkëpunimin, se deri diku po bashkëpunojnë mësimdhënësit (15.6), se pak kanë mundësi për bashkëpunim (5.7%), apo edhe fare pak mundësi bashkëpunimi (3.6%).

Kërkesat e prindërve më të shpeshta për mësimdhënës, sa i përket mësimdhënies, materialeve, punës me nxënës etj., dalin të jenë sqarimet për detyrat që dalin nga orët mësimore që prezantohen në RTK, informatat kthyesë për detyrat e shtëpisë, udhëzime rreth punës me nxënës. Ndërsa, numër më i vogël i prindërve pohojnë se kërkojnë shpjegimin e njësive të reja mësimore dhe detyra të reja për nxënës. Kjo në shumë raste arsyetohet me faktin se një pjesë relativisht e madhe e prindërve nuk janë të familjarizuar me programet mësimore dhe nuk janë shumë të përgatitur për t'i ndihmuar gjithherë fëmijët e tyre në detyra.

Edhe sipas udhëzuesit të nxjerrë nga Banka Botërore: *Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID-19*, kërkohet që të krijohet mundësi e komunikimit të dyanshëm, informata kthyesë për detyrat dhe përgjithësisht mësimet gjatë mësimi në distancë nëpërmjet transmetimeve televizive. Gjithashtu, edhe mënyra se si përcaktohen detyrat për nxënës, përmes orëve mësimore që transmetohen në RTK, kërkon që mësimdhënësit të mbajnë kontakte me nxënës, por edhe me prindër lidhur me detyrat e shtëpisë, si dhe për detyrat e shtëpisë të ofrojnë informata kthyesë. Prindërit dhe fëmijët e tyre kanë nevojë që të marrin informata kthyesë më të detajuara për detyrat që i dërgojnë te mësimdhënësit, sepse shpeshherë nuk e kanë të qartë a janë kryer detyrat si duhet, sepse vlerësimi i mësimdhënësve është sipërfaqësor.

*“Arsimtarët duhet të sqarojnë detyrat që u jepen nxënësve. Kur nxënësit t'i dorëzojnë detyrat, mësimdhënësit duhet të kthejnë përgjigje nëse janë apo*

*nuk janë mirë, aty ku si kanë mirë me u dhënë sqarime se si janë”, (prind i një fëmije në arsim fillor, një fëmije në arsim të mesëm të ulët, qytet-Prishtinë).*

Krahas mbështetjes që bëjnë mësimitdhënësit për nxënës, nëpërmjet informatave kthyesë për detyrat dhe aktivitetet tjera mësimore gjatë mësimit në distancë, të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe prindërit, në mënyrë që të mbështesin të nxënit e nxënësve, njëkohësisht prindërit duhet të krijojnë kushte të përshtatshme, të cilat nxisin fëmijët të mendojnë rreth temave mësimore që mësohen gjatë mësimit në distancë, rëndësisë së tyre dhe lidhjen me jetën.

Duke marrë parasysh situatën, prindërit sugjerojnë që mos të ngarkohen shumë fëmijët me mësim dhe me detyra. Kjo mund të tejkalohet duke i përcjellë mësimitdhënësit me kujdes detyrat që u jepen nxënësve nga orët mësimore që transmetohen në RTK dhe duke bashkëpunuar me kolegët e aktivitetit profesional.

*„Mendoj që në këto rrethana, ngarkesa me detyra të shtëpisë duhet të jetë më e ulët. Përveç mësimëve që shfaqen në RTK, përmes platformave online janë angazhuar edhe arsimtarët e lëndëve të tjera (të cilat nuk shfaqen në RTK), dhe vërtet kjo është ngarkesë e madhe për fëmijët.”, (prind i një fëmije në arsim fillor, një në arsim të mesëm të ulët, qytet-Prishtinë).*

### **Mundësitë e vazhdimit të zbatimit të mësimit në distancë sipas prindërve dhe nevojat për mbështetje të nxënësve**

Prindërit e përfshirë në hulumtim gjithashtu dhanë opinionet e tyre edhe lidhur me mundësitë e zbatimit të mësimit në distancë/E-mësimit dhe nevojat për mbështetje të nxënësve. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se për prindërit, procesi i mësimit në distancë /E-mësimit është një përvojë e re që duhet përkrahur (53.1%) dhe një mundësi shumë e mirë që mund të shndërrohet në një formë standarde të mësimit në distancë (25.1%). Sipas prindërve, përveç që është një përvojë e mirë, fëmijët do kenë rast të mësohen më herët që në rrethana të vështira të mundohen të gjejnë informata dhe të plotësojnë boshllëqet e mbetura, të jenë më të pavarur dhe të zgjerojnë

diapazonin e tyre. Gjithashtu, prindërit e shohin si mundësi dhe si përvojë e re në komunikimin mësimdhënës-nxënës.

Ka edhe mendime se kjo formë e mësimit në distancë duhet të përmirësohet (12.6%).

*“Për momentin është sa për të mos humbur vitin, por nëse vazhdon mendoj se ka nevojë të përmirësohet. Mendoj se duhet të kalojnë më shumë kohë në Zoom ose në Google clasroom bashkë me mësimdhënësit”, (prind i dy fëmijëve në arsimin fillor dhe një fëmijë në arsimin e mesëm të ulët, Podujevë).*

Disa prindër mendojnë se kjo formë deri diku i ngjan mësimdhënies (6.5%), por ka edhe opinione të prindërve se kjo formë fare nuk i ngjan mësimdhënies (2.2%), por *“shërben... fëmijët përfitojnë gjëra të reja në lëmi të caktuara. Edhe pse mësimin e rregullt nuk mund të zëvendësoj mësimi online prapëseprapë jam i kënaqur me këtë mësim”, (prind i tre fëmijëve në një fshat të Podujevës).*

Sipas prindërve, përfitimet e fëmijëve nga mësimi në distancë janë të shumta, por si më të rëndësishmet, sipas tyre, janë:

- Angazhimi i fëmijëve me detyra dhe përmbajtje mësimore;
- Largimi i vëmendjes nga situata aktuale pandemike;
- Përvetësim/rritje e shkathtësive të nxënësve për përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe aplikacioneve elektronike për e-mësimin;
- Përfitimi i shkathtësive dhe shprehive edhe për forma tjera të mësimit, përveç mësimit në klasë.

Prindërit mendojnë se përmes mësimit në distancë fëmijët bëhen më të pavarur, punojnë pa praninë e mësimdhënësve, bazohen në forca të veta pa prituri ndihmë nga të tjerët.

*“Do të ketë përfitime mjaft të mëdha, sepse mësimi online po u jep informacione të ndryshme dhe të kuptueshme”, (prind i dy fëmijëve në arsimin e mesëm të ulët, Podujevë).*

Prindërit janë falënderues për organizimin e mësimit në distancë. *“Duke falënderuar Ministrinë e Arsimit që për një kohë kaq të shkurtër na*

*mundësoj mësim online për fëmijët tanë në këtë fazë të pandemisë, një mësim me benifite mesatarisht të mira dhe shumë interesante, duke e ditur se në një të ardhme të afërme mësimi online do të jetë realitet”, (prind i dy fëmijëve në arsimin e mesëm të ulët në një fshat të Podujevës).*

Me gjithë vlerësimet pozitive të prindërve, theksohet edhe nevoja për mbështetje, për realizimin e mësimin në distancë.

Për nivelin parafillor prindërit i shohin si të nevojshme:

- dërgimin e detyrave (aktiviteteve) dhe përmbajtjeve mësimore me e-mail;
- informatat kthyese për detyrat (aktivitetet) e bëra nga fëmija;
- komunikimin e përditshëm përmes rrjeteve sociale;
- udhëzimet për prindër për punë me fëmijët në shtëpi.

Për nxënësit e nivelit fillor dhe arsimin të mesëm të ulët prindërit mendojnë se gjatë mësimin në distancë duhet:

- të bëhet dërgimi i detyrave dhe përmbajtjeve mësimore përmes platformës që fëmija di ta përdorë (në disa raste kërkohet edhe me e-mail);
- të jepen informata kthyese nga mësimdhënësi për detyrat e nxënësve;
- të ketë komunikim të përditshëm përmes rrjeteve sociale, si dhe
- udhëzime për prindër, për punë me fëmijët në shtëpi.

Për mësimin në distancë me nxënësit e arsimin të mesëm të lartë, prindërit mendojnë se janë të nevojshme:

- Publikimi i materialeve mësimore në një platformë ku kanë qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) të lehtë për përdorim;
- Komunikimi i përditshëm përmes rrjeteve sociale;
- Dërgimi i detyrave me e-mail nga mësimdhënësit;

- Informatat kthyesë nga mësimdhënësit, për detyrat e bëra nga fëmija;
- Udhëzimet për prindër, për punë me fëmijët në shtëpi.

Përveç kësaj, prindërit mendojnë se është e nevojshme të ofrohet më shumë mbështetje për mësimdhënësit, sidomos për mësimdhënësit më të vjetër në moshë, të cilët po kanë vështirësi në përdorimin e teknologjisë mësimore, e po ashtu edhe mbështetjen e prindërve për t'i ndihmuar fëmijët e tyre.

Prindërit e nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sugjerojnë për një platformë, ngase, sipas tyre, nëse vazhdohet herë me RTK e herë me Google classroom fëmijët do ta humbin shumë shpejt interesimin.

Prindërit kanë edhe kërkesa lidhur me mësimin në distancë, si për mësimet që shfaqen në RTK, ashtu edhe me sigurimin e pajisjeve teknologjike dhe përdorimin e platformave elektronike. Kërkesat e prindërve për mësimet që shfaqen në RTK kryesisht lidhen me qartësinë e sqarimeve nga ana e mësimdhënëseve, përdorimin e drejtë të gjuhës, fokusin te fëmija, jo te shpjegimi i madh i përmbajtjeve etj.

Ka edhe kërkesa të prindërve lidhur me sigurimin e pajisjeve teknologjike, për shkak të numrit të fëmijëve në familje dhe pamundësisë së sigurimit të pajisjeve për secilin... *“Na ndihmoni me ndonjë tablet, për shkak që unë jam nënë e pesë fëmijëve dhe e kam të vështirë sigurimin e teknologjisë për secilin”*, (prind, Prishtinë).

Përdorimi i platformave të ndryshme me fëmijë duket si ngarkesë për prindërit dhe fëmijët e tyre. Prindërit bëjnë thirrje të mos i ngarkojnë shumë fëmijët: Zoom, Google classroom, mësimi në RTK, detyrat e dhëna nga arsimtarët... Por, nga ana tjetër ka prindër të cilët kërkojnë që fëmijët të mos kufizohen që detyrat t'i dërgojnë vetëm me e-mail ose Google classroom, por edhe me Viber dhe forma tjera, sepse *“pamundësia e dërgimit të detyrave në format e sipër cekura po shkakton panik dhe stres te fëmijët”*, (prind i dy fëmijëve në arsimin e mesëm të ulët, Prishtinë).

## **Përfundime dhe rekomandime**

**Përfundimet kryesore**, mbi bazën e gjetjeve të studimit lidhur me mësimin në distancë/e-mësimin nga perspektiva e prindërve, janë si në vijim:

- Prindërit tanimë kanë informata për realizimin e mësimin në distancë, e për këtë ata janë informuar nga aktorë të ndryshëm. Për organizimin dhe realizimin e mësimin në distancë prindërit janë informuar nga mësimdhënësit/kujdestarët e klasës së fëmijës dhe mediat, ndërsa pak kanë informata nga DKA-të dhe MASHTI. Informacionet që i kanë prindërit kryesisht lidhen me orarin e mësimëve dhe transmetimin e orëve mësimore në RTK.
- Orët mësimore që po shfaqen në RTK, në masë të madhe, po i përcjellin me përkushtim fëmijët, e më pas nga mësimdhënësit përmes aplikacioneve elektronike po jepen detyra dhe sqarime shtesë. Orët mësimore që po shfaqen në RTK po i ndihmojnë në masë të madhe fëmijët, por sipas prindërve ka vend për përmirësime, si në mënyrën e ligjërimit, qartësisë së informacionit, gabimeve të shumta të mësimdhënësve dhe mospërfshirjes së të gjitha lëndëve;
- Sipas prindërve, fëmijët kalojnë rreth një orë duke i përcjellë orët mësimore në RTK, 1-2 orë me angazhim dhe detyra të dhëna nga mësimdhënësi (mësim online), 1-2orë mësim me mbështetje të prindërve/familjes, si dhe rreth një orë mësim të pavarur, të organizuar nga vetë fëmijët;
- Jo të gjithë fëmijët i përcjellin orët mësimore që po shfaqen në RTK, për shkak se nuk ka përputhje në planifikim dhe mësimdhënësit kanë gjetur forma tjera të mësimin në distancë. Për mësimin në distancë nga mësimdhënësit po përdoren aplikacione dhe platforma të ndryshme, por në masë më të madhe mësimdhënësit po përdorin Viber, Zoom dhe Google classroom;
- Përdorimi i platformave të ndryshme nga mësimdhënësit po sjell telashe për fëmijët, për shkak të pajisjeve teknologjike dhe mungesës së informacioneve për përdorimin e tyre. Për

përballimin e vështirësive, nxënësit po ndihmohen nga prindërit, mësimdhënësit dhe familjarë të tyre;

- Mungesa e teknologjisë, numri i madh i fëmijëve për shfrytëzimin e teknologjisë që posedojnë në shtëpi si dhe vështirësitë në përdorimin e platformave po e kushtëzohet edhe ofrimin e ndihmës nga prindërit për fëmijët e tyre;
- Prindërit nuk kanë marrë udhëzime se si të punojnë me fëmijët e tyre në shtëpi. Po ashtu mungon edhe bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindër. Komunikimet mes tyre janë të rralla e edhe kur ka kryesisht bëhen me grupet e prindërve në aplikacione të ndryshme, që përdoren për dërgimin e detyrave për nxënës, por jo edhe për informata e udhëzime tjera;
- Prindërit janë të shqetësuar edhe për orarin e mësimëve, sidomos për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë. Nxënësit gjatë ditës kalojnë më shumë kohë në detyra të shtëpisë sesa në angazhimet tjera;
- Mësimi në distancë është një përvojë e re, që duhet përkrahur, dhe një mundësi e mirë, e cila mund të shndërrohet në një formë standarde të mësimin në distancë;
- Nxënësit kanë nevojë për mbështetje. Do t'u ndihmonte shumë publikimi i materialeve mësimore në një platformë standarde të komunikimit, në të cilën kanë qasje të gjithë (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) të lehta për përdorim. Prindërit e shohin si të nevojshëm publikimin e video-ligjëratave, udhëzimeve, detyrave dhe ushtrimeve në një platformë të strukturuar mirë;
- Për nxënësit dhe prindërit e tyre ende nuk ka informata kthyesë nga mësimdhënësit lidhur me angazhimin e fëmijëve në mësim. Informata kthyesë nuk ka as për detyrat e shtëpisë, të cilat nxënësit i dërgojnë përmes aplikacioneve e platformave të ndryshme të mësimdhënësve të tyre, dhe kjo po shkakton hutitë të nxënësve, si dhe rënie të interesimit për mësimin në distancë.

**Rekomandimet kryesore** për realizimin e mësimit në distancë, referuar gjetjeve kryesore nga perspektiva e prindërve, janë si në vijim:

- Prindërit t'u përmbahen udhëzimeve të MASHTI-it, që gjatë mësimit në distancë të jenë shumë më të angazhuar me fëmijët sesa gjatë mësimit të rregullt;
- Mësimdhënësit të bashkëpunojnë me prindër dhe të ofrojnë edhe informata kthyesë për angazhimin dhe detyrat e nxënësve. Të kenë kujdes në ngarkesën e nxënësve me detyra të shtëpisë. Fokusi të jetë në udhëzime dhe sqarime të përmbajtjeve mësimore;
- Shkollat të japin informacione me kohë për prindër dhe t'i shpërndajnë ato në faqet zyrtare të shkollave dhe përmes mësimdhënësve që organizojnë mësim në distancë;
- DKA-të të mbikëqyrin procesin e mësimit në distancë dhe të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për mësimdhënësit për realizimin e mësimit;
- MASHTI të hartojë udhëzues edhe për prindër, për punën me fëmijët e tyre gjatë mësimit në distancë, si dhe të përgatisë dhe të lansojë platformë unike elektronike për mësimin në distancë edhe për nivelin fillor dhe arsimin e mesëm.



### **3.6. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E QENDRAVE BURIMORE**

Sahare Reçica - Havolli

Qendrat Burimore (QB) janë institucione edukativo-arsimore, funksioni i së cilave është edukimi dhe arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe mbështetja e shkollave të rregullta, të cilat përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore (MASHTI. UA 23/2013). Pas situatës së krijuar të pandemisë me COVID-19, sikurse edhe të gjitha institucionet tjera edukativo-arsimore në Kosovë, edhe QB iu përgjigjën vendimit të MASHTI (Vendimi 01/07 të datës 11.03.2020) për zbatimin e mësimit në distancë. Mirëpo, duke u bazuar në specifikat e Qendrave Burimore, si dhe specifikat individuale të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, më vonë, më 14 prill 2020, MASHTI ka nxjerrë një udhëzim tjetër të veçantë, i cili specifikon organizimin e mësimit dhe mbështetjes së Qendrave Burimore nga distanca, duke përdorur platformat elektronike. Njëkohësisht, MASHTI paralajmëron se Divizioni për Arsim Gjithëpërfshirës do të bëjë koordinimin e mësimit në distancë në bashkëpunim me DKA, Qendra Burimore dhe partnerët tjerë. (MASHTI,2020e).

Nisur nga specifikat e Qendrave Burimore, në këtë studim kemi pasur një fokus të veçantë për mësimin në distancë në këto qendra, me qëllim të marrjes së informatave dhe perceptimeve të komunitetit të qendrave për mundësitë e realizimit të mësimit në distancë, sfidat dhe nevojat për realizimin me sukses të mësimit në distancë. Respondentët e hulumtimit janë: 5 drejtorë, 11 mësime dhënëse, 5 mësime dhënëse udhëtues dhe 10 prindër, ndërsa instrumentet e hulumtimit (pyetësorët e anketës dhe pyetësorët e intervistës) u janë përshtatur specifikave të Qendrave Burimore.

#### **Mësimi në distancë/e-mësimi para situatës së krijuar me COVID-19 në Qendrat Burimore**

Mësimi në distancë kushtëzohet nga mundësitë e përdorimit të mjeteve dhe platformave të ndryshme të teknologjisë informative dhe komunikimit

(TIK), andaj është e rëndësishme njohja e kapaciteteve të shkollës për mundësitë e realizimit të këtij procesi.

Sipas deklaratave të drejtorëve dhe mësimeve, vetëm dy nga pesë drejtorët e Qendrave Burimore dhe rreth 27.3 % mësimeve të përfshirë në hulumtim janë të certifikuar në ndonjë program trajnimi për përdorimin e TIK në mësime apo mësime në distancë, por ata, gjithashtu, kanë deklaruar se në shkollën e tyre nuk kanë informata se ndonjëherë është përdorur ndonjë platformë me përmbajtje të mësimit online. Ndërsa, për komunikim me nxënësit dhe prindërit e tyre edhe para situatës me Covid -19, mësimeve kanë deklaruar se kanë përdorur aplikacionet Viber, Mesingjer, e-mail, Whatsapp. Këto aplikacione, sipas tyre, janë përdorur për prezantimin e video-incizimeve të lidhura me përmbajtjet mësimore, këshillim të nxënësve për detyra mësimore, dërgim të përmbajtjeve mësimore dhe detyrave të përshatura për nxënësit me dëmtime në të parë.

Ndërsa, për mundësitë e përdorimit të mësimeve kanë deklaruar se i përdorin me lehtësi një ose disa platforma (54.5%), me pak vështirësi (18,1%), dhe se janë shumë pak të përgatitur për ta përdorur vetëm një platformë (27.3 %).

### **Informimi i Qendrave Burimore për organizimin e mësimit në distancë /e-mësimit, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19**

Për organizimin e mësimit në distancë – si një proces i ri në qendrat burimore, pa dyshim se rol të rëndësishëm kishte edhe informimi i aktorëve relevant – zbatuesve të këtij plani: drejtorëve, mësimeve, prindërve dhe nxënësve.

Drejtorët kanë deklaruar se janë informuar nga MASHTI për organizimin e mësimit në distancë, me ç'rast kanë marrë informacione të plota dhe praktike për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si: për punën me mësimeve, nxënësit dhe prindër, si dhe për mënyrat dhe format e punës, mundësitë e realizimit të programit mësimor, orarin e orëve mësimore në RTK (për nxënësit të cilët mund ta përcjellin dhe përfitojnë), etj. Gjatë intervistimit, drejtorët kanë deklaruar se pastaj ata kanë kontaktuar dhe informuar mësimeve dhe të

gjithë stafin profesional të shkollës për t'i ftuar në përgjigje të detyrave të tyre dhe për t'i udhëzuar e konsultuar për mënyrën e realizimit të mësimit në distancë. Po ashtu, drejtorët kanë deklaruar se në vazhdimësi mbajnë takime të rregullta, të përbashkëta apo grupe përmes platformave online me mësime të ndërmjetme, prindër, nxënës; komunikojnë me MASHTI-in dhe përgatisin raporte të përmbledhura nga raportet javore, të cilat i përgatisin mësime të ndërmjetme.

Për mënyrën e informimit për fillimin e mësimit në distancë janë deklaruar edhe mësime të ndërmjetme. Gati të gjithë janë shprehur se informatat më të plota dhe praktike i kanë marrë nga udhëheqësi i shkollës, por edhe nga MASHTI, kryetari i aktivitetit profesional apo kolegët, ndërsa më pak nga mediumet dhe të tjerët. Sipas mësime të ndërmjetmeve, informatat e marra ishin: për detyrat dhe përgjegjësitë në punën me nxënës dhe prindër (54,5%); për orarin e orëve në RTK (36.3 %); për mënyrën dhe format e punës me nxënës dhe prindër (36.3%); për mundësitë e realizimit të plan-programit (9.1%); për çdo gjë, jemi konsultuar me stafin e qendrës dhe ekipin bërthamë kanë deklaruar (9.1%).

Po ashtu, rreth informimit të tyre për mësimin në distancë janë pyetur edhe prindërit gjatë intervistimit. Pjesa më e madhe e prindërve kanë deklaruar se kanë marrë informata të plota nga mësime të ndërmjetme i klasës apo kujdestari dhe mësime të ndërmjetme të lëndorë, ndërsa një pjesë e tyre janë shprehur se janë informuar edhe nga drejtori i QB, MASHTI dhe nga mediumet.

*Një prind, i cili ka dy fëmijë me nevoja të veçanta deklaroi: Vajza nga Qendra Burimore në të cilën vijon mësimin ka marrë informata të plota dhe madje „të ëmbla” dhe vazhdon të marrë për çdo ditë nga mësime të ndërmjetme e saj, ndërsa për djalin(po ashtu me nevoja të veçanta), i cili vijon shkollën e rregullt profesionale, nuk ka kurrfarë informate për mësimin në distancë e as kontakt nga shkolla.*

Prindërit kanë deklaruar se nga QB (kujdestari, mësime të ndërmjetme, drejtori) janë informuar: për mënyrën dhe orarin e realizimit të mësimit në distancë (60%); për orarin e orëve mëimore që shfaqen në RTK (40%); për rolin e prindërve më fëmijë gjatë mësimit në distancë (60%), për mënyrën dhe orarin e

konsultimeve me mësime të mësimdhënës (70%); për detyrat mësimore për nxënës (60%).

*'Para fillimit të transmetimi në RTK, kemi filluar të komunikojmë përmes Viberit me drejtorin, arsimtarët, kujdestarin e klasës, pastaj secili arsimtar ka formuar grupin e vet dhe jemi kyçur në proces', ndërsa një prind tjetër shprehet se edhe në ueb-faqe të shkollës i marrim të gjitha informatat e nevojshme, deklaroi një prind.*

Drejtorët e Qendrave Burimore kanë deklaruar se mësime të mësimdhënës janë udhëzuar të formojnë dosjet e nxënësve me detyrat, të cilat i dërgojnë tek mësime të mësimdhënës. Sa i përket zbatimit të këtij udhëzimi, janë shprehur se janë duke e praktikuar pjesa më e madhe e mësime të mësimdhënësve.

### **Fillimi i mësimit në distancë/e-mësimit, si përgjigje ndaj situatës së krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19**

Për shkak të pandemisë COVID-19, ndërprerja e mësimit në shkolla dhe vendimi për mësime nga distanca ishte një situatë e re e paparashikuar për të gjithë aktorët e shkollave, por, sipas gjetjeve të hulumtimit, shumica nga ta fillimin e këtij procesi e kanë pritur me qetësi, interesim, gatishmëri për angazhim dhe se edhe janë mobilizuar për punë - kështu kanë deklaruar të gjithë drejtorët, por edhe 63.6% e mësime të mësimdhënësve dhe 50% e prindërve. Ndërsa, me pak apo deri diku me shqetësim, stres dhe frikë apo edhe mobilizim e kanë pritur 36.3% e mësime të mësimdhënësve dhe 30% të prindërve. 20% e prindërve deklaruan se e kanë pritur me shumë shqetësim, stres dhe frikë. 3 drejtorë, 45 % e mësime të mësimdhënësve dhe rreth 40% e prindërve kanë deklaruar se mësime në distancë ka filluar që nga java e parë pas ndërprerjes së mësimit. Të tjerët (drejtorë, mësime të mësimdhënës dhe prindër) kanë deklaruar se mësimin e kanë filluar nga dita kur kanë filluar të shfaqen orët mësimore në RTK. Fillimisht janë iniciuar kontaktet, pastaj janë planifikuar dhe realizuar takimet mësime të mësimdhënës - prindër dhe përmes tyre duke i angazhuar nxënësit.

Edhe mësime të mësimdhënësit udhëtues\* (shih masht.2017/08) kanë deklaruar se janë informuar për vazhdimin e realizimit të detyrave të tyre për mbështetje të mësime të mësimdhënësve të shkollave të rregullta, të cilët kanë përfshirë nxënës me nevojë të veçanta në klasat e tyre, mësime të mësimdhënësve mbështetës, asistentëve,

prindërve dhe nxënësve, të cilët ata i kanë në listat e tyre të mbështetjes, përmes platformave elektronike.

Për realizimin e mësimit në distancë, sipas gjetjeve, janë duke u përdorur disa aplikacione nga mjetet elektronike. Aplikacionet të cilat janë duke u praktikuar në masë më të madhe, sipas mësimitdhënësve dhe prindërve është Viber (mbi 80%), por edhe Facebook-u, Mesingjer, ndërsa më pak Watsap, Skype, e-mail, dhe Zoom. 18.1 % e mësimitdhënësve kanë deklaruar se e përdorin edhe kamerën në grup përmes këtyre platformave. Se i përdorin Facebook, Mesingjer dhe Zoom, por edhe format tjera, janë deklaruar edhe mësimitdhënësit udhëtues.

Ndërsa, nga pajisjet e komunikimit për realizimin e mësimit në distancë mësimitdhënësit kanë deklaruar se e përdorin telefonin e mençur (45.4%), telefonin e mençur dhe laptopin (36,3%), dhe laptopin (18.1%). Po ashtu, të gjithë kanë deklaruar se kanë lidhje wireless në shtëpi gjatë gjithë kohës, ndërsa edhe internet në telefon 3G dhe 4G –rreth (18.1%).

Kurse, për orarin e mësimit, rreth 91.9% nga ta janë shprehur se punojnë 5 ditë në javë, nga 2-3 orë në ditë (45.4%), 1 deri 2 orë (27.3%); më pak se 1 orë (18.1%), dhe më shumë se 4 orë në ditë (9.1%). Një mësimitdhënës ka deklaruar se *„nuk ka orar fiks -varet nga disponimi i nxënësve, ndonjë ditë -ndonjë nxënës duhet disa herë me e thirr derisa të jetë i gatshëm për mësimit.*

Edhe prindërit janë deklaruar për kohën të cilën e kalojnë fëmijët e tyre për mësimit në distancë. Sipas disa prindërve (50%), fëmijët e tyre i përcjellin orët në RTK më pak se një orë por disa nga ta deklaruan se, *edhe pse qëndrojnë ndonjë kohë para TV, orët në RTK nuk iu shërbejnë fëmijëve, sepse nuk janë të përshtatshme për aftësitë e tyre të kufizuara.* Ndërsa, prindërit tjerë shprehin pakënaqësinë për orët mësimore nga TV, sepse: janë të shkurtra, të shpejta dhe pa sqarime të nevojshme për nxënësit me dëmtime në të parë, se nuk ka interpretim me gjuhën e shenjave deklaruan disa prindër. *Një prind shprehet se” fëmija im e përcjell çdo emision që interpretohet me gjuhën e shenjave –edhe lajmet, edhe pse nuk arrin t’i kuptojë, pasi që është ende i vogël në moshë, por orët mësimore jo, mungon interpretimi”.*

Me angazhim dhe detyra të dhëna nga mësimdhënësi - 50% e prindërve deklaruan se fëmija kalon 2-3 orë, 1 deri 2 orë (20%), më pak se 1 orë (10%). Fëmijët e tyre mësimin e realizojnë në mbështetje të prindërve dhe familjes gjatë tërë kohës derisa ata janë të angazhuar- deklarohen 80% e prindërve, dhe se, orari i mësimin në distancë po funksionon shumë mirë, kanë deklaruar 50% të prindërve. Pjesa tjetër kanë deklaruar se përgjithësisht mirë apo deri diku po funksionon.

Sipas përgjigjeve të drejtorëve nga informatat që ata kanë mësimdhënësit aplikojnë këto forma të punës gjatë mësimin në distancë: prezantim i video-incizimeve të lidhura me përmbajtjet mësimore, dërgim i detyrave, shpjegim i përmbajtjeve mësimore dhe këshillim të nxënësve për detyra, këshillim të prindërve për mbështetje të nevojshme, informatat kthyesë për detyrat - duke u kyçur në këtë proces sipas nevojës edhe asistentët, interpretët e gjuhës së shenjave, instruktorët, psikologu, deklaruan disa nga drejtorët. Ndërsa, një drejtor gjatë intervistës ka shprehë fuqishëm nevojën për interpretim me gjuhën e shenjave të orëve mësimore në RTK, sepse, sipas tij, nxënësit e shkollës së tij mund të kishin përfituar. *“Interpretimi me gjuhën e shenjave do të mund të realizohej lehtë, pasi që shoqata e të shurdhërve ka mjaftë interpret të cilët edhe janë deklaruar që të punojnë vullnetarisht”*, ka theksuar një drejtor.

Për format e punës që janë duke funksionuar, prindërit kanë deklaruar se mësimdhënësit po ofrojnë: Udhëzime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK (30%); Video-incizime të lidhura me përmbajtje mësimore (50%); dërgimi të përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes aplikacioneve online (70%); komunikim të drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve (40%); komunikim të përditshëm përmes rrjeteve sociale (40%).

Gjetjet tregojnë se drejtorët janë të informuar për zhvillimin e procesit të mësimin në distancë, kur deklarojnë se mësimdhënësit janë të përgatitur dhe të gatshëm të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre për realizimin e mësimin në distancë/e-mësimin sipas udhëzimeve të MASHTI- në masë të mirë (3 drejtorë)], dhe se me kalimin e kohës kjo formë e mësimin është duke u avancuar ka deklaruar një drejtor. *“Procesi po shkon shumë më mirë se sa kam pritur”*, ka deklaruar njëri nga drejtorët.

Po ashtu, drejtorët kanë deklaruar se janë duke e përmbushur rolin e tyre në informimin e mësimit dhe prindërve për procesin e mësimit në distancë, gjë të cilën janë duke e bërë përmes organizimit të takimeve përmes platformës online – Zoom, Viber, Skype, kontakteve me telefon. Drejtorët shprehen se, përveç takimeve, ata vetë informohen për procesin e organizimit të mësimit në distancë edhe përmes raporteve, të cilat ata marrin nga mësimitdhënësit, si dhe kontakteve me prindër, ndërsa një drejtor kanë deklaruar se *informohet edhe përmes takimeve në objektin e QB kur mësimitdhënësit vijin për të marrë materiale mësimore në kabinetet e tyre dhe kur presin në takim familjarët e nxënësve për t'i shërbyer me materiale mësimore* – që do të thotë se edhe gjatë kësaj periudhe kohore ata kanë frekuentuar objektin e shkollës.

Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre janë deklaruar edhe mësimitdhënësit udhëtues të Qendrave Burimore. Edhe mësimitdhënësit udhëtues deklaruan se procesi i mbështetjes po zhvillohet online, përmes rrjeteve sociale: Viber, Facebook, Mesingjer, Skype e-mail dhe platformës Zoom. Kjo formë e mbështetjes po funksionon mirë, sepse po i mban aktivë nxënësit, prindërit dhe mësuesit në aktivitete të përditshme, kanë deklaruar 3 nga mësimitdhënësit udhëtues. Një mësimitdhënësit udhëtues ka vlerësuar se shërbimet e mbështetjes shumë mirë po funksionojnë, ndërsa njëri nga ta ka theksuar se *në disa zona rurale nuk ka mundësi bashkëpunimi* për shkak të vështirësive në krijimin e kontakteve me prindër, mosfunksionimit të rrjetit etj.

### **Pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimit në distancë/e-mësimit**

Drejtorët e Qendrave Burimore kanë deklaruar se janë duke i përmbushur përgjegjësitë e tyre, duke qenë të involvuar në proces dhe duke evidentuar pjesëmarrjen, organizimin, mbështetjen dhe realizimin e mësimit në distancë, për stafin profesional dhe nxënësit e përfshirë.

Të gjithë drejtorët janë shprehur se kanë informata për pjesëmarrjen dhe angazhimin e nxënësve në forma të ndryshme të mësimit në distancë, të cilat organizohen nga mësimitdhënësit, dhe stafi mbështetës i shkollës, si:

mësimdhënësit mbështetës, asistentët, interpretët, instruktorët apo psikologu - varësisht nga përbërja dhe specifikat e shkollës. *I gjithë stafi profesional i qendrës janë të përfshirë në proces, deklaruan drejtorët.* Sipas drejtorëve të shkollave, edhe pjesëmarrja e fëmijëve është e lartë, në një mesatare prej 80-90 % në secilën QB. Këtë e konfirmojnë edhe mësimdhënësit, duke iu referuar evidencave të tyre për pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin në distancë. Ndërsa, pjesa e nxënësve të cilët nuk janë të përfshirë në mësim, sipas drejtorëve, por edhe mësimdhënësve, janë nxënës me dëmtime të shumëfishta apo fëmijë të prindërve me aftësi të kufizuara, familje me gjendje të rëndë ekonomike etj.

Po ashtu, mësimdhënësit udhëtues kanë deklaruar se nga të evidentuarit në listat e rasteve për mbështetje, kanë arritur t'iu ofrojnë shërbime disa më pak e disa më shumë nga rastet e tyre. Kjo shifër lëviz nga 45% deri në 90% të rasteve, varësisht nga zonat, të cilat i mbulojnë mësimdhënësit udhëtues, duke potencuar vështirësitë të cilat kanë hasur në zinxhirin e komunikimit: mësimdhënës udhëtues-mësimdhënës-asistent-prind-nxënës. Po ashtu, mësimdhënësit udhëtues janë deklaruar edhe për format e ofrimit të shërbimeve të mbështetjes, ku ata kanë deklaruar se janë duke ofruar këshilla dhe udhëzime pedagogjike për zbatimin e PIA, video të përgatitura me tema mësimore dhe aktivitete nga Qendra Burimore, rekomandime dhe material didaktik për mësimdhënësit, mësimdhënësit mbështetës, asistentët, prindërit, e në disa raste edhe për nxënësit drejtpërdrejtë - sipas zonave që ata i mbulojnë. Po ashtu, kanë deklaruar *se janë të gatshëm për të ofruar mbështetje edhe për të gjithë të interesuarit, të cilët mund të lajmërohen në platformën e Facebook-ut të Qendrave Burimore përkatëse dhe Mesingjer, ku edhe kanë prezantuar orarin ditor për kontakte të mundshme.* Këto ueb-faqe dhe orare, për secilën qendër burimore janë të publikuara edhe në udhëzimin e MASHTI për DKA dhe QB për realizimin e mësimin në distancë për fëmijët me nevoja të veçanta (MASHTI,2020e).

Ndërsa, format e punës gjatë mësimin online mësimdhënësit kanë deklaruar se i përcaktojnë duke iu përshtatur plan-programeve: sipas fushave të aktiviteteve apo lëndore; grupe apo individuale, varësisht nga përbërja e klasës. Po ashtu, përmes kësaj mënyre të mësimin, ata janë përgjigjur se:



dërgojë përmbajtje mësimore dhe detyra përmes platformës me të cilën punojë (63.6%); video-incizime të lidhura me përmbajtjet mësimore (56.5%); moderimi i prezantimeve të njësive mësimore dhe detyrave të nxënësve (45.4%); komunikimi i përditshëm përmes rrjeteve sociale (36.3%); ligjërata të shkurtra për njësitë e reja mësimore (27.2%); komunikimi i drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve(18.1%), dhe se jap udhëzime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK (18.1%).

Të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim janë deklaruar edhe për vështirësitë, të cilat janë duke hasur gjatë këtij procesi.

Sipas drejtorëve, vështirësitë kryesore të cilat po i hasen gjatë këtij procesi janë: adaptimi me këtë formë të punës, mungesa e pajisjeve dhe internetit, e sidomos niveli i gatishmërisë së prindërve për mbështetje të fëmijëve të tyre. *“Problem i theksuar janë rastet kur edhe prindërit janë me aftësi të kufizuara dhe nuk mund t’iu ofrojnë mbështetje fëmijëve të tyre”*, kanë deklaruar 4 nga drejtorët.

Ndërsa, për mësimdhënësit vështirësitë kryesore për realizimin e planit, gjatë këtij procesi, janë: Mungesa e internetit të qëndrueshëm (56.5%), mungesa e përmbajtjeve mësimore online, në përputhje me kurrikulën (36.3%); menaxhimi i detyrave të nxënësve, ofrimi i informatave kthyesë për detyrat (36.3%); realizimi i plan-programit mësimor sipas planifikimit të bërë (18.1%); ndërsa një mësimdhënës i nxënësve me dëmtime intelektuale deklaroi se *për shkak të specifikave të nxënësve është vështirë që të arrihet ajo çfarë planifikohet, ngase nxënësit nuk janë të disponuar çdoherë, na duhet kohë shtesë - derisa nxënësi të jetë i gatshëm.*

Për vështirësitë, në të cilat janë duke hasur gjatë këtij procesi, janë deklaruar edhe mësimdhënësit udhëtues. Sipas tyre, mosgatishmëria apo hezitimi i prindërve për këtë formë të mësimin, mungesa e njohurive për teknologjinë informative në përdorimin e platformave online (sidomos të moshuarit), mungesa e kontakteve, mungesa e materialeve të gatshme në formë elektronike, krijimi i kontakteve - rrjetëzimit (mësimdhënës udhëtues-mësimdhënësit përfshirës- asistent-prind), kërkesat e shumta për mbështetje, janë disa nga vështirësitë.

Gjatë këtij procesi, me vështirësi janë ballafaquar edhe prindërit, të cilët i mbështesin fëmijët e tyre dhe janë hallka e cila i lidh mësimdhënësit me nxënësit. Ndër vështirësitë, të cilat po i hasin, prindërit kryesisht janë përgjigjur: Mungesa e pajisjeve të TIK-ut për mësim në shtëpi (70%); interneti i dobët (60%); ndërprerja e rrymës (20%); punojmë vetëm me telefon- deklaruan 70% e prindërve. Një prind deklaroi se *“nganjëherë po më duhet me iu marrë telefonin se po më duhet edhe mua, e ata po mbesin pa mësim”*. Ndërsa një prind tjetër është shprehur se *“po kemi problem me gjuhën e shenjave sepse na në shtëpi i kemi përdor tjera shenja, e tash në shkollë po përdoren tjera shenja - na nuk i dimë dhe nuk po kuptohemi me fëmijën, prandaj fëmija po bëhet nervoz dhe agresiv. Më duhet libri i gjuhës së shenjave për t’i mësuar ato”*. Po ashtu, shumica e prindërve pohojnë se gjatë mësimin në distancë – gjatë gjithë kohës fëmijët mbështeten nga familjarët, prindërit (80%), por edhe nga motra apo vëllai (60%).

Ndërsa, për orët të cilat po shfaqen në RTK vetëm 1 drejtor, 27.3% e mësimdhënësve dhe 10% e prindërve kanë deklaruar se po iu ndihmojnë nxënësve (kryesisht përgjigjet janë për nxënësit me dëmtime në të parë). Të tjerët janë deklaruar se fare nuk po iu ndihmojnë apo pak po i mobilizojnë nxënësit. Po ashtu, një drejtor ka shprehur shqetësimin për mungesën e interpretimit në gjuhën e shenjave, e që njëjtë është shprehur edhe një mësimdhënës udhëtues.

Ndërsa, për udhëzimet dhe format tjera të punës së mësimin në distancë, të gjithë drejtorët, por edhe shumica e prindërve, janë shprehur se po ndihmojnë shumë në të nxënin e fëmijës. Pjesa tjetër e prindërve kanë deklaruar se po i mobilizojnë në masë të madhe nxënësit. Një prind ka deklaruar se *fëmija tash është më i interesuar se sa kur ishte në shkollë, edhe në spital më kanë propozuar për mësim në distancë*.

Meqë ende nuk dihet niveli i përparimit të nxënësve gjatë këtij procesi, pasi nuk është bërë ndonjë vlerësim nga ana e mësimdhënësve, për nivelin e angazhimit dhe interesimit të nxënësve gjatë këtij procesi, janë deklaruar mësimdhënësit dhe prindërit të cilët kanë dhënë edhe vlerësime përafërsisht të ngjashme rreth interesimit dhe angazhimit të nxënësve për këtë formë të mësimin. Sipas 60% të prindërve dhe 54.5% të mësimdhënësve, interesimi

dhe angazhimi i fëmijëve është i mirë, kurse 30% e prindërve dhe 36.3% i mësimitdhënësve kanë deklaruar - i lartë. 10% e prindërve dhe 9.1% e mësimitdhënësve e vlerësojnë interesim e nxënësve të - të ulët. Një mësimitdhënës është shprehur se nxënësit *po ndihen të lumtur kur po më shohin mua bashkë me shokët e klasës në kamerë.*

Në një situatë tillë të krijuar, bashkëpunimi ndërmjet mësimitdhënësve – kolegëve, si dhe mësimitdhënësve dhe prindërve, ishte shumë i rëndësishëm për vazhdimin e procesit. Rreth bashkëpunimit ndërmjet kolegëve në rrethana aktuale, pothuajse të gjithë mësimitdhënësit e qendrave burimore kanë deklaruar: *po dëgjohemi dhe komunikojmë për çdo ditë, janë të mobilizuar të gjithë për përkrahje të njëri tjetrit dhe këmbëjnë materiale mësimore.* Bashkëpunimin dhe mobilizimin e mësimitdhënësve për mësim në distancë e kanë vlerësuar në masë të lartë shumica nga drejtorët, por njëri nga ta ka deklaruar se *disa nga mësimitdhënësit nuk po shprehin interesim për të punuar.*

Rreth bashkëpunimit mësimitdhënës – prind, si një faktor thelbësor për realizimin e këtij procesi, janë deklaruar mësimitdhënësit, por edhe prindërit. Sipas mësimitdhënësve (54.4%e tyre) kanë deklaruar se prindërit çdo ditë e më shumë po bashkëpunojnë dhe se prindërit janë mobilizuar shumë (18.1%). Ndërsa, kërkesa më të shpeshta të prindërve për mësimitdhënësit janë: udhëzime rreth punës me nxënës (45.3%); informata kthyesë për detyrat e nxënësve(36.3%); sqarime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK(18.1%); detyra të reja për nxënës (18.1%); shpjegimin e njësive të reja mësimore (9%).

Sa i përket bashkëpunimit me mësimitdhënës në këtë qasje të re, prindërit kanë deklaruar se mësimitdhënësit janë mobilizuar shumë (60% ), po bashkëpunojnë çdo ditë e më shumë (20%) , por disa prindër (20%) janë shprehur se deri diku po bashkëpunojmë. Kurse, sa i përket kërkesave për mësimitdhënës rreth materialeve dhe punës me nxënës, prindërit –shumica nga ta pohojnë se gjithçka është në rregull, ndërsa, 20% kërkojnë më shumë sqarime për detyrat që dalin nga orët mësimore në RTK( kryesisht prindër të fëmijëve me dëmtime në të parë, të cilët kanë mundësi të përfitojnë nga orët mësimore), 10% më shumë detyra dhe udhëzime rreth punës me nxënës.

Ndërsa, një prind ka deklaruar: *“Kam nevojë ta kem librin e gjuhës së shenjave dhe trajnim për gjuhën e shenjave, t’i mësoj shenjat dhe të mund t’i ofroj mbështetje fëmijës tim”*, pasi që, sipas tij, përdorimi i shenjave në shtëpi dhe shkollë dallon.

Po ashtu, edhe mësime të mbështetës kanë deklaruar se rrjeti i bashkëpunimit mësime të udhëtues-mësime të (përfshirës)-prind apo asistent-interpret-instruktur, varësisht nga nevojat, është duke u përmirësuar, krahasuar me fillimin e procesit.

### **Mundësitë e vazhdimet të zbatimit të mësimit në distancë/e-mësimit dhe nevojat për mbështetje të mësime të nxënësve dhe nxënësve në Qendrat Burimore**

Me supozimin se mësime në distancë mund të vazhdojë edhe për një kohë të pacaktuar, është i rëndësishëm vlerësimi i deritanishëm i këtij procesi – si mundësi për identifikimin e nevojave për mbështetje të mësime të nxënësve dhe nxënësve.

Procesin e deritanishëm të mësimit në distancë drejtorët e vlerësojnë se është një përvojë e re, që duhet përkrahur. Njëjtë mendojnë edhe 72.7% e mësime të nxënësve dhe 40% prindërve; se është një mundësi shumë e mirë për të dhënë maksimumin e vlerësojnë disa nga drejtorët, 30% e prindërve dhe vetëm 9.1% e mësime të nxënësve; ndërsa si një mundësi shumë e mirë që të shndërrohet në një formë standarde të mësimit në distancë janë deklaruar 30% e prindërve dhe vetëm 9.1% e mësime të nxënësve. *Një prind ka deklaruar se kjo formë nuk është e përshtatshme për shkak të mangësisë së socializmit.*

Po ashtu, sipas drejtorëve, kjo qasje e mësime të nxënësve ka përparësitë dhe përfitimet e saja, ndër të cilat janë: përshtatja e rrethanave në sfida të punës; bashkëpunimi i të gjithë faktorëve relevantë, si: prindër, nxënës e mësime të nxënës tjerë dhe shkëmbimi i përvojave me ekspertë të fushave konkrete, të cilët janë marrë edhe më parë me këtë mënyrë të mësime të nxënësve; bashkëpunim i shtuar me prindër; transparenca në raportet e punës; realizimi i plan-programit në masë të madhe mban përqendrimin dhe vëmendjen në punët ditore të shkollës; arsimon akoma më shumë prindërit për punë specifike pedagogjike, rrit dhe zhvillon aftësitë funksionale të fëmijëve me

nevoja të veçanta; komunikimi më i shpeshtë edhe me prindër, si dhe përfitimi i të gjithëve nga një përvojë të re, e cila do duhej përkrahur dhe zhvilluar edhe në rrethana normale. Përfitim i vlerësuar nga ana e drejtorëve është theksuar edhe krijimi i rrjetit të grupit të klasave.

Sipas mësimdhënësve, përparësitë dhe përfitimet nga kjo qasje e mësimdhënies mund të jenë: situata emocionale e nxënësve; qasja e mundshme edhe për ata nxënës që ndoshta nuk kanë qenë aktiv gjatë kontakteve fizike, por që tani janë aktiv; të përdoret si model në situata të ngjashme; përfitimi i njohurive gjatë përdorimit të platformave të ndryshme online; praktikimi i mjeteve teknologjike dhe përdorimi i rrjeteve sociale; koha më e gjatë e punës individuale me secilin nxënës veç e veç; nxënësit janë të angazhuar, bëjnë detyra, projekte dhe mosshkëputja nga procesi mësimor; obligimet mësimore dhe në kushte shtëpie; *trekëndëshi mësues-nxënës – prind, është shumë aktiv* është shprehur një mësimdhënës. Ndërsa, 9.1% e mësimdhënësve deklaruan se përfitimet janë shumë të pakta.

Mësimdhënësit udhëtues ndër përparësitë e këtij procesi kanë deklaruar krijimin e mundësive të kontaktit dhe bashkëpunimit më të shpeshtë ndërmjet mësuesve udhëtues, MASHTI-it, asistentëve në komuna, mësimdhënësve përfshirës, dhe *secili po mundohet të sjell diçka nga vetja*, ka deklaruar një mësimdhënës udhëtues.

Prindërit, për përfitimet nga kjo qasje e mësimdhënies kanë deklaruar: përfitimet janë të shumëfishta, qoftë në zgjerimin e njohurive, mbajtjen aktiv të fëmijëve dhe ruajtjen e gjendjes së mirë dhe të qëndrueshme; nuk ngel prapa, po mëson diçka të re, është aktiv, i relaksuar kur merret me mësuesen. *“Ka kryer detyra rregullisht, më do, më dëgjon dhe po punon më mirë se sa kur ishte në shkollë, sepse është afër nesh”*, ka deklaruar prindi i një fëmije me dëmtime intelektuale.

Ndërsa, përveç përfitimeve, kjo qasje e mësimimit në distancë ka edhe probleme, të cilat mund të sjellin pasoja. Sipas drejtorëve, problemet më të mëdha janë: natyra e punës me Plan Individual të Arsimit (PIA), kur brenda klasës janë dy lloje të PIA (sipas lëndëve të individualizuara dhe sipas fushave) e që nevojitet qasje individuale, e cila nuk mund të realizohet lehtë për të gjithë nxënësit; 2,3 grupe të nxënësve brenda klasës kanë krijuar

vështirësi; pamundësia e nxënësve për përdorim të pavarur të pajisjeve elektronike; mospërfshirje e mjaftueshme e nxënësve me dëmtime të shumëfishta; mbingarkesë pas kthimit në shkollë për plotësimin e boshllëqeve të krijuara; vlerësim i mangët i arritjeve të nxënësve etj.

Problemet nga kjo qasje e mësimdhënies, sipas mësimdhënësve, janë: pamundësia në qasje për shkak të bllokimit të rrjetit; moslajmërimi i nxënësve dhe prindërve në orar dhe kohë të caktuar; mosdisponimi i nxënësit; mungon ambienti i klasës; mungesa e përdorimit të mjeteve të konkretizimit; mosrealizimi i punës praktike profesionale; vështirësitë në vlerësim real etj.

Por, nëse do të vendoset që mësimi në distancë të vazhdojë deri në fund të vitit shkollor, drejtorët kanë potencuar se do të kishin nevojë për: trajnim dhe udhëzime për të përdorur platforma online, mjedis më të përshtatshëm për mësim në distancë, mjete pune, si: sigurim i internetit; laptop ose IPED - nevoja këto të theksuara edhe nga disa mësimdhënës. Disa nga mësimdhënësit, përveç atyre të cekura më lart, deklaruan se do të kishin nevojë edhe për koordinim më të mirë me aktivin profesional, ndërsa drejtorët kanë kërkuar edhe lansimin e një platforme për punë specifike me FNVA (gjatë realizimit të këtij hulumtimi, MASHTI me mbështetjen e organizatës ‘Save the Children’, më 29 prill 2020 ka bërë lansimin e platformës „Arsimi Gjithpërfshirës”, e cila gjendet në linkun (<http://arsimigjithperfs hires.rks-gov.net>).

Por, sipas prindërve, nevojat më të mëdha për mbështetjen e nxënësve janë: dërgimi i përmbajtjeve të mësimëve dhe detyrave me e-mail dhe Viber nga mësimdhënësit (30%); komunikim i përditshëm përmes rrjeteve sociale (20%); udhëzime për prindër për punë me fëmijë (20%). motivim i fëmijëve (20%) dhe informata kthyes nga mësimdhënësit për detyrat e bëra (10%). Një prind ka deklaruar se kur mësuesja e motivon nxënësin, ai ndihet shumë i gëzuar: *mësuesja e vlerëson, e stimulon dhe më thotë shkruaja pesëshe në dorë, unë ia shkruaj, e fëmija gëzohet shumë*. Ndërsa, kërkesa shtesë prindërit (60%) kanë edhe për pajisjen e fëmijëve me mjete mësimore personale, si laptop apo IPAD, *sepse me telefon është puna e vështirë*, deklaruan disa nga ta.

*“Disa prej familjarëve nuk i kanë kushtet për mësim në distancë, do të ishte mjaft ndihmesë po të realizohej ndonjë lëndë mësimore në RTK edhe për shkollat e mesme profesionale dhe gjimnazet”, ka deklaruar një mësimdhënëse në arsimin profesional..*

**Përfundimet kryesore** mbi bazën e gjetjeve të hulumtimit lidhur me mësimin në distancë/e-mësimi, nga perspektiva e Qendrave Burimore, janë:

- Të gjitha Qendrat Burimore i janë përgjigjur në kohë vendimit të MASHTI-t për realizimin e mësimin në distancë - sipas detyrave dhe përgjegjësisve të tyre specifike;
- Drejtorët, mësimdhënësit dhe prindërit, kryesisht kanë marrë informata të plota dhe praktike për fillimin e procesit të mësimin në distancë, janë angazhuar dhe mobilizuar për bashkëpunim përmes përdorimit të platformave online;
- Pjesa më e madhe e mësimdhënësve nuk janë të certifikuar në ndonjë program trajnimi për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie apo mësim në distancë, por mbi 50% nga ta mund t'i përdorin me lehtësi një ose më shumë platforma elektronike;
- Pjesa më e madhe e nxënësve, me mbështetjen e prindërve janë të përfshirë në këtë proces, por sfida mbetet përfshirja e nxënësve/fëmijëve të prindërve me aftësi të kufizuara, me vështirësi ekonomike dhe të atyre në zonat rurale;
- Mësimdhënësit dhe drejtorët përgatisin raporte javore për zhvillimin e procesit;
- Orët e mësimin në RTK, përveç nxënësve me dëmtime në të parë, nuk iu ndihmojnë nxënësve tjerë të Qendrave Burimore, pasi që nuk janë të përshtatshme për nivelin e nxënësve apo nuk interpretohen me gjuhën e shenjave;
- Të gjitha qendrat burimore kanë hapur ueb-faqet e tyre në platformën e Facebook-t, në mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta;

- Një pjesë e mësimit dhe nxënësit kanë nevojë për pajisje dhe mjete personale – laptop apo iped;
- Nga fundi i muajit prill është lansuar nga MASHT me mbështetje të ‘Save the Children’ platforma për „Arsim Gjithëpërfshirës”.

**Rekomandimet kryesore** për realizimin e mësimit në distancë, referuar gjetjeve kryesore nga perspektiva e Qendrave Burimore, janë:

- Të organizohen trajnime për përdorimin e TIK-ut në mësimit, si dhe të sigurohen mjete mësimore- laptop për nevojat e mësimit;
- Të sigurohen mundësitë për mbështetje të nxënësve, të cilët nuk janë të përfshirë në proces ( mjete personale-laptop, internet, por edhe mbështetje profesionale në shtëpi për nxënësit në nevojë;
- Të ofrohet mbështetje për prindërit – sipas identifikimit të nevojave: me trajnime për përdorimin e gjuhës së shenjave, për mbështetje profesionale apo programe tjera të nevojshme;
- Të lansohen në media fushata vetëdijesuese për rëndësinë e përfshirjes në mësim nga distanca të NNVA;
- Orët mësimore në RTK të interpretohen me gjuhën e shenjave;
- Mësimi në distancë/online të shfrytëzohet si një nismë për zbatim në situata të caktuara për punë grupore apo individuale - varësisht nga nevojat e nxënësve;
- Të shfrytëzohen kapacitetet e Qendrave Burimore, si mundësi për mbështetje profesionale të nxënësve me nevoja të veçanta.



### 3.7. MËSIMI NË DISTANCË/E-MËSIMI NGA PERSPEKTIVA E GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA

Laura Lutfiu Hoxha

Fillimi i mësimit në distancë/e-mësimit ka sfiduar gjithë sistemin arsimor në Kosovë. Nxënësit e grupeve të marginalizuara dhe familjet e tyre ballafaqohen me sfida shtesë. Kjo për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të familjeve të tyre, nevojave të veçanta shëndetësore, problemeve sistematike me të cilat ballafaqohen pjesëtarë të komuniteteve të caktuara etnike, apo situatave të veçanta nëpër të cilat kalojnë ata ose familjet e tyre. Shpeshherë të gjitha këto edhe të mbivendosura. Audrey Watters, një eksperte dhe gazetare e arsimit, nga SHBA-ja, situatën e këtyre ditëve e përmbledh qartë: “Tashmë e dimë që mësimi online nuk funksionon mirë për të gjithë nxënësit – sidomos për ata të grupeve të marginalizuara – edhe në kushte normale. E tani, këto nuk janë kushte normale” (Insidehighered. 2020).

Kjo pjesë e hulumtimit është bërë kryekëput me metoda cilësore, nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me 9 nxënës, 12 prindër dhe 4 përfaqësues të organizatave që ofrojnë mbështetje për fëmijët e grupeve të marginalizuara, si dhe hulumtimit të literaturës ekzistuese për këtë fushë<sup>44</sup>.

#### **Informimi për organizimin e mësimit në distancë**

Niveli i informimit të nxënësve dhe prindërve nga grupet e marginalizuara për realizimin e mësimit në distancë paraqitet kryesisht i mjaftueshëm ose deri diku i mjaftueshëm, me shumë pak përjashtime. Rastet që kanë deklaruar se nuk kanë pasur informata të mjaftueshme janë raste specifike. Njëri rast ka të bëjë me gjendje të rënduar shëndetësore të fëmijës, që e pamundëson angazhimin normal përgjatë gjithë procesit, dhe kjo jo vetëm gjatë periudhës së mësimit në distancë. Ndërsa, rasti tjetër lidhet me gjendjen

---

<sup>44</sup> Detajet e mostres me grupe të marginalizuara dhe të qasjes hulumtuese, janë prezantuar në kapitullin Metodologjia e studimit.

ekonomike shumë të vështirë të familjes dhe në pamundësi që të kenë lidhje interneti apo pajisje e kanale tjera për t'u informuar, përveç televizionit. Megjithatë, duket se interesimi dhe përpjekjet shtesë të mësimit në distancë apo prindërve mund të ndikojnë që deri diku të tejkalohen edhe këto probleme, siç është rasti i një familje tjetër me gjendje të rënduar ekonomike, e cila nuk ka madje as televizor, por, megjithatë, ka arritur që të sigurojë deri diku informata mbi mësimin në distancë, nëpërmjet komunikimit të kohëpaskohshëm të nënës së fëmijës me mësimit në distancë.

Mësimit në distancë dhe mediet kanë luajtur rolin kryesor në informimin e nxënësve dhe prindërve për realizimin e mësimit në distancë.

---

*Mësimit në distancë dhe mediat kanë luajtur rolin kryesor në informimin e nxënësve dhe prindërve për realizimin e mësimit në distancë.*

---

Me gjithë angazhimin e shumicës së mësimit në distancë, ka raste kur komunikimi i tyre me nxënës nuk është në nivel të duhur. Janë raportuar raste kur interesimi i mësimit në distancë për të komunikuar është shfaqur vetëm pasi që nxënësi nuk i ka dërguar detyrat, si dhe raste kur komunikimi ka ndodhur vetëm me një mësimit në distancë, dhe atë në raste të rralla.

Llojet e informatave që nxënësit dhe prindërit e tyre i kanë marrë janë të ndryshme, por dominon informata mbi orarin e orëve mësimore që shfaqen në RTK. Ka raste të informimit edhe për detyrat e angazhimet që do t'i marrin nga mësimit në distancë, për mënyrën e përdorimit të platformave online, apo edhe raste shumë inkurajuese të informimit paraprak dhe të vazhdueshëm nga mësimit në distancë mbi mënyrën e të mësuarit qysh para fillimit të mësimit në distancë.

### **Fillimi i mësimit në distancë dhe format e punës**

Periudha nga mbyllja e shkollave e deri në fillimin e mësimit në distancë ka ngjallur deri diku shqetësim dhe stres të nxënësit e grupeve të marginalizuara.

Shqetësimi dhe stresi kanë ardhur më shumë për arsye të pamundësisë teknike për ndjekje të mësimit. Situata është paraqitur më e rënduar në rastet

---

*Shqetësimi dhe stresi i nxënësve nga grupet e marginalizuara kanë ardhur më shumë për arsye të pamundësisë teknike për ndjekje të mësimit.*

---

e familjeve me më shumë se një fëmijë, kur për ndjekje të mësimit online fëmijët detyrohen të bëjnë kompromise për përdorimin e telefonit të prindit, që shpeshherë është pajisja e vetme e tillë në familje.

Kjo vjen për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike që rezulton me mungesë të pajisjeve të nevojshme për mësimin online. *“Pamundësia teknike (mungesa e laptopit) për inkuadrim direkt në platforma online ka shkaktuar stres të madh. Djali është shqetësuar shumë se po mbetet mbrapa të tjerëve dhe gjithçka po bën më vonë se të tjerët”*, thotë nëna e njërit prej nxënësve me nevoja të veçanta, në klasën e tetë, që ballafaqohet me këtë problem. Situatat e tilla sikur kjo e pandemisë së COVID-19 janë stresuese në përgjithësi për fëmijët, ndërsa fëmijët nga grupet e marginalizuara janë veçanërisht të rrezikuar, për shkak që këta ballafaqohen me nivele të shumëfishta të mundësive të kufizuara. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka prodhuar dhe publikuar materiale të shumta me këshilla për prindërit dhe kujdestarët për të përkrahur mirëqenien dhe gjendjen mendore të fëmijëve gjatë pandemisë së COVID-19, përfshirë materiale të veçanta për fëmijë me nevoja të veçanta, me kufizime në të mësuar, me autizëm etj (GOV.UK1, 2020).

RTK-ja është transmetuesi zyrtar i mësimit në distancë për fëmijët e klasave 1 deri 9 dhe si e tillë ka qenë dhe vazhdon të jetë burimi kryesor i të mësuarit në distancë. Për shkak që ky kanal është pa pagesë dhe i qasshëm në shumicën e familjeve kosovare, shumica e fëmijëve e kanë filluar mësimin në momentin kur mësimi në distancë ka filluar të transmetohet në RTK. Megjithatë, edhe këtu ka raste problematike që kanë shkaktuar vonesë në fillim të mësimit në distancë. Rastet e tilla lidhen me mungesë të televizorit në familje me gjendje të rënduar ekonomike, mosfunksionimi i RTK 4 në disa lokacione, si dhe sinjali i dobët i transmetimit. Vende të ndryshme, si p.sh. Argjentina, Meksika dhe Xhamajka, kanë mundësuar që, përveç

televizionit publik, orët mësimore të njëjta të transmetohen edhe në televizione tjera private dhe ato lokale, për të siguruar qasje sa më të gjerë në mësimin në distancë (BB1, 2020). Në përgjithësi, nxënësit ndjekin të gjitha lëndët që transmetohen në RTK, varësisht nga klasa të cilën janë duke e ndjekur. Përrjashtim bën gjuha angleze, e cila deri në momentin e realizimit të intervistave ende nuk ka filluar të transmetohet në RTK. Megjithatë, edhe këtu ka raste pozitive, pasi, si rezultat i angazhimit të mësimdhënësve të gjuhës angleze, nxënësit kanë pranuar detyra nga ta nëpërmjet komunikimit direkt.

Për funksionimin me sukses të mësimin në distancë qysh nga fillimi është vlerësuar që përtej RTK-së përdorimi i platformave online është element mjaft i rëndësishëm. Informacionet e detajuara që MASHTI i ka ofruar në faqen e vet zyrtare për mënyrën e përdorimit të platformës ZOOM duket se kanë pasur efekt mjaft pozitiv, sepse vërehet që shumë mësimdhënës dhe nxënës e përdorin këtë aplikacion

për komunikim. Megjithatë, paraqiten pengesa në përdorim të kësaj platforme në rastet kur nxënësit dhe arsimtarët nuk posedojnë një pajisje adekuate ose kur këta të fundit mund të kenë

---

*Informacionet e detajuara që MASHTI i ka ofruar në faqen e vet zyrtare për mënyrën e përdorimit të platformës ZOOM kanë pasur efekt pozitiv.*

---

mungesë të kapaciteteve për të punuar nëpërmjet kësaj platforme. Viber, si mjet më i shpejtë dhe më i lehtë për përdorim, rezulton të jetë më i përhapur në komunikimin ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve. Ky aplikacion përdorimin më të shprehur e ka në rastin e dorëzimit të detyrave nga nxënësit, si dhe në mesin e prindërve për komunikim me mësimdhënësit e fëmijëve. Njëra nga nxënëset e intervistuar dhe njëkohësisht motra e një fëmije me Sindromin Down, me të cilin janë së bashku që nga klasa e parë, thekson se “Viberin e përdorim vetëm me telefon të prindërve dhe komunikojmë vetëm për detyra. Zoom ende nuk po e përdorim, sepse nuk po mundem ta hapin të gjithë nxënësit. Disa kanë probleme për t’u kyçur përmes telefonave e disa nuk kanë fare telefona”. Edhe këtu, në mungesë të pajisjeve adekuate dhe lidhjes së internetit ka raste kur nxënësit nuk përdorin asnjë

platformë komunikimi online, përveç komunikimit të herëpashershëm të prindit me mësime të ndërmjet telefonit.

Koha e kaluar në përcjelljen e mësimit online nga fëmijët lidhet me kohëzgjatjen e lëndëve që transmetohen në RTK, mësimit dhe komunikimit shtesë të drejtpërdrejtë me mësime të ndërmjet e tyre dhe vëllimin e detyrave që

---

*Telefoni i vetëm i familjes ndahet në mes të dy motrave, përderisa vëllai ndjek mësime të ndërmjet në RTK.*

---

jepen nga mësime të ndërmjet. Kryesisht të gjitha këto arrijnë një kohë mesatare të angazhimit prej 4 deri në 5 orë në ditë. Ka raste më të rralla kur fëmijët janë shumë të ngarkuar dhe kalojnë

edhe deri në 6 orë në ditë, kryesisht për shkak të vëllimit të shtuar të detyrave. Kjo kohëzgjatje është e ngjashme me vende tjera që e përdorin televizionin publik si mjet kryesor për mësimit në distancë, siç është Bullgaria, vend në të cilin nxënësit e klasave 1-10 i kalojnë mesatarisht 6 orë në mësimit në distancë (BB1, 2020). Por, dy raste të veçanta e nxjerrin në pah që koha e kaluar me angazhim për mësimit në distancë ndikohet edhe nga gjendja ekonomike e familjes dhe pajisjet në dispozicion. Në një familje me tre fëmijë në shtëpi dhe vetëm një telefon dhe një televizor, telefoni ndahet në mes të dy motrave me prioritet, përderisa vëllai ndjek mësime të ndërmjet në RTK, mirëpo nuk ka mundësi të përdorimit të telefonit. Kjo ia pamundëson realizimin e detyrave dhe komunikimin me mësime të ndërmjet përmes platformave. Rast i ngjashëm është edhe në një familje tjetër me dy fëmijë, por me vetëm një telefon dhe një televizor, ku njëri nga fëmijët detyrohet që mësimit në distancë ta ndjekë vetëm nëpërmjet RTK-së.

### **Pjesëmarrja dhe mbështetja në realizimin e mësimit në distancë**

Vlerësimi mbi dobinë e orëve mësimore që shfaqen në RTK është i ndryshëm, varësisht nga statusi i nxënësve dhe/ose familjeve të tyre. Shumë nxënës të grupeve të marginalizuara RTK-në e kanë të vetmen platformë të ndjekjes së mësimit në distancë, dhe si e tillë mësime të shfaqen aty janë ndihmesë shumë e madhe.

Gjithashtu, mësimet në RTK janë ndihmesë e madhe edhe për disa nxënës me nevoja të veçanta, të cilët këtë formë të mësimimit po e përfjetojnë madje edhe më të përshtatshme sesa mësimin e zakonshëm, për shkak që ambienti i shtëpisë dhe përkrahja nga prindërit është me e përshtatshme për ta. Nëna e një fëmije me autizëm ka pohuar se mësimet në RTK po i ndihmojnë shumë djalit të saj në klasën e katërt. Ajo shprehet se “po i ndihmojnë shumë, e përcjellë gjithë mësimin në RTK, përfshirë mësimet për klasat tjera, nga klasa e parë deri në të katërtën, sepse ashtu edhe po i përsërit gjërat që i ka mësuar më parë”. Në anën tjetër, disa nxënës vlerësojnë që orët në RTK i ndihmojnë deri diku, por “ka arsimitarë që flasin shpejt në TV dhe s’po i kuptojmë mirë, ndoshta pse nuk janë mësimdhënësit tonë dhe nuk e kuptojmë mirë mënyrën e shpjegimit”. Një nxënëse tjetër, nga klasa e dhjetë, thekson se “disa gjëra nuk po mundemi me i kuptu sikur kur i sqaron arsimtari në klasë, si p.sh. në klasë del i shkruan në tabelë, i sqaron formulat. Më shumë kemi vështirësi në lëndët e Matematikës dhe Fizikës, sepse është ndryshe kur i zgjidh detyrat në tabelë e ndryshe kur vetëm flet për to”. Problemi më i madh me orët e RTK-së lidhet me faktin që jo të gjithë nxënësit e një niveli e kanë ndërprerë mësimin në fazën e njëjtë dhe ka klasa të cilët kanë qenë në periudha më të avancuara sesa mësimet që po shfaqen në RTK. Njëri nga nxënësit e intervistuar tregon se “mësimet e RTK-së janë të periudhës së parë, ndërsa klasa jonë tashmë jemi në periudhën e tretë. Ato i kemi mësu e përsërit edhe në periudhë të parë edhe të dytë në shkollë”. Për këtë grup të nxënësve, mësimet në RTK nuk janë aspak ndihmesë. Në fund, vlen të përmendet që mësimet në RTK ende nuk i kanë përfshirë të gjitha nivelet, konkretisht nuk kanë filluar ende për klasat 10 deri në 12.

---

*Mësimet në RTK janë ndihmesë e madhe edhe për disa nxënës me nevoja të veçanta, të cilët këtë formë të mësimimit po e përfjetojnë madje edhe më të përshtatshme sesa mësimin e zakonshëm.*

---

Detyrat që jepen në RTK shoqërohen me udhëzime nga mësimdhënësit përkatës për nxënësit e tyre, por edhe me detyra shtesë. Kjo është forma më e shprehur e punës që mësimdhënësit përdorin gjatë kësaj kohe me nxënësit. Ka raste të shpeshta edhe të komunikimit të mësimdhënësve me grupe të

nxënësve, e që bëhet më së shpeshti për detyra. Forma tjera të punës, siç është ligjërimi i veçantë përmes platformës ZOOM, përdorimi dhe ndarja pasuese e prezantimeve në Power Point, recitimi i vjershave online, testet online në Google classroom apo përshtatja e testeve për nivelin e nxënësve me nevoja të veçanta janë të pranishme, por në raste më të rralla.

Dobia e formave të ndryshme të punës për nxënësit ndërlihet kryesisht me mundësinë e komunikimit të rregullt me mësimdhënësit e tyre. Nxënësit që kanë kontakte të rregullta me ta e vlerësojnë këtë si ndihmesë të madhe. Njëra nga këto nxënëse, në klasën e shtatë, shprehet se *“kemi udhëzime të ndryshme nga arsimtarët për mësimet e reja dhe kjo po më ndihmon shumë”*. Në anën tjetër, komunikimi jo i rregullt, por i kufizuar vetëm në dërgim të detyrave rezulton me ndihmë më të kufizuar për nxënësit. Dobia e

---

*Dobia e komunikimit të rregullt lidhet kryekëput me informatat kthyese, të cilat janë bazë e rritjes dhe përmirësimit të nxënësve në procesin e të nxënës.*

---

komunikimit të rregullt lidhet kryekëput me informatat kthyese, të cilat janë bazë e rritjes dhe përmirësimit të nxënësve në procesin e të nxënës. Rastet kur nxënësit kanë pasur informata kthyese janë

shumë të rëndësishme, duke qenë se ato i sigurojnë ata nëse vërtet kanë arritur të kuptojnë përmbajtjen mësimore dhe nëse detyrat e dhëna janë realizuar me sukses. Po ashtu, ato e ndihmojnë nxënësin që ka nevojë për sqarime shtesë, t'i marrë ato nga burime të sigurta, qoftë drejtpërdrejt nga mësimdhënësi ose nga burime të referuara nga ta. Sipas Bankës Botërore, mundësimi i komunikimit të dyanshëm dhe informatave kthyese është një nga elementet më të rëndësishme që duhet të sigurohet gjatë përdorimit të mësimin në distancë nëpërmjet transmetimeve televizive (BB2, 2020). Angazhimi i mësimdhënësve në këtë aspekt është duke u shtuar, por, megjithatë, mbetet i pamjaftueshëm, sidomos duke pasur parasysh nevojat shtesë të fëmijëve nga grupet e marginalizuara. Ka shumë raste kur kërkesat për sqarime nga nxënësit apo informatat kthyese nga mësimdhënësit kanalizohen nëpërmjet njërit nxënës (p.sh. kryetarit/es të klasës). Duket se arsyeja kryesore për këtë është numri i madh i nxënësve për mësimdhënësit,

sidomos ata lëndorë, të cilët kanë shumë klasë, që e bëjnë gati se të pamundur informatën kthyesë për secilin prej tyre.

Prindërit e vlerësojnë angazhimin e mësimit në distancë. Vlerësimi i prindërve lidhur me këtë angazhim gjatë këtyre ditëve varet nga fakti se sa me rregull komunikojnë mësimit me ta dhe fëmijët e tyre. Prindërit, fëmijët e të cilëve sadopak kanë mundësi kontakti me mësimit, e vënë në pah ndihmesën e madhe nga mësimit. Në anën tjetër vlerësimi i kundërt vjen nga prindërit, fëmijët e të cilëve janë të shkëputur nga platformat online dhe nuk kanë mundësi të komunikimit të rregullt me mësimit. Angazhimi natyrisht se varet nga mundësitë teknike të komunikimit, e jo vetëm nga vullneti i mësimit apo

---

*Në këto rrethana prindërit kanë mundësi të përfshihen shumë më tepër në procesin e mësimit të fëmijëve të tyre, përfshirë ballafaqimin me problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët e tyre.*

---

prindërve e nxënësve. Shumë i ngjashëm është edhe vlerësimi nga prindërit i bashkëpunimit me mësimit e fëmijëve të tyre, i cili po ashtu varet nga niveli dhe mundësitë e komunikimit të rregullt. Kërkesa më e shprehur ndaj mësimit për procesin e mësimit në distancë është pikërisht informata kthyesë. Kjo kërkesë është e njëjtë, si nga prindërit ashtu edhe nga nxënësit. Kjo lidhshmëri e kërkesës së njëjtë si nga nxënësit dhe prindërit mund të vijë nga fakti që në këto rrethana prindërit kanë mundësi të përfshihen shumë më tepër në procesin e mësimit të fëmijëve të tyre, përfshirë ballafaqimin me problemet, me të cilat ballafaqohen fëmijët e tyre. Po ashtu, ngarkesa me detyra, vështirësia në përfundimin në kohë dhe procesi i përcjelljes së detyrave të mësimit, me gjithë vështirësitë, i bën prindërit më të vëmendshëm karshi nevojave që kanë fëmijët e tyre në këtë kohë.

Shkalla e interesimit dhe angazhimit të nxënësve në këtë periudhë është e kënaqshme. Pavarësisht mungesës së pajisjeve adekuate, lodhjes me detyra e angazhimit në platforma të ndryshme, nxënësit nga grupet e marginalizuara pohojnë që kryesisht e mbajnë një ritëm të mirë të punës.



Njëri prind e ilustron këtë duke thënë se “fëmijët kanë ngarkesë e po mundohen shumë. Nganjëherë po me duket që po bien përtokë, e po duhet me u dhanë pak kohë për pushim e pastaj më ngadalë me i rikthy në

---

*Janë prindërit dhe vëllezërit e motrat ata që po i ndihmojnë më së shumti fëmijëve nga grupet e marginalizuara.*

---

angazhim”. Një pjesë e mirë e angazhimit lidhet me obligimin e detyrave që marrin nga mësimdhënësit, orarit të përcaktuar për dorëzim të detyrave dhe presionit për

vlerësim. Gjithashtu, kjo ven në pah edhe angazhimin e shtuar të një pjese të mësimdhënësve, që nxënësit të mos humbasin nga mësimi gjatë periudhës sa janë në shtëpi. Megjithatë, janë prindërit dhe vëllezërit e motrat ata që po i ndihmojnë më së shumti fëmijëve nga grupet e marginalizuara, sidomos me detyra dhe sqarime. Dallohen nënat dhe grupet e nënave në Viber ,që i ndihmojnë më së shumti fëmijët me procesin e të nxënimit. Gjithashtu, ndihma vjen edhe nga shokët e shoqet e klasës, ose kujdestari/ja e klasës. UNESCO ka prodhuar materiale të shkurta vizuale e lehtë të kuptueshme për elemente të ndryshme të mësimin në distancë në periudhën e pandemisë, përfshirë edhe për këshillim të prindërve se si t’u motivojnë fëmijët e tyre gjatë mësimin në distancë (UNESCO, 2020). Materiale të ngjashme, por të përshtatura, mund të jenë të dobishme edhe për prindërit e fëmijëve të grupeve të marginalizuara.

Megjithëse e shohin si mjaft sfidues, por duke i marrë parasysh rrethanat, nxënësit dhe prindërit e vlerësojnë mësimin në distancë si një proces që deri diku i ngjan mësimdhënies. Kjo kryesisht lidhet me atë, që me gjithë sfidat, procesi mësimor në distancë sjell përfitime për fëmijët e tyre. Ky proces po i mban fëmijët e angazhuar në mësim pa shkëputje dhe po u ndihmon që të mos dalin nga rrjedhat mësimore, ndërsa gjithashtu u ndihmon që të zhvillohen në përdorimin e platformave të teknologjisë informative dhe në hulumtim e mësim të pavarur. Në përgjithësi, nxënësit kanë një vlerësim më pozitiv sesa prindërit. Megjithatë, në rastet e familjeve me gjendje më të rënduar ekonomike ky proces nuk vlerësohet që po u ndihmon, pasi që fëmijët e tyre vetëm se po e thellojnë pabarazinë e tyre dhe po mbesin

mbrapa nxënësve të tjerë, të cilët i kanë mundësitë e duhura të përcjelljes së mësimit në distancë.

## **Vështirësitë dhe nevojat për mësim në distancë**

Gjatë kësaj periudhe të vështirë për secilën familje dhe me shumë ngarkesë për nxënësit nga grupet e margjinalizuara, vështirësitë e raportuara normalisht që kanë qenë të shumta dhe të shumëllojshme.

Dominon kategoria e mungesës së pajisjeve të teknologjisë informative, sidomos e një laptopi, tableti ose kompjuteri në shtëpi. Është shumë e

---

*Nga të gjitha familjet dhe fëmijët e intervistuar nga grupet e margjinalizuara, asnjë nga ta nuk posedon laptop, tablet ose kompjuter.*

---

rëndësishme të theksohet që nga të gjitha familjet dhe fëmijët e intervistuar, asnjë nga ta nuk posedon laptop, tablet ose kompjuter. Për mësimin në distancë, kjo është vështirësi e jashtëzakonshme. Të gjitha këto raste janë duke punuar me telefon të prindërve, ndërsa ka raste kur disa fëmijë detyrohen të punojnë vetëm me një telefon. Nxënësja në klasën e dhjetë nga komuna e Gjakovës thekson : *“E kemi të vështirë të punojmë me një telefon tre fëmijë, vëllai nuk mundet fare, vetëm unë dhe motra – kur unë e kam kohën e lirë ia jap telefonin motrës. Jemi pajtuar me motrën se unë kam ngarkesë më shumë, pra kam përparësi në përdorim të telefonit. Telefoni është i mamit dhe ne të dyja kalojmë secila pothuajse nga 5 orë në ditë me të. Problemi tjetër është edhe se në telefon nuk mund t’i bëjmë detyrat në fizikë dhe matematikë, sepse nuk dalin formulat”*. Për të trajtuar pikërisht këtë problem, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, më 19 prill 2020, mori vendim që të gjithë fëmijëve të grupeve të margjinalizuara t’u sigurojë laptopë dhe tablete, si pjesë e përpjekjes për ta bërë mësimin në distancë të qasshëm për të gjithë fëmijët gjatë kohës së shpërthimit të COVID-19. Gjithashtu, do të ofrohen shpërndarës të internetit 4G për ato familje që nuk kanë lidhje interneti, si dhe qasje falas në një numër të caktuar të faqeve edukative nga ofruesit e shërbimeve të TI (GOV.UK2, 2020). Për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, ka familje që e kanë të vështirë ta paguajnë me

rregull qasjen në internet, e si rrjedhojë kanë periudha kur nuk mund t'i përdorin për komunikim me mësimdhënës as telefonat e tyre. Raste të tilla nuk janë karakteristikë vetëm e Kosovës, por edhe e vendeve të zhvilluara. Vetëm 68% e fëmijëve australianë të moshës 5 deri në 14 vjeç, që jetojnë në komunitetet e margjinalizuara, kanë qasje në internet në shtëpitë e tyre, krahasuar me 91% të nxënësve që jetojnë në komunitetet e privileguara (Theconversation, 2020). Sinjali i dobët është problem tjetër që është raportuar, edhe pse jo shpesh. Vështirësi tjetër që përmendet mjaft shpesh është ngarkesa me detyrat e shtëpisë. Kjo ngarkesë më së miri ilustrohet nga një nxënës me nevoja të veçanta (klasa e 8-të, Komuna e Prishtinës), i cili e ndan përvojën e tij. *“I kemi dy palë detyra në të njëjtën kohë, edhe ato nga RTK edhe ato që na japin arsimtarët. Në ditë të mbajmë gjashtë lëndë, të gjithë na japin detyra dhe duhet t'i kryejmë deri në mbrëmje, nuk po arrij t'i kryej, sepse janë shumë, dhe pastaj po mbes mbrapa. Kur nuk i bëjmë detyrat, arsimtarët na vendosin minusa. Tre minusa nënkuptojnë notën njësh. Në fund të vitit edhe këto do të përfshihen në vlerësim, e kjo më jep shumë stres. Këto detyra duhet me i kry patjetër, edhe nëse nuk dimë, duhet me e gjet mënyrën ose me ia marrë dikujt tjetër e me ua dërgu arsimtarëve”*. Vështirësi tjetër që është përmendur, por jo shumë shpesh, janë edhe vështirësitë në përshtatje me këtë formë të mësimi dhe mungesa e përmbajtjeve mësimore online sipas programit mësimor që kanë fëmijët.

Nevojat kryesore që përmenden nga nxënësit dhe kërkesat, të cilat parashtrihen nga prindërit, ndahen në dy grupe kryesore, e të cilat ndërlihen me vështirësitë e identifikuara. Grupi i parë i nevojave lidhet me

---

*Kërkohet mësimi i drejtpërdrejtë me mësimdhënësit e tyre, si mundësi për sqarime e informata kthyesë të atypëratyshme.*

---

pajisjet e domosdoshme për mësim në distancë. Pa një laptop, tablet, kompjuter ose edhe lidhje interneti funksionale realisht mësimi në distancë është shumë i vështirë ose i pamundshëm, ndërsa pritjet janë

që MASHTI t'i përkrahë ata nxënës që i kanë kushtet më të vështira ekonomike. Grupi i dytë i nevojave lidhet me mënyrat e mbajtjes së mësimi në distancë, ku dominon publikimi i materialeve mësimore në një platformë

ku kanë qasje të gjithë. Kjo nevojë është e njohur edhe nga Banka Botërore, e cila në Udhëzuesin mbi mësimin në distancë & COVID19, njërin nga rekomandimet për qeveritë e vendeve të ndryshme e ka ofrimin e një portali unik (*one-stop-shop*), ku do të publikoheshin të gjitha materialet mësimore, mjetet, aplikacionet e platformat për mësimin në distancë, si dhe materialet ndihmëse, siç janë udhëzuesit për nxënës, mësues e prindër (BB3, 2020). Disa vende si Bullgaria e Kroacia kanë krijuar edhe linja telefonike falas (Helpdesk), në të cilat nxënësit dhe prindërit e tyre mund të telefonojnë për të marrë informata të lidhura me mësimin në distancë (EUCROATIA, 2020). Mjaft e shprehur është edhe nevoja për mësim të drejtpërdrejtë me mësimdhënësit e tyre, ku e gjithë klasa janë online së bashku. Kjo e fundit lidhet kryesisht me mundësinë për të komunikuar më lirshëm dhe për të kuptuar më qartë përmbajtjet mësimore nga mësimdhënësit, të cilët i njohin nga mësimi i rregullt, si dhe mundësinë për sqarime e informata kthyesë të atypëratyshme. Një nga nxënësit e ilustron më së miri këtë, duke e vlerësuar një rast pozitiv që tashmë po ndodh në klasën e tij: *“Më së miri është kur arsimtari prezanton në Power Point, na jep detyrat, e pasi që i dërgojmë detyrat e përfunduara ata na kthejnë vlerësimin me pikë”*. Nevoja tjera që janë përmendur nga prindërit janë edhe udhëzimet për prindër, se si duhet të punohet me fëmijët në shtëpi, si dhe mosdyfishimi i mënyrave të mësimin në distancë. Nëna e njërit fëmijë shprehet se *“duhet ta përcaktojnë se si mbahet mësimi online, ose nëpërmjet RTK ose nëpërmjet Zoom, e jo t’i ngarkojnë fëmijët me të dyja njëkohësisht”*.

Sipas një studimi global mbi mësimdhënien me fëmijë të grupeve të marginalizuara, nevojat kryesore të fëmijëve të këtyre grupeve janë të karakterit social-emocional dhe modeleve pozitive nga të rriturit, përfshirë mësimdhënësit (madje para nevojave bazike si ushqimi i mjaftueshëm), ndërsa cilësia kryesore e mësimdhënësve efektivë të fëmijëve të grupeve të marginalizuara është aftësia për të bashkëndier dhe për t’u lidhur me nxënësit, e sidomos dhembshuria dhe mirësjellja (Varkey, 2018). Për këtë arsye, hulumtimi është fokusuar edhe në keqpërdorimet eventuale të platformave online. Gjetjet tregojnë se rastet e abuzimeve ndaj mësimdhënësve janë të rralla, siç ka qenë rasti i vetëm i raportuar i abuzimit nga nxënësit, të cilët duket se gjatë mësimin online e kanë përqeshur

mësimdhënësin e tyre, i cili pastaj e ka ndërprerë menjëherë lidhjen online. Në anën tjetër, intervistat kanë nxjerrë në pah që më të rrezikuarit janë vetë nxënësit. Edhe pse janë raportuar vetëm disa raste, është e rëndësishme të trajtohen seriozisht, sidomos në raport me nxënësit nga grupet e margjinalizuara, që edhe ashtu janë shpeshherë të stigmatizuar

---

*Abuzimet eventuale të nxënësve në platformat online duhet të trajtohen seriozisht, sidomos ndaj atyre nga grupet e margjinalizuara.*

---

dhe ballafaqohen me abuzime në përditshmëri. Njëri nga këto raste lidhet me gjendjen shëndetësore të një nxënësi me nevoja të veçanta, i cili, edhe pse ka qenë i vetmi në klasën e tij që i ka bërë detyrat në njërën lëndë, është ballafaquar me reagim abuzues nga mësimdhënësi i tij, i cili sipas nënës së fëmijës u ka thënë nxënësve të tjerë “a prej këtij keni mbet me bo detyrën a?”. Gjithashtu, është përmendur edhe gjuha e ashpër e një mësimdhënësi në komunikim me e-mail, shqetësim ky i ngritur nga një prind që ka pasur qasje në e-mailin e fëmijës. Ky rrezik nuk duket të jetë trajtuar nga institucionet përkatëse deri më tani, sidomos në aspektin e identifikimit dhe raportimit të rasteve të tilla. Vende të ndryshme tashmë kanë përgatitur udhëzime e kanale shumë të përshtatshme komunikimi për mësimdhënësit, nxënës dhe prindër, me qëllim të ndërtimit të komuniteteve të sigurta për ndjekjen mësimin në distancë (EDU.AUSTRALIA, 2020).

### **Reagimi i organizatave të shoqërisë civile ndaj mësimin në distancë**

Një aspekt tjetër brengosës është edhe vështirësia e shumicës së organizatave të shoqërisë civile që merren me grupet e margjinalizuara, që

---

*Shumica e organizatave të shoqërisë civile kanë arritur që shumë shpejt të përshtatin punën e tyre në shërbim të fëmijëve nga grupet e margjinalizuara.*

---

të ofrojnë ndonjë shërbim specifik në kushtet e shpërthimit të COVID-19. Megjithatë, shumica e tyre kanë arritur që shumë shpejt të përshtatin punën e tyre dhe të ofrojnë një numër shërbimesh mjaft të rëndësishme

për fëmijët e grupeve të margjinalizuara. Një organizatë e fuqishme, e cila

për vite të tëra punon me fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, thekson se nevojat e komuniteteve për realizim të mësimin në distancë janë shumë të mëdha. Ka kërkesa nga familjet që nuk kanë as internet, laptop, telefon e as televizor. Duke qenë se kjo organizatë nuk posedon fonde specifike për mbulim të nevojave të këtij lloji për komunitetet, ata po mundohen të paktën t'u ofrojnë ndihmesë në aspektin e detyrave. Ky proces po ashtu është tejet i vështirësuar shkak i mungesës së pajisjeve adekuate. Ata po ashtu theksojnë se për nxënësit e këtyre komuniteteve etnike do të jetë problem procesi i vlerësimit, shkak i mospërfshirjes në mësimin online.

Organizatat që ofrojnë shërbime direkte për fëmijët me nevoja të veçanta po vazhdojnë të ofrojnë këto shërbime edhe në baza vullnetare, përmes ofrimit të seanceve online. Normalisht që kjo situatë i godet dyfish këto grupe, të cilat, në mungesë të pajisjeve teknologjike, përveçqë humbasin mësimin në distancë, po ashtu do të kenë të pamundur të pranojnë edhe shërbimet terapeutike online, shumë të nevojshme për mirëqenien e tyre dhe të familjeve të tyre.

Në anën tjetër, mësimi në distancë në organizatat që përkujdesen për fëmijët e braktisur dhe ato në strehimore të viktimave të dhunës në familje po vijon shumë mirë. Udhëheqësit e këtyre qendrave rezidenciale theksojnë që rol të rëndësishëm në mësimin në distancë po luan stafi i brendshëm, si ai i përkujdesjes dhe psiko-pedagogjik, ashtu edhe aktorët e tjerë të përfshirë. Stafi ka komunikim të vazhdueshëm me mësimdhënësit dhe po e vlerësojnë pozitivisht përfshirjen e tyre në gjithë procesin, që nga fillimi. Marrë parasysh numrin e nxënësve që kanë në përkujdesje, nevojë e tyre në këtë proces mbetet sigurimi i pajisjeve teknologjike dhe në disa raste edhe i internetit në secilën pajisje dhe i mjeteve të punës. Pa ndonjë ndihmë specifike nga institucionet arsimore dhe të tjera për këtë proces, këto organizata me përkushtimin maksimal të stafit dhe përkrahjen e

---

*Mësimi në distancë në organizatat që përkujdesen për fëmijët e braktisur dhe ato në strehimore të viktimave të dhunës në familje, po vijon shumë mirë.*

---

mësimdhënësve, po ia dalin të sigurojnë ecurinë e duhur të mësimin online për këta fëmijë.

## **Përfundimet**

Nga të gjeturat e hulumtimit dhe analiza e të dhënave, përfundimet kryesore rreth procesit të mësimin në distancë për nxënësit nga grupet e marginalizuara dhe prindërit e tyre janë si në vijim:

- Fëmijët nga grupet e marginalizuara janë ballafaquar me shqetësim e stres, kryesisht për shkak të pamundësisë teknike për ndjekje të duhur të mësimin në distancë, si pasojë e mungesës së pajisjeve të nevojshme;
- RTK-ja është burimi kryesor dhe shpesh i vetëm i të mësuarit në distancë dhe si i tillë është i dobishëm, përveç te familjet me gjendje të rënduar ekonomike, ku kanalet e RTK-së jo gjithmonë janë të qasshme, qoftë për shkak të mungesës së televizorëve apo sinjalit;
- Platformat online për komunikim përdoren shpesh, por shoqërohen me probleme, si mungesë e pajisjeve adekuate nga nxënësit ose kapaciteteve të mangëta të mësimdhënësve për përdorim të platformave të tilla;
- Sipas prindërve të nxënësve nga grupet e marginalizuara, përfitimet kryesore të mësimin në distancë janë mosshkëputja nga procesi mësimor dhe zhvillimi i aftësive për përdorim të TI dhe hulumtimit të pavarur nga ana e nxënësve;
- Mësimi në distancë u mundëson prindërve të përfshihen shumë më tepër në procesin e mësimin të fëmijëve të tyre, përfshirë ballafaqimin dhe trajtimin e problemeve, me të cilat përballen fëmijët e tyre;
- Vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e pajisjeve të TI për nxënësit, sigurimi i së cilave paraqitet si nevoja kryesore e këtij grupi. Shumë familje nga grupet e marginalizuara nuk kanë asnjë laptop, tablet ose kompjuter, e shpesh disa fëmijë të një familje e kanë vetëm një telefon të mençur në dispozicion për mësim në distancë;

- Vështirësi tjera janë ngarkesa e madhe me detyra, përfshirë dyfishimin e tyre, si dhe dallimet në mes të ciklit/fazës së orëve që transmetohen në RTK me ciklet/fazat e ndryshme, të cilat nxënësit kanë qenë duke i ndjekur në momentin e ndërprerjes së mësimi;
- Interesimi dhe angazhimi i nxënësve nga grupet e marginalizuara është i kënaqshëm, ndërsa ndihmën kryesore e marrin nga nënat dhe vëllezërit e motrat e tyre, por këta nxënës kanë nevojë për angazhim shtesë të mësimdhënësve për të komunikuar me ta dhe/ose prindërit e tyre në baza të rregullta;
- Për disa nxënës me nevoja të veçanta, mësimi në distancë është më i përshtatshëm sesa mësimi i zakonshëm;
- Mësimi në distancë nuk u ndihmon fëmijëve të familjeve me gjendje të rënduar ekonomike, të cilët mbesin mbrapa nxënësve të tjerë të cilët i kanë mundësitë e duhura të përcjelljes së mësimi në distancë;
- Rastet e abuzimit të nxënësve gjatë mësimi në distancë nuk janë të shpeshta, por janë të pranishme;
- Shumica e organizatave të shoqërisë civile që punojnë me fëmijë të grupeve të marginalizuara, me gjithë vështirësitë, kanë arritur të përshtaten e të ofrojnë shërbime edhe në situatën e shpërthimit të COVID-19. Qendrat rezidenciale, që përkujdesen për fëmijët e braktisur dhe ata në strehimore të viktimave të dhunës në familje, me angazhim maksimal të stafit dhe mësimdhënësve, arrijnë ta mbajnë me sukses mësimin në distancë.

## **Rekomandimet**

Të gjeturat shfaqin elemente të rëndësishme pozitive, që japin shpresë që mësimi në distancë do të ketë efekt pozitiv, por, megjithatë, për fëmijët nga grupet e marginalizuara dhe familjet e tyre i gjithë procesi mbetet shumë sfidues. Disa prej rekomandimeve që duhet të konsiderohen për t'i tejkaluar ose të paktën minimizuar këto sfida janë:



- MASHTI urgjentisht të gjejë mënyrat e sigurimit të pajisjeve bazike të teknologjisë informative për mësim në distancë për fëmijët nga grupet e marginalizuara, sidomos ata që vijnë nga familjet me kushte të rënduara ekonomike, qoftë nga buxheti publik apo nëpërmjet krijimit të mekanizmave institucionalë, për të nxitur dhurime nga donatorët privatë. Kjo do të siguronte që asnjë nxënës të mos mbetet prapa për shkak të pamundësisë financiare të familjeve të tyre;
- MASHTI të hyjë në dialog me kompanitë private që ofrojnë shërbime të internetit dhe sinjalit televiziv që gjatë periudhës sa mbahet mësimi në distancë të sigurojnë të paktën sinjalin e të gjitha kanaleve të RTK-së dhe sinjal të internetit për të gjitha familjet me gjendje të rënduar ekonomike e që kanë nxënës, qoftë pa pagesë apo nëpërmjet subvencionimit nga buxheti publik;
- MASHTI të vazhdojë praktikën e suksesshme të udhëzimeve për përdorim të platformës ZOOM edhe me udhëzime tjera për përdorim të platformave online, si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit dhe prindërit e tyre, për të nxitur sa më shumë ndërveprim të drejtpërdrejtë në mes të fëmijëve dhe mësimdhënësve të tyre, sidomos për fëmijët nga grupet e marginalizuara;
- MASHTI të hartojë dhe të shpërndajë udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e tyre lidhur me evitimin e abuzimeve online, në formate të kuptueshme dhe lehtë të qasshme, si dhe të nxisë raportimin e rasteve eventuale dhe të trajtojë me seriozitetin maksimal rastet e raportuara;
- MASHTI të ndajë fonde emergjente për organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për fëmijët nga grupet e marginalizuara, me procedura të përsheptuara dhe me qëllim të ofrimit të menjëhershëm të shërbimeve bazë që e ndihmojnë procesin e mësimin në distancë.



### **3.8. KRAHASIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI I TYRE**

Selim Mehmeti, Amantina Pervizaj, Haxhere Zylfiu & Ismet Potera

Ky kapitull paraqet krahasime në mes të rezultateve të studimit me respondentë nga komuniteti i shkollës (drejtues të shkollave, mësime dhënë, nxënë dhe prindër), diskutime, interpretime dhe vlerësime për temat si: (i) Mësimi online para situatës së krijuar me Covid -19; (ii) Informimi lidhur me organizimin e mësimin në distancë /e-mësimin, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19; (iii) Pritjet dhe fillimi i mësimin në distancë /e-mësimin; (iv) Pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimin në distancë /e-mësimin; (v) Përparësitë dhe përfitimet nga mësimi në distancë; (vi) Problemet e shfaqura dhe pasojat që mund të ketë mësimi në distancë; (vii) Nevojat për mbështetje në kushtet e organizmit të mësimin nga shtëpia dhe (viii) Nevojat për mbështetje profesionale.

#### **E-mësimi para situatës së krijuar me Covid -19**

Në arsimin parauniversitar në Kosovë, që nga 23 marsi 2020, ka filluar të mbahet mësimi në distancë për shkak të pandemisë COVID-19. Sipas raporteve të MASHTI-t dhe DKA-ve, mësimi deri tani është duke shkuar në mënyrë të kënaqshme, megjithatë mësimi në distancë po përcillet edhe me disa sfida. Mungesa e pajisjeve të nevojshme teknologjike për përcjellje të mësimin në distancë, mungesa e materialeve mësimore për mësim online në përputhje me kurrikulat dhe plan-programet mësimore, mungesa e përvojave dhe kapaciteteve për mësim online, kanë sfiduar në masë të madhe sistemin e arsimit në Kosovë, në mënyrë të veçantë arsimin parauniversitar.

Mësimi online në arsimin parauniversitar zë fill edhe para situatës së krijuar me COVID-19. MASHTI për vite me radhë ka bërë përpjekje për integrim të TIK-ut në mësimdhënie dhe atë përmes dokumenteve strategjike dhe disa projekteve, të financuara nga fondet qeveritare dhe nga donatorët e ndryshëm, ka realizuar projekte për mësimin online përmes platformave të

ndryshme. Nisur nga këto argumente, për këtë studim kemi mbledhur të dhëna nga drejtuesit e shkollave dhe mësimit lidhur me pjesëmarrjen e tyre në programe aftësimi për përdorimin e TIK-ut dhe të materialeve mësimore online për mësimit, përvojat e tyre në mësimit online, si dhe platformat me materiale mësimore që janë përdorur para situatës së krijuar me COVID – 19.

Sipas drejtorëve të shkollave dhe mësimit, mësimit online/e-mësimit para situatës së krijuar me Covid -19 ka qenë i kufizuar në mesin e mësimit, bëjnë përjashtim mësimit e disa shkollave që kanë qenë pjesë e ndonjë projekti ose programi për mësimit online dhe mësimit që kanë praktikuar mësimit online me vetiniciativë. Sipas tyre, 65 % e mësimit asnjëherë nuk kanë përdorur ndonjë platformë me përmbajtje të mësimit online, mbi 25% e mësimit vetëm në një rast ose ndonjëherë kanë përdorur ndonjë platformë mësimore, kurse pjesa tjetër, ndonjëherë, shpesh ose çdoherë kanë përdorur platforma mësimore në praktikat e mësimit. Platformat që kryesisht janë përdorur prej mësimit janë School Me, Microsoft Showcase Classroom 365, Busulla.COM.

Rrethanat e krijuara nga COVID-19 kanë bërë që të gjithë mësimit, në bazë të rrethanave dhe mundësive të tyre, të përdorin së paku një formë të mësimit online përmes e-mailit dhe aplikacioneve të ndryshme. Gjithsesi, kjo është gjeja më elementare që duhet të bëhet për të kontribuar në realizimin e mësimit në distancë. Por, mungesa e përvojës në përdorimin e aplikacioneve të tilla për qëllime të mësimit rrezikon cilësinë e mësimit dhe rrezikon që nxënësit të kenë paqartësi në mënyrën dhe procedurat e punës dhe të prezantimit të suksesit të tyre, për shkak se nuk kemi disa udhëzime bazike për mënyrën e përdorimit (MASHT ka ndarë udhëzimet për përdorimin e platformës Zoom - zoom.us), kohën e përdorimit, interaksionin që duhet të kenë përdoruesit të këtyre aplikacioneve gjatë mësimit në distancë. Shkathësitë e zbatimit të tyre nuk krijohen shpejtë.

Nga rezultatet e studimit, konfirmohet se rreth 40% e mësimit dhe 45% e drejtorëve të shkollave nuk kanë ndjekur asnjë program aftësimi për përdorimin e TIK-ut dhe të materialeve mësimore online në praktikat e

mësimdhënies dhe nxënies. Gjithashtu, konfirmohet se kanë pak përvojë në përdorimin e platformave për mësim online dhe për përdorimin e formave dhe aplikacioneve të ndryshme për takime dhe komunikime online. Mungesa e kompetencës digjitale të një pjesë e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave do të reflektohet në efektshmërinë e mësimin në distancë ndërsa nxënësit do të rrezikohen të mos marrin mbështetjen e nevojshme në procesin e të nxënës gjatë mësimin në distancë.

Mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë në Kosovë e detyroi MASHTI-n që fillimisht me mbështetjen e DKA-s së Prishtinës, pastaj edhe të komunave të tjera, të fillojë mësimin në distancë për klasat 1-9 nëpërmjet të RTK 1 e RTK 4 dhe platformës e-mësimi.rks-gov.net në kanalën e MASHTI-t në 'YouTube'. Në rrethanat e krijuara, kjo iniciativë u vlerësua si mundësi e vetme për të përfshirë të gjithë nxënësit e Kosovës, prandaj edhe u prit mirë nga nxënës e prindër dhe mësimdhënës. Përkundër qëllimit të gjithëpërfshirjes, jo të gjithë nxënësit janë përfshirë, për shkak se për ata që vijnë nga familjet me gjendje të rënduar ekonomike kanalet e RTK-së nuk janë gjithmonë të qasshme, qoftë për shkak të mungesës së televizorit, apo të sinjalit të transmetimit. Vlen të theksohet se kishte edhe hezitime për shkak të mungesës së përvojës nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Sipas Cameron Sublett (2020), politikat, praktikat dhe investimet tona sugjerojnë që të shohim mësimin në internet më shumë si një mjet për menaxhimin e krizave sesa forcimin e arritjeve dhe barazisë. Rezultatet tona e tregojnë atë. Dhe, për fat të keq, mungesa jonë e planifikimit institucional, në mbështetje dhe ngritje të kapaciteteve deri në këtë pikë, rezulton që shumë institucione e filluan dhe do t'i mbijetojnë në këto rrethana, duke përsëritur dhe amplifikuar të gjitha gjërat që ne nuk dimë të bëjmë. Për shembull, ndërsa ne kemi mësuar në javët e fundit se distanca sociale është një mënyrë e mirë për të rrafshuar një kurbë infeksioni, ndërveprimi social është çelësi për pedagogji efektive në internet (Insidehighered. 2020). Edhe fillimi i mësimin në distancë në Kosovë rezultoi si mjet për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia. Për sistemin tonë aplikimi i pedagogjisë efektive në internet do të jetë sfida tejet e madhe kur e kemi parasysh

mungesën e shkathtësive të mësimdhënësve për mësim në distancë, mungesën e platformave mësimore online dhe mungesën e teknologjisë, si për mësimdhënës, ashtu edhe për nxënës.

### **Informimi lidhur me organizimin e mësimin në distancë/e-mësimin, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19**

Udhëzimet e publikuara në faqen zyrtare të MASUTI-t (e-mësimi) për organizimin e mësimin në distancë, mediet dhe informacionet për orarin javor të transmetimeve të orëve mësimore në RTK, kishin efekt pozitiv në informimin e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave. Megjithatë, procesi i informimit është përshkruar me dallime në kapitujt që trajtohen gjetjet e ndara për drejtuesit e shkollave, mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Analiza krahasuese e bërë për informimin, për organizimin e mësimin në distancë/e-mësimin, tregon se drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit kanë nivel më të lartë të informimit për organizimin e mësimin në distancë dhe rolin e tyre në këtë proces, ndërsa edhe nxënësit dhe prindërit kanë nivel të mirë të informimit, por me dallime në përqindje kundrejt drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve. Nxënësit nga grupet e marginalizuara po ashtu kanë nivel të mjaftueshëm të informimit, me mësimdhënësit dhe mediet si burime kryesore të informacionit.

Nga roli që kanë drejtuesit e shkollave dhe mësimdhënësit, pritet që ata të jenë më të informuar, por roli i tyre duhet të përmbushet edhe me informimin e drejtë dhe me kohë të nxënësve dhe prindërve, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja në mësimin në distancë, angazhimi dhe mbështetja, sidomos nga prindërit. Kjo është e rëndësishme, sidomos për nxënësit dhe prindërit nga grupet e marginalizuara, të cilëve, në mungesë të pajisjeve të nevojshme të teknologjisë, u duhet më shumë vëmendje dhe informim i drejtpërdrejtë për procesin. Rezultatet tregojnë se, edhe pse jo në baza të rregullta, mësimdhënësit, megjithatë, janë interesuar në rastet kur nxënësit e tyre nga grupet e marginalizuara nuk e kanë përcjellë mësimin në distancë. Në të njëjtën kohë, u kanë ofruar udhëzime se si t'u ndihmohet që të punojnë në shtëpi, brenda kushteve ekzistuese të gjithsecilit. Angazhimi natyrisht se

varet nga mundësitë teknike të komunikimit dhe jo vetëm nga vullneti i mësimit apo prindërve e nxënësve.

Në pyetjen se *çfarë informacionesh keni marrë për organizimin e mësimit në distancë/ e-mësimit*, të gjithë respondentët e përfshirë në studim, në përqindje më të madhe i referohen orarit të orëve mësimore që shfaqen në RTK dhe detyrave e përgjegjësi të tyre. Të dyja këto aspekte janë plotësuar nga MASHTI, DKA-të dhe shkollat. Ndërsa, më pak i referohen informimit për mundësitë e realizimit të kurrikulës/ programit mësimor. Kjo për faktin se MASHTI nuk ka marrë vendim për riformatim të programit mësimor ose vendim për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Tani kjo situatë kërkon kujdes dhe udhëzime të qarta, se të gjitha detyrat, angazhimet, veprimtaritë mësimore që zhvillohen duhet të jenë themelore nga programi mësimor, që nuk është zhvilluar gjatë mësimit në shkollë, dhe duhet të ndërlidhen me rezultatet e të nxënësve dhe qasjet në mësimit që aplikohen gjatë mësimit në distancë.

Nga rezultatet e studimit konfirmohet se një pjesë relativisht e madhe e mësimit në distancë, rreth 30% e tyre, kanë informacione tejet të shpërndara dhe të paqarta apo informacione të pamjaftueshme për realizimin e mësimit në distancë. Kjo e dhënë është mjaft jetike, kur kemi parasysh se ka kaluar më shumë se një muaj kur ka filluar mësimi në distancë. Roli i DKA-ve dhe shkollave duhet të jetë më i madh në informimin e mësimit në distancë, nxënësve dhe prindërve. Tani, kur kemi hyrë në fazën e dytë të mësimit në distancë, në vend të përqendrimit në informata teknike, duhet të vendoset debati në krijimin e kushteve dhe mundësive që çdo nxënës të marrë pjesë aktivisht në mësimin në distancë në kushtet e mësimit në shtëpi.

### **Pritjet dhe fillimi i mësimit në distancë/e-mësimit**

Mësimi në distancë/e-mësimi është një sfidë e re për drejtuesit e shkollave, për mësimit në distancë, por edhe për nxënësit dhe prindërit. Prandaj, për të gjithë përfaqësuesit e komunitetit të shkollës, të përfshirë në këtë studim, është shtruar pyetja: *Si i keni pritur (përjetuar) fillimin e mësimit në distancë/e-mësim dhe angazhimin tuaj në këtë formë të mësimit?* Në përgjithësi, nga i gjithë komuniteti i shkollës (rreth 80 % e gjithë komunitetit të shkollës të

përfshirë në studim) fillimi i mësimit në distancë është pritur me qetësi, interesim, gatishmëri, por edhe me mobilizim për angazhim. Pjesa tjetër, rreth 10% deri diku e kanë pritur me shqetësim, stres dhe frikë, si dhe rreth 10% me pak ose shumë shqetësim, stres dhe frikë. Dy grupet e fundit, sipas rezultateve të studimit, kanë qenë më pak të informuara lidhur me përgatitjen për organizimin e fillimit të mësimit në distancë dhe me rolin e tyre në këtë proces. Në anën tjetër, me gjithë nivelin e mjaftueshëm të informimit, fëmijët nga grupet e marginalizuara janë ballafaquar me shqetësim e stres, kryesisht për shkak të pamundësisë teknike për ndjekje të duhur të mësimit në distancë.

Gjetjet për pritjet e komunitetit të shkollës për fillimin e mësimit në distancë/e-mësimit dhe angazhimin janë informata të rëndësishme për institucionet arsimore që udhëheqin këtë proces (MASHTI-n, DKA-të dhe udhëheqjen e shkollës), por edhe një tregues i qartë për maksimizimin e angazhimeve për të përmbushur këto pritje dhe për të siguruar pjesëmarrje dhe angazhim të gjithë nxënësve, mësimitdhënësve, por edhe të prindërve, në këtë proces të ndjeshëm dhe kompleks në rrethanat që po zhvillohet.

Nga rezultatet e studimit, konfirmohet se mësimi në distancë, në shumicën e shkollave dhe klasave, ka filluar të realizohet nga dita kur kanë filluar të shfaqën orët mësimore në RTK. Një përqindje relativisht e madhe e mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve, rreth 30% e tyre, janë shprehur se kanë filluar të komunikojnë të japin detyra për nxënës dhe angazhime të tjera, edhe para se të fillojë shfaqja e orëve mësimore në RTK. Rreth 2.5 % e mësimitdhënësve kanë dhënë informacion se akoma nuk kanë filluar të mbajnë mësim me nxënësit e tyre. Kjo nuk konfirmohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga drejtorët e shkollave, mirëpo nxënësit dhe prindërit shprehen se janë një numër i mësimitdhënësve që akoma nuk kanë filluar të mbajnë mësim.

Edhe pse pas një muaji që ka filluar mësimi në distancë, rreth 8% e nxënësve janë shprehur se akoma nuk kanë filluar të mbajnë mësim në distancë me mësimitdhënësit e tyre, apo janë në përgatitje për të filluar. Mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave konfirmojnë se rreth 10% e nxënësve nuk marrin pjesë në mësimin në distancë. Kjo konfirmohet edhe në raportet javore të



disa DKA-ve, që i dërgojnë në fund të javës në MASHTI. Te disa mësimdhënës, mospjesëmarrja e nxënësve në mësim shkon deri në 30-50 %. Mospjesëmarrja e nxënësve, por edhe e mësimdhënësve, në mësimin në distancë krijon pabarazi, që pritet të reflektohet në suksesin e nxënësve dhe të ardhmen e tyre. Çdo shkollë, përkatësisht çdo komunë, duhet të sigurojë pjesëmarrje të të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve në mësimin në distancë.

Fillimi i mësimin në distancë është mundësuar pasi që MASHTI me mbështetjen e mësimdhënësve të Komunës së Prishtinës, pastaj edhe të Prizrenit, të kompanive të teknologjive të reja (Kallxo. com, Gjirafa, Microsoft, Link Plus) dhe të RTK, ka arritur që brenda 10 ditësh nga ndërprerja e mësimin në shkollë të fillojë mësimin në distancë, fillimisht për nivelin fillor (1-5) dhe pastaj edhe për nivelin e dytë (6-9), si dhe në gjuhën turke dhe boshnjake, duke e ofruar atë në mënyrë të centralizuar përmes RTK dhe kanalit të MASHTI-t në 'YouTube'. Ndërsa, në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-12 të arsimit të mesëm të lartë (si në gjimnaze dhe në shkolla profesionale), mësimi në distancë në ka filluar dhe është duke vazhduar në mënyrë të decentralizuar, në nivel shkolle dhe mësimdhënësit në nivel klase. Realizimi i mësimin online në shkollat e mesme të larta është i fokusuar në disa lëndë të përgjithshme (Gjuhë, Matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore) (MASHTI, 2020 b).

Nga dita e parë e fillimit të mësimin në distancë, mësimdhënësit me nxënësit e tyre përdorin platforma/aplikacione online të ndryshme, si Zoom, Skype, Viber, Teams, Google classroom, e-mail, etj. Viber është aplikacioni që përdoret më së shumti për komunikim nga mësimdhënësit me grupet e nxënësve dhe prindërve, e thonë rreth 85 % e mësimdhënësve. Aplikacioni Zoom konfirmohet se përdoret nga rreth 55 % e mësimdhënësve, kurse Google classroom nga 22 % e mësimdhënësve. Kjo konfirmohet edhe nga nxënësit dhe prindërit, por me dallime të vogla. Rreth 30 % e mësimdhënësve komunikimin dhe mësimin me nxënësit e mbajnë vetëm me telefonin e mençur. Kjo përbën një sfidë për mësimin në distancë, përdorimin e platformave mësimore online, për qasjen ndaj mësimdhënies etj.

Sipas Deb Adair (2020), është inspiruese të dimë se edhe njohësit dhe praktikuesit e kamotshëm të sistemit On-Line predikojnë se : *“Askush nuk mendon se kjo është mënyra se si duhet të bëhet arsimit në internet. Fitorja gjatë pandemisë nuk do të përfshijë zhvillimin e arsimit online me cilësi të lartë.”*. Cilësia ka rëndësi. Prandaj, ne duhet të fokusohemi në më të mirën e mundshme, por jo perfeksionin (Insidehighered, 2020). Fokusimi në më të mirën e mundshme, në masë të madhe varet nga vlerat etike dhe përkushtimi për të pambushur rolin dhe përgjegjësitë profesionale. Pavarësisht pajisjeve të komunikimit që i kanë në dispozicion mësime dhënësit dhe prindërit, nëse udhëhiqen nga këto premisa, ato do t’i përmbushin kërkesat dhe nevojat e fëmijëve/nxënësve në këto rrethana.

Sipas Kantar (2019), në Kosovë penetrimi i internetit është vazhdimisht në rritje, mbi 90% për të gjitha grupmoshat dhe pa dallim nga vendet urbane dhe rurale (sipas Qirezi, 2020). Këtë e konfirmojnë edhe përfaqësuesit e komunitetit të shkollës, që kanë marrë pjesë në këtë studim, pasi mbi 90 e tyre shprehen se nuk kanë pasur problem me internet në javët e para të mësimit në distancë. Pajisjet kryesore që janë duke i përdorur mësime dhënësit dhe nxënësit këto ditë për mësim në distancë /e-mësim, kryesisht janë telefoni i mençur (rreth 90%) dhe laptopi (rreth 70%). Nga disa mësime dhënësit dhe nxënës përdoren edhe kompjuteri dhe tableti, por në përqindje më të vogël. Probleme të theksuara janë evidentuar në familjet e nxënësve që kanë disa fëmijë në shkollë dhe nuk është arritur të harmonizohen oraret e mësimit, për shkak të shkollave dhe niveleve të ndryshme të shkollimit, por edhe në familjet të mësime dhënësit që kanë situata të njëjta.

Të dhënat e siguruar nga grupet e marginalizuara tregojnë se një përqindje e lartë e tyre kanë probleme me qasje në pajisje ose internet dhe janë të papërfshirë në procesin mësimor. Është shumë e rëndësishme të theksohet që nga të gjitha familjet dhe fëmijët e intervistuar nga grupet e marginalizuara, asnjë nga ta nuk posedon laptop, tablet ose kompjuter. Për mësimin në distancë, kjo është vështirësi e jashtëzakonshme. Të gjitha këto raste janë duke punuar me telefon të prindërve, ndërsa ka raste kur disa fëmijë detyrohen të punojnë vetëm me një telefon.

Nga rezultatet e studimit, konfirmohet se ditët e punës të mësimdhënësve gjatë mësimin në distancë janë të ndryshme. Mbi 57% e mësimdhënësve shprehen se në pesë ditë të javës mbajnë mësim (konsultime, detyra, ligjërata, prezantime, aktivitete me nxënës, etj.), 13% shprehen se mbajnë mësim në katër ditë të javës, pjesa tjetër mbajnë mësim vetëm 3,2 apo 1 ditë. Edhe sa i përket kohës së angazhimit në një ditë që mësimdhënësit kalojnë me nxënësit tuaj, në forma të ndryshme të mësimin në distancë /e-mësimin, ka dallime të theksuara. Më pak se 50% e mësimdhënësve kalojnë 3-5 orë në ditë në angazhimet e tyre të drejtpërdrejta me nxënës.

Koha e të mësuarit, koha e mësimdhënies, është një element thelbësor për suksesin e nxënësve. Rezultatet e studimeve tregojnë qartë se mësimi i mirë varet nga një numër faktorësh. Koha aktive për mësim është një prej faktorëve kryesorë përcaktues për nivelin e arritjeve të nxënësve në mësim (Hanushek & Wößmann, 2007). Edhe në rrethanat e mësimin në distancë duhet kushtuar kujdes të veçantë nga ana e mësimdhënësve kohës së punës me nxënës, në mënyrë që ata të kenë mbështetjen e duhur për procesin e të nxënës dhe të motivohen për mësim.

### **Pjesëmarrja, organizimi dhe mbështetja në realizimin e mësimin në distancë /e-mësimin**

Shkollat, përmes raporteve javore të mësimdhënësve, mbledhin informacione për përfshirjen e nxënësve në përcjelljen e mësimin/orëve mësimore, përmes RTK dhe platformës së MASHTI-t e-mësimi dhe për pjesëmarrjen e nxënësve në mësimet dhe format tjera të punës që organizohen nga mësimdhënësit e tyre. Drejtorët dhe mësimdhënësit shprehen se rreth 90 % e nxënësve marrin pjesë në mësimin në distancë, përfshirë atë përmes platformës e-mësimi dhe formave të mësimdhënies që organizohen nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve. Pavarësisht faktit që ka kaluar më shumë se një muaj që nga fillimi i mësimin në distancë, akoma nuk është arritur të sigurohet përfshirja e të gjithë nxënësve. Theksohen vështirësi për qasje në platforma nga grupet e marginalizuara dhe mospërfshirje e të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve në mënyrë dhe nivel të njëjtë. Rreth 30 % e prindërve dhe nxënësve, vështirësitë me përfshirje

dhe angazhim në mësimin në distancë të fëmijëve të tyre i ndërlidhin me mungesën e pajisjeve të teknologjisë, me mosfunksionimin e orarit të mbajtjes së mësimin në distancë përmes platformave online dhe formave tjera që i aplikojnë mësimdhënësit.

Format e punës së mësimdhënësve me nxënës gjatë mësimin në distancë janë të shumta dhe të ndryshme. Ato konfirmohen si nga udhëheqësit e shkollave mësimdhënësit, ashtu edhe nga nxënësit dhe prindërit e tyre. Vlejnë për t'u veçuar disa nga format e punës së mësimdhënësve: (i) Udhëzime për detyrat që dalin nga orët mësimore të prezantuara në RTK; (ii) Ligjërata të shkurtëra për njësitë e reja mësimore; (iii) Video-incizime të lidhura me përmbajtjet mësimore; (iv) Moderimi i prezantimeve të njësisve mësimore dhe detyrave të nxënësve; (v) Dërgimi i përmbajtjeve mësimore dhe detyrave përmes platformës me të cilën punojnë dhe (vi) Komunikimi i drejtpërdrejtë me grupe të nxënësve. Mësimi në distancë në kushtet e shtëpisë kërkon që format e punës së mësimdhënësve të balancohen në raport me kohën e kontaktit të drejtpërdrejtë me nxënës dhe në raport me përmbajtjet mësimore thelbësore që duhet të zhvillohen gjatë mësimin në distancë, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen tej mase.

Me gjithë gatishmërinë dhe mobilizimin e shprehur për angazhim në fillimet e mësimin në distancë, pjesa më e madhe e respondentëve nga shkollat ndajnë mendim të njëjtë sa u përket vështirësive me të cilat janë duke u përballur gjatë realizimit të mësimin në distancë /e-mësimin, si: adaptimi me këtë formë të mësimin, përdorimi i aplikacioneve për mësim në distancë, mungesa e përmbajtjeve mësimore online, në përputhje me kurrikulën, interneti i dobët, realizimi i plan-programit mësimor, detyrat e shtëpisë, etj. Por, mendimet e tyre dallojnë në raport me vështirësinë kryesore me të cilat ata ballafaqohen në këto rrethana të mësimin në distancë. Rreth 44% e prindërve konsiderojnë se vështirësi kryesore është adaptimi me këtë formë të mësimin, në përqindje të njëjtë, rreth 44% e nxënësve, shprehen se vështirësi kryesore kanë ngarkesën me detyra të shtëpisë dhe sigurimin e internetit, ndërsa mësimdhënësit (rreth 43%) shprehen se vështirësi kryesore kanë në realizimin e plan-programit mësimor sipas planifikimit të bërë. Nga mënyra se si shpërfaqen vështirësitë kryesore shtrojnë nevojën për të

reflektuar ndaj të kuptuarit të qëllimit kryesor, organizimit të mësimit në distancë në këto kushte, dhe ndaj rolit që kanë faktorët subjektivë të mësimit në distancë.


Mësimi në distancë në rrethanat aktuale, të shkaktuara nga pandemia COVID-19, duhet të ketë në vëmendje mirëqenien dhe angazhimin e nxënësve, jo ngarkesën e tyre dhe jo në fokus realizimin e programit mësimor që nuk mund të realizohet në kushtet e shtëpisë, i cili kërkon përshtatje të të gjitha rrethanave për të qenë mësim mundësues për të gjithë nxënësit.

Ashtu si nxënësit, edhe mësimdhënësit ndihen më të ngarkuar me këtë qasje të mësimdhënies, e cila është një përvojë e re dhe mjaft sfiduese për të gjithë. Në përkrahje të nxënësve dhe mësimdhënësve për tejkalimin e ngarkesave aktuale drejtorët e shkollave, Drejtoritë Komunale të Arsimit, MASHTI dhe profesionistët pedagogjikë/arsimorë duhet të mbështesin nxënësit dhe mësimdhënësit që të mos pësohet me një zhgënjim dhe venitje të punës së kësaj periudhe. Sipas K. Holly Shiflett (2020), një përvojë negative sigurisht që mund të shkaktojë një ndjenjë të frazës "kurrë më". Prandaj, përgjegjësia është te ne, si praktikues/hulumtues të mësimit në internet, të rritemi në këtë kohë urgjence dhe të sigurojmë që përvoja të jetë aq sa e mira e mundshme (Insidehighered, 2020).

Rezultatet e studimit tregojnë se ka mobilizim të komunitetit të shkollës për të ndihmuar njëri-tjetrin në përballimin e vështirësive që janë duke u përballur gjatë realizimit të mësimit në distancë/e-mësimit. Nxënësit nga grupet e marginalizuara ndihmën kryesore e marrin nga nënat, vëllezërit dhe motrat e tyre.

Ka dallime në mendimet ndërmjet respondentëve nga komuniteti i shkollës sa i përket ndihmës nga orët mësimore që po shfaqen në RTK. Nxënësit janë ata që në përqindje më të madhe, 22%, shprehen se pak ose fare nuk po ndihmojnë orët mësimore që po shfaqen në RTK në të nxënët e tyre. Prindërit kanë një vlerësim më të lartë. Shumë nxënës nga grupet e marginalizuara RTK-në e kanë të vetmen platformë të ndjekjes së mësimit në distancë dhe si e tillë mësimet që shfaqen aty janë ndihmesë shumë e madhe. Gjithashtu,

mësimet në RTK janë ndihmesë e madhe edhe për disa nxënës me nevoja të veçanta, të cilët këtë formë të mësimi po e përjetojnë, madje edhe më të përshtatshme sesa mësimin e zakonshëm, për shkak se ambienti i shtëpisë dhe përkrahja nga prindërit janë më të përshtatshme për ta. Prindërit kanë vlerësim më të lartë. Dallimet tjera krahasuese prezantohen sipas përqindjes në figurën në vijim.




Grafiku 19. Ndhimja e orëve mësimore nga RTK-ja

Mbi 15% e mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët nuk kanë informacione nëse nxënësit e tyre i përcjellin apo nuk i përcjellin orët mësimore që emetohen në RTK dhe në linkun për kanalën e MASHTI-t në ‘YouTube’. Kjo e dhënë tregon se ky grup i mësimdhënësve nuk siguron ndërlidhjen në mes të asaj që ofron RTK-ja, detyrat dhe aktivitetet, dhe asaj që vetë mësimdhënësit e ofrojnë nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies së tyre, që i aplikojnë gjatë mësimi në distancë.


Nxënësit dhe prindërit janë pyetur edhe për atë se sa po e ndihmojnë të nxënësve udhëzimet dhe format tjera të punës që organizohen nga mësimdhënësit. Përgjigjet e tyre në përqindje janë të përafërta. Mbi 56% e tyre shprehen se mësimdhënësit me udhëzimet që po i ofrojnë dhe me format

e punës që janë duke i përdorur, po i mobilizojnë në masë të madhe dhe po ndihmojnë shumë si nxënësit ashtu edhe prindërit. Një pjesë e tyre relativisht e madhe (rreth 34%), shprehen se deri diku po e marrin ndihmën e duhur nga mësimdhënësit, ndërsa mbi 10% e nxënësve dhe prindërve shprehen se mësimdhënësit me udhëzimet që po i ofrojnë dhe me format e punës që janë duke i përdorur, pak ose fare pak po ndihmojnë nxënësit, ashtu edhe prindërit. Figura në vijim i prezanton këto dallime.



Grafiku 20. Ndhimja e udhëzimeve të mësimdhënëseve

Sa i përket vlerësimit të mësimdhënëseve, nxënësve dhe prindërve për interesimin dhe angazhimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë, ka dallime të vogla ndërmjet vlerësimeve të tyre. Në përgjithësi, ekziston një pajtueshmëri se interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar përmes mësimin në distancë, është në nivel të mirë. Një përqindje e nxënësve, rreth 10% e tyre vlerësojnë se interesimi i nxënësve është i ulët apo tejet pasiv.




Grafiku 21. Interesimi dhe angazhimi i nxënësve për të mësuar gjatë mësimit në distancë

Në rrethanat kur mësimi po zhvillohet në kushtet e shtëpisë, online dhe në distancë, përmes një llojshmërie aplikacionesh, ekziston mundësia që në raste të caktuara ato të keqpërdoren, për qëllime të ndryshme. Për këtë i kemi pyetur nxënësit dhe mësimdhënësit dhe mbi 50% e tyre shprehen se kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, apo nuk janë të informuar se ka ndodhur një gjë e tillë gjatë mësimit në distancë. Mirëpo, ka një përqindje të nxënësve dhe mësimdhënësve (rreth 36% e nxënësve, përkatësisht 44 % e mësimdhënësve) që shprehen se kjo po ndodh rrallë ose ndonjëherë. Ndërsa, rreth 12 % e nxënësve shprehen se kjo ndodh shpesh ose shumë shpesh. Kjo situatë kërkon vëmendje të shtuar, si nga ana e mësimdhënësve dhe prindërve, ashtu edhe nga ana e vetë nxënësve. Intervistat me nxënësit dhe prindërit nga grupet e marginalizuara kanë nxjerrë në pah që më të rrezikuarit janë vetë nxënësit. Edhe pse janë raportuar vetëm disa raste, është e rëndësishme të trajtohen seriozisht, sidomos në raport me nxënësit nga grupet e marginalizuara, që edhe ashtu janë shpeshherë të stigmatizuar e në përditshmëri ballafaqohen me abuzime.



Si mësimdhënësit, ashtu edhe prindërit, shprehen se është rritur bashkëpunimi i tyre që nga fillimi i realizimit të mësimin në distancë. Prindërit janë më shumë të kënaqur me bashkëpunimin e mësimdhënësve kundrejt këtyre të fundit, të cilët janë më kërkues ndaj prindërve, në mënyrë të veçantë mbi 15 % e mësimdhënësve, të cilët shprehen se pak ose fare pak kanë mundësi të bashkëpunimit me prindër.



Grafiku 22. Komunikimi dhe bashkëpunimi mësimdhënës/prindër - prindër/mësimdhënës

Si prindërit, ashtu edhe mësimdhënësit, shprehen se komunikimi dhe bashkëpunimi i tyre lidhet më shumë me sqarime për detyrat që dalin nga orët mësimore që prezantohen në RTK dhe informatat kthyesë për detyrat e nxënësve. Kjo është një e dhënë e mirë, kur kemi parasysh se, sipas nxënësve, rreth 64 % e mësimdhënësve vlerësimin e tyre e bëjnë duke iu referuar detyrave individuale. Mirëpo, nuk duhet lënë anash edhe komunikimin dhe bashkëpunimin në aspektet tjera që lidhen me mësimin në distancë, sidomos në aspektet kur ka më pak komunikim dhe bashkëpunim në mes të mësimdhënësve me prindër dhe anasjelltas, lidhur me udhëzimet për punë me nxënës, shpjegimin e njëjësive të reja mësimore dhe për detyrat e reja për nxënës.

## **Mësimdhënia elektronike në distancë**

Nga datat 01 -20 prill 2020 u përcjellën dhe u vëzhguan 100 orë mësimore dhe 50 mësimdhënës, në klasat 1-5 dhe 6-9, dhe objekt i vëzhgimit ishin: metodika e zbatimit të mësimdhënies, përmbajtja e mësimdhënies, ana teknike e zbatimit të mësimdhënies, si dhe harmonizimi i përmbajtjeve me kërkesat e Kurrikulës.

Mësimdhënia elektronike në distancë nxori në shesh gjëra me interes për mësimdhënës dhe për sistemin arsimor, si shfrytëzimi i burimeve të ndryshme për mësimdhënie dhe nxënie dhe thyerja e shabloneve dhe stereotipave mësimorë, se vetëm mësimdhënia në klasë është më e mira, ka dëshmuar të kundërtën. Dëshira dhe guximi për t'u sfiduar edhe me këtë formë të mësimdhënies ishte një test për mësimdhënësit, të cilët nuk hezituan që t'i përgjigjen thirrjes për mbajtjen e e-mësimit.

Në fokus të vëzhgimit, përveç tjerash, ishin edhe shkathtësitë metodike e gjuhësore të mësimdhënësve të angazhuar. Sa i përket këtij aspekti të vëzhgimit, mësimdhënësit e vëzhguar mund të ndahen në dy grupe kryesore: me shkathtësi dhe gjuhë të përshtatshme, të mira, dhe mësimdhënës të cilët shprehnin mangësi të theksuara në këtë aspekt të mësimdhënies.

Gjatë përcjelljes së e-mësimit u identifikuan dy grupe mësuesish: një grup i përgatitur mirë nga aspekti profesional dhe pedagogjik, me shkathtësi të mira metodike, me gjuhë të përshtatshme dhe të sigurt gjatë realizimit (shtjellimit) të njësisë mësimore dhe një grup me përgatitje profesionale-pedagogjike -metodike të dëshirueshme. Përcaktimi i drejtë dhe i saktë i qëllimit të njësisë mësimore, rezultateve të të nxënit, ishte pjesa më e dëshirueshme për ta identifikuar.

Mësimdhënia elektronike në distancë është sfiduar nga dy aspekte, (i) aspekti i parë ndërlidhet me nivelin e ngarkesës nga rrethanat e pandemisë, presionin kohor dhe kushtet teknike me të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit; (ii) ndërsa aspekti i dytë ndërlidhet me sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve, si dhe me shkathtësitë metodike, profesionale dhe pedagogjike të një numri mësimdhënësish.

## **Mundësitë e vazhdimit të mësimin në distancë/e-mësimin dhe nevojat për mbështetje**


Rrethanat në të cilat ka filluar mësimi në distancë tashmë dihen. Vazhdimi i organizimit të mësimin në distancë në Kosovë do të varet nga masat për siguri shëndetësore të shoqërisë kosovare, mënyra e jetesës dhe përditshmëria e gjithë bartësve të procesit të edukativo-arsimor, ku përfshihen edhe komuniteti i shkollës, nxënësit, mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe prindërit. Gjithsesi, vazhdimi i mësimin në distancë për një kohë më të gjatë pritet të reflektohet më ndryshe, kundrejt fillimit, mobilizimit, gatishmërisë për të kontribuar etj. Përvojat në muajin e parë mund të kenë ndikim pozitiv, mirëpo edhe sfidat dhe problemet e shfaqura, nëse nuk tejkalohen, pritet të sfidojnë në masë të madhe vazhdimin e realizimit me sukses të mësimin në distancë në këto kushte.

Për të analizuar mundësitë e vazhdimit të mësimin në distancë/e-mësimin dhe nevojat për mbështetje, për të gjithë respondentët e shkollës, kemi shtruar pyetje që lidhen me një vlerësim të përgjithshëm për situatën aktuale të mësimin në distancë/e-mësimin, për të parë mundësitë e vazhdimit, si dhe pyetje për përparësitë, përfitimet, problemet, pasojat, nevojat e për mbështetje në kushtet e organizimit të mësimin nga shtëpia dhe nevojat për mbështetje profesionale.

Në përgjithësi, nga i gjithë komuniteti i shkollës (rreth 80% e gjithë komunitetit të shkollës të përfshirë në studim) ekziston një vlerësim i përbashkët nga drejtorët e shkollave, mësimsdhënësit dhe prindërit se mësimi në distancë është një përvojë e re, që duhet përkrahur. Këtë e shprehin rreth 62% e mësimsdhënësve dhe rreth 54 % e prindërve. Të njëjtit, mbi 19% e mësimsdhënësve dhe rreth 25% prindërve, shprehin se mësimi në distancë është një mundësi shumë e mirë, që mund të shndërrohet në një formë standarde të mësimin në distancë. Përqindja tjetër e mësimsdhënësve dhe prindërve ndajnë mendimin se presin që ky modalitet i mësimsdhënies të përmirësohet, apo shprehin se kjo formë deri diku i ngjan mësimsdhënies, përkatësisht kjo formë fare nuk i ngjan mësimsdhënies. Në grupin e fundit hyjnë edhe rastet e familjeve me gjendje më të rënduar ekonomike, të cilët vlerësojnë që ky proces nuk po u ndihmon shumë, pasi që fëmijët e tyre vetëm se po e thellojnë pabarazinë e tyre dhe po mbesin mbrapa nxënësve të

tjerë, të cilët i kanë mundësitë e duhura të përcjelljes së mësimit në distancë. Drejtorët e shkollave, në intervista dhe pyetësorë të plotësuar, shprehin mendim të përafërt me mësimsdhënësit.

Në anën tjetër, nxënësit janë atë që kanë shpërndarje të mendimeve më ndryshe kundrejt subjekteve tjerë. Në përqindje më të vogël, apo rreth 33% e nxënësve ,shprehen se mësimi në distancë është një përvojë e re, që duhet përkrahur, rreth 29 % shprehen se mësimi në distancë është një mundësi shumë e mirë, që mund të shndërrohet në një formë standarde të mësimit në distancë, ndërsa pjesa tjetër, rreth 36 %, ndajnë mendimin se presin që ky modalitet i mësimsdhënies të përmirësohet, apo se kjo formë deri diku i ngjan mësimsdhënies, përkatësisht kjo formë fare nuk i ngjan mësimsdhënies.



Grafiku 23. Vlerësimi i përgjithshëm për situatën aktuale të mësimit në distancë

Pra, vlerësimet tregojnë se mësimi në distancë, gjegjësisht kjo qasje e mësimsdhënies në këto rrethana, është alternativë e vetme, që duhet përkrahur nga të gjithë, në mënyrë që të këtë më pak probleme dhe pasoja për brezin e ri dhe të ardhmen e tyre. Gjithashtu, vlerësimet tregojnë se këtë përvojë duhet shfrytëzuar për ta konsoliduar dhe avancuar, në mënyrë që në të ardhmen mësimi në shkolla të plotësohet edhe me mësime online të formave standarde, të cilat sigurojnë cilësi në procesin e të nxënësve.

Duke menduar skenarin që viti mësimor/shkollor duhet të përfundojë përmes mësimin në distancë, pa kushte dhe mundësi që të kthehet procesi mësimor në shkolla, për drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës u shtrua pyetja në vijim: Në kushtet e qëndrimit në shtëpi, nëse do të vendoset që deri në fund të vitit shkollor të mbahet vetëm mësimi në distancë/e-mësimi, për çfarë do të kishit nevojë? Kërkesat e tyre, në mënyrë të veçantë kërkesat e mësimdhënësve, lidhen me mjetet punës, gjegjësisht sigurimin e laptopit si një mjet efikas për punën me nxënës në kushtet e shtëpisë (mbi 53% e mësimdhënësve), krijimin e mjedisit më të përshtatshëm për mësim në distancë/e-mësim, si (rreth 41% e mësimdhënësve) dhe për koordinim më të mirë me aktivin profesional (rreth 48% e mësimdhënësve). Në rrethanat kur nuk mund të plotësohen të gjitha këto kërkesa, bazuar në një analizë të gjendjes së përgjithshme për sigurinë shëndetësore, duhet analizuar mundësitë e hapjes së shkollave vetëm për mësimdhënës, në mënyrë që pajisjet në shkolla (kompjuteri, laptopi, interneti) dhe hapësira shkollore të shfrytëzohen për mësim në distancë me nxënës. Në kushtet e punës në shkollë mund të sigurohet edhe një koordinim më i mirë në mes të aktiveve profesionale, për detyrat drejtuar nxënësve dhe aspektet tjera që lidhen me mësimin në distancë.

Në anën tjetër, nevojat e komunitetit shkollor për mbështetje profesionale janë të shumta dhe specifike, sipas rolit të tyre. Kështu, nxënësit dhe prindërit shprehen se kanë nevoje më shumë për (i) mbështetje përmes publikimit të materialeve mësimore (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje) në një platformë ku kemi qasje të gjithë dhe është e lehtë për përdorim; (ii) informata kthyesë nga mësimdhënësit për detyrat e bëra nga nxënësit, si dhe (iii) g) dërgimin e përmbajtjeve mësimore dhe detyrave nga mësimdhënësit përmes e-mailit ose platformës online, që nxënësit/fëmijët i përdorin më lehtë. Një përqindje relativisht e madhe e prindërve (rreth 32%) kërkojnë të mbështeten me udhëzime për prindër lidhur me punën që ata duhet ta bëjnë me fëmijë gjatë mësimin në shtëpi.

Informatat kthyesë nga mësimdhënësit për detyrat e bëra nga nxënësit janë alternativë e rëndësishme së veçantë në kushtet e mësimin në distancë, përmes së cilave sigurohen mbështetja e të nxënësve, motivimi për mësim dhe nxitja për angazhim të mëtejshëm gjatë mësimin në distancë. Platforma

online “Edukimi në distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç“ është një mundësi e mirë për edukimin në këtë nivel. Përvoja e ndjekur me zhvillimin e kësaj platforme duhet ndjekur edhe për zhvillimin e platformave në nivelet tjera të arsimit parauniversitar.

Edhe mësime të mësuara (mbi 54%) dhe drejtuesit e shkollave shprehin mendimin se kanë nevojë për materiale mësimore të lidhura me kurrikulën e re (video-ligjërata, ilustrime, udhëzime, ushtrime, detyra, pyetje), që mund të publikohen në një platformë që kanë qasje të gjithë dhe është e lehtë për përdorim. Kërkesë tjetër e shprehur nga pjesa më e madhe e mësime të mësuara (rreth 52%) dhe e drejtorëve të shkollave është mbështetja e tyre gjatë kësaj kohe me trajnime dhe udhëzime për të përdorur platforma online. Publikimi në faqen zyrtare të MASHTI-it i udhëzimeve për përdorimin e platformës Zoom-zoom.us është një hap i mirë, që duhet të përcillet edhe me trajnime të mësime të mësuara në metodologji të mësimdhënies për mësim në distancë dhe për përdorim të platformave mësimore online dhe aplikacioneve të tyre.

Kërkesë e veçantë e mësime të mësuara (mbi 71% ) dhe drejtuesve të shkollave është mbështetja me udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë. Kjo kërkesë tashmë është plotësuar nga MASHTI dhe mbetet të shihet se sa mësime të mësuara dhe drejtuesit e shkollave u përmbahen parimeve dhe rekomandimeve të vendosura në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë. Për këtë nevojitet informim dhe këshillim i mësime të mësuara dhe drejtuesve të shkollave.

Duhet cekur edhe dy-tri aspekte të ngritura nga përfaqësuesit e komunitetit shkollor dhe përfaqësuesit e institucioneve arsimore të nivelit qendror dhe lokal, lidhur me përparësitë, përfitimet, problemet dhe pasojat që mund të shfaqen si rezultat i mësimin në distancë, në këto rrethana.

Është e rëndësishme që të theksohet se respondentët e komunitetit të shkollës kanë krijuar një bazë të të dhënave me mendimet e tyre për përparësitë e mësimin në distancë në këto kushte, përfitimet, por edhe për problemet dhe pasojat. Idetë e tyre për përparimet dhe përfitimet janë një bazë e mirë, e cila duhet të shërbejnë si motivim për të gjithë që janë duke kontribuar dhe po kontribuojnë këto ditë që të realizohet mësimi në distancë.

Ndër përparësitë që veçohen janë: sistemi është mbajtur gjallë në të gjitha nivelet e tij, po sigurohet kontinuiteti i vitit mësimor/shkollor, fokusimi në mirëqenien e nxënësve dhe për të bërë atë që mund të bëhet në këto rrethana, mobilizimi i shkollave dhe DKA-ve është mbi të pritjet, ndërsa prindërit e kanë tejkaluar vetveten, shfrytëzimi i teknologjisë në mësimdhënie ka filluar të masivizohet, pavarësisht sfidave etj.

Përfitimet shihen në njohjen më të madhe të realitetit për sistemin, shkathtësitë e përdorimit të teknologjisë, mundësitë që ofron mësimi në distancë, njohja më e madhe e rolit që mësimdhënësit dhe prindërit. Sipas Jonathan Zimmerman (2020), mësimi në distancë në këto rrethana nuk është eksperiment në edukim. Është testim/provim i demokracisë sonë, gjithashtu (Insidehighered, 2020). Ky testim duket të jetë për të gjitha sistemet arsimore, pra edhe për sistemin tonë arsimor, mundësia për të reflektuar.

Mësimi në distancë në këto rrethana do të ketë edhe probleme dhe pasoja. Sipas të gjeturave të këtij studimi, ato lidhen me krijimin e distancës sociale si faktor i pazëvendësueshëm në mësimdhënie dhe nxënie, zvogëlimin e shprehisë së punës dhe të orarit të mësimi, cilësinë e qasjes së mësimdhënies në këto rrethana, mungesën e teknologjisë te mësimdhënësit dhe te nxënësit (familjet), mungesën e kushteve shkollore në shtëpi, mospjesëmarrjen në mësim e fëmijëve nga familjet me kushte të rënduara dhe atyre të grupeve të marginalizuara.

Problemet e ngritura dhe paralajmërimet për pasojat e mundshme, po ashtu, janë një bazë e të dhënave, të cilat duhet të përdoren për analiza dhe ndërmarrjen e masave të menjëhershme, që mundësojnë tejkalimin e problemeve kryesore dhe minimizimin e pasojave për fëmijët tanë dhe për sistemin arsimor në përgjithësi.

E rëndësishme është vënia në spikamë e mësimi nga kjo situatë, pasi secili mësimdhënës duhet të mendojë për rëndësinë që ka teknologjia në situata të këtilla dhe për rolin e tij/saj gjatë mësimi në distancë. Por, gjithashtu, sa e rëndësishme është teknologjia edhe në situata normale, kur shfrytëzohet në mësimdhënie. Ndërsa, institucionet duhet të përgatiten për integrimin e mësimi online në sistemin arsimor të Kosovës.





## Referencat

1. Qeveria e Republikës së Kosovës (11 mars 2020). *Vendim për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet...*, <https://kryeministri-ks.net/dokumente/page/3/>
2. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 a). *Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë*, [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti_1.pdf)
3. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 b). *Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta (SHML)*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf)
4. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 c). *Udhëzime për DKA për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf)
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 d). *Përdorimi i platformës Zoom – Zoom – us*. [https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf)
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 e). *Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimin në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta*. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 f). *Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë*, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020 g). *Vendimi 25/01B për procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë*. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne->

[distance-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf](#)

9. Faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për mësimin në distancë-e-mësimi , <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi> dhe platforma e-mësimi në kanalën e MASHTI-t në ‘YouTube’ <https://emesimi.rks-gov.net/shq/>
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë .(2013). Udhëzimi administrativ nr. 23/2013 për Qendrat Burimore.
11. Banka Botërore (BB1, 2020). “Si po e përdorin shtetet teknologjinë arsimore për të përkrahur mësimin në distancë gjatë pandemisë COVID-19” - Banka Botërore, 2020  
<https://www.worldbank.org/en/topic/edutech/brief/how-countries-are-using-edtech-to-support-remote-learning-during-the-covid-19-pandemic>, (qasur më 24.04.2020).
12. Banka Botërore (BB2, 2020). Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID0-19, versioni i 17 prillit 2020, Banka Botërore  
<http://documents.worldbank.org/curated/en/659411587145759242/pdf/Rapid-Response-Guidance-Note-Educational-Television-COVID-19.pdf>, (qasur më 23.04.2020)
13. Banka Botërore (BB3, 2020). Udhëzues mbi mësimin në distancë & COVID19, versioni i 7 prillit 2020, Banka Botërore  
<http://documents.worldbank.org/curated/en/531681585957264427/pdf/Guidance-Note-on-Remote-Learning-and-COVID-19.pdf>, (qasur më 23.04.2020)
14. (EDU.AUSTRALIA, 2020) Portal online i Ministrisë së Arsimit të Australisë dedikuar mirëqenies dhe sigurisë gjatë mësimin në distancë <https://studentwellbeinghub.edu.au/>, (qasur më 23.04.2020)
15. EU CROATIA (2020). Implikimet e koronavirusit të ri (COVID-19) në arsim dhe trajnime: Gjendja në shtetet anëtare (Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training: State-of-play in Member States), Presidenca Kroate e Këshillit të Bashkimit Europian, Versioni i 9-të i 31.03.2020
16. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (GOV.UK1, 2020). Udhëzime për prindër dhe kujdestarë për përkrahjen e shëndetit mendor dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve gjatë pandemisë së COVID-19, Qeveria e

Mbretërisë së Bashkuar, Versioni i 21 prillit 2020

<https://www.gov.uk/government/publications/covid-19-guidance-on-supporting-children-and-young-peoples-mental-health-and-wellbeing/guidance-for-parents-and-carers-on-supporting-children-and-young-peoples-mental-health-and-wellbeing-during-the-coronavirus-covid-19-outbreak#helping-children-and-young-people-cope-with-stress>, (qasur më 24.04.2020)

17. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar (GOV.UK2, 2020) Faqja zyrtare e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, <https://www.gov.uk/government/news/new-major-package-to-support-online-learning>, (qasur më 24.04.2020)
18. Insidehighered (2020). “A do të ndihmojë apo lëndojë mësimin online kalimi i pjesës më të madhe në mësim në distancë” – Përmbledhje e panelit të ekspertëve - <https://www.insidehighered.com/digital-learning/article/2020/03/18/most-teaching-going-remote-will-help-or-hurt-online-learning>, (qasur më 24.04.2020)
19. (Theconversation, 2020) “Shkollat janë duke lëvizur drejt mësimin online, por jo të gjithë fëmijët e kanë nisjen e barabartë digjitale” – Artikull akademik <https://theconversation.com/schools-are-moving-online-but-not-all-children-start-out-digitally-equal-134650>, (qasur më 23.04.2020)
20. UNESCO (2020) Motivimi i fëmijëve gjatë mësimin nga shtëpia, UNESCO 2020, <https://en.unesco.org/news/resources-parents-and-teachers-motivating-supporting-children-during-remote-learning>, (qasur më 22.04.2020)
21. (Varkey, 2018) “Cilësia e mësimdhënësve efektivë të fëmijëve të grupeve të marginalizuara”, Raport Hulumtues, Varkey Foundation, 2018 [https://www.varkeyfoundation.org/media/4508/qualities-of-effective-teachers-who-teach-disadvantaged-students\\_4.pdf](https://www.varkeyfoundation.org/media/4508/qualities-of-effective-teachers-who-teach-disadvantaged-students_4.pdf), (qasur më 22.04.2020)
22. Banka Botërore. (2020). Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID0-19, versioni i 17 prillit 2020 <http://documents.ëorlbank.org/curated/en/659411587145759242/pdf/Rapid-Response-Guidance-Note-Educational-Television-COVID-19.pdf>
23. Caritas Switzerland in Kosovo, (2020). Rutina ditore në ambientet e shtëpisë: prindër-fëmijë, <https://drive.google.com/file/d/1soHM07MT7fCDkz7rAEge1dIHBSi3E25j/view>

24. Carroll, A., Forlin, C. dhe Jobling, A. (2003) Ndikimi i trajnimit të mësuesit në arsimin e posaçëm të qëndrimet e arsimtarëve të përgjithshëm australianë përpara emërimit në detyrë kundrejt njerëzve me aftësi të kufizuara. Revista trimestrale për arsimin e mësuesve, 30 (3), 65-79
25. Eric A. Hanushek & Ludger Wößmann (2007). Education Quality and Economic Growth. The World Bank Washington, DC.  
<http://hanushek.stanford.edu/sites/default/files/publications/Hanushek%20Woesmann%202007%20Education%20Quality%20and%20Economic%20Growth.pdf>
26. France, P. (2020). 3 Tips for Humanizing Digital Pedagogy, 2020,  
<https://www.edutopia.org/article/3-tips-humanizing-digital-pedagogy>
27. Handikos, (2020). Një listë e aktiviteteve që prindërit mund t'i bëjnë bashkë me fëmijët e tyre në shtëpi, <http://www.handikos.org/sq/Njoftime/Nje-liste-e-aktiviteteve-qe-prinderit-mund-ti-bejne-bashke-me-femijet-e-tyre-ne-shtepi-494>
28. Lleshi, K. & Sylhasi, V. (2017). FËMIJËT TANË - Udhëzues praktik për prindër dhe mësues. Qendra për Arsim e Kosovës. Prishtinë.  
<http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/06/C-2.1-F%C3%ABmij%C3%ABt-Tan%C3%AB-Udh%C3%ABzues-praktik-p%C3%ABr-prind%C3%ABr-dhe-m%C3%ABsimdh%C3%ABn%C3%ABs-05.pdf>
29. Metodat jo të dhunshme të disiplinës,  
<https://suzukiasociation.org/news/25-nonviolent-discipline-options/>,
30. Ndihmojuni fëmijëve tuaj të mësojnë,  
[http://www.prvite5.mk/content/pdf/DOC\\_Pomognete%20im%20na%20svoite%20deca\\_ALB%20web.pdf](http://www.prvite5.mk/content/pdf/DOC_Pomognete%20im%20na%20svoite%20deca_ALB%20web.pdf)
31. Plakolli, Z, Aliu-Gashi, M. (2016), Bashkëpunimi edukator-prind në institucione parashkollore në Kosovë, Instituti Pedagogjik e Kosovës, Prishtinë.
32. Thompson, K. & al.(2014). Effective Strategies for Engaging Parents in Students' Learning to Support Achievement, Maine Education Policy Research Institute,  
[https://usm.maine.edu/sites/default/files/cepare/Effective\\_Strategies\\_for\\_Engaging\\_Parents\\_in\\_students\\_Learning\\_to\\_Support\\_Achievement.pdf](https://usm.maine.edu/sites/default/files/cepare/Effective_Strategies_for_Engaging_Parents_in_students_Learning_to_Support_Achievement.pdf),

33. Unicef, mars 2020, Udhëzues për prindërit me fëmijë të vegjël, <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-prind%C3%ABrit-me-f%C3%ABmij%C3%AB-t%C3%AB-vegj%C3%ABl>,
34. Zymeri, T. (2017). Udhëtimi nëpër internet - Udhëzues për prindër. Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/lib03-udhezuesi-per-prinder.pdf>

**Botues**  
Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Shtypi**  
Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37(496.51)

Mësimi në distancë /e-mësimi në arsimin  
parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara  
nga pandemia COVID-19 / udhëheqës i projektit  
hulumtues Selim Mehmeti. - Prishtinë : Instituti  
Pedagogjik i Kosovës, 2020. - 275 f.: ilustr.; 24 cm.

1.Mehmeti, Selim

**ISBN 978-9951-591-51-5**

